

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

BIBLIOTEKA E NXENESIT

ALI ABDIHOXHA



NJË VDESHTË  
ME STUHË  
FORTË

SHTËPIA BOTUESE  
E LIBRIT SHKOLLOR

891.983 - 31

BIBLIOTEKA E NXENËSIT

8SH-31 ALI ABDIHOXHA  
A 14

R

# NJË VJESHTË ME STUHI

Roman



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR  
TIRANE, 1980

Përgatitur pér botim me parathenie  
nga Hysen Sinani

ЭТ НЕ МЕ СИНА

п а м о я

БИБЛІОТЕКА Університету ім. Яна Казимира

## **ROMAN PËR UNITETIN E POPULLIT RRETH KOMUNISTËVE**

Tema e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si momenti më i rëndësishëm në historinë e popullit tonë, është më e lëvruara në letërsinë dhe artet tona të realizmit socialist. Edhe romani «Një vjeshtë me stuhinë shkrimtarit Ali Abdiroxha trajton këtë temë të rëndësishme, duke pasqyruar një pjesë të luftës së madhe të popullit tonë për çlirimin e tij kombëtar dhe shoqëror.

Ngjarjet në roman, siç e tregon edhe titulli i veprës, zhvillohen në vjeshtën e vitit 1943. Lufta e vendosur e popullit tonë, e bijve dhe bijave të tij partizanë të udhëhequr nga Partia, kundër pushtuesve fashistë sa po ka përfunduar me fitoren e plotë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Italia fashiste është e detyruar të kapitullojë. Por vendin e saj, si pushtuese, e zë një armik tjetër më i fuqishëm dhe më i egër, Gjermania naziste. Lufta kundër këtij armiku të ri të përbindshëm është një provë e vërtetë guximi dhe sakrifice për popullin dhe komunistët, që qëndrojnë në ballë të tij.

Në këto kushte të reja, pati edhe njerëz që u lëkundën, pati nga ata që u trembën, pati, sidomos, një propagandë të shfrenuar nga organizatat reaksionare të vendit, që e quanin si të marrë dhe të pamundur luftën e popullit dhe të Partisë kundër këtij pushtuesi të përbindshëm. Por populli s'u dha, sepse në krye kishte një parti të paepur, luftarake, heroike, që e udhëhiqnin komunistë të sprojuar... Shpejt, armiqtë e huaj, trädhta-

rët e vendit, të tremburit e të lëkundurit do të mësonin për forcën gjigante të popullit dhe të bijve të tij komunistë, për shpirtin e pamposhtur të tyre. Këtë forcë të madhe shpirtërore, këtë shpirt të paepur të popullit dhe të komunistëve na sjell edhe autori përmes faqeve të romanit të tij.

Në qytetin e Elbasanit, si kudo në Shqipëri, pushtesit gjermanë nisin të ngrenë zyrat dhe burgjet e tyre, që do t'u duhen për shqyrtimin dhe shfarosjen e komunistëve. Të ndihmuar nga forcat reaksionare të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit, ata mendojnë se puna e tyre për pastrimin e këtij qyteti të vogël nga komunistët do të jetë çështje ditësh për ta. Por llogaritë i kanë bërë keq, sepse populli dhe komunistët nuk i presin ata duke fjetur në shtëpitë e tyre, por me plumbin ballit. Si kudo në Shqipëri, Partia Komuniste Shqiptare ka organizuar planet e saj të sulmeve të rrufeshme dhe vazhdon, nën hundën e gjermanëve, të mobilizojë masat, sidomos të rinjtë, për shtimin e radhëve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, organizon shpërndarjen e trakteve, të shtypit të saj, aksionet e guximshme të ilegalëve etj. Ndërmjet shumë të tjera, si përfaqësues të komunistëve që mbartin peshën kryesore të luftës kundër pushtuesit të huaj në këtë qytet, janë Lumto Gjinari dhe Petrit Guraj. Lidhjet e tyre féminore me Qamil Tapinë, komunistin herë-herë të lëkundur, dhe Nazmi bej Topin, tradhëtarin dhe armikun e betuar të komunizmit, duke marrë një raport të ri në kushtet e luftës së ashpër kundër pushtuesve dhe shfrytëzuesve të bashkuar me ta, përbëjnë bazën e subjektit të romanit. Lumta, Petriti, Qamili dhe Nazmiu kanë qenë shokë të një klase. Pak kohë para pushtimit të vendit nga fashistët italianë, ata janë të rinj që kanë filluar të mendojnë më gjërë për jetën. Të tre djemtë kanë rënë në dashuri me Lumtën. Por ajo nuk mund t'i dashurojë që të tre, edhe pse për seicilin prej tyre ndien simpati. Nazmiu është i egër dhe mendjemadh (si bir beu që është), kurse Qamili (bir avokati) është i ftohtë dhe me një natyrë të tillë që s'e kuption kurrë në është i gjëzuar a i zemë-

ruar. Ndaj, për Lumton, njeriu i saj më i ëndërruar është Petriti, punëtori i fabrikës së duhanit, djali i urtë dhe i menduar si një burrë i madh. Pushtimi fashist, qëndrimi që duhej mbajtur ndaj tij, si detyrë e qdo qytetari të ndershëm, krijoi ndryshime në jetën e të rinjve. Nazmi bez Topi veshi uniformën e pushtuesit dhe u shkëput nga shokët e tij, nga Petriti që ishte bërë një komunist i flaktë, nga Qamili, që edhe ai kishte përqafuar Lëvizjen Antifashiste Nacionalçirimitare, dhe nga Lumta, tanimë ilegale sypatrembur. Kështu që dashuria e tij për Lumtën s'mund të kishte më asnje shpresë. Megjithatë, Nazmi beu nuk heq dorë. Ai arrin deri atje sa ta arrestojë vajzën dhe të kërkojë prej saj që të braktisë luftën, idetë e saj komuniste dhe të bëhet gruaja e tij. Por, me gjithë premtimet e tij për një jetë të lumtur e të pasur, me gjithë lutjet e tij, me gjithë, më në fund, kërcënimet e vrazhda që zbulojnë karakterin e tij të ulët, Lumto Gjinari nuk e tradhton kauzën e popullit, të Partisë e të revolucionit, nuk tradhëton veten, si një e re e denjë për emrin e lartë të komunistes, të luftëtares të së resë. Ndërkohë, duke dashur që ta largojë të birin me çdo kusht nga lufta, i ati i Qamilit, Demir Tapia, i cili është bërë shkak që të arrestohet Lumta, duke spiunuar në gestapo babanë e saj, bëhet përsëri shkaktar i arrestimit të Petrit Gurajt bashkë me të birin, të cilët bien në duart e armiqve pas një qëndrese heroike. Arrestimi i të birit e bën avokat Demirin të futet edhe më thellë në llumin e spiunllëkut, duke menduar se me këtë akt të ulët do të mund ta shpëtonte të birin nga kthetrat e nazistëve. Por gabohet rëndë. Po kështu gabohen në llogaritë e tyre edhe pushtuesit gjermanë, që mendojnë se me kapjen e disa komunistëve, dhe duke u përpjekur që ata të tregojnë bazat e tyre sekrete, do të mund të zbulonin e të asgjësonin Partinë Komuniste dhe krejt Lëvizjen Nacionalçirimitare. Por ata as që mund ta merrnin me mend forcën e popullit dhe të komunistëve.

Jeta vazhdon edhe pas arrestimit të Petritit, Qamilit dhe Lumtos; aksionet e ilegalëve nuk pushojnë në qytet,

lufta vazhdon edhe më e ashpër, urejtja e popullit për pushtuesit nazistë bëhet edhe më e madhe. Nënë Dana mjekon Markun, komunistin e plagosur, dhe mëson të qëllojë me pushkë; Vasil Gjinari, babai i Lumtos, u mëson vajzave të reja, që zakonet dhe regjimi i mbanin të mbyllura në mes të katër mureve, gjuhën shqipe, atje, në shtëpinë e Muratit, nën hundën e esesëve; Usta Dine Çeliku shkon deri lart në male për të rregulluar armët e partizanëve; të rinjtë ilegalë hyjnë e dalin nëpër qytet me misione të caktuara partie; nëpër rrugë traktet e afishuara bëhen më të shpeshta; në majë të selvisë më të lartë, në qendër të qytetit, valëvitet flamuri shqiptar. Të gjitha këto i bëjnë pushtuesit e huaj të tërbohen nga zemërimi dhe bashkëpunëtorët e tyre, tradhtarët e kombit, të tmerrohen nga hakmarrja e popullit. Kjo frikë i hyn thellë në palcë edhe Nazmi bej Topit, që, pasi ka lyer duart me gjakun e popullit, e, madje, edhe me atë të Lumtos, në një përpjekje qesharake e plot urejtje për të shqyer flamurin e lirisë në majën e selvisë, gjen vdekjen, si një njeri krejtësisht i dështuar, i përbuzur dhe i urryer nga populli. Po këtë fund ka edhe Demir Tapia, që çmendet kur merr vesh se të birin ia kanë vrarë; shkaktar për vrasjen e të birit është vetë ai që, duke dëshëruar të mbetet asnjanës, u kthyen në një spiun, në një vegël të pushtuesit dhe në një viktimë të tij. Pas largimit edhe të ordinancë Qazimit nga detyra prej shërbëtori, i penduar për bashkimin e tij me pushtuesit dhe tradhëtarët, romani mbaron me grupin e vogël të komunistëve ilegalë që ngjitin të përpjatat e para të malit, për të shkuar te shokët e tyre partizanë.

Në këtë roman, që pasqyron luftën e popullit dhe ilegalëve në një qytet të Shqipërisë kundër pushtuesve të huaj dhe tradhëtarëve të brendshëm, kontradiktat antagonistë zbulohen nga shkrimitari përmes episodeve të shumta mbi të cilat është ngritur edhe vepra. Në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kontradikta antagonistë kryesore ishte ndërmjet Partisë e popullit nga njëra anë, dhe pushtuesit të huaj nga ana tjetër. Edhe në roman theksi vihet në këtë kontradiktë. Që në

faqet e para, pushtuesi i huaj, i përfaqësuar me major Francin dhe personazhe të tjera, zbulon synimet e tij shkatërruese pér Partinë Komuniste dhe skllavëruese pér popullin. Këtyre synimeve u kundërvihen me pushkë dhe me fjalë komunistët, mbarë populli, që kërkon të fitojë lirinë dhe pavarësinë e tij, pér të cilat ka ëndërruar e luftuar shekuj pas shekujsh. Në zhvillim të kësaj kontradikte, edhe pse në roman konflikti kryesor nuk zgjidhet përfundimisht, lihet të kuptohet në mënyrë të qartë që disfata është e pashmangshme pér armikun, që fitorja është e popullit dhe e komunistëve. Me këtë kontradiktë me pushtuesit e huaj ndërthuret edhe kontradikta tjetër antagonistë me armikun e brendshëm, spiunë e tradhëtarë të bashkuar me pushtuesit. Nazmi bij Topi është mbartësi më tipik i kësaj kontradikte në këtë roman. Duke qenë bir beu, e aq më tepër nga ata pasanikë që u ripërtërinë gjatë pushtimit fashist, ai jo vetëm është shfrytëzues, por edhe tradhëtar i interesave të Atdheut. Si i tillë ai nuk mund të bashkohet me forcat patriotike e revolucionare kundër okupatorëve, të cilët, duke i krijuar kushte të reja përfitimi, kënaqin interesat e tij prej shfrytëzuesi të pangopur. Ai, pra, nuk ka rrugë tjetër veç kursit të tij tradhtar, ndaj është i dënuar me vdekje nga populli, si dhe pushtuesi i huaj.

Nëpërmjet zbulimit, trajtimit dhe pasqyrimit të këtyre kontradiktave, si dhe të personazheve që i mbartin ato, shkrimitari shpreh ide mjaft të rëndësishme. Që një popull të fitojë lirinë dhe pavarësinë kombëtare, duhet të udhëhiqet në luftë nga bijtë e tij më të denjë. Lufta jonë Antifashiste Nacionalçlirimtare udhëhiqej nga komunistët, që, të dalë nga radhët e klasës punëtore, të fshatarësissë dhe të inteligjencës patriote, nuk i humbën lidhjet me popullin, por i forcuan edhe më shumë, i bënë të pazgjidhshme në dallgët e luftës së përgjakshme çlirimtare. Kjo lidhje e ngushtë e komunistëve me popullin është e tillë që habit edhe pushtuesin e huaj, i cili e sheh të pamundur depërtimin në organizatat ilegale të komunistëve, sepse kudo populli di t'i fshehë ata në gji të tij. Ai i mbron dhe i strehon luftëtarët e tij,

sepse ka besim tek ata, sepse është i bindur që ata luftojnë për çlirimin e tij, për të ardhmen e tij të ndritur. Në roman shprehet qartë gjithashtu ideja se luftën e bën populli, punëtorët dhe fshatarët të bashkuar rrëth partisë së tyre, se, pa këtë bashkim të forcavë popullore, s'mund të ketë fitore. Një ide tjetër e rëndësishme, që theksohet në disa episode të romanit, është edhe ajo e qendresës së pamposhtur të komunistëve. Të kaititur nga Partia e tyre Komuniste, ata s'duan t'ia dinë nga asnjë vështirësi, as nga torturat çnjerëzore dhe as nga premtimet e gjithëfarshme të armikut; mbi idealin e madh komunist ata nuk vënë as jetën e tyre të re. E tillë është qëndresa e Lumto Gjinarit, e Petrit Gurajt e, bile, edhe e Qamil Tapisë, që vdes nga torturat e nazistëve gjermanë, duke përbuzur paratë e babait si shkëmbim për tradhëtinë ndaj çështjes së madhe të At-dheut.

Romani «Një vjeshtë me stuhi», si një vepër e shquar e prozës sonë të realizmit socialist që trajton temën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ka mjaft personazhe me psikologji të pasur e që janë përfaqësuese të shtresave të caktuara shoqërore. Ato, kryesisht, i përkasin dy kampeve ndërluftuese, dy botëve: njërsë që po ngrihet e fuqishme, e re, e zjarrtë, dhe tjetrës që po shembet. Personazhet që përfaqësojnë këtë botë të re, luftëtarët e së ardhmes së ndritur, janë përshkruar me dashuri nga autori; ata kanë forcën e rinisë, shpirtin e sakrificës, moralin e shëndoshë, karakterin e qëndrueshmë, mendjen e ktnjellët dhe idealet e larta komuniste që i bëjnë të pamposhtur.

Lumto Gjinari është një nga figurat më të realizuara të luftëtares në romanin tonë me temë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare. Bijë e një mësuesi patriot, ajo ka një dashuri të madhe për Atdheun. Ajo është vajzë e bukur, por edukata e mirë e ka bërë atë që të mos e shohë veten vetëm si një stoli. Ndaj, duke u lidhur me shokët e saj komunistë, ajo, si një vajzë e ndërgjegjshme për rolin e saj të rëndësishëm në luftën e popullit kundër okupatorit të huaj, i kushtohet krejtë-

sisht çështjes së madhe të Atdheut dhe të revolucionit popullor. Lumto Gjinarin shkrimtari nuk na e jep vetëm si luftëtare. Ajo edhe dashuron Petritin, por dashuria e saj nuk është e ngushtë. Ajo lidhet tanimë me fatin e luftës, të revolucionit, lidhet me idetë e saj komuniste. Dashuria është për të një nxitje për të qenë më e palodhur në punën agitative me vajzat e qytetit, për të qenë më e guximshme në aksionet e njësitet gueril ku bën pjesë, për të qenë më e lumtur që vdes për një çështje aq të madhe, së cilës i dhuron jo vetëm jetën, por edhe dashurinë e saj. Lumtua tregon vetëm një shenjë dobësie para armikut, pranon njëfarë marrëveshjeje me të, por që pendohet më pas dhe e shlyen me vendosmërinë e saj të patundur. Dhe kjo dobësi është aq sa ajo mund të bënte në castet e fundit të jetës së saj për njeriun që e donte aq shumë, për shokun e saj të armëve, Petritin, i cili arratiset nga burgu për të vazhduar rrugën e revolucionit, èndrrën e vajzës tri-me që sakrifikohet për kauzën e madhe të popullit.

Petriti, si përfaqësues i njeriut të ri, i rritur në mes revoltës së klasës punëtore të shfrytëzuar deri në palcë dhe i formuar në flakët e luftës, është tipi i komunistit. të vërtetë që i ka dalë për zot, si shumë të tjerë, fatit të Atdheut dhe çështjes së revolucionit popullor. Ai është i matur, i fuqishëm, si punëtor që është, dihe i papërkulur para vështirësive. Qëndrimi që mban ai përpëra armiqve, përpëra torturave është i rrallë, i tillë që vetëm një njeri i mbrijtjatur me ideale të larta, vetëm një revolucionar i bindur për drejtësinë e ideve të tij mund ta ketë. Petrit Gurajn shkrimtari e ka pëershkuar me ngjyrat më njerëzore. Ai e paraqit atë të thjeshtë, të afërt e të dashur me shokët e tij, të lidhur ngushtë me njerëzit e thjeshtë të popullit dhe të urtë e të arsyeshëm me nënën e tij, sidomos kur ajo shfaq shenja të pandërgjegjshme të lëkundjes, kur i thotë të birit se mjaft ka luftuar. Por Petriti, brenda karakterit të tij, është tjetër njeri me armiqtë e popullit e të partisë së tij, me pushtuesit e huaj dhe tradhtarët e Atdheut. Fjalët e tij të mprehta plot zgjuarsi

dhe ironi therëse i bëjnë ata ta humbin durimin, ta flakin tej demagogjinë dhe hipokrizinë, duke treguar kështytyrën e tyre të vërtetë prej njerëzish të prishur, kthyer në kriminelë të paskrupull, qëllimi i vetëm i cilëve është vrasja, sklavërimi dhe shkatërrimi i popujve, i gjithshkaje që këta kanë ngritur me gjak dhënjersë. Triumfi moral i Petrit Gurajt mbi armiqjtë, pushtues e tradhtarë, është triumfi i shqiptarit patriot ndaj qëndrimit të Atdheut e të popullit, është triumfi i moralit komunist mbi atë nazist. Nëpërmjet dialogut Petrit-Franc, shkrimitari shpreh edhe një herë forcën e madhe të komunistëve, shpreh idenë se fitorja është e shpejtë dhe e sigurt në anën e tyre, sepse ata luftojnë për popullin dhe kanë mbështetjen e popullit. Kësaj ideje i shërbejnë edhe një figura të tjera pozitive të romanit, si nënë Dana, Vasil Gjinari, Dine Celiku etj.

Nënë Dana, e éma e Petrit Gurajt, e do Atdheun dhe e mbështet luftën e «djemve», edhe pse ajo nuk e ka kuptuar thellësishët çështjen për të cilën ata luftojnë. E shtyrë nga fjalët e Demir Tapisë, e nxitur nga shqetësimi për jetën e të birit, ajo, për një çast, bie në pozitat e nënës pacifiste. Por, shpejt, jo vetëm kuption që vazhdimi i luftës kundër pushtuesve gjermanë është i domosdoshëm për çlirimin e vendit, por arrin deri atje sa të marrë pjesë aktivisht në këtë luftë dhe të hedhë pushkën krahut për të dalë malit bashkë me djemtë. Po kështu vepron edhe Vasil Gjinari, babai i Lumtos, por me një ndryshim. Si përfaqësues i intelektualëve patriotë e revolucionarë, pranë pushkës ai mban edhe penën, që e ka shoqëruar kurdoherë shqiptarin e etur për liri dhe dituri. Qëndrimi burrëror para humbjes të së bijës e rrit edhe më figurën e tij, duke e bërë një personazh tipik, që përgjithëson me forcë artistike ata mësues patriotë që nuk kursyen asgjë për Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Ndërsa usta Dine Celiku, si përfaqësues i shtresave të varfëra të popullit, duke u bashkuar me dy figurat e para, si edhe me atë të Muratit, plotëson atë grup personazhesh pozitive, që i lejon shkrimitarit të shprehë idenë e rën-

dëshishme të unitetit të brezave, pa të cilin fitorja e revolucionit është e pamundur ose provizore.

Në përshkrimin e tipave e të karaktereve në këtë roman, meritë e shkrimitarit është depërtimi në rrënjet sociale të personazheve. Duke i marrë ata nga një shtresë e caktuar shoqërore dhe duke i vendosur në raportet e reja që ka krijuar Lufta, ai zbulon shkaqet e qëndrimeve të njërit a të tjetrit personazh, për të arritur kështu në krijimin e figurave me forcë përgjithësuese, tipizuese. Në këtë drejtim, si një figurë komplekse, me botë të ndërlikuar shpirtërore, ku ndikojnë disa faktorë psikologjikë, edukativë dhe botëkuptimorë, është edhe figura e Qamil Tapisë. Si një bir avokati, ai është rritur me të mira, nuk ka njojur shtypjen dhe shfrytëzimin feudo-borgjez. Si një patriot dhe njeri me ide përparimtare, ai nuk e duron pushtimin fashist dhe bashkohet me popullin e Partinë për ta luftuar atë. Por lufta është e gjatë dhe e vështirë, presioni i babait të tij për ta braktisur atë është i madh. Qamili s'është mësuar me vuajtjet dhe sakrificat, ndaj lëkundet, trembet para forcave të reja armike dhe është gati të dezertojë. Por tanimë ai nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. Ndjenja e përgjegjësisë ndaj fatit të Atdheut ka filluar të thellohet në shpirtin e tij, idetë komuniste kanë filluar të bëhen të ndërgjegjshme tek ai. Prandaj, në mes të dy udhëve, ai pranon më mirë braktisjen e të atit sesa tradhtinë ose tërheqjen e turpshme. Edhe te kjo figurë, ndonëse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, zbulohet forca e ideve të Partisë sonë në ato vite të zjarrta, ide këto që e bëjnë edhe një të lëkundur të vdesë, më në fund, në mënyrë të ndershme, heroike.

Këto janë edhe personazhet kryesore që përfaqësojnë bijtë e bijat luftëtarë të popullit, që përfaqësojnë botën e re që po ngrihet mbi botën e vjetër, për ta shembur atë një herë e mirë nga themellet e për të ngritur mbi gjermadhat e saj jetën e re të lirë e të lumbtur, pa pushtues të huaj dhe pa shfrytëzues. Personazhet që përfaqësojnë botën e kalbur e të perënduar, janë të pakta në romanin «Një vjeshtë me stuhi», megjithatë

ato e plotësojnë mjaft mirë tablonë e zymtë të origjinalitës së tyre. Kjo ndodh sepse shkrimtari ka ditur tipizojë ata: pushtuesit e huaj, nепërmjet figurës së major Francit; tradhtarin e kolaboracionistin, nепërmjet figurës së Nazmi bij Topit; shërbëtorët e tjerë të ndër gjegjshëm e të pandërgjegjshëm të armikut, nепërmjet figurave të përkthyesit, avokat Demir Tapisë, ose ordiancë Qazimit.

Major Franci është një personazh mjaft i goditur në këtë roman. Çdo gjë ai e mat me metrin e ideologjisë dhe të mentalitetit të tij borgjez. Ndaj edhe dështimi i tij para një komunisti të vërtetë është i menjëhershëm dhe i pashmangshëm. Ai (kemi parasysh pyetjet e tij drejtuar Petritit) i premton komunistit të ri lirinë, me kusht që ky t'i tregojë udhëheqësit e lëvizjes, kur populli është ngritur në këmbë për të fituar pikërisht atë liri që ia kanë rrëmbyer të huajt; Franci i premton djalit të ri vajza të bucura, kur djali ëndërron atë lumturi që mund t'ia falë vetëm një dashuri e pastër dhe jo korrupsioni; majori i premton Petritit para, kur komunisti ka hedhur pushkën krahut jo vetëm për çlirimin kombëtar të vendit, por edhe për atë shoqëror, për jetën e re pa të varfër e të pasur, për barazinë sociale. Edhe sikur t'i kuptojë këto kontradikta thelbësore ndërmjet dy botëve, major Franci nuk mund të veprojë ndryshe, sepse nuk mund të dalë nga këllëfi i ngushtë i botëkuptimit dhe i psikologjisë së tij borgjeze. Si i tillë, ai është i detyruar të vdesë, i dërrimuar nga vetë historia e njerëzimit. Këtu, pra, qëndron edhe realizmi në përshkrimin e kësaj figure, që nuk jepet vetëm me uniformën e pushtuesit dhe me frazat e tij mekanike, por edhe me një psikologji të caktuar, që i përket shoqërisë në të cilën ai bën pjesë.

Këtë vështrim klasor të personazheve shkrimtari e ka pasur në qendër të vëmendjes edhe në krijimin e figurës së Nazmi bij Topit, që zë një vend të rëndësi-shëm në vepër. Edhe ai, si borgjez e bir borgjezi që është, nuk mund ta konceptojë jetën jashtë parasë. Siç kërkon major Franci që t'ia blejë Petritit tradhtinë me

para, Nazmi beu kërkon të blejë dashurinë me para. Por, siç dështon me turp major Franci para forcës morale të komunistit Petrit, ashtu dështon edhe Nazmi Topi para vullnetit të papërkulshëm të Lumto Gjinarit. Këto lidhje nuk janë të rastësishme në roman. Ato tregojnë, nëpërmjet përbajtjes sociale të personazheve, arsyet që i bëjnë komunistët të lidhen aq ngushtë me njëri-tjetrin, nga njëra anë, dhe, në anën tjetër arsyet që i bëjnë klasat shfrytëzuese të bashkohen me push-tuesit, botëkuptimi dhe interesat e të cilëve përputhen. Duke ndjekur deri në fund rrugën e personazhit Nazmi bej Topi, vëmë re prirjen e shkrimitarit pér ta përgasur, per ta indentifikuar atë me pushtuesin. Edhe pse në dukje janë motivet intime që e shtyjnë atë të kërkojë nga Lumto Gjinari mohimin e Partisë, braktisjen e Lë-vizjes Nacionalçirimitare nga ana e saj, në thelb kjo kërkesë këmbëngulëse e Nazmi Topit është shprehje e urrejtjes së tij të madhe pér komunizmin. Sepse, duke hyrë më thellë në psikologjinë fashiste të këtij personazhi, vëmë re se dashuria e tij pér Lumton s'është dashuri, po një formë lufte ndaj komunizmit. Si ta kuptojmë këtë? Nazmi Topi, si kundërshtar i betuar i komunizmit, kërkon ta pengojë triumfin e tij duke u përpjekur ta dëmtojë atë sadopak që të jetë e mundur, në pamundësi pér ta dëmtuar shumë. Shkëputja e Lumto Gjinarit, në këtë rast, nga gjiri i popullit, i Lëvizjes, i Partisë, do të shënonë pér Nazmi bej Topin një fitore ndaj komunistëve. Prandaj, kur bindet se Lumton nuk do të mund ta bëjë kurrë të heqë dorë nga çështja e popullit dhe e revolucionit, Nazmi beu e dorëzon atë te gjermanët, duke zbuluar kështu karakterin e tij prej reaksionari thellësisht të ndërgjegjshëm. Duke kujtuar të njëtin qëndrim të majorit Franc me komunistët e të tjerë të burgosur, vëmë re se figura e Nazmi Topit këtu përputhet plotësisht me atë të pushtuesit, qëllimi i parë i ardhjes së të cilit në Shqipëri është «zhdukja e farës së komunizmit», pér ta pasur më pas më të lehtë shtypjen dhe shfrytëzimin e popullit të mbetur pa udhëheqje.

Një tjetër personazh i romanit nëpërmjet të cilës shkrimtari shpreh idenë se asnjanësia është e pamundur në një luftë të madhe si ajo e popullit tonë në vite 1939-1944, është edhe Demir Tapia. Duke dashur qëndrojë jashtë luftës së popullit për çlirim e, aq më tepër, duke kërkuar të njëjtën gjë edhe nga i biri, që është lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, me këtë «asnjanësi» të tij, në të vërtetë, avokat Demir Tapia bën punën e armikut, që dëshiron shuarjen e kryengritjes së armatosur. Edhe këtë personazh, që përfaqëson borgjezinë e atyre viteve, frika e humbjes së pasurisë dhe përbuzja që ka për shtresat e varfra, të cilat, të udhëhequra nga Partia Komuniste, kanë hedhur pushkën krahut dhe i kanë dalë zot vendit të tyre, e bëjnë të kthehet nga «asnjanës» në një tradhtar e spiun të nazisteve gjermanë. Por, në këtë rast, duke tradhtuar atdheun, ai tradhton edhe interesat e tij të ngushta deri në humbjen e plotë të birit, shkaktar për vrasjen e të cilit nga gjermanët është vetë ai. Vetëdija për aktin e tij të ulët përbën edhe dënimin e merituar të këtij personazhi, që përfundon në qmenduri.

Në vijim të këndvështrimit klasor të personazheve, mund të themi se ndryshe e paraqet shkrimtari, në përmjet figurës së Qazimit, fshatarin gjysmë të pasur e të gënjerë nga propaganda balliste. Ai është bir qehajai dhe, si i tillë, mjaft tipare të karakterit të tij janë negative. Ai pi, është imoral, frikacak dhe i pas-krupull në disa gjëra. Megjithatë, ai nuk është vrasës. Qazimi e kupton se pushtuesit dhe krerët e reaksionit kanë synime shkatërruese e gjakpirëse për popullin dhe kombin, ndaj fillon t'i duket e drejtë lufta e partizanëve, aq sa i duken të padrejta dhe çnjerëzore masakrat e pushtuesve të huaj dhe të bashkëpunëtorëve të tyre vendas. I bindur për këtë, ai nuk mund të qëndrojë më si ordinancë e Nazmi Topit. Pra, të gjitha këto personazhe, që janë kryesore në roman, si mbarëtës të botëkuptimeve dhë ideve të caktuara shoqërore, krijojnë një tablo të plotë në vepër, ku secili flet për një kategori të caktuara njërezish. Kjo është ana ideore

e tyre. Ana tjetër është përshkrimi i tyre, mënyra se si paraqiten ata në sytë e lexuesit, me gjuhën, sjelljet, fisionominë e tyre. Në këtë drejtim, mund të thuhet se shkrimtari, për të theksuar sa më shumë anën ideore të tyre, për të nxjerrë sa më në dukje thelbin klasor të tyre dhe për ta bërë këtë sa më me realizëm, nuk i ka karikaturizuar personazhet e tij, por i ka paraqitur ashtu siç mund të jenë në të vërtetë në jetë: të bukur ose të shëmtuar fizikisht, por mbartës të së keqes ose të së mirës njëkohësisht e pavarësisht nga pamja e tyre e jashtme.

Që një vepër letrare ose artistike t'i përçojë te lexuesi sa më mirë, sa më qartë e më me forcë idetë që përmban, është e domosdoshme edhe një formë e përshtatshme, e tillë që të jetë në harmoni me përbajtjen. Në këtë roman forma është në unitet me përbajtjen. Ndërtimi i romanit, i mbështetur në episode të ndryshme që lidhen me njëri-tjetrin nëpërmjet linjave të personazheve, ngjarjeve dhe ideve që kalojnë nga njëri episod te tjetri, duke plotësuar kështu tërësinë ideore të veprës, është i domosdoshëm për një roman si «Një vjeshtë me stuhi», që në subjektin e tij përfshin aspekte ngajeta e një qyteti të tërë, ku veprojnë shumë personazhe.

Një veçori stilistike e këtij romani është edhe gjuha e pasur me figura të ndryshme letrare, epitete, krahasime, metafora etj., që i gjen në çdo faqe të romanit. Por ajo që bie më shumë në sy, është gjuha e personazheve, te të cilat shkrimtari ka ditur të vendosë një rapport të drejtë ndërmjet gjuhës së folur dhe asaj letrare. Ai ka ruajtur disa shprehje popullore krahinore ose edhe disa dialektalizma, por këtë e ka bërë deri në atë masë sa është e nevojshme për tipizimin e një personazhi, për vendosjen e tij në një hapësirë të caktuar gjeografike, që në këtë rast është ajo e Shqipërisë së Mesme. Jashtë këtyre shprehjeve e dialektalizmave, që tregojnë njëkohësisht edhe për njohjen e thellë nga ana e shkrimtarit të së folmes së popullit, gjuha e personazheve është e pastër nga pikëpamja letrare, e thjeshtë,

e rrjedhshme dhe e zhdërvjellët. Por, duke i parë mënga afër, më me hollësi këto çështje ideore e stilistike në vepër do të zbulohen shumë vlera të tjera ideoartistike, që e bëjnë këtë roman edhe për ditët tona mjaft aktuale.

Rrethimi imperialisto-revizionist i vendit tonë, kushtet e bllokadës së egër në të cilën jeton e punon populli ynë, kërkojnë, siç na porosit Partia dhe shoku Enver, një unitet të çeliktë të popullit rreth Partisë, një mbështetje të fuqishme në forcat tona dhe luftë të pandërprerë kundër ideologjisë së huaj borgjezo-revizioniste. Këto ide, që në romanin «Një vjeshtë me stuhi» i gjejmë të theksuara, e bëjnë këtë vepër shumë aktuale, sepse shembulli i heroizmit të paparë të popullit dhe të Partisë sonë në vitet e stuhishme të Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare sot është më fryshtë se kurdoherë. Ndaj, edhe ky roman, duke qenë një pasqyrë e atyre viteve të zjarrta, është gjithashtu për ne sot një nxitje e fryshtë së lartë mobilizuese, unititetit parti-popull dhe e besimit të patundur të popullit te Partia, tek idealet e komunizmit.

## *Kapitulli i parë*

### **MAJA E SELVISE**

Nata e vjeshtës ishte e qetë dhe e ngrohtë. Diku poshtë dëgjoheshin zhurmat e qytetit të përgjumur: këngë e ndonjë gjeli, uturima e një motori dhe përsëri heshtje.

Petrit Guraj shpejtoi çapet, zbriti në zall, por, kur kapërceu murin e kopshtit, nguroi një çast. Ai kishte shkelur deri në prag të portës: ku ishin rojat?

— Jo, more! Ti re brenda me të dy dy këmbët! — ia preu mendimet një zë i mbytur.

Petrit Guraj kérkoi me sy në errësirë.

— Ku jeni strukur?

— Ne jemi bërë luftëtarë të regjur, kurse ti na kérkon rrëzave! — foli dikush mbi kokën e tij.

— Shiko! Shiko! Kësaj i thonë të rrethuar!

— Mbamë, se të shtypa.


Petriti ngriti kokën dhe mezi shqoi në degët e ulëta të manit një hije të zezë.

— S'të mbaj dot. Ngrije këmbën, se ma ke vënë në plagë.

Dy shokët u përqafuan.

— Të paska ecur shëndeti maleve!

— Si i keni punët?



— Si në luftë!

— Aty janë të katër?

— Po.

Ai u mat të pyeste pér Lumtë Gjinarin, por atë ças u dëgjua e qeshura e saj atje brenda. Petriti, pasi shkëmbeu nja dy fjalë me shokun, eci pérpara, hapi derën dhu fut brenda pa bërë zhurmë. Aty ishte e njohur çdo gjë. Era e dërrasave të vjetra të musandrës i ra në hundë dhe lagështira e korridorit i freskoi trupin e lodhur nga udhëtimi i gjatë. Zhurma e makinave të shkrimit dhe e shaptilografit i kujtuan netët e panumërtë, kur, i ulur pranë oxhakut, punonte tërë natën me kokën të rëndë e me sytë që gati i mbylleshin nga pagjumësia.

Përmes derës gjysmë të hapur Petriti dalloi Lumtë në gjunjë, mbi hasër, duke lidhur pakot e komunikative. Në drithën e zbehtë të llambës, fytyra e saj vezake, nën kurorën e zezë të flokëve, kishte marrë atë bukuritë rrallë e të egër, pér të cilën Petritit i qe mbushur mendja se vetëm ai kishte ditur ta çmonte aq sa duhej. Sado pak të ndizeshin e të shuheshin bebëzat në sytë e saj të mëdhenj, sado të padukshëm të ishin damarët në qafën e saj, ai do t'i vinte re patjetër, ashtu siç vinte re menjëherë qerpikun e zi, kur i binte nga qepallat mbi mollëza. Por sonte, nga mënyra se si ajo e mbante kokën, të kërrusur e të kthyer pak anash, nga duart që i ngatërröheshin kur lidhni spangon, Petriti e kuptoi se Lumta ishte e lodhur dhe e mërzitur. Aty pranë punonte Qamil Tapia, që s'dihej pse i shikonte orë e çast me ngulm lëvizjet e ngathëta të gishtave të saj. Petritin e pushtoi një ndjenjë e turbullt dhe një copë herë s'qe në gjendje të lëvizte nga vendi. «Mos vallë...» Ai nuk deshi t'i conte deri në fund mendimet.

— Ej! — thirri duke hapur kanatet.

U bë rrëmujë. Marku u lëshua i pari, por Petriti i vuri dorën pérpara:

— Mark, mos, po të them, se do të më lëndosh plagë.

— Të të hedh një herë lart.

— Mos.

— Atëherë i bëre hak ca grushte...  
Marku shquhej në mes të shokëve për fuqinë e rra-llë.

— Mbahu, o partizan! — briti ai duke i rënë Petritit në gjoks.

Petriti u tund, por nuk u zmbraps:

— Ti kujton se s'jam më ai i pari? Hajt pra, matemi!

Rifati herë futej në mes tyre për t'i ndarë, herë largohej si për të soditur ndeshjen.

Qamili, i ulur në një stol të vogël, i shikonte pa interes.

— Sa herë takohen, do të kapen patjetër. U bënë si deshtë, — tha ai duke u kthyer kurrizin me njëfarë nөverie.

Lumta u shqetësua:

— Ç'bëni kështu? Mjaft!

Atë çast, njëri nga rojet u duk te pragu.

— More shokë, mos keni ndër mend t'ia merrni edhe këngës?

Kur duart e tyre u ngatërruan, Rifati i kapi për flo-kësh dhe i detyroi të putheshin.

— Kripë e benzinë të gjallë e paske fytyrën! — tha Petriti duke rrudhur buzët. — Me sa duket, ke nja dy ditë që s'u ke hedhur ujë syve!

— Ç'më bëre ti mua, si borgjezët që lahen me s-pun myshku? Apo si ky, biri i avokatit.

Qamili, që s'ishte ngritur akoma nga stoli, tundi kokën në shenjë padurimi dhe shtriu këmbët, pa vënë re se këpucët iu zhytën në hirin e vatrës.

— Mbaje gojën, të thonë! — iu kërcënuai.

Pas këtyre shakarave, të katër shokët u ulën dëhe ia nisën muhabitet shtruar...

Pasi biseduan për këshillat e reja nacionalçirimtare që ishin ngritur fshatrave, për plagën që mori Petriti në një ndeshje të befasishme, për detyrat që i pritnin me rastin e formimit të Brigadës së Maleve të Shqipes, më në fund në shtëpinë e vogël nisi përsëri puna, kurse Petriti u shtrit në dhomën tjetër për të marrë një sy gju-

më. Por, megjithë lodhjen nga udhëtimi i gjatë, atij s'i u mbyllën sytë menjëherë. Puna e shokëve aty pranë, zhurma e shaptilografit dhe e makinave, i kujtonin fabrikën ku pat punuar gjashtë vjet. Tymi i gjetheve të duhanit, ballgami i dajë Kolës, nallanet e vajzave, llambë e zbehtë mbi makinën grirëse, gjysmerrësira, dhjetë lekët në javë dhe prapë zhurma e fabrikës që i përzuhej me atë të shaptilografit në dhomën tjetër... ja, këto ishin kujtimet e së kaluarës. Dhe mendimet e tij të fundit lidheshin me shtëpinë që u kishin djegur, me nënë Danën që do të kthehej të nesërmen nga fshatrat dhe me usta Dine Çelikun, në shtëpinë e të cilit do të jetonin përkohësisht...

Dalingadalë gjumi ia mbylli sytë, iu ndenë damarët e trupit e, megjithëse koka iu mpi, diku thellë, një pjesë e trupit të tij rrinte akoma zgjuar dhe mendonte përpërshtypjen që i kishin lënë vragë të pashlyer në jetë. Pastaj, gjithshka u bashkua me një të vetme, të turbullt, pa formë dhe, para se ta merrte gjumi një herë e mirë, ai mundi të shkëpuste nga ky kaos një mendim të vetëm:

«Po Lumta pse dukej aq e lodhur dhe Qamili e shikonte me aq ngulm?»

...Shumë vjet më parë, një ditë të nxehjtë vere, Petrit Guraj, Qamil Tapia dhe Nazmi Topi me Lumta Gjinarin në mes, shkuantë lozni te Namazgjaja. Kur bënte vapë e madhe, sheshi i saj mbushej me fëmijë: vargu i selvive mbulonte me hije të dendur Namazgjanë, që kundërmonte erë rrëshirë.

Ndërsa fëmijët ishin mbledhur nën hijen e selvisë më të gjatë; Nazmi Topi tha:

— Do t'i ngjitem!

— Nuk i ngjitesh dot!

— I ngjitem!

— Jo, Nazmit! — ndërhyri Lumta Gjinari.

Por, ai hoqi këpucët, u kap pas trungut dhe zuri t'i ngjitej.

Deri atëherë asnjieri nuk i pat dalë në majë asaj selvi, sepse atje lart trungu i saj bëhej i pakapërcyeshëm

*nga degët e dendura, që qepeshin e gërshtetoheshin midis tyre. Kishte dhe nga ata që thoshin se dikur një fshatar i qe ngjitur deri lart, por këtyre fjalëve fëmijët s'para u besonin. Përveç kësaj, qenë përhapur dhe thashetheme të tjera, që e bënин të tmerrshme selvinë në përfytyrimin e të vegjelëve. Dikush thoshte se atje sipër gjarpërinjtë ishin të panumërt dhe se një luftë e përhershme zhvillohej midis tyre dhe laraskave që mbronin vezët.*

*Kur Nazmiu iu afrua mesit të selvisë, poshtë të vëgjlit zunë të thërritnin:*

*— Zbrit, ore!*

*— Nazmi, do të të hanë gjarpërinjtë.*

*Dalngadalë sheshin e Namazgjasë e pllakosi heshtja. Fëmijët, të mbledhur kokë më kokë, vështronin lart pa bërë zë. Nazmiu qe futur në degët e selvisë e s'dukej më. Pasi kaluan ca minuta, nga maja e saj laraskat zunë të shqetësosheshin. Krakérinin, hidheshin nga degë, derisa u bashkuan në një tufë të madhe dhe ia nisën fluturimit përmbi Namazgja. Dhe ja, u duk cepi i këmishës së kaltër të Nazmiut, që u mbërthye me të dy duart pas degëve të holla. Poshtë gumëzhiti turma e fëmijëve. Dikush duartrokiste, dikush, me zërin gati në të qarë, thërriste:*

*— Do të rrëzohet!*

*E me të vërtetë, dega lëshci një krismë të mbytur dhe u thye. Nazmiu, që mbeti një hop i kacavarur, mundi të kapej pas degëve të tjera të selvisë. Por, po atë çast, atje lart befas u duk këmisha e bardhë e Qamilit! Ai u qe vjedhur shokëve fill pas Nazmiut dhe, pa u vënë re, i qe ngjitur selvisë nga ana tjetër. Pas pak Nazmiu, që sapo i shpëtoi vdekjes, u ngjit përsëri pranë shokut.*

*— Pritmëni, or-e-e! — thirri Petrit Guraj aty poshtë dhe, pa e bërë të gjatë, iu qep trungut të selvisë.*

*Kur të tre shokët u bashkuan në majë, hoqën këmishët dhe zunë t'i valavitnin.*

*Ndërkaq, lagjja u ngrit më këmbë. Nëna e Petritit dhe e Nazmiut erdhën me një frymë. I ati i Qamilit,*

*avokat Demir Tapia, me ta marrë vesh, mbylli avokatoren dhe ia nisi vrapijt.*

*Prindërit i muarën fëmijët dhe për një javë nuk shkeli këmbë njeriu në sheshin e Namazgjasë.*

*Por jeta bëri të sajën. Kaluan kohë e nën hijen selvisë gumëzhitën përsëri zërat e të vegjelvë. Asaj vënë shokët, Nazmiu, Qamili e Petriti, kishin pushtuar majën më të lartë të Namazgjasë.*

*Dhe këtë ata e bënë për Lumtën, sepse që të tregojnë dashuruar me të, me dashurinë e pashprehur, tashmë e të fshehtë fëminore dhe që të tre deshën të tregonin guximin e tyre para saj. Ajo ditë mbeti si një nga kujtimet më të ëmbla të fëmijërisë...*

*Pas vdekjes së të atit, Petrit Guraj e la shkollën dhe u fut në fabrikën e duhanit, kurse Lumta Gjinari, Nazmi Topi dhe Qamil Tapia vazhduan mësimet në Normale.*

*... Por Petriti ishte shumë i lodhur. Ai kishte udhëtuar tërë ditën. Dhe tani qe shtrirë aty, në dhomën përbri, ku dëgjohej shaptilografi e ... U shua edhe mendimi i fundit nga pikë e vetme e trurit që kishte mbetur akoma zgjuar...*

\* \* \*

Në bazën e shtypit puna u ndërpre ndaj të gdhirë. Marku, pasi mbushi trastën me komunikata, doli i pari. Pas tij iku Rifati. Me zore me përtim hoqi këmbët zvarrë Qamil Tapia. Para se të kaptonte pragun e derës, pyeti:

- Po ti, Lumtë?
- Unë do të rri dhe pak!
- A të pres?
- Jo!

Qamil Tapia e shikoi me vëmendje, tundi kokën në shenjë qortimi dhe u zhduk prapa derës.

Me të mbetur vetëm, Lumtë Gjinari u ul para tavos

linës, zgjidhi gërshetat, nxori nga xhepi i fustanit një pasqyrë të vogël dhe zuri të krihej me një copë krehëri, që mezi e mbante në dorë. Gërshetat e zeza u derdhën dhe i pushtuan gjoksin. Sa herë që krihej, Lumta pyeste veten: si t'i mbante flokët pas lufte, gërsheta apo t'i shkurtonte pas modës? Megjithëse e lodhur nga pagjumësia, fytyra e saj s'e kishte humbur freskinë; shkëlqi-mi i syve të mëdhenj e të zez tregonte se ajo ishte e kënaqur dhe e gjuar. Petriti ishte kthyer! Ai ishte në dhomën tjetër, vetëm katër metra larg. Po sikur të ngri-hej e ta përgjonte: mos vallë ishte zgjuar? Mirë, po ç'do t'i thoshte?

Kështu i kishte ndodhur edhe herë të tjera. Ajo e kishte më lehtë të bisedonte me vetveten sesa me të. Që kur shkeli të pesëmbëdhjetat, Lumtës zunë t'i lindnin èndrrat e para të rinisë. Mëngjeseve, me t'i dalë gjumi, thoshte shpesh me vete: «Me cilin të martohem? Me Nazmiun? Po ai është i egër. Sapo të zgjohet, do të më urdhërojë. Na, moj, jepu bojë këpucëve. Me këpucët bën si bën, por kur të të japë çizmet që po mbath kohët e fundit! Uh, sa rëndë të vjen, e aq më tepër kur është njeri i huaj, burri dhe jo babai yt! Jo, unë s'dua të merrem vetëm me punë shtëpie, unë dua... Çfarë dua unë?... Kthehej përsëri nga i ati, që flinte pa u ndier, dhe i thoshte: «— Jo, Nazmi Topi s'më përshtatet. Kurse në pyetsh për Qamil Tapinë, edhe ai është i ftohtë, s'është për mua! Atë s'e kupton kurrë në është në qejf apo i zemëruar, si maskë! Kurse babai i tij, avokat Demiri, sa i ngrysur që është aman, o zot, të ther natën me thikë!... È, si thua ti, baba, mirë e kam? Ti mos u mërzit, unë jam vajzë e do martohem! Ja, të marrim Petrit Gurajn. Ai është i urtë e gjithmonë të duket sikur mendon diçka si burrë i madh. Jo, nuk them se mendon për vete, ashtu... se ç'mendon! Po, s'ka shkollë. Ai grin duhan në fabrikë, kurse unë... S'vete fare. Do bëhemë lojë e botës. Uh, sa zor qenka të gjesh burrë! As me atë s'martohem, e dëgjon, baba, as me atë. S'dua. Do të rri këtu me ty. Të kisha dhe nënën gjallë!»

— Lumtë! — e kapte për krahu i ati.

Vajza dridhej nga kjo e papritur.

— Ngrihu, se do të shkojmë në shkollë.»

Atë e bijë, të zënë për dore, dilnin në rrugë: Vasi me çap të gjatë e të ngadalshëm, Lumta me çap shkurtër e të shpejtë.

Dy vjet më parë Nazmi Topi e priti kur ajo po dilit nga shkolla dhe: «Martohemi!» — i tha.

Lumtës iu prenë këmbët, qëndroi dhe uli kokën. Një herë asaj iu bë sikur kishte dëshirë t'i përgjigjej «Mirë! Pas pak iu duk më e drejtë sikur t'ia priste: «Jo, s'dua! Por ajo s'tha as njérën, as tjetrën. Iku gati me vrapi duke e lënë Nazmiun të habitur në mes të rrugës.

Ajo kaloi ditë të tëra në ankth duke e ruajtur të mos takohej me të. Lumta nuk e dinte as vetë përsë ia kishte frikën Nazmiut! «Martohemi!» — i tingëllonin fjalët e tij në heshtjen e netëve. «Jo, s'dua! — ngulte këmbë ajo si në fëmijëri. — Dë të rri me babanë.»

Para disa muajsh Nazmi Topi i preu rrugën prapë. Lumtë Gjinari qëndroi dhe, padashur, nguli vështrimin te çizmet e tij të lustruara.

«— Fol, — mezi u dëgjua zëri i saj dhe me marifet u zmbraps një hap.

— S'mund të pres më...

Heshtje.

— Pse nuk përgjigjesh?...

«E këtillë është dashuria? — thoshte me vete Lumta duke shikuar vështrimin e përulur e të vagëlluar të Nazmiut. — Ah, si i përulet bukurisë, vetëm bukurisë! Sa turp!» Lumta u zmbraps me vendosmëri. Ç'ishin këto arsyetime të kota? Përpara kujt qëndronte ajo?

— Ti je bërë njeri i madh tan! — i foli pa e fshehur tonin thumbues.

— Dale, moj, prit, mos u tall!

— Në tallem, domethënë se e meriton! — ia priti me të shpejtë dhe u largua pa e kthyer kokën prapa.

— Mendohu mirë! — e ndoqi zëri i Nazmi Topit. — Politika s'është përfemra. Hëpërhë le të bëhet jotja, por dije se unë do ta përmbysh botën, derisa të të marr. Mos më thënçin Nazmi Topi. O do të të marr, o do të vdes!...»

Në fillim Lumta u largua nga Nazmiu me shpejtësi, por, duke e ndier veten gjithnjë më larg, i rralloi çapet. «O do të të marr, o do të vdes!...» — i gjëmonin fjalët e fundit të Nazmi Topit.

... I mblodhi gërsheetat kurorë prapa kokës, u ngrit më këmbë dhe, pasi qëndroi ca e menduar, thirri me zë të dobët:

— Petrit!

Por ai nuk iu përgjigj as herën e dytë, as të tretë.

Ajo nuk mund të priste më: hapi ngadalë derën dhe u fut në dhomë. U kërrus mbi të dhe gati e puthi në ballë, por befas u zmbraps duke pëshpëritur me zë: «Ç'bëj kështu!» Po, kur u gjend në prag të derës, këmbët nuk i bënин të largohej; i shkoi mendja te plaga; pati dëshirë t'ia shikonte; u kthye:

— Petrit! — i thirri fort.

Petriti murmuriti diçka, u shtriq dhe ra përsëri në gjumë. Lumta i përveshi jakën e këmishës.

— Petrit! — i thirri më fort. — Zgjohu, të thonë.

Pas një çasti, e trembur nga zëri i vet dhe nga sytë gjysmë të hapur të Petritit, ajo mori pakon me komunikata dhe hapi kanatin e dritates. Me një kërcim të lehtë u hodh mbi murin gjysmë të shembur aty përballë.

— Lumtë! Lumtë! — thirri Petriti me të ardhur në vete.

Por ajo, duke i lënë lamtumirën me dorë, u zhduk matanë.

— Lumtë, kthehu! — i thirri ai përsëri, por s'mori asnje përgjigje.

Megjithatë, Petriti nuk u dëshpërua. Përkundrazi. Mbuloi fytyrën me duar, u kthye përmbyss dhe futi kokën nën jastëk, i dehur nga gjumi.

— Ajo më do! — pëshpëriti. — Ajo më do!

Rrezet e para të diellit ranë mbi xhamat e dhormës së vogël. Ishte një ditë e bukur vjeshte plot drithë. Ajri që hynte nga dritarja e hapur, prej nga kërceu Lumta, ia gudulisi trupin akoma të ngrohtë nga gjumi. Aty afër dëgjohej gu-gu-iuja e butë, melodioze, e një kumrie.

— Kur të çlirojmë Shqipérinë, s'do t'i lëmë fëmijë t'i vrasin!

Në oborr u dëgjuan zërat e rojeve të natës.

— Petritin mos e zgjo, — tha ai që po dorëzont bazën. — Është shumë i lodhur, erdhi në mesnatë nga fshatrat.

Rrezja e diellit u var pas murit si njollë, ra në dy sheme, pastaj qëndroi një kohë mbi fytyrën e Petritit, cili, as i hapte sytë, për t'u zgjuar fare, as i largonte mendimet që të flinte. Më në fund u ngrit, u vesh shpejt e shpejt, doli nga dritarja e hapur dhe ra në kopsht andej nga u largua Lumta.

Duke shpërndarë komunikata, Lumta Gjinari përipiqej të përfytyronte ngjarjet e mëngjesit, por më kot, atë ditë s'ishte e zonja të përqëndrohej në asnjë mendim. Ajo dinte vetëm një gjë: Petriti ishte kthyer, ai ishte në shtëpinë e vogël prej qerpiçi. Ata do të luftonin prapë bashkë.

...Kur po ecte përmes kopshteve, mendimet e saj u ndërprenë nga qindra krisma, që ushtuan në faqet e maleve të Kërrabës.

Ato ditë, pas kapitullimit të Italisë, një pjesë e vogël e ushtarëve italianë qe hedhur me partizanët; pjesa tjetër kishte mbetur si qeni pa zot, ndërsa shumica qenë dorëzuar te gjermanët. Po mund të thoshe, se italianët nuk e kishin lëshuar fare fuqinë dhe as gjermanët nuk e kishin marrë plotësisht. Nëpër rrugë qankullonin njerëz të panjohur, që zhdukeshin përsëri si hije. Vetëm ballistët kishin ngritur komandat në ndërtesarat më të mira dhe flitej se s'kishin ndër mend të largoheshin nga qyteti.

Por ja, buçitja e pushkëve në faqet e Kërrabës.

«Filloi lufta me armikun e ri!» — tha ajo me vete dhe po atë çast një zë ia ndërpree mendimet:

— Lumtë!

Ajo qëndroi.

— Lumtë!

Petriti u afrua ngadalë, kokulur, me sytë përdhë.  
Qëndruan një copë herë pranë e pranë pa shqiptuar as-  
një fjalë e dukej sikur po rrin në aty vetëm për të dëgju-  
ar krismat që vinin nga Kërraba. Petriti hodhi përpara  
hapis e fundit, ndërsa trupi i derdhur i Lumtës, në fi-  
llim u step, pastaj u përkul e ra në krahët e tij.

## *Kapitulli i dytë*

### **B L I T Z K R I E G<sup>1)</sup>**

Pas krismës së fundit, tanku bëri një kthesë shpejtë dhe u gjend përpara autokolonës së vogël. Një dorë e madhe leshtore ngadale kupolen ku ishte stamposur kryqi i thyer nazist. Me të njojur dorën e feldfebelit, ushtarët, që sapo ishin ngritur pas përpjekjes, morën qëndrimin gatitu. Te kupola u dukën më parë flokë të kuq e të ashpër, pastaj një fytyrë e madhe, si pufkë e butë, në të cilën humbisnin dy sy të vegjel pa vetulla e pa qerpikë. Feldfebeli u ngrit më këmbë dhe, si nxori krahët jashtë, u lëshoi një britmë ésesëve që rrinin akoma shtrirë në anët e rrugës. Por ushtarët s'lëviznin nga vendi, me përjashtim të njërit, i cili ktheu vetëm kokën. Në këto e sipër, nën oficeri u hodh nga tanku, i ra përqark një kamioni që digjej dhe, pa e zgjatur, u vërsul mbi ushtarët e shtrirë. I pari dhe i dytë nuk iu përgjigjën shkelmave të tij, kurse esesi i tretë ngriti dorën për tu mbrojtur. Vetëm kur shkeli mbi njollat e gjakut, feldfebeli arriti të kuptonte gjendjen e tyre të vërtetë! I zemëruar së tepërm, ai vrapi me

---

1) Gjerm. — Luftë rrufe.

revole në dorë atje ku ishin kacafytur dy njerëz. Parizani dhe esesi kishin vdekur me kohë, por nën oficeri e kapi armikun për jake dhe e ngriti si të kishte të pënte me një të gjallë.

Një autoblindë frenoi aty ku po digjej makina dhe nga ajo zbriti me shkathësi një oficer madhor. Megjithëse pamja e oficerit shprehte qetësi dëhe bile një farë mirësie, megjithëse vështrimi i tij ishte mjaft njerëzor, ushtarët ngrinë në vend, si të qenë statuja. Pasi shqyrtoi gjendjen me sy, oficeri u kthye nga feldfebeli, që mbante akoma partizanin për jake.

— Mjaft u more me të vdekurit! — i foli ngadalë.

Kësaj radhe oficeri s'ë la feldfebelin të tmerrohej, siç i ndodhë zakonisht kur shikonte shefin e vet.

— Varrosini! — urdhëroi ai me zërin e tij gjithmonë të butë, duke u kthyer shpinën.

Ndërsa po shikonte me dylbi qytetin nga maja e Kërrabës, oficeri provoi një ndjenjë të çuditshme. Të gjitha rrugët ishin të ngushta e të shtrembra; shtëpitë e ulëta, të grumbulluara njëra pas tjetrës pa kurrfarë plani, s'para shëmbëllën me banesat e Evropës! Duke kërkuar me dylbi oxhakët e fabrikave, në vend të tyre i dolën minaretë e bardha të xhamive, si dhe selvitë e larta, pas të cilave oficeri u bë merak. Një gjë e çuditit përmbi të gjitha: se mos ishin të shtrembra vetëm rrugët! Çdo gjë që binte në xham të dylbisë, ndërtesa, pemë, shtylla elektriku, edhe minaretë, bile edhe vetë selvitë e bukura, qëndronin për mrekulli shtrembër! Çudi! Oficeri vuri buzën në gaz! Hoqi dylbitë. Ai s'po u besonte as atyre, as syve, që zakonisht s'para i shikoni larg. Si mund të ishte një qytet i tërë i shtrembër, si mund të qëndronte çdo gjë e pjerrët? «Vjetërsirë, unë do të të drejtoj!» — murmuriti, duke ndier diçka të rëndë në zemër. Radhën e dytë oficeri i ngriti pa qejf dylbitë. Por ja, gjëja e parë që i ra në xham qe një ndërtesa e bukur, e punuar prej guri të bardhë. I pëlqyen ballkonet, shtyllat, tarraca, dritaret e mëdha dhe sidomos oborri me blerim të dendur. Vetëm njollat e zeza e të shumta që lëvizin para saj e prishën shijen e oficerit.

## *Kapitulli i dyte*

### **BLITZKRIEG<sup>1)</sup>**

Pas krismës së fundit, tanku bëri një kthesë të shpejtë dhe u gjend përpara autokolonës së vogël. Një dorë e madhe leshtore ngriti ngadalë kupolën ku ishte stamposur kryqi i thyer nazist. Me të njohur dorën e feldfebelit, ushtarët, që sapo ishin ngritur pas përpjekjes, morën qëndrimin gatitu. Te kupola u dukën më parë flokë të kuq e të ashpër, pastaj një fytyrë e madhe, si pufkë e butë, në të cilën humbisnin dy sy të vegjël, pa vetulla e pa qerpike. Feldfебeli u ngrit më këmbë dhe, si nxori krahët jashtë, u lëshoi një britmë ésesëve që rrinin akoma shtrirë në anët e rrugës. Por ushtarët s'lëviznin nga vendi, me përjashtim të njërit, i cili ktheu vetëm kokën. Në këto e sipër, nënoficeri u hodh nga tanku, i ra përqark një kamioni që digjej dhe, pa e zgjatur, u vërsul mbi ushtarët e shtrirë. I pari dhe i dyti nuk iu përgjigjën shkelmave të tij, kurse esesi i tretë ngriti dorën për t'u mbrojtur. Vetëm kur shkeli mbi njollat e gjakut, feldfebeli arriti të kuptonte gjendjen e tyre të vërtetë! I zemëruar së tepërm, ai vrapi me

---

1) Gjerm. — Luftë rrufe.

evole në dorë atje ku ishin kacafytur dy njerëz. Parzani dhe esesi kishin vdekur me kohë, por nën oficeri kapi armikun për jake dhe e ngriti si të kishte të ënte me një të gjallë.

Një autoblindë frenoi aty ku po digjej makina dhe ga ajo zbriti me shkathësi një oficer madhor. Me gjithëse pamja e oficerit shprehte qetësi dëhe bile një arë mirësie, megjithëse vështrimi i tij ishte mjaft njerëzor, ushtarët ngrinë në vend, si të qenë statuja. Pasi shqyrtoi gjendjen me sy, oficeri u kthye nga feldfebeli, që mbante akoma partizanin për jake.

— Mjaft u more me të vdekurit! — i foli ngadalë.

Kësaj radhe oficeri s'e la feldfebelin të tmerrohej, siç i ndodhte zakonisht kur shikonte shefin e vet.

— Varrosini! — urdhëroi ai me zërin e tij gjithmonë të butë, duke u kthyer shpinën.

Ndërsa po shikonte me dylbi qytetin nga maja e Kërrabës, oficeri provoi një ndjenjë të çuditshme. Të gjitha rrugët ishin të ngushta e të shtrembra; shtëpitë e ulëta, të grumbulluara njëra pas tjetrës pa kurrfarë plani, s'para shëmbëllën me banesat e Evropës! Duke kërkuar me dylbi oxhakët e fabrikave, në vend të tyre i dolën minaretë e bardha të xhamive, si dhe selvitë e larta, pas të cilave oficeri u bë merak. Një gjë e çuditi përmbi të gjitha: se mos ishin të shtrembra vetëm rrugët! Çdo gjë që binte në xham të dylbisë, ndërtesa, pemë, shtylla elektriku, edhe minaretë, bile edhe vetë selvitë e bukura, qëndronin për mrekulli shtrembër! Çudi! Oficeri vuri buzën në gaz! Hoqi dylbitë. Ai s'po u besonte as atyre, as syve, që zakonisht s'para i shikonin larg. Si mund të ishte një qytet i tërë i shtrembër, si mund të qëndronte çdo gjë e pjerrët? «Vjetërsirë, unë do të të drejtoj!» — murmuriti, duke ndier diçka të rëndë në zemër. Radhën e dytë oficeri i ngriti pa qejf dylbitë. Por ja, gjëja e parë që i ra në xham që një ndërtesë e bukur, e punuar prej guri të bardhë. I pëlqyen ballkonet, shtyllat, tarraca, drifaret e mëdha dhe sidomos oborri me blerim të dendur. Vetëm njollat e zeza e të shumta që lëviznin para saj e prishën shijen e oficerit.

Mori vendim që atje të ngrinte gestapon, ndërsa ve si shef, të merrte katin e sipërm, që kishte lidhje i taracën, pasi aty ai do ta ndiente veten më të sigur e më larg nga tërë ajo shtrembësirë që po i shikoi sytë. Sa për njollat e zeza, ai ndiente se po i rritej dëshira e hakmarrjes së menjëherë për pesëmbëdhjetë esesët që posa i qenë vrarë. Dicëka murmuriti me vëdhe në ftyrën e tij u end lëhja e një buzëqeshjeje.

Një gjysmë ore më vonë, forcat e gestapos, të baskuara me autokolona të mëdha të artilerisë, që vinë nga Tirana, morën të tatëpjetën, drejt Elbasanit.

\* \* \*

Major Franci filloi menjëherë nga puna. Përzur nga ndërtesa gjeneralin plak, ish-komandantin e përgjithshëm të kuarterit italian, si dhe komandën e ri nisë së Ballit, që kishte zënë vend aty përkohësisht. Të njëqind e ca esesët filluan të sistemonin zyrat e gestapos. Kurti, ordinanci i majorit, kontrolloi telefonat dhimori në dorëzim kuzhinën, pasi vetëm ai ia dinte min huqet dhe shijet shefit të vet.

Kur u ngrys, major Franci hëngri darkë me oreks duke i ndarë gjellët me Setrin veshllapush, të cilin, gjatë gjithë kohës, nuk e largonte nga gjuri. Në kuzhinë mori informatat e para nga esesët që kishin ardhur në qytet ditën e kapitullimit të Italisë. Hante ngadalë, duke fshirë herë pas here buzët e holla, dhe dëgjonte lajmet vetëm me një të tundur të kokës. Sytë e bardhë as i ndizeshin, as i shuheshin.

— Megjithë situatën e krijuar, — raportonte njëri nga esesët, — komunistët ruajnë konspiracion të madh. Nuk mësuam dot ku i kanë bazat. Traktet komuniste shpërndahen me ritmin e mëparshëm. Shumica e forcave të partisë nacionaliste gjenden në krahinat në veri të qytetit, por atje s'para ndihen të sigurta. Forcat partizane shtohen nga dita në ditë. Pas Brigadës së Parë,

që komandohet nga komunisti i rrezikshëm Mehmet Shehu, flitet për formimin e një brigade të re... Kjo do të quhet Brigada e Maleve të Shqipes.

Vetëm kur dëgjoi fjalët e fundit, major Franci pu-shoi së përtypuri dhe hodhi një vështrim të ftohtë mbi të dy esesët e mbi kolonelin e SIMI-t, që rrinte prapa tyre me një dosje në dorë.

— Mehmet Shehu! — murmuriti me kërcënëm dhe s'e ngriti më kokën.

Koloneli italian, të cilit iu duk se i erdhi radha, hodhi një hap përpara duke vënë mbi tavolinë ca letra të daktilografuara.

— Emrat e komunistëve të qytetit! — foli italiani me një gjermanishtë të kulluar.

Major Franci mori një copë rosto me pirun dhe ia zgjati Setrit. Pastaj lexoi me zë të ulët emrin e parë që i ra në sy:

— Rifat Sinani.

— Punëtor! — foli koloneli.

— Po të jetë punëtor, atëherë duhet futur në rreth!

— ia priti majorit dhe pa u ngutur, nxori ngadalë stilografin për të bërë rrethin.

— Petrit Guraj! — vazhdoi të lexonte.

— Ky, dyshohet të jetë udhëheqësi i tipografisë së fshehtë...

— A ka femra komuniste? — pyeti majori, pa e dëgjuar kolonelin deri në fund.

Italiani nguli gishtin në një pikë të listës;

Majori lexoi disa emra.

— Dëshiroj që njérën nga këto ta var të parën, — murmuriti ai me gjakftohtësinë e tij të zakonshme.

Bashkëfolësit heshtën. Në dhomë dëgjohej vetëm përplasja e bishtit të Setrit pas dyshemesë.

— Sa informatorë shqiptarë janë, në shërbimin tuaj?

— Tetë. Të tjerët na i vranë komunistët.

— Të regjistrohen në dispozicionin tonë... Dhe na thoni, ju lutem, sa është numri i të burgosurve politikë?

— pyeti major Franci, si gjithmonë, pa e shikuar n  
fytyrë bashkëfolësin.

Koloneli ndërroi çehrë.

— Dyqind! — mezi u dëgjua. — Por... një javë m  
parë, komunistët e thyen burgun dhe i liruan të gjithë

Në dhomë pllakosi një heshtje e papëlqyer. Kurti  
parandjeu se diçka do të ndodhte. Megjithëse sytë e ma  
jor Francit ishin fare pa ngjyrë, vetëm Kurti e shikoni  
flakën e tyre kur ndizeshin. Vëç zërin s'e ndryshont  
kurrë major Franci.

— Çfarë sekretesh të tjera keni? — pyeti butë-butë  
Koloneli nuk foli.

Majori u ktheu kurrizin bashkëfolësve dhe ia bë  
me shenjë Setrit që të hipte mbi tavolinë.

— Gjenerali bashkë me shtabin e tij, të arrestohen  
— urdhëroi. — Oficerët e SIMI-t bashkë me shefin e ty  
re të pushkatohen për tradhti ndaj gestapos.

Pas një hutimi të vogël, koloneli zuri të ankohej.

— Unë si shef i SIMI-t...

— Punkt!<sup>1)</sup>

Setri, duke qëndruar në bisht mbi tavolinë, i zgjastë  
putrat të zotit, i cili ia shtrëngonte si një baba i përmal  
llur, kur shtrëngon doçkat e foshnjës së vet.

I zmbrapsur nga të shtyrat e dy esesëve, koloneli  
italian thërriste:

— Ju thyeni rregullat ndërkombëtare!

Major Franci luajti një copë herë me Setrin. Kurti  
qëndronte si më gjemba, pasi e dinte mirë se në kësi  
rastesh shefi i tij dukej i qetë sa për sy e faqe.

— Sa iurrej këta italianët me kaçurrela të zeza! —  
foli nëpër dhëmbë major Franci.

Në të vërtetë, koloneli i sotëm që nga ata biondët e  
rrallë italianë me flokë të gjatë e të lëpirë nga brilan  
tina. «Kushedi, ndoshta e ngatërron me atë që vrau dje  
në mëngjes!» — mendoi Kurti pa e korrigjuar, pasi tan  
i s'ishte ajo kohë.

---

1) Gjerm. — Pikë.

— C'mund tē bëjë gestapoja pa tē burgosur? —  
yeti pas pak majori.

— Si zogu pa krahë, — u përgjigj po vetë.

Pas darke, shefi i gestapos u takua me Karemman bez Çërlën, major Alush Leshin dhe kapiten Xhafer Palën, re komandantët më tē shquar tē Ballit. Sipas udhëzimeve që kishte marrë, atyre u ngarkoi si detyrë tē shpejtë tē organizonin forcat e Ballit për tē filluar sa më parë luftën kundër «bandave» partizane në rrethet e qytetit. Gjithashtu, i lajmëroi se së shpejti komanda gjermane, në bashkëpunim me forcat balliste, do tē ndërmerrte një operacion tē gjerë për shkatërrimin e plotë tē këtyre «bandave». Kaq u tha hëpërhë major Franci. Për veprimet e mëvonshme tre komandantët e Ballit do tē mbanin lidhje me komandaturën e qytetit që pritej tē vinte së shpejti, Fon Gutman. Ja cili pritej tē vinte, Gjeneral fon Gutman.

Atë natë major Francin mezi e mori gjumi. Nervat i qeni lодhur dhe acaruar mjaft. Në këtë qytet kishte diçka tē rëndë, diçka tē pakuptueshme. Atij s'para i pël-queu gjendja, po, mbi tē gjitha, e shqetësoi burgu pa asnjë tē burgosur. Prandaj, me t'u zgjuar në mëngjes, thirri në raport Nazmi bez Topin, me tē cilin gestapoja do tē bashkëpunonte ngushtësisht. Më se një orë major Franci i dha udhëzime Nazmi beut për mënyrën se si do tē funksiononte komanda e rinisë së Ballit, si dhe për lidhjet e fshehta që do tē mbante me gestapon. Përsa u përket detyrate, nën diktimin e përkthyesit, Nazmi beu mbushi pothuaj tē gjitha faqet e një blloknoti tē vogël. Së pari duheshin arrestuar katër a pesë «të mëdhenjtë». E gjithë puna tek ata qëndronte! (Ky parim i major Francit u përputh me atë tē Nazmi beut, i cili kishte bindje se kudo dhe kurdoherë udhëheqësит ishin e vëtmja forcë politike). Së dyti duheshin rekrutuar sa më shumë tē rinj dhe më besnikëve t'u jepeshin armë. Major Franci i tha hapur Nazmi beut se kishte ardhur koha tē përdoreshin tē gjitha mjetet e t'i hyhej punës me tē gjitha fuqitë:

— Kjo javë do tē jetë vendimtare, — vâzhdoi ai.

— Të hënën që vjen, të urdhëroj të më raportosh, duk përdorur këto tri fjali: të gjitha çerdhet komüniste shkatërruan. Të gjithë komunistët, me të mëdhenj me të vegjël, u arrestuan. Dhe e treta: i gjithë qytetështë me anën e Ballit Kombëtar dhe komanda e rinis balliste eshtë gati të ndërmarrë veprime kundër bandave nëpër fshatra, ku gjendja paraqitet me të vërtetë e ko klavitur dhe serioze. Punkt!

Nazmi beu, që e kuptonte fare mirë se këto punktë nuk kryheshin kaq shpejt, mbylli bloknotin dhe shikoi major Francin si për t'i thënë: «Tallesh, apo e ke më tërë mend?!»

— Brenda një javë? — e pyeti ai pa frikë.

Major Franci nuk e merrte dot me mend që në një qytet prej ca mijëra banorësh, esesët e tij të mos dinin t'i jepnin fund kësaj gjendjeje. Ai ishte i bindur se përsë shpejti do t'i raportonte Tiranës se, në qytetin e Elbasanit, rrjeti komunist nuk ekzistonte më, ai ishte zhdukur si vesa në rrezet e para të diellit. (Ja ai, damari i kamufluar poetik!)

Prandaj, kur major Franci dëgjoi nga përkthyesi pyetjen e Nazmi beut, ftyra e tij pak e hëqur u ndez përtë parën herë. Heshti një hop, pastaj foli rëndë:

— Një patriot si ju, që e do aq shumë atdheun e vet, nuk duhet të bëjë një pyetje të tillë. Fati i Francës u vendos për katërbëdhjetë ditë. Për Greqinë na u desh vetëm një ditë. Dy muaj mjaftuan për të nënshtruar tërë Evropën e për të hedhur këmbën në Afrikë. Hapësirat ruse u kaluan me shpejtësi motorike dhe në krye të tre muajve ne trokitëm në dyert e Moskës.

— Të pushtosh një popull, nuk do të thotë se e kenë nënshtruar. Po sikur...

— Në këtë çështje kemi pikëpamje të ndryshme, — ia ndërpren fjalën majori. — Ne gjermanët jemi partizanë të «Blitzkrieg»..

— Po...

Major Franci nuk pati as kureshtje ta dëgjonte deri në fund.

— Punkt!

Me kaq biseda u mbyll. Nazmi beu kafshoi gjuhën, futi bloknotin në xhep dhe nguli vështrimin në një pikë të dyshemesë.

Shefi i gestapos nxori nga sirtari një listë të vogël.

— Petrit Guraj, — lexoi ai përsëri i qetë.

Nazmi beu ngriti kokën dhe e shikoi majorin, pa qenë i zoti të shkëputej nga mendimet e veta.

— E njeh? — e pyeti majori.

Beu i vogël nguli sërish vështrimin në pikën e më-parshme të dyshemesë:

— E njoh, — foli me gjysmë zëri.

Kështu u përgjigj dhe për emrat e tjerë që erdhën më pas. Vetëm kur major Franci lexoi emrin e Lumta Gjinarin dhe e pyeti «E njeh?», Nazmi beu foli:

— Nuk e njoh.

Major Franci e shikoi bashkëfolësin nën vetulla, si për t'i lëhënë: «Vërtet?». Ndërsa beu e shikoi majorin me bisht të syrit, si për të lexuar në fytyrën e tij të qetë nëse i besoi nazisti, apo jo.

Pasi lexuan të gjithë emrat e listës, dhe feldfebeli mbajti shënimet e rastit, takimi i tyre mori fund. Majori thirri vartësit e vet për të dhënë urdhrin e parë në sy të Nazmi beut:

— Të bëhet rrethimi në vende kyçë të qytetit. Të bëhen përgatitje për arrestime në masë. Burgu duhet të mbushet. Të fillohet menjëherë nga puna. Punkt!

Vartësit ktheyen shpinën. Nazmi beu u largua. Major Franci i hipit veturës dhe u nis për t'i hedhur një sy personalisht godinës së burgut. Atje i rrihte mendja shefit të gestapos. Sipas botëkuptimit të tij, burgjet ishin një nga karakteristikat rrënjosore që dallonin shoqërinë një-rëzore nga bota e kafshëve.

Duke dalë nga godina e burgut, major Franci shthangu në vend, sikur e qëlloi njeri me shuplakë syve. Në qendër të qytetit, në majën e selvisë më të lartë, valavitej një flamur i madh kuq e zi. Majori e shikoi një hop flamurin që skuqte në sfondin e kaltër të qilllit, pastaj murmuriti si me vete:

— Të priten të gjitha selvitë e qytetit... Kurt?!

Ndoshta qe e para herë që Kurti i kërciti thembr me vonesë. Ai s'do të çuditej aspak sikur majori të urdh ronte po me atë zë të fjetur pushkatimin e njëqind nj rëzve. Këtu ai e kuptonte majorin. Por, të priteshin n dhjetëra selvi aq të bukura për një copë flamur, ky isht krim i vërtetë për Kurtin.

— Herr major! Ne s'jemi kundër flamurit kuq e të shqiptarëve! Një gjë të tillë e kemi shpallur edhe n proklamatë...

— Kurt?! — ia preu fjalën majori me zë të ulët, p të zemëruar. — Kush të urdhëroi ta lexosh proklamatën

Kurti trokiti thembrat, ndërsa majori u përplas deng në sedile të makinës.

\* \* \*

Kur doli nga gestapoja, Nazmi bez Topi mori nga dalë rrugën e shtëpisë. Kostumi i bardhë, me këmishën bojë trëndafili të hapur, nuk i shkonin fare fytyrës së ngrysur. Fizionomia e Nazmiut ishte nga ato që, me një të parë, të lënë dy përshtypje: edhe fisnike, edhe boshe.

Atë e çuditi shumë mendjelehtësia e oficerit gjerman. Vallë a mund të shkatërrohej aq shpejt lëvizja ile gale në qytet? Një farë ngurrimi, një farë mosbesimi fshihej në bebëzat e çelëta të syve të mëdhenj, që atë ditë kishin humbur çdo kureshtje.

— «Dreqi ta hajë, të dalë ku të dalë! — murmurit kur i qe afruar shtëpisë. — U pa kjo punë, s'ka qetësi mbi tokë!»

... Ditetë të qeta Nazmi beu mbante mend vetëm ato të fëmijërisë, kur bridhte me Lumtën e me shokët e tjerë. Pas vdekjes së të atit, Reshit beut, punët në shtëpinë e tyre nuk shkuan mbarë. Nga viti në vit të ardhurat erdhën duke u pakësuar dhe ata u detyruan ta shitnin pasurinë pjesë-pjesë. Por ca kohë pas hyrjes së Italisë se si u rregullua me anën e autoriteve të vendit dhe e ëma. Saibe hanëmi, u bë pjesëtarë në kontratën e mishit të

ushtrisë. Që nga ajo kohë, paraja filloi të hynte përsëri në shtëpi. Por, bashkë me pasurinë që po rritej, Nazmiu zuri të kuptonte rëndësinë e fjalës «bej», me të cilën e përkëdhelnin zakonisht të afërmit. Duke e gjykuar pozitën e vet në shoqëri, ai u bind se nuk ishte në vendin e duhur. S'para i përshtatej një beu të shoqërohej me një punëtor fabrike si, bie fjalë, me Petrit Gurajn. Prandaj, u shkëput nga shokët dhe u fut në rrëthim që i kishte hije një beu. Kjo ndodhi pikërisht në kohën kur në Shqipëri sapo kishte dalë Balli Kombëtar.

Por, megjithë këto, ai e shikonte se s'para u ngjante djemve të tjerë të bejlerëve, të cilët, të rritur që në fëmijëri në mes të bollëkut, mbaheshin larg nga çdo gjë që s'kishte të bënte me huqet e zakonet e oxhaqeve. Jeta e gjatë në mes të shokëve të fëmijërisë i kishte lënë gjurmë të thella. Dhe një nga këto gjurmë ishte dashuria e tij për vajzën e Vasil Gjinari. Kjo dashuri i dukej e natyrshme Nazmi beut dhe, megjithëse pozita dhe mendimet e tij kishin ndryshuar shumë nga ato të së kaluarës, prapëseprapë ai s'kishte fuqi ta flakte. Kjo ishte e vëtmja fije, që e mbante akoma të lidhur me rrëthim e me kujtimet e ëmbla të fëmijërisë...

Kur shkeli në prag të portës, Nazmi beu i hodhi një sy kostumit, shtrëngoi nyjën e vogël të kravatës dhe, pasi e palosi në formë trikëndëshi shaminë e mëndafsltë, e futi në xhepin e vogël të xhaketës. Ai e mori me mend se e ëma e priste me shqetësim kthimin e tij nga gestapoja. E me të vërtetë, sapo futi këmbën në oborr, Saibe hanëmi i doli përpara:

— ...?

— Hiç, mama!

— E fituat? — kjo pyetje hanëmit i qe bërë zakon që kur zhvilloheshin debate midis rinisë komuniste dhe balliste.

— E fituam! — iu përgjigj ai pa qejf.

— Bukur! — dhe, duke hequr një qime të zezë nga supi i të birit, shtoi: — Vetëm gjak s'dua unë. Po atë harroje, ama. E dëgjon?

— Sa herë të kam thënë, nuk e harroj, jo!

- Atë kurbatkë komuniste?
- S'do të thotë gjë se është komuniste. Aq më bë  
E bëj balliste.
- Ah, ku e meriton ajo të bëhet balliste?!
- Lumtën e kam në zemër!
- Befas, Saibe hanëmi qëndroi në majë të shkallëve
- E shikon? — i tregoi me gisht flamurin kuq e  
që valavitej te Namazgjaja. — Më ngriu gjaku kur e pa-  
shë!
- Flamurin?!
- Thashë se mos ke hipur ti si atëherë kur ishe  
vogël... — por, duke parë fytyrën e zverdhur të të bë-  
rit, Saibe hanëmit i mbeti fjala në gojë.
- Nazmi beu me një të kërcyer u gjend në oborr.
- Saibe hamëni e ndoqi të birin deri te pragu i portës  
aty qëndroi dhe, duke parë nja dy fqinjë që zgjateshin  
nga muret për të shikuar flamurin, thirri:
- Ajo kuckë i ka fajet, që i tërboi çunat. Vetë më  
në hije të selvisë, kurse të tjerët i shpon të ngrenë fla-  
murin e të kuqve.

\* \* \*

Me t'u kthyer në gestapo, major Franci e anulloi ve-  
ndimin për prerjen e selvive. Një gjë e tillë do të linte  
përshtypje të keqe e do të qe mjaft qesharake.

Aty nga dreka, meqë komanda e rinisë s'kishte aks-  
ma forca, major Alushi i dha Nazmi beut disa balliste  
nga të batalionit të vet. Kështu flamuri u hodh poshtë.

Nazmi beu u kthye në shtëpi pas mesit të natës.

— E dëgjon, Qazim, — i tha qehajait që e shoqë-  
ronë, — që sot e paskëtaj ti do të quhesh ordinanca im.

— E mora vesh! — ia pat Qazimi, duke hedhur  
pushkën nga njëri sup në tjetrin.

Ecën disa hapa në heshtje.

— Ç'do të thotë kjo fjalë, bej efendi? — pyeti Qa-  
zimi si pa të keq.

— Ordinanca?... Ordinanca është ordinancë! — iu përgjigj Nazmi beu me mendjen gjetkë.

— Aha, e mora vesh! — foli si nëpër gjumë Qazimi, duke e hedhur sërisht pushkën në supin tjetër. — Demeq, ordinanca është ai që mban pushkë të gjatë, kurse zotrote, që je komandant, mban automatik. E mora vesh!

Sapo u futën në shtëpi, Nazmi beu u mbyll në dhomën e gjumit. Ai ishte tepër i lodhur.

Nata ishte e kthjellët. Kjo bukuri e natyrës së përgjumur, që Nazmi beu e shikonte përtëj dritareve të mëdha, diç ia ngacmonte ndjenjat rimore. Nganjëherë thoshte se kot i qe futur kësaj valleje. Ç'i duhej atij automatiku? Atij i duhej Lumta. Ç'kohëra të çuditshme kishin ardhur! «Asgjë s'fitohet pa luftë, as dashuria...»

Diiku u dëgjuan të lehura. Para se ta merrte gjumi, Nazmi beu mundi të mendonte për herë të fundit se atje ku po lehnin qentë, ndoshta ishin duke ecur komunistët! Me të krijuar komandën e rinisë, ai do t'i lëshonte ballistët nga të katër anët (si ata qentë që po lehnin) pastaj të zëstë komunistë... Vrimë e miut një mijë groshi! Shqipëria s'do të bëhej komuniste, Lumta s'do t'i shpëtonte nga duart!

## Kapitulli i tretë

### PRINDËR E BIJ

Pas largimit të usta Dine Çelikut fshatrave për t'u ndrequr partizanëve ndonjë armë të prishur, Dana mendoi të shkonte një herë te Demir Tapia. Tre muaj që s'ishin parë, që kur ajo iku fshatrave pas të birit.

Kunatin e gjeti duke ujitur tufën e madhe të trëndafilave. Me të kaluar pragun e portës, Dana ndjeu erën e luleve të shumta që mbushnin saksitë, buzën e sallonit dhe rretheqark muret e oborrit.

«I zoti është për lule. Im shoq, gjettë rahmet, s'para ua kishte ngenë», mendoi Dana.

Me ta parë, avokat Demir Tapia përplasi kapakët e syve dhe ujitesja i ra padashur nga duart; për të shpëtuar nga stërkalat e ujit, u hodh mëtanë si djale i ri, megjithë peshën e rëndë të trupit të madh e të ngjallur.

— E Danë, ti je! — bërbëliti pa e shikuar.

Dana e kuptoi se Demiri e priti me buzë. «Ku t'i ketë mbetur hatri?» — foli me vete dhe i erdhi inat kur ai s'e pyeti fare për të birin.

— Siç më shikon, unë jam, Demir efendi!

— E shoh, po më thuaj, pse erdhe?

— Mblidhe mendjen, Demir efendi. Të paktën më prit si kunatë që më ke.

— Ah, kështu?! — foli ai dhe u fut në dhomë. —  
Prit aty ku je, tashti kthehem...

Dana mbeti më këmbë te shkallët e hajatit.

...Demir Tapia qe martuar me të motrën e Danës njëzet vjet më parë. Si gocë e një marangozi të varfër, ajo s'pati asnje të «mirë» përveç bukurisë. I ati e dha pa qejf në derën c Tapiajve, të cilët, megjithëse s'para ishin xhins, numëroheshin ndër tregtarët e pasur të qytetit.

Dhe vërtet, gjashtë muaj pas martesës, Demiri ia ndaloj së shoqes të hynte në derën e njerëzve të vet. Vëtëm në kohën që ai shkoi në Gjermani për studime ajo i vidhej të vjehrrit dhe shkonte tek ata. Plaku çmallej me të bijën e me nipin, Qamilin, pastaj lidhte duart prapa kurrizit, duke murmuritur me vete: «Të mora më qafë, gocë! Të mori më qafë bukuria!» Tashmë të dy pleqtë kishin vdekur prej kohësh dhe pas kthimit të Demirit nga Gjermania, kishte vdekur nga barra edhe motra e Danës.

Demiri s'u martua më. Kur u rritën Petriti dhe Qamili, dy familjet sikur u afruan përsëri dhe e kaluara u harrua. Për punët e shtëpisë, avokat Demiri pajtoi një shërbëtore plakë, ndërsa vetë s'donte t'ia dinte për asgjë tjetër, veç avokatores, që i jepte flori, dhe të birit që ishte trashëgimtari i vëtëm i pasurisë së tij.

... Nuk shkoi shumë dhe Demir Tapia doli nga dhoma duke hedhur përpara këmbëve të Danës një bohçe të mbushur me cule të vjetra.

— Na, këto, janë ca mbeturina të pajës së motrës tënde. Merri dhe m'u hiq! Harro se ke qenë kunata imë!

— Je në vete ti, Demir efendi?! Kur e paske kthyer prapë pllakën?

— S'ka ç'të duhet ty!

Dana vuri dorën në ballë, siç bëjnë njerëzit kur u vriten sytë nga dielli:

— Demir efendi, mblidhe mendjen. Je dhe njeri me shkollë.

— Ka ardhur kohë e keqe, secili ka hallet e veta.

— Sot u kujtovë ti? Çunat tonë kanë dy vjet që po luftojnë me kokën në torbë!

*Demir Tapia nuk qe pérzier me punët e luftës. Një muaj më parë, midis tij dhe të birit plasi një grindje e madhe. Meqë ai u trembej shumë thashhemëve të bo-tës, pérzuri dhe shërbëtoren plakë. Më në fund, kur Qamili s'pati nga via mbante, u duk sikur iu nënshtrua dëshirës së të atit. Ndërkokë, i ati u qetësua disi, sidomos një mëngjes, kur pasi gjeti librat e ndaluar të të birit, i dogji në zjarr në sy të tij.*

Por ja, Dana e turbulloj përsëri me fjalët që i tha Demiri heshti një copë herë, hodhi cigaren që sapo kishte ndezur dhe foli me zemërim:

— Yt bir, mbasse, kurse Qamili im ka hequr dorë me kohë nga punët e luftës.

Megjithëse hunda e Demir Tapisë ishte e rregullt, bile e drejtë dhe e bukur, Danës iu duk sikur ajo ishte ngritur si çekiç, gati për ta goditur në ballë.

— Kështu flasin vetëm ata... që i di vetë zotrote!

— Léri llogjét, s'të pinë ujë tek unë, unë jam asnjanës!

— Eja në vete, mos i pengo çunat. Ata po derdhin gjak...

— Tim biri, po u hyri përsëri këtyre punëve, do t'ia këput kokën si të zogut.

— Dëgjo ç'të thotë Dana. Do vijë një ditë që do pëndohesh.

— Pusho, po të them... se po të shaj! S'më mëson dot mua!

— Domethënë, zotrote do të dalësh vetëm, kundër rinisë. E pe dje flamurin në majë të selvisë? E di kush e ngriti? Petriti me Qamilin!

Me të dëgjuar këto fjalë, fytyra plot tul e Demir Tapisë u bë pëlburë e verdhë. Njëri muskul i faqes zuri t'i dridhej; sytë e vegjël iu rrëgjuan fare.

— Si the, moj? — pyeti ai me frikë, duke shikuar Danën me kujdes. — Dije, pra, se im bir ka hequr dorë nga lufta që kur i doli flaka shtëpisë sate.

Fytyra e Danës u ndez.

— Po komunikatat kush i shtyp?

— Gënjen ti... S'ia dalin dot gjermanit çunat tanë!

— Cunat tanë s'janë vetëm. Ata kanë Partinë.  
— Mos thirr!  
— E di zotrote sa e madhe është Partia?  
— Mos e zër Partinë me gojë në shtëpinë time!  
— Mirë, të rroftë mendja që ke, Demir efendi! — ia  
preu Dana dhe pa e bërë të gjatë, i ktheu kurrizin.  
— Danë, moj Danë! — e ndaloi në mes të oborrit  
zëri i zbutur i Demir Tapisë. — T'i lëmë mënjanë këto  
llafe e të bëjmë një pazar tjetër. Shtëpia që të dogjën e  
zëmë se qe pjesa jote, kurse kopshti i vogël e zëmë se  
i përket sat motre. Unë të këshilloj me të mirë ta he-  
dhësh përmbi mua, se fundi i fundit... një copë plakë  
je ti...

— I paturpshëm! S'jam plakë. Jam grua pesëdhjetë  
vjeç. Shëndetin e kam të mirë dhe do ta gëzoj shtëpinë  
që do të ma ngrejë Partia në kopsht, më të bukur se  
tënden.

Dana u largua, pa e kthyer kokën majtas e djathtas.  
Kishte zënë të errësohej, veç andej nga perëndimi kuqë-  
rronin akoma ca re të vogla. Megjithëse ishin ditët e  
fundit të shtatorit, shi s'pati rënë fare; pluhuri kishte  
mbuluar çatitë si çarçaf ngjyrë hiri; ajri ishte i ngrohtë,  
i palëvizshëm dhe i rëndë si në kohë vere. Një tufë e  
madhe laraskash u ngrit nga selvitë e Namazgjasë dhe  
mori lart, duke u rrotulluar përmbi sheshin e pazarit.  
«Hej, kohëra që kanë ardhur! — ndiqte fillin e men-  
meve Dana, duke shikuar tufën e bashkuar të laraskavë.  
— U përcanë keq njerëzit; po vret vëllai vëllanë!»

Grindjen që pati me Demir Tapinë, ajo vendosi të  
mos ia thoshte të birit. Përse ta hidhëronte kot me fjalët  
e atij të shkalluari?

Sapo shkeli në hajat, Dana dëgjoi një zhurmë të  
mbitur prapa krahëve. Megjithëse ishte errësuar, sytë e  
saj mundën të shquatin një hije në murin e kopshtit.

— Petrit! — e qortoi me përkëdhelje, sapo i biri u  
hodh në oborr.

— Mirë e ke ti, nënë, po ja që na u bë zakon të  
ngjitemi mureve!

Dana hoqi ferekhenë dhe u ul në buzë të sofrës.

me një rënkim të lehtë.

— Je lodhur, mor bir?

— Po, nënë. Patëm punë sot, jo shaka. Përcollëm edhe partizanë të rinj.

— Do ta digjni depon sonte?

— Po!

Ndërsa po i ziente një kokërr vezë në shpuzën e vatrës, ajo vendosi që atë natë t'i thoshte të birit: «Dëgjo, mjaft luftove! Ti të vrithesh, kurse Demir efendiu të shpëtojë e të gëzojë Shqipërinë. Mjaft! Le të luftojë edhe ai aq sa ke luftuar ti. Shqipëria s'është vetëm jetja!...» Mirëpo, duke biseduar kështu me veten e saj, një zë tjetër i brendshëm e kundërshtonte vazhdimisht! «Ti, Danë, nuk i ke harruar mbrëmjet kur çunat mblidheshin në dhomën e vogël të zjarrit dhe lexonin nga ata librat e çuditshëm! Ti uleshe në qoshen tjetër të vatrës duke tjerrë e duke dëgjuar me orë të tëra... Atje larg, në Rusi, s'kishte më të varfër. Ti aty e more vesh se çunat që mblidheshin dhe lexonin libra donin të cilëronin vendin, të vinin dorë mbi pasuritë e bejlerëve dhe ta bënин si në Rusinë e Leninit!... E, pra, si mund t'i thuash Petritit të heq dorë nga lufta? Mos do të bëhesh edhe ti si Demir Tapia?»

Flakët e dobëta të zjarrit pasqyroheshin në bebëzat e trembura të syve të saj. Në heshtjen e thellë të dhomës, dëgjohej fëshfërima e kraheve të një fluture nate tek përplasej pas xhamave të dritares. Dana vuri në tepsi vezën e zier, një copë bukë misri dhe ca kripë. Në prag të derës qëndroi në mëdyshje. A do të **ngopej** Petriti me ato që po i jepte Dana? «**Mos qofsha!** Kështu niset çuni në luftë?» **E ku s'i shkonte mendja nënë Danës.** Po sikur të mos i kthehej më? Shikoi edhe një herë tepsinë dhe aty për aty vendosi të merrte hua te fqinjë një lugë gjalpë. Po ku do ta gjente pastaj gjalpin që t'ia kthente? Ata, ëmë e bir, i mbante usta Dinia, që mezi ia dilte për vete: «Të paktën të mos i jap bukë me kripë!»

— Nënë, po vonohem.

— Erdha!

Kur i vuri përpëra tepsinë, Petriti u gëzua:

— Edhe vezë! — tha ai.

Një copë herë heshtën. Petriti hante me oreks; plaka, e ulur në buzë të sofrës, me duar të lidhura në prehër, ishte zhytur në mendime.

Petritit nuk i erdhi mirë që eëma dukej aq e mju-ruar.

— Fol, pra, ç'do të më thuash?

— Kot... Po ja, sikur ta rralloje pak këtë... punën e luftës...

Petriti buzëqeshi.

— E di si them unë, Danë? Të të ngarkojmë me de-tyra lufte edhe ty.

— Pse?

— Të mos jetosh vetëm brenda katër mureve të shtëpisë.

— Ej! — u çudit Dana.

Petriti u ngrit, mori revolen nën jastëk, vari dy bombat pas rripit dhe iu drejtua s'ëmës me gjallëri:

— Hajt, Danë, uromë punë të mbarë!

— Ah, se mos po shkon në punë ti?

— Po dhe lufta jonë baras me punën është!

— Ç'të të them unë e shkreta. Babai im e kishte zakon të uronte: «T'u bëftë malì fushë dhe pushka top!»

Ajo e përcollti të birin deri te porta dhe, si gjith-monë, u largua nga pragu vetëm atëherë kur s'u dëgjua më zhurma e çapeve të tij.

Me t'u kthyer në dhomë, Dana u lëshua mbi minder, si t'i qenë prerë këmbët. Mbështeti fagen pas xhamit të dritäres dhe aty, në errësirën e heshtur të natës, iu shfaq fytyra pak e hequr e Petritit me flokët e zinj tërë dallgë e të butë si kadife.

\*  
\* \* \*

Afër mesit të natës Qamil Tapia veshi rrrobat e vjet-rra, ngjeshti në kokë kasketën, mori bombat dhe revolen, që i fshihte nën dyshek, dhe eci në majë të këmbëve.

Gojën e kishte tē hidhur, nē zemër ndiente një boshllék, që s'e linte tē mbushej me frymë. Me tē vënë dorën mbi hekurat e ftohtë tē dritares, iu kthyë mendja. Pa e kuptuar as vetë, u zmbraps, u zhvesh dhe u fut përsëri nē dyshek.

Po sikur tē mos shkonte sonte nē aksion? A s'kishte mundësi që aksioni i parë kundër gjermanëve, tē cilët ishin shquar për egërsi nē tërë Evropën, tē dështonte, kurse nga njësiti tē vriteshin shumë veta?...

Kohët e fundit Qamil Tapia diç ndiente nē zemër. Sa mirë do tē qe sikur lufta tē kishte marrë fund me kapitullimin e Italisë! Do tē niste jeta nē paqe dhe ai do tē numërohej nē mes tē njerëzve tē nderuar! Por ja që luftës s'po i dukej fundi, kurse Qamilin po e linte vullneti. «Mjaft luftuam!» — përsëriste shpesh me vete.

Sic ishte i shtrirë nē dyshek, mbërtheu vështrimin përtej xhamit, te një yll i vogël, që përpélitej nē tē çarat e reve. Ylli u shua dhe pas pak qielli ushtoi nga një bubullimë. Xamat shkëlqyen nga drita verbuese e një vetëtime. Edhe një bubullimë. Edhe një vetëtimë. «Nata mposht natyrat më tē forta!» — ngushëlloi vetveten Qamili. Por, duke menduar pér njësitin e vogël, i cili në atë kohë mund tē ishte nē afërsitë e depos, ndjeu njëfalonin orët, aq më i egër bëhej vështrimi i syve tē tij, aq më tallëse i bëheshin buzët e holla tē shtrënguara fort. As pushkë *s'po dëgjohej*, as flakë *s'po shikohej*. Dhe kështu, i *kënaqur* pér vendimin që mori, u mbulua kokë *e këmbë me jorgan* dhe mbylli sytë pér tē fjetur...

... Por krismat qenë aq tē shumta, sa s'qe e mundur tē mos e zgjonin. Nxori kokën nē mes tē hekurave tē dritares pér tē parë më mirë gjuhët e mëdha tē flakëve që shndritnin nē tē dalë tē qytetit. U mbulua përsëri me jorgan, por më kot: dysheku iu bë zjarr. Ndiente nevojë tē domosdoshme tē ngrihej e tē shkonte patjetër te shkët. Kur u përsërit buçitja dhe flaka ndriçoi qiellin, pér një çast, nē zemër tē Qamilit u ndez zjarri i dikurshëm, që e përfshinte sa herë hidhej përpara me automatik ndër duar. Pa ngurruar, u vesh, hoqi hekurat e dritares

dhe u gjend në kopsht. Ai, si komunist, s'do t'i trembej së vërtetës! Do t'ua thoshte të gjitha shokëve! Ata do t'ia falnin!

Në dhomën tjetër, avokat Demir Tapia bënte gjumin e lepurit. Thua të ishte e vërtetë që i biri s'kishte hequr dorë nga Partia Komuniste? «Po sikur çuni të ma ketë futur shtëpinë në një listë më të kuqtë?» Sidoqoftë, hë-përhcë, Demir Tapia vendosi të mos bënte zë. E mira e të mirave ishte që ta përgjonte të birin se mos i vidhej natën. Prandaj, me të plasur pushka te kazerma, u hodh më këmbë dhe e mbajti vrapin te pragu i dhomës ku flinte Qamili: «Ah, Danë, t'u thaftë goja, ç'ma punove!» murmuriti i kënaqur, kur u sigurua se i biri po flinte në shtrat. Me shpirt të qetë u zmbraps në majë të këmbëve. U shtri në dyshek, u kthyte në kurriz dhe sic e kishte zakon sa herë që punët i shkonin mbarë, zuri të fërkonte barkun me pëllëmbët e duarve të buta. Në këto çaste lumturie dhe qetësie, Demir Tapisë iu kujtua një anekdotë e vjetër:

Një herë, një palo burri i thanë të ngrihej se po digjej lagjja. Po ai:

— Flaka t'i dalë! — tha dhe u këput përsëri në gjumë.

Po, kur i thanë se po i digjej shtëpia, atëherë ai vuri duart prapa dhe thirri:

— Larg meje!

Atë çast në dhomën e të birit u dëgjua një zhurmë e mbytur. Pa e bërë të gjatë, u hodh më këmbë dhe u lëshua në vrap. Ndezi elektrikun, po ç'të shikonte: hekurat e dritarës ishin zhdukur. Demiri shtangu, i ra kokës me grushte dhe u këput mbi krevatin e të birit.

— Bo-o-o-bo! U fika me laçkë e me plaçkë. I lava duart nga çuni! — murmuriti.

Nga dritarja e hapur frynte veriu i freskët i vjeshtës.

\* \* \*

Njësiti u kthye në shtëpinë e usta Dine Çelikut me Markun të plagosur. Dana i dha shenjë Rifatit, që e mbante në krah, të hynte brenda.

... Pasi mori zjarr depoja, njësiti u tèrhoq në drejtimet e caktuara. Grupi i Markut, i ndjekur nga plumbat e një mitralozi, u detyrua të futej në oborrin e një shkollë. Nëpér rrugë u dëgjuan britma, fishkëllima bilbilash dhe zhurmë çapesh. Alarmi ishte dhënë dhe kyçet e rrugëve mund të mbylleshin nga çasti në çast. Çdo minutë e tepërt në oborrin e shkollës ishte vdekjeprurëse. Prandaj, grupi i vogël u lëshua drejt portës, por aty u gozhdua nga plumbat e mitralozit.

— Shokë! Përpara! — thirri Marku duke u hedhur aty ku xixat e plumbave ishin më të rralla.

Kaq u desh: pas Markut u lëshua i gjithë njësiti. Me të kaluar rrezikun, Marku qëndroi në vend dhe i vuri krahët murit:

— Hidhmë në krah! — urdhëroi Rifatin. — U plagosë që kur ishim në shkollë!

... Me ta shtrirë në dyshek, Rifati shkoi për të gjetur doktorin. Petriti ra më gjunjë dhe e qëlloi në faqe. Marku s'dha asnje shenjë gjallërie. Gjaku që i rridhte nga gjoksi, i futi frikën nënë Danës. Ç'të bënte? Duke u munduar të gjente një rrugë shpëtimi, asaj i vajti mendja te fqinja. Vrapoi në oborr dhe i lëshoi zë. Me ta marrë vesh, fqinja erdhi me futën të mbushur me gëlgjere të pastër, me lloj-lloj melhemrash e gjethë mullage. Pasi ia lidhën plagën e gjoksit me çarçaf, Marku erdhi në vete, u qetësua pak dhe ra si në gjumë.

Në këto çaste, nëpér oborr u dëgjuan të ecura të shpejta. Te dera e dhomës bëri ballë Bardhyli, një çunak i vogël, më i vogli ndër shokë, me fytyrë të njomë, si prej vajze, e me flokë të verdhë e të butë. Këmbët e pantallonave i qenë grisur dhe ai ecte duke çaluar si një topall që e ka të keqen në kupë të gjurit. Me njëren dorë shtrëngonte një kaçavidë dhe me pëllëmbën e dorës tje-

tër mbulonte veshin e djathtë, nga i cili i rridhte një çurg i hollë gjaku nëpër pushin e hollë të faqes.

— Ç'të ngjau, Bardhy! — e pyeti Dana.

— Oh, e mori dreqi! Gjermanët na shkatërruan bazën e shtypit.

Të qarët e kishte në majë të buzëve. U tregoi shokëve se si rojet e bazës i diktuani gjermanët dhe se si ata i shpëtuan rrithimit duke tërhequr me vete shumicën e materialeve.

— Mirë që paskeni shpëtuar të gjithë, — i tha Dana.

Bardhyli e shikoi me sytë e përlotur, kur ngjyra e qiellit ishte bërë më e thellë se zakonisht, dhe, pasi mbuloi fytyrën me pëllëmbët e duarve, ia dha të qarit:

— Nuk shpëtuam të gjithë, jo!

— Fol! Cilin kapën?

— Cilin? — bëlbëzoi Bardhyli. — Shaptilografin tim. Ishte i rëndë e s'e ngrija dot.

Aty për aty njësiti vendosi të mblidhej në shtëpinë e Lumtë Gjinari. Duhej gjetur që atë natë një bazë tjetër. Duheshin mbledhur materialet e shpërndara dhe komunikatat duhet të dilnin ditën e caktuar.

Dana diç u përpoq të fliste, por shtëpia u boshatis menjëherë. Në këtë rrëmujë, asaj iu bë sikur i biri i pëshpëriti:

— Po të lëmë Markun në dorëzim. Së shpejti kthehet Rifati...

Kur Dana ngriti sytë, të birin s'e pa më aty.

\* \* \*

Është e pamundur të ndalosh rrymën e mendimeve, ashtu si nuk është e mundur të shterosh rrjedhën e burimit përmbi shtratin e vet. Kjo ndodhte shpesh me zotin Vasil Gjinari, i cili tretej në mendime për një kohë të gjatë. Megjithëse po afrohej fundi i shtatorit, shkollat nuk ishin hapur atë vit. Zoti Vasil Gjinari, që shërbente në arsim prej vittit një mijë e nëntëqind e dympëdhjetë,

ishte mësuar me mëngjes herët të dëgjonte thirrjet gazzmore të nxënësve. Dhe kjo e detyronte të thoshte: «Ashtu si zogjtë, edhe të vegjlit kanë këngët e tyre të mëngjesit!»

Pasi bënte apelin, ngrinte kokën pér t'u hedhur njësy të shpejtë nxënësve. Ky vështrim i heshtur ishte, si të thuash, përshëndetja e tij.

Në klasë ka nxënës që janë të heshtur. Ka nga ata që s'lënë dy gurë bashkë. Ka dhe të tjerë, sytë kureshtarë të të cilëve lëvizin nën ballin e zgjuar, si pér t'i blerë fjalët e mësuesit pa i nxjerrë nga goja. Dhe Vasil Gjinari njeh secilin veç e veç, u di huqet, u ka mësuar zakonet e shijet, të mirat e të këqijat. Ndodh nganjëherë që sytë e nxënësve koten, mendja e tyre fluturon larg, fantazia e re futet nëpër labirinte të panjohura. Sapo zoti Vasil e kupton se ata nuk po e dëgjojnë mësimin, hesht, duke i përfshirë të vegjlit me vështrimin e tij qortues. Nxënësit zënë të lëvizin: dikush fërkon sytë, si të zgjohet nga gjumi, dikush mbulon me dorë gojën që i hapet, tjetri fut nën bankë letrën ku ka vizatuar diçka të pakuptueshme dhe dalngadalë ata shikojnë përsëri me vëmendje mësuesin plak. Mund të thuash se ai i mbledh nxënësit rrëth vetes, si magneti që mbledh copat e vogla të metalit.

Fytyra e zotit Vasil është nga ato që me një të parë të mbetet në mendje. Sytë i ka në ngjyrën e gështenjës, pak të futur e me një vështrim të thellë, sikur duan të mësojnë gjithçka menjëherë. Ata i përshtaten pamjes së tij, që shpreh akoma energjinë e një të riu, megjithëse i ka kapërcyer të gjashtëdhjetat. Rrudhat e thella në faqe e në ballë, flokët e zbardhur si bora, lëkura e butë e duarve, zëri i matur dhe i rrähur nga vitet, e bëjnë më të dashur e më të afërt pënpara nxënësve.

Të jesh i mirë është gjë e lehtë, por të jesh i drejtë është e vështirë. Ja cili ishte parimi i zotit Vasil më sjelljet me nxënësit: «Të gjithë janë njësoj — u thoshte të tjerëve. — Por te secili mësuesi i mirë duhet të dijë të zgjojë ato anë që janë akoma të fjetura, — ja detyra e mësuesit të vërtetë!»

Kështu pat punuar zoti Vasil që në ditët e para. Gjatë këtyre tridhjetë vjetëve disa nga nxënësit e tij ishin bërë njerëz të ditur, agronomë, doktorë e partizanë.

... *Vetull e syzi, i rëndë si një i madh, i heshtur, bile pak i vrazhdë, i tillë kishte qenë njëri nga nxënësit këtu e dhjetë vjet më parë. S'ishte e mundur të kujtonte çdo gjë me saktësi, por zotit Vasil Gjinari i bëhej sikur e pat* pyetur aso kohe:

— Me ç'zanat ke qejf të merresh, mor bir?

Nxënësi qe ngritur më këmbë dhe i qe përgjigjur:

— S'e di. Bile as nëna ime s'e di!

Ja, pra, kjo përgjigje e Petrit Gurajt kur po merrte dëftesën e shkollës fillore, i kishte mbetur në mendje zotit Vasil.

Dy vjet më parë, të mbledhur në shtëpinë e mësuesit, Petriti u fliste shokëve për çastet e vështira që po kalonte atdheu. Përballë Petritit qe ulur e bija, Lumta. Kushedi se pse ajo iu duk Vasilit fort e bukur, më e bukur se zakonisht. Bile atij i bëhej sikur edhe dhoma kishte marrë një ndriçim të veçantë nga nuri i saj.

Ngjitur me Lumtën rrinte Qamili.

...Një çapkën i vogël, me dy sy si xixa, që i lëviznin plot djallëzi. Prapësítë e tij zotit Vasil i kujtoheshin edhe sot.

— Zotni, Qamili më pickoi në krah, — ankohej shoku i bankës.

Zoti Vasil e dinte se Qamili ishte nga ata nxënës që u duhet tërhequr pakëz freri. E shikonte në heshtje me vështrim qortues. Qamili s'ishte pa sedër. Atij i vinte plasje kur e kallëzonin, i skuqeshin veshët dhe i fliste shokut, aq sa e dëgjonte e gjithë klasa: «Spiun! Pastaj ngrihej më këmbë dhe, duke shikuar poshtë, shqiptonte me zë të ulët:

— Zotni, ai vetë e fillo i pari!

Gënjenote. Kalonte një kohë, përsëri:

— Zotni, Qamili më bie me këmbë!

Qamili ngrihej dhe, po me atë zë të ulët, shqiptonte gënjeshtren e tij të zakonshme:

— Zotni, ai vetë e fillo i pari!

Mirëpo këtu e dy vjet më parë, ndërsa e shikonte Qamilin afër së bijës, me buzë të shtrënguara e fytyrë të ngrysur, si atëherë kur ishte i vogël, zoti Vasil pyeti vëten: «Mos ka ndër mend t'ia nisë përsëri nga gënjeshtrat?»

Në atë mbledhje të rinxjtë qenë betuar se do të luftonin deri në pikën e fundit të gjakut për qirimin e popullit. Përpara madhështisë, vogëlsirat e humbasin rëndësinë e tyre. Kështu ngjau atëherë dhe me zotin Vasil, i cili padashur i la mënjanë pyetjet që e mundonin prej kohësh për rrugën që kishte nisur e bija dhe me zemër të hapur u betua se edhe ai do ta vazhdonte luftën deri në fund bashkë me ish-nxënësit e vet.

Por këtë vit zotin Vasil e kishte mbuluar mërzitja. Cdo gjë që s'kishte lidhje me shkollën, mund të thuash se ishte fshirë nga koka e tij. Ky ishte shtatori i parë prej tridhjetë vjetësh që ai s'ndodhej përparrë nxënësve. Hynte e dilte nëpër shtëpi e s'i jepej për asgjë. Kjo jetë, mendonte ai, nuk i kishte pikë lezeti burrit.

Atë pasdite zoti Vasil bëri shëtitjen e zakonshme në-përrrugët e qytetit. Pasi piu një kafe te Refiku, me kapelën në dorë, doli jashtë. Në rrugën e drejtë takoi dy nga nxënësit e tij. I mori për dore; i porositi të lexonin librin e historisë, të gjeografisë dhe këndimin letrar; u tha se shkollat mund të hapeshin së shpejti; u tha se mbyllja e tyre ishte një turp i madh që i kishin bërë nazistët kombit shqiptar; i mblodhi rrëth vetes, kur u kaloi pranë me këngë e me hap të rëndë një kompani ushtarësh gjermanë; i ndoqi me sy nxënësit derisa ata u larguan nga rruga kryesore, ku lëvrinin makinat ushtarake. Pastaj, mori rrugën e shtëpisë, i druajtur për të bijën, për mungesën e së cilës e pyetnin shpesh të njojurit dhe ai u thoshte se e kishte çuar te një i njojur në fshat nga frika e bombardimeve. Po deri kur do ta besonin të tjerët këtë gënjeshtë? C'bënин spiunët?... Atë mbrëmje, i ulur para tavolinës (para asaj tavoline, ku zakonisht korrigjonte hartimet e nxënësve) rre grushta në tëmtha u tret në mendime deri në orët e vona të natës... Shkolla. Lufta. E bija. Nxënësit. Shqipëria...

Zotin Vasil e sollën në vete disa buçitje të forta në kazermat e Krastës. Ai u shqetësua për këtë aksion. Ai e merrte me mend se atje mund të ndodhej edhe Lumta. Por, kur dëgjoi çunat të hidheshin nga muri i kopshtit — në mes tyre ai njozu edhe zërin e Lumtës — zemra iu lehtësua disi. Me të nisur shamata në dhomën tjetër, atij iu ngjall kureshtja për të dëgjuar.

— Uluni dhe flitni me radhë!

«Të lumtë, Petrit! Sonte çunat kanë nevojë për dorën tënde!»

— Si ndodhi që u zbulua teknika?

Mbledhja u qetësua.

Por, duke dëgjuar ato që fliteshin matanë, zoti Vasil Gjinari pandehu se atë natë lufta dhe jetë e çunave ishin në rrezik. Ai po jetonte ato caste, kur njeriu hidhet nga një gjendje në tjetrën, nga frika e përfytyruar, në frikën e vërtetë. Bile, nganjëherë atij i shkonte mendja se gjermani, që mundi të zbulonte një bazë aq të fshehum, paskëtaj do të zbulonte gjithçka. Ndoshta edhe shtëpia e tij mund të ishte e rrethuar dhe... S'i duruamë. U ngrit. Diçka duhej të bënte...

Atë çast në prag të dhomës ku po zhvillohej mbledhja, befas u duk Qamil Tapia, i zverdhur, i lodhur, i mbytur në djersë... Me të kapërcyer murin e kopshtit të vet, ai e mbajti vrarin në shtëpi të usta Dines. Kur pa Markun të plagosur dhe mori vesh se gjermanët kishin zbuluar teknikën, Qamilit iu duk se për të gjitha këto, faji kryesor rëndonte mbi të. Me të dëgjuar nga Dana se shokët ishin mbledhur në shtëpinë e Lumtës, vrapoi, duke menduar edhe një herë se s'kishte krim më të madh sesa të gënjente. «U frikësova, shokë! Gjykomeni!»

— do t'u thoshte hapur.

Kur shkeli në prag, uli kokën duke ndier mbi vete vështrimet pyetëse të shokëve. Këtu Qamili provoi për herë të parë sesa zor e kishte të thoshte të vërietën.

— Pse s'erdhe në aksion?

Ai s'kishte vendosur akoma cilën anë të mbante, kur në dhomë u fut zoti Vasil.

— Urdhëro, urdhëro! — e ftuan dy a tre me një gojë.

Të gjithë sa qenë në dhomë shkëmbyen nga një vështrim. Ç'e shtyu zotin Vasil të vinte në mbledhjen e tyre në këtë orë?

— Këtu, baba, — i tha Lumta, duke i liruar karri-gen.

Qamili e ndjeu veten ngusht, aq më tepër kur pa pranë ish-mësuesin e vet.

— Po ja, si t'jua them... — foli ai duke shpejtuar, — isha i sëmurë.

Duke i kaluar pranë, Vasili, që e kishte vënë rë shqetësimin në sytë e ish-nxënësit, qëndroi një hop dhe i përkëdheli flokët, si atëherë kur ai ngrihej nga banka dhe e gënjeni pa të keq.

Qamilit iu duk se me atë gjest mësuesi i sprovuar s'para i besoi. Ai mbeti si i turpëruar para shokëve.

— Atëherë kot që erdhe, — ia priti Petriti.

— Kthehu në shtëpi, — i tha Lumta.

— Jo, do të qëndroj! — tha ai i pavendosur.

Sakaq, zoti Vasil iu afrua Petritit:

— Na, merre këtë çelës. Shkolla mund t'ju shërbnjë, qoftë përkohësisht, pér punët që keni.

Petriti e mori çelësin, po atë çelës të madh që kish-te parë këtu e dhjetë vjet, kur qe nxënës i vogël, pastaj foli:

— Po, shokë, vërtet!...

## *Kapitulli i katërt*

### H A P I F A T A L

Kur u kthye në shtëpi, Qamil Tapia e gjeti dritarët të mbyllur dhe hekurat të vënët në vendin e tyre. «Ah, më paska përgjuar. Edhe kjo duhej!» U kthye prapë, doli në rrugët dhe trokiti në portë.

— Ku je, mor qen bir qeni! — e priti i ati. — Ora shtatë e mëngjesit.

Avokat Demiri s'kishte vënët gjumët në sy që nga çasti kur i biri u vodh nga shtëpia.

— Fol, ku ishe e mos m'i var buzët! — i briti për herët të dytë.

— Ti e di, pse më pyet?

— S'ke turp dhe merresh me kotësira!

Qamili, pa i bërë zë, u fut në dhomën e vet.

Kjo mospërfillje e ndezi më tepër avokat Demir Tapinë. U lëshua pas të birit:

— More vesh, më mirë të të vrash me dorën time sesa të të vrashin bota. Kush është bërë komunist? Pa më thuaj! Vetëm leckamanët, që s'kanë as brekë të veshin. Mblidhe mendjen, mos e vërt kokën në torbë për hiçgjë! Ti sikur tërë jetën të mos punosh, prapëseprapë rron për bukuri me florinjtë e babait!... — Avokat Demiri heshtë

dhe kafshoi gjuhën, pasi e teproi ca kur zuri në gojë florinjtë. Ata s'duhej t'i dinte as i biri.

— Kjo luftë s'ka lënë njeri mënjanë! Sot s'ka rrugë të mesme, ose me njérën palë, ose me tjetrën.

— Oj, kur mësoi dhe ky të merret me politikë. Asnjani, si unë, a s'bën?

— Njëqind herë ta kam thënë, asnjanësit s'janë siti.

— Dëgjomë mua, sot është koha fjalën e mirë e gurin në trastë, ashtu siç bëjnë ballistët. Kësaj i thonë punë me mend.

— Si ballistët? — ia ktheu Qamili pa e fshehur përgëmimin.

— S'të pëlqejnë ballistët ty, surrat! — thirri ai duke e zënë të birin për krahu.

— Deri dje ata gënijyen sa mundën, sot po hanë në një çanak me gjermanët.

Si zakonisht kur e kapte inati, avokat Demir Tapisë i përpëliteshin kapakët e syve.

— Të paktën ata i kanë tre burra të dëgjuar, — ia pat ai. — Po për komunistët as që do t'ia dijë njeri. përveç ndonjë intelektuali të verbër, si Vasilloja.

Qamili çlroi krahun me forcë nga dora e të atit.

— Ata ballistë, për të cilët mendon ti, unë as që i krahasoj me zotin Vasil Gjinari.

— Me cilin? Me atë plakarecin që mezi heq brekët zvarrë?

— Shkolla e zotit Vasil s'është si avokatorja jote, ku bëhet tregti me djersën dhe gjakun e fukarasë.

Pas këtyre fjalëve avokat Demir Tapia zuri kokën me duar. Sa larg kishte shkuar i biri! Ai po ngrihej edhe kundër babait, edhe kundër avokatores që e ushqente me bukë.

— Do të të mbyt! — thirri duke zgjatur duart. — Komunist i qelbur. Kujt i ngjave? Gjyshin tënd e mbante në gojë për të mirë një qytet i tërë!

— Po, ata që donin të lëpinin ndonjë kockë.

— Ke ngjarë nga fisi i sat ëme, gjak hislli, kopuk. Atje e ke zemrën.

Qamili, pasi u zmbraps pak pér t'u shpétuar cirkave tē péshtymës që fluturonin nga buzët e tē atit, befas u rrotullua mbi thembra dhe mori tē dilte jashtë. Te pragu qëndroi dhe tha:

— Dégjo, baba. Tani e vure gishtin mbi plagë. Atje më pëlqen më shumë. Të paktën te teze Dana nuk flitet pér fitime. Më janë mérzitur pázarllëqet e tua. Dhe e pérqeshi: «Po tē mos thahen portokallat, domethënë, po tē mbajnë nja pesë dimra tē butë, bahçja do t'i nxjerrë paratë e veta...»

Demiri e shikonte me qepallat gjysmë tē rrëzuara.

Qamili vazhdonte ta pérqeshte:

«Me duhanin e këtij viti, aksioni prej njëqind napoleonash në fabrikën e cigareve do t'i kalojë tē dyqindët. Floririt i ra fare vlera! Nëntëdhjetë e nëntë lekë! Hej, sa ka zanati! Ku ore, ke Demiri? Ja e më nxirr këtë plaçkë nga sytë, o mbret! A ka verdhushka me gjel, me gjel ingjilizi. Ajo kurvëz ka qenë dhe do tē jetë gjithmonë timoni i politikës në tē gjithë botën...»

Demiri e shikonte me qepallat gjysmë tē rrëzuara.

Qamili vazhdonte ta pérqeshte:

«Edhe gjermani, ama, ka tē drejtë që e nisi luftën. Pse, vetëm englezit tē hajë me lugë floriri? Gjermani s'dashka tē rrroka, s'dashka toka!...»

— Mjaft! — e ndërpren i ati dhe ngriti qepallat.

— S'të pëlqejnë këto fjalë?

— Ti tē më pérqeshësh mua? Ti tē jesh mérzitur nga tē mirat e babait? Ti tē duash Danën injorante?...

— Dije, pra, se unë atje e kam zemrën. Me njerëzit e nënës jam, me tē varfrit.

I ati iu kërcënuat:

— Të varfrit do t'i shtypin.

— Ti i mendon gjérat gjithmonë ashtu si tē pëlqen ty. A s'të shkon mendja që tē shtypurit ngrihen?

— Ti je kundër meje. Ti edhe mua më vret! Ja komunizmi!

Avokat Demirit ius sos durimi. Shikoi anash si tē kërkonte diçka, pastaj u hodh mbi tē birin. Në fillim Qamili s'lëvizi nga vendi, por kur ndjeu se thonjtë e tē atit

po e shtrëngonin në grykë si darë, atëhere e shtyu me fuqi. Duke u zmbrapsur, Demiri rrëmbeu mbi tavolinë abazhurin dhe, pa menduar gjatë, ia vërviti Qamilit.

— Do të të vrás! Më fëlliqe!

Hekuri i abazhurit e goditi Qamilin mbi vetull, por i ati, duke parë çurgun e gjakut në faqen e të birit, u tërbua më shumë:

— Do të të vrás! — u skërmis përsëri duke marrë një nga hekurat e dritares që hiqte Qamili kur largohej gjatë netërve.

— Unë po iki përgjithmonë, — e ndaloi në vend zëri i vendosur i të birit.

Demiri u step në mes të dhomës me hekur në dorë. Pastaj u lëshua përpara, po kësaj radhe pa vendosmëri. Kur doli te shkallët, Qamilin s'e pa gjëkundi. Deri në mes të oborrit ai eci me çap të ngrirë. Aty qëndroi, lëshoi hekurin dhe mbeti si kërcu. «Ma dogje zemrën, çun. E humbe veten. Ma le pasurinë pa trashëgimtar. Më mirë të ishe bërë kurvar e bixhosqi sesa komunist!»

Në këto çaste avokat Demir Tapisë iu kujtuan fjalët e fundit që i tha i biri për Vasil Gjinarin. «Këta mësues plakarecë, që na mbahen si intelektualë, po ia prishin mendjen rinisë». Atij iu tipos në kokë se «Vasilloja» duhej të kishte gisht patjetër në këto punë. Ai ishte një nga shkaktarët që po ia merrte më qafë çunin. Duhej bërë diçka. Qamili mund të kthehej në shtëpi, vetëm në qoftë se do të mbetej pa shokët dhe pa «Vassillot». U ul në shkallët e sallonit dhe i vuri syrin diellit. Ndihej keq, tëmthat i rrihnin, i dhembte koka, krahët i çanin dhe i vinte si për të vjellë. Herë-herë i bëhej sikur gjermanët kishin vënë gishtin mbi emrin e tij. «Hej, më futi çuni në listën e zezë!» Një drithërimë e fortë i pëershkoi trupin nga koka në këmbë. Tërë jetën e jetës ai e pat dashur Qamilin, por që ta donte kaq fort, këtë vetëm atë ditë e kuptoi. E ç'vlerë kishin florinjtë që kishte vënë në bankat e Zvicrës sikur të mos qe i biri? Trashëgimtarë i duhej për florinjtë, kurse florinjtë i shtonin dashurinë për trashëgimtarin.

Në mbrëmje, pasi fitoi pak gjakftohtësinë, avokat De-

mir Tapia zuri t'i shoshiste punët më shtruar. Si natën e kaluar, edhe natën e dytë ai as fjeti, as hëngri. Të nesërmen nuk shkoi në avokatore. Sa më shumë kalonte koha, aq më shumë e mbyste halli: duhej gjetur një rrugëzgjidhje, duhej fshirë emri nga lista e zezë. Shtrejhej përmbyss, kthehej në kurriz, ngrihej përsëri dhe ia niste lart e poshtë nëpër hajat. Natën e tretë mezi e zuri pak gjumi. Ndaj të gdhirë avokati pati një shtytje të çuditshme: u ngrit dhe mori të kontrollonte me kujdes librat e të birit. Dhe ja: një fotografi e Lumta Gjinari në palën e një libri dhe po aty, një listë me njëzet emra të të rinjve të fabrikës së duhanit. Me shpresë se mos gjente ndonjë gjë tjetër, kërkoi përsëri. Me fotografinë dhe listën në duar, si të mbante ca njerëz të gjallë, zuri t'i binte hajatit lart e poshtë.

Heshtja e thellë që kishte pllakosur qytetin sikur ia mblodhi mendjen e i dha zemër për të vepruar...

...Jo, kostumi i punës s'ishte i përshtatshëm; gjatë tri ditëve ai qe bërë pis e plot zhura. Veshi smokingun, mori bastunin dhe me sytë poshtë, duke mbajtur cilindrin në dorë, avokat Demir Tapia doli në rrugë. Të ecu, lëvizjet dhe shikimi i tij shembëllinin me lëvizjet e një automati. «Unë s'u përzjeva deri më sot me politikë, se nuk më qenë prekur interesat, por tanë që m'i vutë shpatullat pas murit e më rrëmbyet trashëgimtarin, dijeni, pra, se Demir Tapinë e keni kundër. E zhvesha shpatën. Pritni, o nacionalçlirimtarë, do të merremi vesh kush do të dalë më i fortë, ne apo ju!... Kështu ecte e mendonte avokati, por ja që pas një gjysmë ore, në vend që të shkonte atje ku kishte qëllimin, padashur këmbët e quan në avokatore. Mallëkoi veten, pështyu pragun e zyrës, vuri cilindrin në kokë dhe tamam në kohën kur njerëzia po dilnin për në punë, bastuni i tij trokiti në drejtim të shtëpisë.

U mbyll në dhomë, lëshoi perdet e trasha, u zhvesh dhe u këput mbi krevat me kokën të shtrënguar në mes të duarve të fryra si pufka. Dalngadalë avokat Demirit i erdhi mendja në vend. Oh, sa mirë bëri që nuk shkoi atje... Si mund të hiqte dorë aq shpejt nga asnjanësia?

Pérderisa nuk u pérzie me politikë pér katér vjet me radhë, pérse të lyhej tani? Le të grindeshin e le të there-shin njëri me tjetrin gjermani me rusin, ballisti me komunistin, po ai ç'kusur kishte që të ngutej?! «Dale, të pres dhe ca. Akoma s'dihet cili do ta fitojë, se, po të qe ndryshe, hajde de!...» Sa pér punën e të birit, ajo du-hej menduar urtë e butë, sa t'i gjendej një rrugë... Me këto mendime avokati ra në gjumë të thellë tërë pas-diten dhe tërë mbrëmjen.

... Nga mesi i natës atë e zgjuan disa zhurma dhe britma në rrugë. Hapi sytë i zglebosur dhe në të çarat e perdeve shqoi flakë të ndritshme. Nga ndriçimi i madh, avokatit iu bë sikur po digjej i gjithë qyteti, bashkë me lagjen e me shtëpinë e tij. «Bo-o-bo-, ç'hata!»

Pas pak, zjarret e shtuan dhe gjuhët e mëdha të flakëve pushtuan mbarë qiellin. Lart, disku i hënës, që dilte e fshihej prapa reve, u bë dyst, pa asnje njollë: yjtë e rrallë vezullonin me një shkëlqim të shpëlarë. Nganjëherë gjithçka dukej qartë, ndriçonin faqet e mureve, çatitë, oxhakët e shtëpive, majat e portokajve, pastaj dritat tulateshin dhe qyteti mbulohej në errësirë të plotë. Por, kur flakët ndizeshin përsëri, atëherë minaretë dhe selvitë e gjata të Namazgjasë skuqnin me një zjarr pa flakë e pa tym, me një dritë të kuqe mjaft të ëmbël.

Kur trarët, shtyllat dhe dërrasat e thata të shtëpive shekullore u kthyen në qymyr, flaka ra disi, por fuqia e zjarrit u bë më e madhe. Bashkë me erën e Krastës, që filloj papritur, nëpër quell zunë të fluturonin xixa e copëra thëngjijsh. Dhe ja, ndonjë nga këta thëngjij të ndezur ra deri në oborrin e shtëpisë së Demir Tapisë.

Pastaj, shkrepëtiu e gjëmoi e një shi i rrëmbyer rro-dhi nga qelli litar-litar.

Ndaj të gdhirë, rrugët e qytetit u mbushën me ushtarë. U dëgjuan fishkëllima bilbilash, të trokitura, klithma, britma, të qara fëmijësh e mbi të gjitha ngriheshin gjëmimet e autoblindave, të kamionëve dhe të veturave ushtaraKE, që çanin me shpejtësi nëpër rrugët kryesore.

... Nga vrima e çelësit të portës Demir Tapia mundi të

shquante ca esesë që kishin vënë përpara burra, gra e fëmijë të tulatur në krahët e nënave të heshtura. «E pat Partia. U fikën familjet e partizanëve. U përmbysh bota. Lum kush do të mbësë i gjallë pas këtij rrebeshi, — murmuriste Demiri. — More, po unë ç'pres?» — Vëtëm tani e kuptoi avokati se i biri kishte pasur të drejtë kur i thoshte se ai s'kishte qenë asnjëherë me shpirt asnjanës.

...Atë ditë u gdhi një mëngjes i zymtë me një mje-gull që s'ishte parë. Asgjë s'dukej përvèç mureve që ngriheshin në të dyja anët e rrugëve. Demir Tapia ecte ngadalë, duke u përpjekur të shquante gërmadhat e ndonjë shtëpie të djegur, por ja që sytë e tij nuk e shponin dot perden e dendur të mjegullës. «U qorrova! U qorrova!» — ecte dhe murmuriste me vete.

Në orën shtatë ai u ngjit nëpër shkallët e errëta të gestapos, duke ia qarë edhe një herë hallin vetes për dritën e syve që po e linte para kohe...

Pas takimit me major Francin, avokati kujtoi se aq e pat. Në gestapo e çmuani në mënyrë të veçantë informacionin e tij. Shefi thirri dy ndihmësit e vet dhe, në sy të Demir efendit, u tregoi fotografinë e Lumtës dhe i urdhëroi që të studionin me hollësi pozicionin e shtëpisë, të bahçes e të shkollës, që ishin nën zotërimin e mësuesit. Për këtë majori u dha vetëm një ditë afat. Nesër duhej të mbaronte hetimi. Pasnesër mësuesi, bashkë me të bijën e me bandën komuniste, duhej të gdhi-hej në burgun e gestapos.

Biseda qe mjaft e shkurtër, por ajo e goditi si thikë Demir Tapinë, i cili u kthyte në shtëpi me një parandje-një të keqe. Ai pat menduar se gjithçka do të kryhej më thjesht. «Vassillon» do ta arrestonin në pazar ose në shtëpi dhe me kaq puna do të merrte fund. Në këtë mënyrë Demir Tapia ëndërronte të mbante përsëri direkun: asnjanës! Pa dale?... Po sikur shkolla të qe kthyer në

bazë komuniste, siç dyshoi menjëherë major Franci e aty brenda të ndodhej edhe i biri?

Mbrëmjen e fundit avokati vendosi të vepronte. Duhej gjetur çuni, duhej shkëputur nga shokët qoftë për një natë të vetme. Po ku ta gjente?

Doli pazarit, pa ditur nga t'ia fillonte. Sytë i qenë skuqur nga pagjumësia, fytyra i qe zverdhur si e të së-murit kur apo është ngritur nga shtrati. Ekte ngadalë dhe ekuilibrin e trupit të rëndë e batall dukej sikur e mbante vetëm bastuni me kokë sermi që trokiste ritmikisht nëpër kalldrëmin e rrugëve tak-tak-tak. Herë pas here qëndronte në kyçet e rrugëve dhe murmuriste, mbase për të dhjetën herë, po të njëjtat fjalë:

— Ku të shkoj? Ku të mbytem?

S'kishte ku të shkonte Demir Tapia, veçse në shtëpi për të pritur atë që do t'i dhuronte fati... Por një shpresë e vagëlluar e mbante akoma të gjallë. Kjo shpresë ishte lista e të rinjve të fabrikës së duhanit, që nuk ia kishte dorëzuar akoma major Francit. Kështu, sikur t'ia gjente të birin ndonjë fatkeqësi, avokati kishte edhe një gurtjetër, me të cilin do të tregonte besnikërinë ndaj gjermanëve: listën. Gjatë jetës së vet si avokat ai ishte bindur se lumturia e njërit ngrihej mbi fatkeqësinë e të tjerëve dhe përderisa këtë të vërtetë s'e luante as topi, atëherë përsë të bënte përjashtim vetëm Demir Tapia?

«Oh, oh», — rënkoj ai duke e ndier, megjithatë, se ishte futur në një qorrsokak, nga i cili s'kthehej më prapë. Hoqi drejt shtëpisë për të nxjerrë listën nga sirtari e për ta mbajtur në gjji.

## *Kapitulli i pestë*

### **GRIMCA NGA JETA JONË E PËRDITSHME**

Ajri i lagësht ishte ngarkuar me aromën e bimëve vjeshtake dhe me erën e pluhurit të porsambytur nga vesa e shiut që kishtë rënë natën. Zogjtë cicérinin. Në hapësirën e zymtë kryqëzoheshin bletë të panumërtë, që shpejtonin për të mbledhur nektarin e fundit të luleve. Insekte të ndryshme fluturonin ulët, rrafsh me tokën, me një zukatje të lehtë.

— Do të bjerë shi, — foli Lumta duke shikuar retë e zeza.

Petriti ecte pas saj.

Lumta kishte veshur një triko të kuqe, punuar tre vjet më parë. Por ajo qe rritur dhe tashti trikoja i rrinte e ngushtë. Fundi pak i shkurtër, sandalet dhe kordelet në kokë të linin përshtypjen se kishe të bëje më tepër me Lumtën e djeshme, kur ishte akoma nxënëse shkolle. Vetëm sytë e saj të zinj, që të shikonin pa drojtje, gërshtat e trashë, të mbledhur kurorë pas kokës, rrudhëza e vetme që i ngjitej nga mesi i vetullave drejt ballit, të kujtonin se Lumta qe bërë vajzë në moshë të pjekur...

Kur qenë larguar nga baza e shtypit dhe u futën në kopshtet e thella, ajo tha:

— Pasdite do të vij në shtëpinë e usta Dines!

— Për mua? — pyeti Petriti në hutim e sipër.

— Jo, për të parë Markun, — qeshi ajo.

«A, me mua s'dashka të takohet!» — foli me vete Petriti.

— Pse s'vjen tani? — i tha.

— Do të shkoj të vishem. — Ti e di, këto i kam rroba punë.

— Mirë je veshur!

Lumta e shikoi e habitur. Ajo e dintë se Petritit nuk i pëlqenin fundi i shkurtër dhe trikoja e ngushtë. Përveç kësaj, për veshje të këtilla në qytet kishte shumë thashetheme.

— Bëj si të duash, — ia priti ai. — Veç luaj këmbët më shpejt.

Kur iu afroan shtegut ku do të ndaheshin, Petriti deshi të gjente shkak për të qëndruar edhe pak me Lumtën.

— A të hahen? — e pyeti duke i treguar me gisht një hurmë kokërrvogël, degët e së cilës po thyheshin nga pesha e rëndë e frutave.

— Edhe pyet! E kam gojën të hidhur nga puna e natës.

Petriti aq deshi: u qep pas degëve dhe menjëherë u gjend në majë të hurmës. Bisqet e para ia hodhi Lumtës poshtë.

— Ha për vete më parë, — i tha ajo.

— Leri llafet e tepërtë.

— Sot qenke bërë kavalier i vërtetë!

Lumta mbledhi bisqet me hurma dhe pa bërë zë, u ul mbi një trung të vogël. Zogjtë, të trembur nga Petriti, vërtiteshin pa zënë vend.

Ajo as që e vuri ré Petritin, i cili kishte zbritur nga hurma dhe i qe ulur pranë pa zhurmë. Kur ndjeu ngrohtësinë e trupit të tij, Lumta pat një drithërimë të lehtë; ajo lëvizti pak, por, në vend që të largohej, pa e kuptuar as vetë, u afroa më shumë. Ai i hodhi dorën në sup. Ajo e ndjeu veten të shqetësuar, por përpjekja që bëri për ta fshehur këtë, ia shtoi më tepër shqetësimin. Ndoshata për herë të parë në jetë truri i saj u çlirua nga çdo mendim: të gjitha përshtypjet e deriatëhershme iu fshinë nga

kujtesa; pér tē s'kishte më as tē kaluar, as tē tashme, as tē ardhme, por vetém një çast, i cili pérmblodhi gjithçka në një pikë tē vetme... Zhurmat e niëngjesit, zogjtë mbi kokë, kopshti pérreth, retë e ulëta, s'kishin tē bënин fare me qenien e Lumtës, që në tē njëjtën kohë provonte dehje' e turbullim si dhe guxim e frikë nga ky hap i panjohur...

Papritur, në faqet e Kërrabës u ndeh perdja e zezë e një shiu që po vërvshonte drejt qytetit. Krisma e një rrufeje u duk sikur e çau tokën më dysh.

Lumta u hodh më këmbë dhe, pasi rregulloi fundin, eci përmes kopshtit.

— Lamtumirë, Petrit!

— Prit, Lumtë!

Ajo zuri faqet me pëllëmbë, si pér tē fshehur tē kuq-të që i kishte ndezur fytyrën.

— Po afron rrebeshi!

— Atij rrebeshi i trembesh ti? — pyeti ai me nënqeshje.

Petri shikoi shtegun nga u largua Lumta.

— Rrufe e mallkuar! Bëhet luftë edhe në qiell!

Rregulloi revolen pas brezit, rrasi kasketën dhe mori rrugën e shtëpisë.

Tufani sa vinte e shtohej. Nga tē katër anët ngriheshin si flutura me krahë tē prerë gjethë tē zverdhura pemësh e copa lettrash. Diku, tundej teneqeja e një oxhaku, majat e pemëve përkuleshin, rrapëllinin telat e elektrikut. Mijëra laraska, lajmëtare tē stuhisë, u lëshuan në një tufë tē vetme përmbi qytet, duke mbushur qielin me krakaritjen e tyre. Herë-herë ato ndehnin krahët dhe i jepeshin rrymës së erës, e cila i merrte me vete e i shpinte larg. Por s'kalonte shumë dhe tufa kthehej përsëri përmbi qytet plot shamatë, duke e çarë stuhinë ballë pér ballë.

Pranë një gardhi, tre fëmijë gjuanin me llastika. Njëri prej tyre i qe afruar një zogu që cicërinte majë një portokalli.

— Mos e vrit! — i thirri Petriti.

Të voglit duket i bëri përshtypje i panjohuri me

kasketë. Mblodhi llastikun, e futi në xhep dhe mbeti më këmbë me një buzëqeshje naivë.

— Ja, i shikoni? — u tregoi Petriti laraskat në qiel. — Ato gjuani, në jeni të zot.

Pa mbaruar mirë fjalën, një bubullimë e fortë pusztoi qiellin dhe menjëherë plasi me zhurmë një shi i rrëmbyer e pikëmadh.

— Në magaza të dajë Muratit, — thirri një nga të vegjlit.

Sapo u futën në magaza, fëmijët zunë t'i vërtiteshin Petritit me mërifikat për t'i parë revolen, por nuk shquan dot gjë.

— Daj Murati ka dhjetëshe turke! — tha njëri nga ata, ndërsa shtrydhte flokët e lagur.

I lodhur nga pagjumësia, Petriti u mbështet mbi dengjet e barit të thatë.

— Cili është ky dajë Murat? — bëri sikur nuk e njihte.

— Dajë Murati?! — u çudit i vogli. — Është ai hanxhiu me xhokë e benevrekë, që i ka mësuar pëllumbat t'i çukasin mustaqet.

— Na-a-a i ka mustaqet! — ia pat tjetri, duke zgjatur duart te veshët.

— Mirë, pra, — foli Petriti, — do shkoj ta takoj dajë Muratin. Ai paska revole.

Të vegjlit e shikuani me dyshim Petritin si për t'i thënë: «Po ti, s'ke revole?»

Jashtë shiu përplasej me potere pas gjetheve, pas tje-gullave, pas ullukëve. Nga toka e djegur ngruhej avulli i ngrohtë. Në magaza kishte zagushi dhe erë bari të thatë.

\* \* \*

— Ku jam këtu? — pyeti Marku.

— Në shtëpinë e usta Dines! — u përgjigj tërë gë-zim Dana, kur pa se më në fund Marku erdhi në vete.

Ai, pasi shikoi gjoksin e lidhur, shqiptoi:

— Po....

Njëzet e katër orët e para atij i bëhet sikur një palë duar të ftohta i mbyllnin vazhdimisht kapakët e syve dhe një peshë e rëndë e shtypte në gjoks e s'e linte të mbushej me frymë. Hera-herës fliste përcart duke u grijndur me njerëz të padukshëm, pastaj tulatej dhe humbiste për një kohë të gjatë.

— Po... — murmuriti përsëri, si njeriu që përpigjet të kujtojë diçka të harruar.

Dhe tashti, duke shikuar tavanin, rrezet e diellit në perdet e lëshuara të dritares së vetme si dhe njollën e pértharë të gjakut nën rezen e derës. Markut filluan t'i kujtoheshin të gjitha ato që ndodhën dy net më parë në oborrin e kazermës: britmat, flaka e depos dhe krismat e mitralozit... Pastaj, dhembja nën shpatullën e djathë e asgjë tjetër!...

Sot u gdhi më mirë. Me t'u zgjuar, zuri të kërkonte diçka me rrëmbim nën jastëk.

— Ku ma keni vënë revolen? — pyeti nënë Danën.

Dy netët e para Dana qe frikësuar dhe i bëhej sikur orë e çast gjermanët vinin deri në prag të portës dhe ja, vec kur të trokitnin. Por ata s'u dukën as ditën e parë, as të dytën, e kështu nënë Danës zuri t'i dilte frika.

— C'revole, atë me këllëf të kuq?

— Po.

— Mos u bëj merak. E ka Dinia.

Pas pak Dana pyeti:

— O Mark, këllëfi që more atje është ai?

— Po, nënë.

...Shumë kohë më parë, kur Lëvizja apo kishte nisur, një ditë njësiti guerril rrethoi njérën nga furrat ushtarake të qytetit dhe brenda tridhjetë minutash ngarkoi më se dyzet kuintalë miell. Marku qe futur i pari në furrë dhe që tërhequr i fundit. Por ja që, kur iku, harroi në tezgën e furrës këllëfin e revoles. Gjysmë ore pas aksionit, papritur, u hodh nga makina dhe u kthyte prapë. Nuk dihet se si u fut në furrë, por në mbrëmje Marku u kthyte me këllëfin e kuq në brez.

Një vit më vonë, kur u shtrua kandidatura e tij për në Parti, disa nga shokët s'deshën t'ia jepnin votën; Marku as kuqej, as verdhej. Më në fund, mezi u pranua, po disa vota i pati kundër. Atë kohë, prapa kurrizit të shokëve qe dukur koka e madhe e Markut me flokët e shkurtër e të ashpër si zhugë. U ngrit ngadalë, ngrysi vetullat dhe foli:

«— Or po, ajo puna e këllëfit, që thoni ju, këllëf mor i shkreti, të dhimbset, apo jo?»

Këto kujtime nënë Dana ngajeta e Markut jetim, po kur ajo hodhi sytë për ta parë, Markun e kishte zënë gjumi ose kishte rënë përsëri në dremitje. Sidoqoftë, ai ishte më mirë. Atë ditë ai ishte përmendur për herë të parë. I shikoi fytyrën e zverdhur e të munduar nga dhëmbjet, e mbuloi me kujdes dhe doli jashtë.

\* \* \*

Petriti eci në majë të këmbëve për të mos zgjuar Markun.

— Pse kaq vonë? — pyeti e éma.

— Shiu, nënë. Si u bë? — pëshpëriti ai duke shikuar fytyrën e murrëtyer të Markut.

— Më mirë. Doktori i pastroi plagën dhe ia mbushi me fitila.

Petriti ra në gjunjë pranë Markut.

— Mos i rri mbi kokë se i jep siklet! — e qortoi ajo.

— Mirë, — pëshpëriti Petriti, të cilit i pëlqeu toni i s'ëmës. — Tani e di vetë ti çfarë dua unë. Veç shpejt, se jam lodhur. Shiko, një çikë si shumë. Kam uri.

Kur i biri kishteuri, për nënë Danën donte të thoshte se punët shkonin mbarë.

Pasi hëngri, Petritin e zuri gjumi menjëherë. Ndërsa po shikonte me mall trupin e të birit, Dana vuri re se bërrylat e xhaketës prej doku i ishin ngrënë, kurse këmbët e pantallonave i rrinin të shkurtra. Atë kostum Petriti e pat qepur tre vjet më parë. Nënë Danës i vinte plasje

që s'mblodhi dot ca para sa t'i blinte një kostum të ri, si, bie fjala, kafe, blu ose gri, po veç këtë ngjyrë të mos ia shikonte në trup, pasi kjo i kujtonte rrobat e ushtarrëve të huaj, që mbushën vendin këtu e pesë vjet më parë e s'po shkuleshin dot.

Ajo u ngrit t'i hidhte ndonjë gjë përsipër të birit, kur dera u errësua.

— S'më njeh? U trembe? — u dëgjua një zë i mbushur.

— Ah, fol, more Rifat!

Djali kërrusi kokën, se për trupin e tij dyert ishin të ulëta në shtëpinë e usta Dine Çelikut dhe me dy çape të gjata u gjend në mes të dhomës.

— Erdha për Markun.

— Është më mirë!

— Vërtet? — e ngriti zërin Rifati dhe, pasi shikoi Markun, pyeti:

— Fle?

— Po.

Rifati u ul në minder pranë këmbëve të Petritit.

— Po ky karafil, ç'na qenka shtrirë kështu?

— Edhe Petritin apo e zuri gjumi, po mos thirr, se zgjon Markun.

— Ah, po!... — por, megjithëkëtë, zëri i tij qe përsëri i lartë.

— Po ti, Rifat, ke fjetur?

— Hiç, Danë. Edhe unë, pasi u ndava me doktorin, brodha tërë natën sa nga ullishta në qytet.

— Po mos thirr, pra, se e ke zërin si bori!

— Ah, po!... Që thua ti, një herë nxorrëm material, oh si e nxorëm! Nën hundën e gjermanëve! Kurse hëren e dytë përcollëm partizanë të rinj.

— E gjithë rinia po del maleve?! — pyeti e çuditur Dana.

— Së shpejti do të formojmë një brigadë të re! Brigadën e Maleve të Shqipes!

— Mos thirr, pra!

— Ah, po!...

Atë ditë danës iu duk shumë i dobët Rifati. Faqet !

Kishte të thata, lëkurën të verdhë, sytë të futur thellë.

— Shtriu, Rifat, fli edhe ti një çikë, — iu lut ajo,

— Unë s'pyes për gjumë, Danë, u mësova. Do pres dhe pak sa të zgjohen Marku me Petritin.

— Mirë, si të duash, — i murmuriti Dana dhe doli në hajat, por kur u kthye, Rifatin e kishte zënë gjumi ashtu ndenjur, me kokën që i kolovitej pas murit e me një të gërhitur si ata që vuajnë nga nefezë. Dana e shtriu ngadalë në minder dhe i vuri një jastëk nën kokë. Një copë herë s'diti me çfarë të mbulonte, por, më në fund, vendosi t'i hidhte jorganin e vetëm prej atllasi, që usta Dinia e ruante për raste të rralla. «S'thotë gjë ai!» mendoi ajo. Kur ia hodhi përsipër, këmbët e Rifatit mbetën një pëllëmbë jashtë.

— I ke të gjata, çun, s'kam ç'të bëj! — murmuriti Dana me përkëdhelje.

U hodhi edhe një vështrim të tre çunave që flinin, lëshoi perdet dhe doli jashtë. Atje ajo përgjoi me orë të tëra zhurmat më të vogla. Ndoshta për herë të parë Dana e ndjeu veten jo vetëm nënë...

\* \* \*

Usta Dine Çeliku doli nga magazaja me një pushkë në dorë, i ra me peshqir qafës së djersit dhe u ul në hajat për të pritur që të hante drekë me Danën.

... Ai sapo kishte shkelur në të gjashtëdhjetat, por në të parë, me flokët e thinjura e të ashpër, të dukej më te-kurit, ai ishte tepër i thatë, por krahët leshtorë e plot muskuj i kishte akoma të fuqishëm. Me çunat qe «lidhur» që kur mori vesh se qe formuar Partia, ajo Parti që do të cilronte vendin dhe pastaj do të «bënte komunizmin, ku të gjithë njerëzit do të ishin të barabartë, do të hanin e do të visheshin njësoj.» Me gjallje të të atit, usta Dines s'iua bë mbarë të martohej, por edhe pas vdekjes së tij s'imbodhi dot aq para. I mbeti peng usta Dines që s'pu

linte njeri pas vetes. Vëtmia qe shoku i tij i pandarë gjatë jetës, prandaj që nga dita kur «u lidh me çunat», atij iu duk sikur u fut në një familje të madhe. Kur qëllonte t'u ndreqte atyre të qytetit makinat e shkrimit, revolet, ose t'u lëmonte ndonjë çelës të rrremë, usta Dinia gëzohej si fëmijët. Bisedonte me ta për politikë, u tregonte historira të vjetra dhe u lutej:

«— O çuna, ejani në shtëpinë time. I shtypim bashkë komunikatat.

— Usta, edhe shtëpisë sate do t'i vijë radha.

— Eh, s'u var njeri pleqve!

Por qejfi i madh i usta Dines ishte kur e thërritin fshatrave për të ndrequr ndonjë pushkë. Me ta parë, partizanët e rrethonin dhe ustai, duke u kollitur nga gjëzimi, i dorëzonte partizanit maliherin.

— Usta, imi është ky? — e pyeste partizani. — Po ky s'u njohka fare! E paske bërë tring të ri!»

Qëllonte shpesh që partizanët ta provonin aty për aty pushkën e ndrequr. Kur pas krismës, guriçka zhdukej, armëtari mezi arrinte të pëshpëristë me vete: «Gjak në vetull të marrin çunat e shqipes!»

— E dogjën qytetin qafirët. Dymbëdhjetë shtëpi partizanësh! Jo pak! — tha Dinia me keqardhje.

Këto fjalë i kujtuan Danës shtëpinë e vogël, që ia kishin djegur italianët këtu e tre muaj më parë. Atë natë ajo s'mundi të shpëtonte asgjë, veç një bohçe më ndërresat e Petritit. Po, kur doli në rrugë, edhe atë ia shqitën me bajonetë dhe ia hodhën në zjarr. Të nesërmen në mëngjes, i shoqëruar nga usta Dinia, mori malet e shkoi deri tek i biri. Ajo e kishte plagë në zemër shtëpinë e vogël, atë shtëpi ku kishte ardhur nuse e re e që bërë nënë. Por Dana s'e bënte veten, as i qahej njeriu, as e zinte në gojë. Kur usta Dinia i kujtoi shtëpitë që u dogjën një natë më parë, ajo e hodhi fjalën gjetkë:

— Ç'është kjo pushkë Dine?

— Eshtë pushkë komandanti të kuq, Danë, e Spiru Shtegut nga Malet e Shqipes.

— Po si erdhi deri këtu?

— Spiro Shtegu e pa që u bëra merak pas kësaj dhe një ditë ma vuri në sup si pa të keq. Bre, dhashë e mora që të mos ia merrja, po pse, i mbushej mendja? »Merre usta, më tha, unë kam tjetër, kurse ti, si armëtar që je, s'është keq se e ke një pushkë si kjo». S'pata ç'të bëja. E mora dhe u dhashë malipherin tim të vjetër.

— Më çudite! — foli Dana duke prekur tytën me drojtje. — Çfarë i ndreqe ti kësaj?

— Ja këtë. I qe shtrembüruar nga plumbi i taljanit.

— Po ç'punë bën ky picërr si majë gjilpëre? Usta Dinia s'e mbajti të qeshurën.

— Pa thep pushka s'vlen fare. Me atë vihet nishan.

— Po hajde e ma rrëfe një herë si vihet nishani!

— Nishani? — pyeti usta Dinia duke u hedhur në gjunjë me shkathtësinë e një të riu... — Ja, kështu... kondakun pas gjoksit. Ashtu... Hajt, tani shiko teneqenë e oxhakut. E pe?... Tani vëre thepin...

— Ç'thep, mor Dine?

— Picrrin, pra.

— Po kështu fol!

— Teneqenë dhe picrrin futi te kjo shqekëza. Ja, të kjo këtu, Gati je?

— Gati.

— Aha, kështu s'ke gjë në vijë, duhet të mbyllësh syrin e majtë, se pérndyshe.

— S'm'u mbyllka!

— Po mos i mbyll të dy.

— Po hë de, jap të mbyll njërin, më mbylljet dhe tjetri!

Usta Dinia i vuri pëllëmbën e dorës në syrin e majtë.

— Shikon tani?

— Shikoj, Dine, po ç'dreqin ka teneqeja që më kërcen lart e poshtë?

— Ej, moj Danë! — S'të ka faj teneqeja, por duart që të dridhen.

— Më çudite! — e shikoi me frikë Dana. — Domethënë unë kurrën e kurrës nuk mund të shtie e të vras fashistë?!

— Jo xhanëm, i vret që ç'ke me të, por duhet të mbështetesh gjékundi. Në këtë jastek.

Dana s'e bëri të gjatë, afroi jastëkun nga vetja dhe mbështeti bërrylat mbi të.

— E shikon?... Hajt, zhgrapja,

— Na, pra, bëje gati. Vetëm kujdes se mos e mbush shejtani e po ngremë fqinjët më këmbë?

— Mos ki merak, Danë, shejtani s'ka plumba partizanësh! — i tha me të qeshur usta Dinia dhe ngriti llozin.

Dana shtrëngoi buzët, mbylli syrin e majtë dhe ia pat «Çap».

E vrave, Danë!

— Or po, mos qofsha, tre muaj qëndrova maleve, me çunin e s'e zhgrapa një herë të shkretën.

— Mos u dëshpëro, ke për të dalë përsëri malevë. Atje e kemi kokën, po të na shërohet Marku më parë.

\* \* \*

Duke dredhuar nëpër rrugica e kopshte, më në fund, qëndroi për të dëgjuar më mirë murmuritjen e madhe që ngrihej nga qendra e qytetit. Lumtën e pushtoi malli për vitet e fëmijërisë, kur ajo shkonte te sheshi i pazarit, që ziente nga mëngjesi në mbrëmje...

...Afér prefekturës, nëpër rrugët që të çojnë në pazarin e drithërave e të zarzavateve, turma ecën me rrëmbim. Dikush, i kërrusur nën peshën e thesit, merr anëve të rrugës, ku njerëzit janë më të rrallë. Pak më tej dëgjohet krikëllima e rrotave dhe zëri i fuqishëm i karrrocierit:

— Salla!

Jo vetëm zhurma e lëvizjet, por edhe ngjyrat ndryshojnë orë e çast. Nga larg rruga duket e shtruar me lëvere të kuqe plot oje të fshatarkave. Aty-këtu zbardhin takjet e qeleshet ose nxin ferekheja e ndonjë qytetareje. Ja, një nuse e re me fustan të kuq, me byzelik të florinj-

të, ecën me kujdes duke shkelur gur më gur me këpucët spic. E shoqëruar nga shërbëtorja, nusja, me ecjen e saj nazike, duket sikur do që t'u kujtojë të tjerëve bukurinë, rininë dhe pasurinë e saj. Por jo, njerëzit s'kanë nge të hedhin vështrimin nga ajo. Me barrë në krah ose duke hequr kafshën për kapistre, fshatarët largohen nga she-shi pa humbur kohë. Duhet kthyer sa më parë në fshat; atje i presin punët që s'kanë të sosur. Ja njërit prej tyre i janë tharë buzet, ndoshta s'ka ngrënë tërë ditën, por, megjithatë, në sytë e tij lëvrin një shkëndijë gëzimi. Në grykë të torbës duket një simite e kuqe, peshqesh i rrallë për fëmijët.

Ditëve të pazarit, sheshi i vogël është i vetmi vend ku sytë s'të shikojnë ushtarë të huaj me shelmeta në kokë. S'dihet se pse atyre s'para ua ka ënda të çajnë përmes turmës së ngjeshur! Por të nesërmen, nëpér atë shesh do të trokasim këpucët me gozhdë të patrullave, kurse rrugët e ngushta, ndërtesat e vjetra e të ulëta të qytetit ngjajnë sikur presin me padurim javën tjetër, kur turma do të vijë në gjirin e tyre për t'u dhënë përsëri jetë e gjallëri.

... Edhe atë ditë, ndërsa rrinte aty në mes të kopshtit, Lumta përpiquej të dallonte zérat e ndryshëm, hingëllimën e kuajve, krikëllimën e karrocave, vajin e fëmijëve të imirë kopan në prehër të fshatares, zérin monoton të furxhiut që shet simite me kanistër në kokë, ose thirrjet e gertexhinjve, tek lëvdojnë me fjalë të bukura mallin e tyre.

Lumta e gjeti Sanijen duke punuar një triko leshi për të atin. Pas çdo pesë a gjashtë shtizash, Sanija kthente kokën nga gjuri i djathjtë, ku mbante një libër të hapur dhe lexonte një copë herë me vëmendje të thellë. Me sa dukej, leximi e lodhte shumë, fërkonte sytë shpesh dhe niste përsëri të thurte trikon. Po mbusheshin gjashëtë muaj që ajo merrte pjesë në rininë komuniste tinëz dajë Muratit. Puna e saj ishte mjaft e kufizuar; shpërndante komunikata dy herë në javë në të rejat e lagjes, bënte dhe agitacion, por shokët e shoqet i kishin thënë se më parë ishte e nevojshme të dinte shumë gjëra vetë,

pastaj t'u fliste të tjerëve. Nga ana tjetër, dajë Murati i rrinte gjithnjë si çekan mbi kokë:

«— Çfarë po këndon ashtu, Sanije? — e pyeste ai me dyshim.

— Përralla, baba!

— Hë... Pa më trego njérën!»

Dhe Sanija, përveç hallevë të tjera, ishte e detyruar të shpikte edhe përralla pas përrallash...

— Po ku je, moj Lumtë? Im atë ka qejf të të shikojë e të të pyesë si venë punët e luftës.

— E ka kthyer mendjen për çarçafin tënd?

— Jo. Si më parë. Thotë se shkollarët si Lumta le të dalin e të luftojnë, kurse ju, shtëpiaket s'dini ta mbani veten, bëni gafa. Atij ia morën mendjen pëllumbat.

Sanijes nuk i rrin në duart rehat, herë i ndreqte Lumtës jakën e bluzës së kuqe, herë i shtrëngonte kollanin e mesit ose i largonte nga balli një qime floku të ndarë nga gërshetat.

— Në shtëpinë tënde dëgjohet fare afër zhurma e pazarit — e ktheu muhabetin Lumta. — Si të durohet që rri në shtëpi? Ah, të mos isha ilegale, do vrapo-o-o-ja, aq do vrapoja, sa fryma të më merrej derisa të shkoja në mes të pazarit. Sa më ka marrë malli për të parë qytetin

— Pa më pyet mua një herë? Ty të mbyllën fashistët, kurse mua çarçafi!

— Së shpejti do të shkojmë në mal...

— Unë jam gati! Dje ia thashë troç përgjegjësit në mbledhjen e grupit të rinisë. Dua të dal partizane, i thashë, për tim atë as mos pyetni, i thashë, do të bërtasë ca kohë, pastaj do të bindet, i thashë. — Pasi heshti një hop, vazhdoi përsëri:

— Moj, po këto do t'i presim? — pyeti duke marrë në duar gërshetat e veta.

— Dó t'i presim, — iu përgjigj Lumta. — Pas luftë shohim e bëjmë, mbase i rritim përsëri.

— Sa keq! Gërshetet e mia s'para kanë pamje, verdhucka. Po këto të tuat të therin në zemër, si pendët e korbit!

— Ç'flet kështu? Kurse mua më pëlqeijnë më shumë flokët e tu, se si të shkëlqeijnë në diell!

— Të mitë?! Uh, pika! — klithi ajo dhe diç iu kujtua.

— Ç'ke?

— Im atë më porositi që, me të ardhur ti, të ther pikaloshen.

— Lëre zogun e shkretë. Unë do dal përsëri se kemi një mbledhje. Kur të kthehem bëjmë si bëjmë pér të ngrënë...

— Po komunikatat m'i solle?

— Po.

— Tashti hajt të zëmë pikaloshen. A të kujtohet pikaloshja jonë? E therim, ti shko në mbledhje, kurse unë e pjek gati pér darkë.

Dy vajzat vrapuan një copë herë nëpër oborr pas zo-gës por ajo doli më e lehtë se ato; ia nisi me të kakarisur aq sa zhurma u dëgjuan deri në han. Daj Murati nxori kokën në dritare:

— Moj Sanije! briti me të egër. — Ç'kanë pulat që morën kot?

— Ka ardhur Lumta! — i pëshpëriti ajo me zë të ulët rrëzë murit.

— A!... Mirë pra! — i qeshi fytyra dajë Muratit.

Pasi e kapën zogën, dy shoqet s'po vendosnin ta thernin, teksha ajo i shikonte me sytë e saj të vegjël, si rruaza të zeza.

— Vëri dorën në gjoks, sa fort i rreh. Fshihe thi-kën mos ta shikojë!

— Na, there vetë! — i tha Lumta.

— There ti!

— S'më bën zemra!

— As mua s'më bëjnë duart! — tha Sanija, duke shikuar pikaloshen që përplaste krahët pér të shpëtuar.

— Unë them ta lëshojmë.

Sanija u mendua pak.

— Edhe unë ashtu them.

Ato mbetën me thikë në dorë, derisa më në fund vendosën dhe e lëshuan zogën; por, megjithatë, dy vajzat e ndoqën me shikim të dhembshur pikaloshen; ajo patjetër do të therej: dajë Murati e kishte taksur për Lumtën.

\* \* \*

Dy orët e para të gjithë dëgjuan me interes dhe se-cili pyeti e mbajti shënimë. Orën e tretë të leximit interesi ra, kurse në orën e katërt shumica e pjesëmarrësve futën fletoret nëpër xhepa dhe varën buzën. Nga fundi Bardhyli kishte kërrusur kokën dhe s'donte t'ia dinte fare për ato që thuheshin. Rifati qe bërë merak pas duarve të veta, i lëmonte, kruante ithonjtë dhe, për të dhjetën herë, barazoi gishtat njërin me tjetrin; më në fund i mbështeti të dy pëllëmbët në prehrin e Bardhylit!

— Shikoji, aman, — i pëshpëriti në vesh. — Sepse po më duken më të trashë gishtat e dorës së djathtë!

Bardhyli foli me përtim, si ta kishin zgjuar nga një gjumë i rehatshëm:

— Po ashtu duhet të jenë.

— Pse?

— Dorën e djathtë njeriu e ka më të zhvilluar. Ja, të marrim shembullin tënd. Kur ndërton mure, ti e mban mistrinë gjithnjë me dorën e djathtë.

Rifati e shikoi nën vetulla, si për t'i thënë: «Ej, loço/gjete me cilin të tallesh!» Por atij i tha:

— Çudi!

— Po ti ç'bën? Dëgjon apo s'dëgjon ç'po lexon shoku?

— Aq sa po dëgjon ti!... E mora vesh ku e ka hallin, U ngrit Spartaku me robërit e më t'ia... nënën aristokratëve!

Lumta e shikoi me vërejtje. Bardhyli uli kokën, kurse fytyra e madhe e Rifatit u skuq si e një vajze të turpshme. Por, me të parë nga fundi i bahçes rojen në majë

të murit, Rifatit iu largua përsëri mendja. Ah, ishte njeri pa fat ai, sot ta kishte pasur radhën për të bërë roje! Pak më vonë vëmendjen e Rifatit e tërthoqi zoti Vasil. Ai doli në bahçë u erdhi përqark rrënjjëve të portokallave, u vuri sfurqe degëve të rënduara nga kokrrat dhe, papritur, nxori nga xhepi një copë spango. «Shiko, morel — u çudit Rifati sikur zunë t'i hanin pëllëmbët. I kujtohej bishti i mistrisë, zhurma që nxjerr ajo kur fërkohet me llaç pas faqes së murit. Padashur lëshoi një psherëtimë, që e dëgjuan të gjithë.

Edukatori heshtि për një çast, vuri buzën në gaz dhe foli me zërin e tij të butë, por autoritar:

— U zgjata ca, shokë, së shpejti i jap fund.

— Jo, mor vëlla, lexo sa të duash, e pata hällin gjetkë unë! — i foli Rifati, i penduar, dhe kësaj radhe u mpreh të dëgjonte me tërë vëmendjen. Por... ja që zoti Vasil u kthyte përsëri në bahçë, i veshur me rroba të vjetra, me një kazmë dhe lopatë në dorë.

Pas pak, Petriti, pasi bisedoi me shokun me gjyzlykë, e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Mirëpo pikërisht atë çast Bardhyli tha:

— Pritni, kam një pyetje, — tingëlloi zëri i tij prej tenori. — Këtu u tha se në të gjitha sistemet shoqërore, duke përjashtuar sistemin e fundit, socializmin, shfrytëzimi i njeriut prej njeriut nuk është hequr, por janë ndërruar vetëm klasat shfrytëzuese. Kështu?... Tamam. Atëherë unë kam një pyetje... i

— Bjeri shkurt, se ma prure në majë të hundës! — ia preu Rifati.

— Prit, or shok, s'është aq lehtë, i thonë teori! — e mori përsëri fjalën Bardhyli. — Pra, unë kam këtë pyetje: po sikur të kishte fituar Spartaku, a do të që zhdukur që në ato kohëra shfrytëzimi? Apo edhe ai do të pranonte të bëhej mbret?

— Perandor dhe jo mbret! — foli Qamili si nëpër gjumë. — Duhet parë historikisht.

Disa nga shokët qeshën, por ja që Rifati e mori me zjarr.

— Hajt e ma shpjego, të kam rixha; — ia pat ai.

Në fillim u dëgjuan disa pëshpëritje, pastaj dhoma zjeu si koshere bletësh. Të gjithë sa merrnin pjesë në mbledhje, ia nisën bisedës dhe s'qe e mundur të vendosë qetësia, megjithë përpjekjet e Petritit, që ishte ngri-tur më këmbë.

— Pritni... Ju sikur s'paskeni qenë fare këtu!

Gjatë leximit të broshurës «Sistemi i skillavërisë», ata mbetën të kënaqur me luftën e robërve, të udhëhe-qur nga Spartaku. Dukej qartë se asnjerit prej tyre s'i vinte mirë që ta bënин Spartakun perandor.

— Kështu nuk shtrohet problemi... — mundohej të shpjegohej Petriti. — Ti thua se po të fitonte Spartaku, shfrytëzimi do të ishte zhdukur që në ato kohëra...

Dhoma ziente dhe biseda kthehej edhe një herë në pikën ku qe nisur:

— Mor vëlla, e kemi të qartë, — foli Rifati. — Lufta e robërve qe një hap përpara pér zhvillimin e shoqërisë. Pas shkatërrimit të skillavërisë u vendos feudalizmi (lexuesi i broshurës tundte kokën me aprovim dhe që për-tej gjyzlykëve sytë e tij të vegjël shkëlqenin nga gëzimi). Por Bardhyli do të dijë nëse do të bëhej apo jo perandor Spartaku?

— Do të bëhej që ç'ke me të!

— E pamundur!

— Të lumtë! Bravo të qoftë!

— Pse?!

— Ama dëngla, ore, lëre të na flasë shoku...

Rifati hapi krahët anash, si të donte të fluturonte dhe vendosi qetësinë me një britmë të fortë:

— Hajt, të dëgjojmë ç'na thonë studentët! — foli ai duke iu drejtar Qamilit.

U vendos disi rregulli dhe Qamili, duke ndier vësh-trimet e shokëve, lëvizë pak nga shiltja ku ishte ulur. Në sytë e tij të kotur dukej qartë se deri në atë minutë ai s'i pat dhënë rëndësi asaj pyetjeje. Në fillim u bë gati të thoshte se punët nuk shtroheshin më «po sikur, dhe lufta e Spartakut s'qe luftë pér socializëm, por, tamam në atë çast, dikush e ngacmoi nga prapa duke i përshpëritur:

«Nuk pranonte Spartaku tē bëhej perandor, jo!»

Qamili ktheu kokën nga ai dhe, nuk dihet se pse, donte tē përsëriste po ato fjalë, por, kur një çast më vonë dëgjoi tē kundërtën nga krahu tjetër, atëherë mbushi faqet dhe foli si tē shtinte me top:

— Do tē bëhej!

Dikush qeshi, disave u mbeti hatri, një tjetër ia krisi:

— Mirë e ka Qamili!

Në mes tē kësaj rrëmuje, Rifati brofi më këmbë. Nga gjatësia sa nuk iu përpoq koka në tavanin e ulët tē dhomës:

— Si the, o shoku Qamil? Do tē bëhej?! Kaq shpejt e harrove se Spartaku s'qe veçse një punëtor i thjeshtë? E ku dëgjon punëtori tē bëhet perandor, more? Ja, — dhe zgjati përpara duart e veta si dy lopata tē gjata, — i shikon këto tē shkreta? S'e harrojnë kurrë zanatin, duan punë këto e jo kulltuk. A e patë zotin Vasil në bahë, kur mati murin me spango?

— E pamë! — u përgjigjën ca zëra.

— E, pra, — vazhdoi Rifati, — që nga ajo minutë më ka zënë një e kruar në duar e s'po më durohet derisa tē mbarojë kjo mbledhje...

— E kam tē qartë pyetjen, — ia preu fjalën Bar-dhyli. — Përsa u përket duarve, tē gjithëve po na hanë, tē gjithë punëtorë jemi:

— O burrani në bahë!

— Mos thërritni!

— Dhe dëgjoni, herë tjetër, më tē shkurtra mbledhjet! — pëshpëriti dikush.

— Mirë thotë, më tē shkurtra!

— Patjetër!

Përveç kazmës dhe lopatës çunat kërkuan nga zoti Vasil një teneqe pér ujë dhe një mistri. Drejtimin e punës e mori Rifati. Pikë së pari, ai caktoi nja katër veta pér tē bërë roje, pastaj ndau ata që do tē përzienin bal-tën, si dhe ata që do t'i jepnin gurët. Shokun me gjyzly-kë, si shëndetdobët, e caktoi tē mbante fijen e spangos. Ai kundërshtoi, por Rifati ia pat:

— Këtu jam unë i parë. Rri urtë, ashtu siç ndenja edhe unë në mbledhje.

— Ama, urtë ndenje! — e thumboi Bardhyli.

— Pusho ti atje! — iu kërcënuar Rifati dhe, pasi mori mistrinë në dorë, thirri:

— Para-marsh!

Puna filloj me shpejtësi dhe zotin Vasil e mallën-gjeu gëzimi i çunave si dhe ajo bindje që tregonin ata kur jepte urdhra Rifati.

— O burra, Rifat, jepi si Spartaku!

Në orën shtatë të mbrëmbjes Rifati u hodh nga maja e murit, pastroi me kujdes mistrinë, hapi krahët e gjatë dhe mbushi gjoksin me frysë, duke shikuar hapësirën që po errësohej.

Zoti Vasil Gjinari vuri re se shokët e rrethuan muratorin, duke e vështruar me ëndje e zili trupin e tij të madh e të lidhur mirë: «Ah, të isha i ri në këto kohëra!» — murmuriti me vete, duke ndier edhe ai zili për fuqinë e shkathtësinë e Rifatit.

## *Kapitulli i gjashtë*

### **NJË NATE NË VENDIN E PUSHTUAR**

Që kur doli ilegale, më se tre muaj më parë, Lumta Gjinari s'kishte fjetur asnjë natë në shtëpi. Vinte rrallë sa për t'u qmallur ose për t'i larë e hekurosur të atit ndonjë rrobë, pastaj shkonte herë te kushërinjtë e herë te shoqet, veçanërisht te Sanija e dajë Muratit. Por atë natë e zgjati ca si shumë tek i ati.

— Demek, dajë Murati të paska therur një zogë.

— Theri pikaloshen. Ti s'e pate parë pikaloshen. Sa e bukur ishte pikaloshja!

Vasili hapte përsëri librin për të lexuar, por errësira që mbulonte dritaret nuk e linte të getë. Që kur erdhën gjermanët s'kishte natë të mos kërciste pushka.

— Gjermanët e ngritën gestapon. Tani duhet të ruheni.

— Ja dhe pak, baba. Sa t'i hekuros të gjitha!

— Lumtë, pse e kursen kostumin e ri?! Edhe sandalet e kuqe mbathi përderisa s'kanë filluar shirat.

— Do t'u vijë radha. Sa për sandalet e kuqe, më dalin nga këmbët e s'janë të përshtatshme për ilegalët!

Aty nga ora nëntë, apo ajo palosi rrobat e hekurosura, u dëgjuva një e trokitur e fortë te porta.

Vasili lëshoi gjyzlykët mbi minder dhe u ngrit. Në

fytyrën e tij ra ajo hije e ftohtë që i bie të dënuarit me vdekje kur ka humbur qđo shpresë shpëtimi.

Në rrugë u dëgjuan të ecura dhe porta trokiti për herë të dytë.

Pa humbur kohë, Lumta mori revolen nën jastëk dhe iu drejtua të atit me zë të ulët:

— Baba, ata s'vijnë vetëm për mua.

Vasili u zembraps me vendosmëri.

— Unë s'kam ku vete... Do të rri këtu për t'i mbajtur me fjalë derisa ti të kapërçesh bahçen.

— Jo, do të ikim bashkë!

— Lumtë, mos u bëj merak për mua!

— Do të të internojnë!

Vasili e shikon me mëdyshje.

Në rrugë u dëgjuan llomotitje të mbytura.

— Do të dalim bashkë në mal, te partizanët.

Vasili u lëkund. Koha s'priste. Atje përtëj filluan të bërtisnin e të qëllonin kanatet e portës me kondakët e pushkëve.

— Shpejt, baba.

Kur u shqye porta, atë e bijë e patën kaluar derën e bahçes. Gjithçka kishte humbur në errësirë; një sqottë e hollë rrihte pas gjetheve të pemëve dhe nëpër lamarinat e teneqetë e oxhaqeve. Pasi u ngjitën nëpër shkallët që shërbën për vjeljen e portokalleve, ranë në kopshtin fqinj. Aty u qetësan disi dhe i ngadalësuan çapet. Lumta, që kishte shkuar përpara, priti të atin që mezi mbushej me frymë.

— Ej, ti plak, ku shkon? — u dëgjua një zë prapa një gardhi. — A mos je mësuesi?

Vasili, që s'para shikonte natën, qëndroi duke mbuluar Lumtën me trupin e vet, pastaj pyeti:

— Cili je ti?

— A, edhe pyet cili jam unë? — tha i panjohuri duke i kthyer llozin pushkës. — Afrohu, se për ty e bëmë harram gjumin sonte. Po gocën ku e ke? Apo është hazdisur pas djemve!

Aty pas shpinës, Vasili ndjeu se Lumta nxori revolen dhe mori shenjë me dorë të mbështetur mbi supin e tij.

Vasili mbeti një hop më këmbë i shushatur nga krisma, pastaj u lëshua me vrap pas Lumtës. Pak më tej u dëgjuan britma e të shtëna. Vasilin po e linin këmbët, por prapëseprapë ai vraponte, duke i ardhur keq që s'pati armë e t'i bëhej krah së bijës.

Pasi ecën dhe pak, ai qëndroi:

— Lumtë, nuk eci dot, m'u zu fryma!

— Edhe pak!

— Ikë ti. Unë, në mundsha, po fshihem në han të Muratit.

— Në han është më rrezik! Është rrethuar e gjithë lagjja!

— S'kam ç'bëj. Nuk eci dot.

Lumta ngurroi një çast.

— Baba! — ... po ç't'i thoshte?

U puthën dhe u ndanë. Vasili s'lëvizi nga vendi, derisa silueta e Lumtës u zhduk përtej, pastaj u nis drejt hanit me çap të ngadalshëm.

... Në kopshtin e fundit, Lumta qëndroi për t'u ghodhur pak. Atë s'e ndanin veçse disa hapa nga Zaranika, pas së cilës shtrihej ullishta e heshtur dhe e errët. Kishite vendosur të shkonte deri te çifliku i Tyxharëve në mullirin e xha Shahinit. Edhe këtu e tre muaj po atje kishte shkuar për t'u shpëtuar ndjekjeve. Atëherë kishte qëndruar tri ditë në mulli bashkë me Filen dhe Blertën. Por kësaj radhe do të kthehej që të nesërmen. Do të kërkonte të atin, do të pyeste për Petritin, se kushedi... Duke menduar kështu, veshët e saj dëgjuan trokashkën e mullirit. Para syve i doli figura e xha Shahinit, e lyer e tëra në miell, pastaj Filja me guxmin e natyrshëm, pastaj Blerta me shqetësimin e saj. Po tani të dyja ato ishn në mal me partizanët... Zbriti me kujdes kapërcyellin e fundit, mirëpo, pa i zënë këmbët dhe, një goditje e befasishme e trulloosi prapa kokës. Një copë herë s'e mori dot veten dhe, kur u kujtua se duhej të ngrihej, nijë palë duar të forta e shtrënguan për beli dhe e përplasën përsëri në tokë:

Dikush ndezi elektrikun e dorës.

— Bëj!

- C'dreqin ke?
- Shiko, aman, erdhëm për sorrë, ramë në pulë!
- Hesht!
- Peqe!
- Shko deri te zalli për të marrë ujë, se i ka rënë të fikët.
- Me çfarë ta marr ujin?
- Me q'të duash. Me grushte.
- Peqe, bej!

\* \* \*

Trokiti dhe, si ta pritnin me kohë ardhjen e tij, dera e vogël e hanit u hap, duke lëshuar në kopsht një brez të zbehtë drite.

— Murat, më bëj vend. Jam Vasili.  
 Pas një heshtjeje të shkurtër, Murati pyeti:  
 — Po të ndjekin, zoti Vasil?

Në dritën e fenerit, Vasil Gjinari shqoi vetullat e thinjura të Muratit.

— Bujrëm, zoti Vasil!  
 E futi brenda, mbylli derën me lloz dhe ia bëri me dorë që t'i shkonte prapa. Pa thënë asnjë fjalë, Murati eci me hap të vendosur, mori një sfurk, u fut në magazanë e barit dhe, pasi hapi një vrimë, i tha:

— Futu, zoti Vasil!  
 Ndërsa po e mbulonte me bar, në kopsht u dëgjuan britma dhe një e shtënë revolveri. Por Murati nuk u ngut. E mbuloi mësuesin deri në grykë, pastaj i hodhi një kurorë bari mbi kokë.

— Duro pak, zoti Vasil, se erdhën qafirët!  
 — Ej, hanxhi, hape!  
 Shamata vazhdoi disa minuta.  
 — Plasja ju rëntë! — u dëgjua zëri i përgjumur i Muratit. — Në doni të blini bar, ejani nga porta e madhe.  
 — O Murat, hape se është qeveria.

Një hop heshtje.

— Sa qeveri të tilla kam parë unë!... A?!... Qeveria? — bëri sikur u çudit Murati.

— Hape shpejt, po të them!

— Çfarë qeverie është kjo që të vjen nga dera e qenefit!

Kaluan dhe nja dy minuta të tjera në heshtje derisa rënkuan çivitë e ndryshkuara të derës së kopshtit.

— Oj, pa dale! — u çudit Murati, duke e shtyrë atë që deshi të hynte i pari. — C'është kështu? Ti më qenke veshur si komit?

— Dëgjo këtu, plak i dreqit! — iu kërcënuar tjetri duke i vërtitur grykën e revoles para syve. — Ta djeg hanin me ç'ke e ku ke. Të përcëlloj të gjallë edhe ty brenda. Ne jemi ballistë e jo komitë.

— Në jeni ballistë, shëndosh qofshi! — ia ktheu Murati pa e prishur gjakun. — Hyni andej nga hyhet e jo nga kopshti.

— Lëri llafet. Sapo na e vranë një shok. A ke komunistë në han?

— Ta thashë, hanin nuk e kam për komitë.

— S'po të them komitë, por komunistë!

Ballisti mori të futej brenda, por Murati nuk i hapi rrugë. Ngriti fenerin dhe i ndriçoi fytyrën.

— C'më shikojnë sytë?! — bëri sikur u çudit ai.

— E, ç'të shikojnë? — u ngrys ballisti, një gjatovinë me kokën për mbi derë.

Murati buzëqeshi:

— Oj, që kur kështu? Edhe ti Qazim e paske hedhur pushkën në krah!... Gjettë rahmet, të paska nxjerrë nga hundët yt atë!

— Plakun e kam gjallë edhe sot e kësaj dite.

— A, të pastë ymër! Mos ma e vini re ne pleqve. Ne të vdekurim e nxjerrim mbi tokë, të gjallin e mbuljmë me dhé.

— Me dhé apo me bar? — pyeti Qazimi me djallëzi.

— Murat, a mos kujton ti se punojmë më tym ne? Hap

rrugë! — iu kërcënua. — Ku e ke futur të atin e asaj orrospisë, që sa po na vau shokun?

— Hajde i bir i Demes, hajde! Ti më qenke bërë bilbil nga goja! Dhjetë vjet ka Murati që ka zbritur nga fshati, ty të kujtohet mirë, apo jo, kur më përcole në pikë të dimrit e më mbaje Sanijen hopa... Nejse. E, pra, dhjetë vjet në qytet e me politikë s'di të jem marrë ndonjëherë. Mre kam parë Zogun, mre Duçen, mre Hitlerin, po Murati mbeti po Murat! :

— Dajë Murat, mos e zgjat muhabetin, se jam në detyrë. E di që je burrë i ndershëm, të njoh mirë, se nga një fshat jemi, por sot kamë ardhur të tjera kohë, s'të besoj dot, politika na bëri të gjithë katran me bojë. Hapu, se do të futemi brenda.

Murati uli fenerin, por nga pragu nuk u largua.

— More Qazim, mblidhe mendjen, jam me gocë në shtëpi. Turp kush ta dëgjojë!

— Ohu, ti qenke prapa dynjasë! E kush pyet sot se ke gocë në shtëpi? Pastaj, mos harro, Sanijen e kam si motrën time. Ne duam mësuesin. Na dorëzo plakun e s'të ngasim më. More vesh gjë zotrote?

— Ej, ç'më zuri me ju! Hëjde, pra futuni, — u tha Murati dhë, ndërsa po zmbrapsej, lëshoi si padashur fenerin nga duart.

— Tyt, lanet! ofshani. — Mezi të bleva!

Poçi krisi copë e thërrime; vajguri u derdh; errësira mbuloi oborrin.

— Mos, Murat! Na le pa dritë? — briti Qazimi.

— Pritni sa të marr një tjetër, — dhe i lëshoi zë Sanijes.

Kur kapërcyen pragun, u dëgjua një zhurmë e mbytur, si goditja e një çekiçi mbi dërrasë të kalbur.

— Oh! Unë i ziu! — klithi Qazimi.

— C'pate? — pyeti Murati.

— Lere, mos e pyet. M'u përpoq balli te dera.

— S'të ka faj njeri, i ke këmbët të gjata.

— Ti i ke fajet e jo këmbët e mia. Na le në errësirë. E theve, qafir! — fliste Qazimi me kokë të trullosur.

Tre ballistët, me Muratin në krye, pritën në mes të oborrit derisa Sanija solli një fener tjetër.

— Mashalla, sa të qenka rritur goca! — u çudit Qazimi. — Më ke harruar? — pyeti duke u drejtuar nga ajo. — Të kam mbajtur në krah. Atëherë ti ishe tetë vjeçë, kurse unë njëzet e kusur...

Qazim! — e shpoi njëri nga ballistët. — S'erdhëm këtu pér të bërë llogje!

— Gocë, — foli ashpër Murati, — shko brenda!

Tre ballistët, me Muratin përpëra, u futën në magaza. S'lanë denga pa rrokullisur, s'lanë vend ku s'futën sfurqet e duart, por s'po gjemin gjë.

Murati ishte hequr mënjanë, i ngrysur dhe i hesh-tur. Një frikë e tmerrshme ia kishte marrë fare mendjen.

— Ngrije fenerin, or ti! — urdhëroi shokun e vet Qazimi, kur pa kurorë bari të hedhur në një rrëzë.

— Ja ku e paska futur! Ej, Murat, kur u bëre dhe ti komunist! — foli Qazimi duke iu afruar vendit të dyshimtë.

— Epo, qameti të bëhet... — deshi të tregonte Murati, por Qazimi ia preu:

— Rri e mos fol, se që nga kjo minutë u bëmë ar-miq, të betuar! — i tha duke shpuar kurorën me sfurk. Pastaj futi duart thellë, e hodhi barin matanë, por s'gjeti njeri!

— Më duket se të ramë më qafë kot, Murat! — foli nëpër dhëmbë Qazimi. — Kështu e kanë këto punë. Mos e prish zemrën.

Murati as fliste, as lëvizte. «Nuk qenka aty zoti Vasil? — pyeti veten. — Po ku shkoi? Ku?»

— Mos m'u zemëro, Murat, dëgjon... Ama goca të ishte rritur! Oh, sa po më dhemb balli! Aq u vrava, sa u bëra pér qepë me kripë. Hajt, mbeç me shëndet! Ejani, shokë, të ikim! — u lëshoi zë dy të tjerëve që kërkonin akoma.

— Dal, të shikojmë lart. Të futemi dhe në shtëpi! — foli tjetri.

— Hajde, se e di Qazimi atë punë. Kur s'ka gjë në bar, domethënë hani është i pastër.

Te pragu i derës u dëgjua një zhurmë e mbytur.

— Oh, ç'u vrava përsëri! — ofshani Qazimi. — Djalili të marrtë, Murat, me gjithë derë që paske!

— Të thashë, është derë e qenefit ajo! — e talli Murati, që sakaq e kishte marrë veten. — Po s'ka gjë. Se mos është plagë plumbi.

— Oh, unë i ziu, si e pësova!

Me të mbyllur derën hanxhiu u mbështet pas murit dhe zuri kokën me duar: «Epo i trashë je, o Murat! — iu drejtua vetes. — A fshihet burri në bar? Atë hile e di gjithë bota... Po ku shkoi zoti Vasil?...» Me këto mendime kaloi derën e vogël që ndante hanin me shtëpinë, eci përmes oborrit dhe mezi u çapit deri në hajat.

— Baba! — e zuri për krahu Sanija. — Zotin Vasil e mbështolla me hasër dhe e vura më këmbë në qoshe të dhomës.

Muratit sa nuk i shpëtoi feneri nga duart. Pa thënë asnjë fjalë, shpejtoi çapin:

— O zoti Vasil! O zoti Vasil! — u dëgjua zëri i tij në buhar e brenda në dhomë.

\* \* \*

— Plasi pushka! — foli Rifati duke mbajtur vesh krismat.

Bardhyli, që priste t'i jepnin komunikata për t'i ndarë në pako, nxori kokën në dritare.

— Po bëjnë të tyren, si çdo natë! — tha pa e përcaktuar dot vendin ku binin.

— Luftë i thonë! — Qamili tundi kokën i mërzitur, fshiu me shami djersën e ballit dhe, pasi e rrrotulloi një dy herë dorezën e shaptilografit, u ul në dysheme, duke u mbështetur mbi një thes të mushur me komunikata e broshura, të ardhura nga Tirana.

— Si e solle gjithë këtë thes deri këtu?

— Unë? — pyeti Rifati, që vazhdonte punën mbi shaptilograf. — Në krah e solla!

— A mbahet ky? — Qamilit po i mbylleshin sytë nga lodhja e pagjumësia.

Rifati tha:

— Je rritur në mes të të mirave ti; punon babai pér ty.

Qamili deshi t'i thoshte të mos ia zinte më në gojë babnë, as pér mirë, as pér keq, por basi i Rifatit nuk e la:

— Në kohë lufte, njerëzit bëjnë punë dyfishë.

— Rifat! Veç ti mos fol, se e ke zërin të fortë! — tha roja nga baxha e tavanit

— Lerna rehat ti atje! — u nxeh Rifati.

— Jo, more! — e vazhdoi muhabetin Qamili.

Pas derës dëgjohej e qeshura e përmbajtur e Petrit. Ai pyeti:

— Pastaj?

— Ta thashë, pra! — pëshpëriste Bardhyli.

— Edhe mua të ma mbash kaq të fshehtë?!

— Dashuria s'pyetka pér miqësi! Tashti që i erdhi koha, tashti po ta rrëfej.

— Pastaj?

— Ç'të flas? I shkrova e më shkroi.

— E vendosët?

— Ohu!

Pas një heshtjeje të vogël, Bardhyli i vuri dorën në sup Petritit, që numëronte komunikatat, dhe i tha:

— Sa të shkoj në batalionin partizan do t'i shkruaj një letër... E kam me gjithë mend.

— Ti po shkon pér t'u martuar! — u tall Petriti.

— Eh, ku të shkon mendja. Ato punë i kemi lënë pas lufte ne.

Sytë e kaltër të Bardhylit shkëlqenin nga gëzimi.

— Se aq duan e ta vënë bishtin prapa. Shkoi pas Katrinës, do thonë, s'ka turp, as mustaqet s'i kanë djer-situr dhe ka rënë në dashuri. E di unë, klasa punëtore duhet të shikojë luftën e jo të merret me... — Bardhyli kroi zverkun dhe shtrembëroi buzët, — mua më zuri e

keqja. Dua ta flak, por ja që s'qenka e mundur. Këtu e kam të keqen, në zemër. Shiko, se mos i thuash njeriu, or qyq.

Petriti buzëqeshi...

Në dhomën tjetër biseda nxehet.

— Lufta s'të bën më të madh nga ç'je në të vërtetë!

Rifatit iu duk sikur me ato fjalë Qamili poshtëroi luftën. Ai s'gjeti fjalë më të mëdha se këto:

— Brezi ynë është heroik.

— Brezi ynë është heroik, por i ardhshmi do të jetë brezi i mrekullive. Tani i mjafton vetëm gishti i këmbëzës, kurse nesër duhet heroizëm dhe mendje. A më kupton?..

— More, sa thellë jeni futur. Ruhuni se mos mbyteni. Brezi ynë... Brezi i ardhshëm! — u dëgjua zëri i Petritit pas derës.

Rifati zuri dorezën e shaptilografit:

— Ama teori, ore!

— Rifat! Ule zërin! e qortoi prapë roja.

Qamili vazhdoi:

— Nesër do të jetë më vështirë se sot!

— Por ata që shoshiten sot, s'i ke as për nesër. Lufta i pastron njerëzit! Ehu! — Rifati i ktheu kurrizin dhe ia nisi punës mbi shaptilograf.

Krismat e rralla nuk u përsëriten më. Qyteti ra në heshtje.

Sapo nisen të këndonin gjelat e parë, Rifati dhe Bardhyli mbushën gjirin me komunikata dhe u larguan. Në shkollë do të qëndronte vetëm Qamili, që priste mëngjesin për tu zëvëndësuar me një tjetër. Petriti mori bombat, vari automatikun nën sjetull, veshi mushamanë dhe doli në oborr. Ca pika të imëta shiu i përkëdhelen fytyrën dhe i larguan gjumin. Eci rrëzë murit dhe hodhi një grusht zhur mbi tjegullat e ulëta. Pas pak roja nxori kokën majë murit:

— Petrit! — i pëshpëriti ai.

— Gjithçka në rregull. Ik nga kopshti, — i tha Petriti.

U kthye në anën tjetër dhe hodhi përsëri një grusht zhur.

— Largohu bashkë me të tjerët. Nesër mbrëma takohemi këtu në orën dhjetë.

Prapa shkollës u dëgjua fëshfëritja e barishteve të shkelura, u thye një bisk i thatë, trokiti një tjegull, pastaj...

... Kamionët qëndruan në krye të rrugës. Feldfebeli doli i pari nga kabina. Esesët u ndanë në katër grupe. Një palë u vendosën në rrugicat e lagjes, të tjerë kapërcyen mure e kopshte dhe zunë vend rretheqark shkollës, duke vendosur «sharrësat» në drejtim të xameve të veshur me letër të zezë. Por, megjithë kujdesin e tyre e megjithëse ishte akoma errët, në lagje u përhap me njëherë një shqetësim i përgjithshëm. Të parët ia nisën qentë, pastaj edhe fëmijët bënë të tyren...

... Petriti qëndroi një hop në mes të oborrit, rregulloi automatikun nën sqetull dhe çapiti duke menduar për pushkët e rralla që u dëgjuan para mesit të natës. Se përsë i që ngulitur në mendje se ato krisma kishin rënë rrëth shtëpisë së Lumtës. Prandaj vendosi të shkonte atje; nuk do të futej brenda, po sa të shikonte nga bahçja. Mirëpo iu kujtua se atë natë Lumta do të flinte te dajë Murati, i cili i kishte therur pikaloshen! Edhe atje do të shkonte. Pasi të sigurohej se s'kishte ndodhur asgjë, atëherë do të merrte rrugën e shtëpisë, ku e priste nënë Dana, sigurisht, e shqetësuar për vonesën e tij. More, po këta qen ç'kanë që lehin?... Tërhoqi kanatin e rëndë të portës së madhe të shkollës dhe...

... Me të zbritur Petriti, Qamili mori automatikun dhe zuri vend në dritare. Nuk hipi si zakonisht në tavan për të shkuar lagjen nga baxha. Tani që kishte mbetur vetëm, ai e kishte kuptuar sa shumë ishte lodhur; i dhembte kurrizi, i çanin duart dhe i hapej goja nga pa-

gjumiësia... Po babai si i kishte hallet e punët? Qenë bërë tri ditë që ishte ndarë me të e mbase s'do ta shikonte kurrë më! Kushedi, luftë i thonë! Ah, kjo luftë!... Fundi i fundit baba e kishte, edhe mund të pajtohej, por, sidofoftë, ai e kishte shpallur veten hapur kundër Luftës Nacionalçlirimtare, ai ishte treguar ballist. Po sikur të përzihej me gestapon, se u dinte dhe gjuhën, pa le të tjerrat! Atëherë!... Pse lehin qentë me kaq ngulm?! Nejse, Qamili duhej të shkonte një herë nga shtëpia sa të paralajmëronte të atin se mos bënte ndonjë gabim dhe, sidomos, për të zhdukur ndonjë sekret që mund të kishte mbetur nëpër këmbë. Sa keq sikur lista e shokëve të fabrikës të kishte rënë në duart e të atit! Të zeztë ata po të ndodhët ndonjë gjë... Oj, si lehin qentë!... Iu hap goja fort dhe në të njëjtën kohë, në vend që t'i mbyllte sytë si zakonisht, i çapëloj sa mundi: përparrë portës së shkollës shqoi disa silueta që po zvarriteshin anës së rrugës. Një ndriçim i zbehtë, ndriçimi i agimit të parë, fekste në helmetat që rrëshqitnin si njolla të hirta pas murit. Në çast e mblodhi veten, hoqi siguresën e automatikut, u ngrit më këmbë dhe thirri:

— Petrit, mos e hap portën! Gjermanët!

Një varg krismash sharroi hapësirën, duke thyer xhamat e shkollës. Qamili, u kërrus dhe, pa e hequr vështrimin nga siluetat që u vërsulën drejt portës, hodhi një granatë. Vetëm një eses u ngrit si i mpirë, duke shtënë kuturu; por edhe ai, pasi bëri dy hapa, u kolovit dhe ra përmbyss.

Duke përfituar nga errësira, Petriti u tërroq pa humbur kohë, vrapi përmes oborrit dhe zuri vend në njérën nga klasat e katit të parë. Të mugëtit po përhapej dhe sendet po shquheshin më qartë. Sapo doli në dritare, pa të vërvshonte vala e parë e gjermanëve dhe e ballistëve. Petriti nuk u ngut. Kur ata u afroan rrëzë murit, atëherë u hodhi një bombë. Shkolla u mbulua në tym e flakë nga fishekët me zjarr. Qëndrimi në katin e parë u bë i pamundur. Pasi i futi një karikator tjetër automatikut, doli nga klasa dhe mori vrap nëpër shkallë. Nga dritarja e katit të dytë zmbrapsi me breshë-

ri esesët që ishin përhapur nëpër oborr dhe, pa e bërë të gjatë, i lëshoi një zë Qamilit.

— Në çati!... Rrethimi duhet çarë nga kopshti!

Kur doli në majë të çatisë, Qamili ndjeu t'i fishkëllinenin plumbat mbi kokë. U shtri barkas dhe u zvarrit deri në buzë. Një grup esesësh bëri ballë te muri pértej, por, para se ata të shpérndaheshin nëpër kopsht, Qamili u hodhi granatën e fundit. Në rrëmujë e sipër u kap pas degëve të një mani, mirëpo, kur po matej të hidhej në oborrin e shtëpisë më të afërt, diç i theri në kupë të gjurit. Humbi ekuilibrin, automatiku i shpëtoi padashur nga duart, ndërsa vetë ra marramendhi në oborr...

Kur u ngjit pas shkallëve të litarit dhe doli në çati, Petriti nuk e pa gjékundi Qamilin. Mendoi se rruga ishte e hapur po, ndërsa zvarritej, e fshikën plumbat e një automatiku. Mbeti mbi tjegulla, pa ditur ç'të bënte e nga të shkonte...

Mos vallë qe mbyllur qdo rrugë shpëtimi? Ndoshata për herë të parë mendoi se mund të vdiste. Ngriti automatikun dhe e shkrepi me breshëri të gjata. Nga fundi i kopshtit dolën ushtarë të tjerë, mitralozët ia nisën nga të katër anët, bombat fluturonin në drejtim të çatisë. Eefas, Petritit i theri në shpatullën e djathjtë, mu aty ku qe plagosur tre muaj më parë. Gjaku i doli mbi xhaketë, por ai nuk e shikoi vendin e plagës, as nuk e preku me dorë: nuk donte të pajtohej me gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej, nuk donte t'i pérulej asaj fuqie që i kërcënonte jetën. U zvarrit deri te baxha dhe u fut përsëri brenda. Ku shkonte? Cila ishte rruga e shpëtimit? Me të zbritur, hodhi bombën e fundit në mes të esesëve që vërviteshin te porta dhe menjëherë zuri vend në majë të shkallëve. Shkallët ishin e vetmja rrugë prej nga armiku do të përpinqej të hynte. Aty ai vendosi të luftonte deri në fishekun e fundit, pastaj...

Por feldfebeli ishte njeri i rrahur në luftë. Kur u dëgjuan të shtëna nga kati i parë dhe i dytë, nga maja e çatisë dhe, sidomos kur sulmi për pushtimin e shkollës, i komanduar nga ai vetë, u zmbraps duke lënë pesë të vrarë nëpër shkallë, feldfebeli u bind se atje brenda gru-

pi i armiqve duhej të ishte i madh dhe i armatosur mirë. Dha urdhër të shtoheshin forcat e rrithimit, ndërsa esë-sët dhe ballistët që ishin futur në oborr, të tërhiqeshin, derisa të rishqyrtohej plani për pushtimin e shkollës.

Mëngjesi i shtatorit, ai mëngjes i largët dhe i zyrtë që vjen si me përtim, po jepte shenjat e para. Me të pushuar pushka, gjelat e lagjes ia nisën këngës së bashku. Sytë e vegjël të feldfebelit zunë të shquanin më qartë format e tokës dhe objektet e ndryshme që rrithonin shkollën. Ja, mureve të oborrit u mungonin tjegullat. Ndërtesa dykatëshe duhej të kishte më shumë se tetë dhoma; ajo qe ngritur si në një piedestal, prandaj edhe dritaret e vogla e të ngushta në katin e parë ishin dy metra lart nga toka; oborri ishte fare shesh, kurse nga ana e kopshtit mund të ngjiteshe dhe me shkallë në çati përtë sulmuar nga baxha, por edhe atje armiqtë kishin zënë një pikë të fshehur... Këtu feldfebelit iu prenë mendimet. Ai vështroi me kujdes, duke u thelluar në çdo objekt, duke matur me sy gjysmë të myllur çdo largësi dhe madhësi. Kur mendoi se u kishte hyrë brenda të gjitha «sekreteve», urdhëroi të kontrolloheshin shtëpitë përreth, se mos lidheshin me shkollën me ndonjë llogëm të fshehtë. Ky urdhër e ngriti më këmbë lagjen nga të qarat e të lebetiturat e fëmijëve, pasi gjermanët dyshon se hyrja për në atë llogëm mund të ishte pikërisht aty, nën ato djepe të vogla e të çuditshme!

Më në fund erdhi koha për të vepruar:

Feldfebeli ngriti gishtin tregues dhe iu drejtua dhjetë esesëve:

— Kom!<sup>1)</sup>

Pastaj thirri përsëri:

— Kom! — Kësaj radhe gishti i tij ra mbi pesë ballistë nën strehën e portës.

Feldfebeli, pasi parakaloi para skuadrës së rreshtuar, dha urdhrin e dytë:

— Të pushtohen shkallët e brendshme me sulm!

---

1. Gjerm. — Eja.

Pasi ktheu kurrizin nga ushtarët dhe fytyrën nga shkolla, ngriti përsëri gishtin tregues dhe përshkoi një gjysmë harku në drejtim të portës së shkollës:

— Marsch! — urdhëroi duke sulmuar vetë në ballë të grupit.

«C'ndodhi?» — pyeti i çuditur Petriti kur krismat u ndërprenë menjëherë. Pasi zuri vend më mirë në majë të shkallëve, kërkoi me dorë plagët e shpatullës, ku gjaku i qe bërë pelte mbi xhaketë. Ndihej i dobët aq sa duart mezi i mbanin automatikun; faqet i ndizeshin, mornica të ftohta i përshkonin trupin e dërrmuar e të rraskapitur. Sytë i mbylleshin orë e çast. Sa dëshironë të shtrihej e të mos lëvizte asnjë gjymtyrë, megjithëse ai e kuptonte fare mirë se pesha që i rëndonte mbi kapakët e syve s'kishte të bënte me gjumin... Kur ja, në dremitje e sipër Petriti mendoi të mbledhët për herë të fundit fuqitë e veta! U ngrit dhe mori përpjetë shkallëve të litarit. Në majë të çatisë veshët i fishkëllyen nga plumbat. Po ai u hodh në degët e manit dhe u kolovit mbi mur. Para se të binte në oborrin e fqinjës zbrazi gjithë karikatorin kundër ushtarëve që e ndiqnin nga pas. Kaq u desh, pastaj u lëshua në vrap. Krismat e britmat, herë i afroheshin herë i largoheshin, derisa heshtja mbuloi qytetin.

I lodhur, me çap të ngadalshëm, pa qenë i zoti të mbledhët mendimet, Petritin e çuan këmbët te hani i dajë Muratit. Atje u çudit. Si kishte ngjarë që ishin mbledhur të gjithë dhe pritnin vetëm atë? E éma, zoti Vasil, Rifati dhe usta Dinia! Veç Lumtën me Qamilin s'ia panë sytë. Aq më mirë: ata s'para dëshironë t'i shikonte pranë njëri-tjetrit. Petritit nuk i harrohej nata kur u kthyë nga fshati disa ditë më parë. Lumta punonte, kurse Qamili s'e hiqte vështrimin nga duart e saj! Por, ah! Tani s'ishte koha të mendonte pér këto... Ndërsa e éma po e mbulonte me të puthura, Petriti iu afrua dajë Muratit:

— Më fal, që s'të kam ardhur më parë, por ja, edhe hanit tënd i erdhi radha...

Petrinit i mbetën fjalët në gojë nga një buçitje e fortë. Edhe ai bëri si të tjerët: mbylli sytë dhe zuri veshët, por... një krismë aty afër e solli në vete. Kur hapi sytë, në gjysmerrësirën e shkollës shqoi dhjetëra helmetë që po ngjiteshin drejt tij. «Ah!» ia pat. Me t'iu këputur filli i èndrrës, rrëmbeu automatikun që i kishte rënë nga duart. Sytë e çapëlyer të gjermanëve të zënë në befasë, Petritit iu dukën sikur po i luteshin. Në kujtesën e tij u tipos fytyra e një bardhoshi të ri, i cili, duke mos pasur kohë të zmbrapsej, mbuloi sytë me duar dhe thirri:

— Kamerad!<sup>1)</sup>

Shkolla gjëmoi sérish. Vala e esesëve dhe e ballistëve herë sulmonte, herë zmbrapsej për të nisur përsëri sulmin me forca të reja...

Fytyra e hequr e major Francit ishte mjafët e lodhur nga pagjumësia. Sytë e thellë sikur i mbante me zor të hapur. Herë-herë fërkonte qafën e hollë, të skuqur si lafshë gjeli, herë-herë dystonte flokët cil, të ndarë mënjanë me shteg të drejtë.

Që kur i raportuan se të gjitha gjurmimet për të kapur mësuesin plak dhe bandën që u ndodh në shtëpi të tij, dështuan, major Franci e humbi qetësinë. Ekte lart e poshtë nëpër dhomë, ngjiste shkallët, dilte në tarracë dhe shikonte qytetin e errësuar e të heshtur. «Ku gjeti strehë, ku?»

Aparati i gestapos hyri i gjithi në veprim. Në orën katër pas mesit të natës, në nerva e sipër, major Franci vuri përpëra listën e shtëpive të dyshimta dhe shënoi pesë kryqe; kryqi i fundit ra mbi shkollën e Vasil Gjinarin...

Kështu u regjistrua suksesi i parë i major Francit që nga ardhja e tij në këtë qytet.

---

1) Gjerm. — Shok!

Në orën shtatë, pasi dëgjoi raportin për rrithimin e plotë të bandës, major Franci zbriti në kuzhinë për të ngrënë mëngjesin. Aty luajti një copë herë me Setrin ojnatar dhe, meqë pushkët s'u dëgjuan më, vendosi të vishej për ta pritur në zyrë raportin përfundimtar.

— Kurt!

Kurti u fut në dhomë, kërciti thembrat dhe, pa pritur urdhër të dytë, eci përpara me çap të vendosur. Ai e dinte mirë detyrën e vet: qdo mëngjes duhej t'i mbërthente majorit tirantat, t'i vishte xhaketën, çizmet e lustruara dhe... por sot, tamam atë çast kur po i jepte kapele, sytë e majorit shquan përtëj dritarës shtëllunga të dendura tymi përmbi çatinë e shkollës. Rrëmbeu kapelen nga duart e Kurtit dhe u lëshua tatëpjetë shkallëve.

Kurti ngriti supet: «Ç'pati majori që e humbi përsëri qetësinë!» Pa u ngutur, krehu flokët para pasqyrës, u kthye në profil dhe pa kurrizin: Lëshoi një fishkëllimë të lehtë: rripi i rrinte për bukuri. Mori shpatën e majorit (vetëm ajo i mungonte!) e vari në bel dhe u shikua përsëri. Buzëqeshi, por, me të hapur buzët, vetja nuk iu duk e përshtatshme për atë shpatë: i mungonte një dhëmb, një të dytë e kishte të thyer përgjysmë. Tundi kokën me inat dhe murmuriti duke i treguar grushtet pasqyrës: «Partizan!»

Me të zbritur në oborr, major Franci ia bëri me dorë shofërit në drejtim të shkollës. Vetura e zbuluar ushtarake mori rrugën me shpejtësi, duke u dridhur përmbi gürët e kalldrëmit, ndërsa kapelja e rrumbullakët e majorit, me kryqin e thyer në ballë, ulej e ngrihej si bostani mbi ujë.

Te porta e shkollës, major Franci u hodh nga makina pa pritur që ajo të ndalej mirë.

— Komunistët të kapën të gjallë! — thirri ai duke treguar me gisht derën e shkollës.

— Marsch!

Dhjetë esesë, me feldfebelin në ballë, u hodhën përmes flakëve dhe tymit.

Gjatë paraditës major Franci shkoi vetë në spital për të parë gjendjen e dy komunistëve. Njëri nga ata, ai që u gjet në oborrin e një shtëpie, kishte marrë një plagë të lehtë përmbi gju, kurse tjetri ishte djegur e plagosur rëndë nën shpatullën e djathjtë. Qamil Tapinë e ngriten po atë ditë nga spitali dhe e mbyllën në bodrumin e gestapos për të filluar menjëherë nga hetimet, kurse për Petrit Gurajn, major Franci kërkoi nga mjekët të bënin çishte e mundur për ta shpëtuar nga vdekja, qoftë dhe për një ditë të vetme, pasi gestapos i nevojitej shumë «gjuha» e tij. Majorit iu duk se komunisti s'ishte dhe aq i siguruar në spital vetëm me dy roje te koka. Pa vonesë, nën kryesinë e Kurtit, u nisën për të rrethuar spitalin më se dhjetë esesë.

Duke u kthyer për në gestapo, Kurti urdhëroi shoferin që ta ndalonte makinën në qendër të qytetit, aty ku varesin reklamat e kinemasë. Nga artistët — merrej shumë me kinematografi Kurti — e mori me mend se sonte do të shfaqej një film i dëgjuar italian.

— Gut, gut!)

Atë mbrëmje, Kurti do të shkonte në kinema. Por s'kaloi një çast dhe fytyra e tij e re pa qime, u ngrys. Në urdhrin e shpejtë të major Francit ai kishte dëgjuar jo vetëm se duhej rrethuar spitali, por në krye të çdo ore ai vetë, Kurti, duhej të kontrollonte personalisht rojet. «Oh, majori im, e humbe përséri qetësinë!»

Buzëvarur, i dha shenjë shoferit të niste makinën. Rrugës Kurti nxori fotografinë e një gruaje. Në gushën e saj ai, koleksionisti i famshëm i artistëve, kishte shkrurar me kaligrafi: «Ylli i kinematografisë gjermane, Zara Leander.» Duke shikuar fotografinë, sytë pa ngjyrë të Kurtit shkëlqyen dhe çehreja iu bë më e ëmbël. Zbërttheu jakën e këmishës dhe ia mori nëpër dhëmbë një këngë, këngës së preferuar të Zara Leanderit, këngës së ushtarit në luftë që po humbiste të dashurën, melo-

---

1) Gjerm. — Mirë, mirë!

dia e së cilës herë-herë tingëllonte e butë, melankolike, si ankim, herë-herë e egër, si kërcënim. Vetëm në fund Kurti e ngriti pak zërin, me buzët e holla të zgjatura jashtë masës:

*Wie einst Lili Marlen!  
Wie einst Lili Marlen!*

Shoferi ngrinte supet pa pushim për të shoqëruar me këtë, jo vetëm tempon e këngës, por edhe kamionin bosh, që hidhej e përhidhej ritmikisht nëpër gropat e kall-drëmit;

*Wie einst Lili Marlen!  
Wie einst Lili Marlen!*

## *Kapitulli i shtatë*

### **«NUK I DUROJ HISTORITË E GJATA!»**

Që kur plasi pushka mbrëmë, si dhe gjithë ditën, Nazmi bez Topi nuk u duk në shtëpi.

Saibe hanëmi zgjaste kokën herë pas here në dritare me shpresë se mos shikonte të birin duke ardhur. Kur u errësua, piu nja dy filxhanë kafe, por qetësi nuk gjeti: as i hahej, as i flihej. Duke përgjuar nëpër heshtjen e thellë të natës, asaj i bëhej sikur po ia vritnin të birin. U-u-uh, i merrjej fryma.

Nažmu u kthyesh bashkë me Qazimin pas mesit të natës. Saibe hanëmi i doli përparrë:

— E fituat?

— Lëre mos e pyet! — ia priti Qazimi me të tallur.

— Kësaj radhe e fituam me gjithsej.

— Ti hesht, diavolo!<sup>1)</sup>

Në dritën e llambës, fytyra e Nazmiut dukej e loddhur, por njëkohësisht mjaft e kënaqur. Ekte ngadalë dhe buzëqeshte nën hundë.

— Ti e di, veç gjak nuk dual! — i tha Saibe hanëmi, duke i dalë në krah.

---

1) Itali — Djall!

— Me gjak e pa gjak, hanëm, — ndérhyri përséri Qazimi, — sidoqoftë, kësaj radhe vramë shkaktarin e gjithë të këqijave.

— Cilin vratë?

— Një gomar topall. «Ndal», i thanë gjermanët, por gomari si gomarët...

— Diavolo! — e mallkoi hanëmi dhe u kthye nga Nazmiu.

— Ç'janë këto që fliten, Nazmi? — e pyeti duke e shikuar me dhembshuri. — Sikur gjoja vetëm çuni i Danës, i Danës së marangozaxhiut e paska mbajtur luftën katër orë.

I biri ngjiti shkallët dhe u ul në një karrige pranë tavolinës së bukës, në mes të sallonit.

— Le të llapin bota ç'të duam, — e mori përséri fjalën Qazimi, duke lëshuar pushkën mbi qilim. — Atje u dogj një batalion me komunistë. Na-a, as hiri s'u mbeti.

Saibe hanëmi s'ia vuri veshin. Nga ngërdheshja e buzëve, ajo e kuptoi se Qazimi tallej.

— Mjaft!

Pasi piu një gotë qumësht dhe pasi shkëmbeu disa fjalë me të emën, Nazmi bej Topi u ngjit lart për të fjetur. Në vetminë e dhomës, padashur atij iu kujtuan ngjarjet e fundit. Drejtoi trupin e lodhur dhe u mbështet në kolltuk, si të përgatitej të bisedonte me një njeri të padukshëm. Po tani si do të shkonin punët, kur Lumtën e shtiu në dorë dhe Petriti me Qamilin së shpejti do t'i linin lamtumirën kësaj bote? Një buzëqeshje e lehtë u end në buzët e tij plot gjak prej të riu. Sytë e mëdhenj, që dukej se i mbante me zor të hapur, u kotën e ranë në ëndërrime... u zhvesh e ra.

Poshtë, në sallon Qazimi, pasi ktheu një gërqe raki nga faqorja me rruaza shumëngjyrshe, iu lut hanëmit ti jepte diçka për të ngrënë.

Punët e qehajait Qazimi i kishte marrë trashëgim nga i ati, i cili pat shërbyer tërë jetën te Selman beu. Tre vjet më parë, kur paraja e ngriti përséri derën e Topit, Saibe hanëmi thirri qehajanë e vjetër, së vetëm ai i njihte mirë bujxit dhe çiflikun. Por plaku s'deshi të

vinte më në qytet, prandaj nisi të birin. Hanëmit, megjithëse nuk i pëlqeu mendja e Qazimit, s'iuh dha ta kthennte prapë e të kërkonte tjetër. Që nga kjo ditë kaluan tre vjet dhe hanëmi u mësua me Qazimin, se fundi i fundit ai kishte një të mirë, që i mungonte të atit: moshën e re e tërë atë trup të gjatë.

Vitin e parë Qazimi s'para e mori veten, por dalngadalë u mësua me jetën e qytetit dhe u bë i shkathët siç e lypte puna e qehajait. I hyri në qejf të rruhej çdo ditë e të derdhë kolonjë në flokët e zez, që i lante një herë në gjashtë muaj. Por vitin e tretë Qazimi u bë i njojur në gjithë qytetin si njeri i dhënë me mish e me shpirt pas grave të zanatit, pas rakisë dhe bixhozit...

— Të marrtë Qazimi të ligat, hanëm, më preu përbukë. A ta zgjoj Dadon? — iu lut ai.

— Mos e zgjo. Të jap unë, — i tha hanëmi duke u ulur pranë tij me një rënkim të lehtë. — Pa më thuaj, përsë s'erdhët fare dje në shtëpi?

— A, dje thua ti? Pas luftës që bëmë te shkolla, filloam nga operacioni, hanëm, — nisi të tregonte pa qejf Qazimi. — Arrestuam më se dyqind veta. U mbush burgu, se po i luante tepeleku të parit të gjermanëve kur e shikonte bosh atë goxha godinë.

— Qazim, si ta pret mendja ty, mori fund kjo punë? — pyeti hanëmi duke u afruar edhe pak pranë tij.

Fytyra e lodhur e Qazimit u zgërdhi, pastaj bëri sikur ra në mendime.

— E, moj hanëm, ç'të të them unë i shkreti. S'para ma pret për politikë. Kur erdha këtu, tata më porositi të shikoj vetëm punën e qehajait. Se, ta marrësh vesh ti, hanëm, s'jam fshatar si çdo fshatar. Kështu linda, i trashë për kësi punësh. Mirëpo, hallbu që yt bir më bëri ordinancë.

— Mos ki merak, do të mësohesh. Po si ta pret ty, mori fund lufta këtu brenda?

— Këto tri ditë e kemi vënë në defter ta kthejmë të gjithë qytetin ballist! — u përgjigj Qazimi duke shikuar qendismat e kombinezonit të mëndafshët të hanëmit, që zbardhonin në grykën e hapur të fustanit.

— Veç pa gjak, — iu lut hanëmi dhe bëri sikur do të mbërthente grykën, por s'dihet se si iu ngatërruan gishtat, një sumbull e mbértheu, një tjetër e zhërtheu.

— Urtë e butë, do ta bitisim. Pse thonë: qeveria e zë lepurin me qerre. Atë të rrezikshmin e kemi në duartona, po vdes në spital.

— Bastardi!

— A?!

— Qeni!

— Por, ama, trim me fletë! T'i lëpish këmbën! Hanëmi i vuri dorën në gju.

— Mos fol kështu. Komunistit t'i lëpish këmbën ti. Duke ndier dorën e butë të hanëmit në gjunjë, Qazimi lëpiu buzët dhe shikoi përsëri tylin e kombinezonit.

— S'po merret vesh se ç'dreq bese paskan komunistët!

— Ku e gjetën besën ata, Qazim! Qazimi ktheu faqoren.

— Ah, të shkretën, qenka mbaruar!

— Ma jep ta mbush.

— Jo!

Qazimi mendonte se po të ngrihej hanëmi mund të mos i ulej më aq afër. Të tjera ndjenja dhe epshe e kishin pushtuar tek rrinte pranë trupit të lidhur të hanëmit.

— Ku e gjetën besën komunistët? Kështu the ti hanëm? — e mori fjalën Qazimi duke tundur kokën e madhe, që dukej sikur i mbahej me zor në qafën e hollë e të gjatë si të patokut... — Kanë një besë ata, që lëre mos e pyet. Unë di një sekret, po hëpërhë s'ta rrëfej dot. Kam urdhër.

— Oi, edhe mua do më mbake gjë të fshehtë ti, surrat?! — u qudit hanëmi.

— Atëherë, meqë dashke zotrote, po të rrëfej një tjetër.

— Ti e di, nuk i duroj historitë e gjata!

— Që ta kam fjalën, dyqind nga ata të rinjtë i futëm në burgun e komandës sonë. Doli beu i vogël në majë të dritares dhe u mbajti fjalë. Në fillim u tha me të mirë të

bëheshin ballistë, të lëshonin firmën e të merrnin pjesë në punët e ndryshme të Ballit. Por, meazallah, ç'më pamë këta sy! Çunat thanë: «Na bëni ç'të doni, na vritni, na varni, por ballistë s'na keni!» Mor dhamë e muarëm me të mirë e me të keq, por s'doli gjë. Vetëm çunat e Selim agait, janë katër mashalla, thanë se mund të shkruheshin ballistë, por me kusht që pushkën të mos e mbanin në krahë, se demek s'paskan izëm nga i ati! S'do mend shumë kjo punë, hanëm. Të pasurin e ke ballist, të varfrin, s'e luan topi, e ke komunist. U nda më dysh bota. Mirëpo, a e di ti, se ka hyrë keq në popull fara e komunizmit? Por unë, të të them të drejtën, s'e dua. E dua unë, po me një kusht, që të më lënë kështu siç jam, me fajore në xhep e të bredh tërë jetën pas beut të vogël. Atë komunizëm e puth në ballë Qazimi. Mirëpo e keqja është se ata edhe beut të vogël do t'i japid kazmën në dorë, pa le mua! Epo, të marrtë Qazimi të ligat, oj hanëm, vërtet s'kam ndonjë muhalefat të madh, një pëllëmbë tokë lëroj, por komunizmin s'e dua. Phu!

Pas këtyre fjalëve ra një heshtje e gjatë. Rreth poçit të llambës (nga bombardimet Saibe hanëmi nuk e ndizte elektrikun) vërtitej një bumallë me uturimë monotonë. Qazimi vështronte para vetes me sy të kotur si njjeriu që nuk i kuption as vetë fjalët që thotë. Herë pas here, padashur, vështrimi i butë i syve të tij mbërthehej në gjoksin e shqetësuar të hanëmit.

— Me t'u dhënë fund këtyre punëve, s'të duhet gjë tjetër, veçse një grua! — theu heshtjen hanëmi duke e çikur gjurin e vet në kërcinjtë e thatë të Qazimit.

— Unë të martohem? — pyeti Qazimi i tronditur nga gjuri i zbuluar i hanëmit. — Kurrë mos e thëntë perëndia. Qazimi nuk i vë rrëth kokës.

— Po kur do ta gëzosh jetën? Më more të keqen, po u afrohesh të tridhjetave.

Shikimi i Qazimit u ngul në buzët e saj. «Oj, i kapitë dyzetat, por s'do t'ia dijë fare. Në majë të gishtit i vë të rejat e sotme. Edhe Aishja vetë s'krahasohet me të... Ah, Aishe, sa ditë u bënë që s'të kam ardhur? Na

hutoi kjo e shkretë luftë! Bo-o-bo! Shiko, ore qorr, si e zbuloi hanëmi edhe gjurin tjetër!...»

Qazimit i kishte rënë me kohë në sy se hanëmit të bukur ia kishte fort qejfi, por deri më sot as që i pat shkuar në mendje se mund të bënte gjë. Ku hanëmi, ku ai! Asaj vërtet ia kishte qejfi, por dihej, vetëm me kaqolët e mëdhenj, me anën e të cilëve siguronte kontratat e mishit e sipërmarrjet e tjera. Dinte e zgjidhëte ajo, ajkën e burrave të Elbasanit. Sa herë që beu i vogël nisej për Tiranë, ajo do t'i ngjiste prapa edhe Qazimin. «Dëgjo, çun, — i thoshte, — mos u kthe shpejt. Rri sa të duash. Kënaqu, se të kam të ri e të bukur». E, kur ndodhë që Qazimi të kthehej nga Tirana para kohe, hanëmi dilte të nesërmen nga shtëpia e kryetarit të bashkisë me çehre të vrarë, me sy rrëthuar me qemer të zi dhe, megjithëse e lodhur, ajo dukej e kënaqur, e butë, e urtë dhe e bukur pa masë. Të gjitha këto i dinte Qazimi.

Por, sidooqoftë, qejfin e madh hanëmi e pat bërë me një kolonel italian, Antonion, burrë i pashëm e i gjatë. Bile një herë u hap fjala se Saibe hanëmi do të martohej me kolonelin. Por s'doli gjë. Punët u zvarritën aq, sa kapitulloi Italia dhe kolonelin, si shef të SIMI-t e pushkatuan aty ca ditë më parë. U pikellua hanëmi por ja që zunë t'i shkëlqenin përsëri bebëzat e syve. Po ç'e do, se mos donte ajo me njerëz si Qazimi. Mbase për herë të parë ai e mallkoi veten që kishte lindur atje, në mes të ferrave, fshatar e bir fshatari të humbur, e jo në Italinë e madhe, që të vinte pastaj në Shqipëri si kolonel, ose të paktën të kishte lindur rrëzë kalasë e të bëhej kryetar bashkie!

— Phu, — pështyu Qazimi te këmbët pa asnje shkak.

— Ah, ti dreq! Sa herë të kam thënë të pështysh në shami!

— Kështu e shau hanëmi dhe prapë u afrua si pa të keq nga ai.

— Phu, — pështyu përsëri pa e pasur mendjen aty.

Kësaj radhe hanëmi vuri buzen në gaz. Qazimi, pa

e kuptuar se si, ngriti krahun dhe uli fitilin e llambës që ndriçonte mbi kokën e hanëmit.

— Shkon kot vajguri, — foli ai nëpër dhëmbë. — Po agon.

Me t'u shuar drita, sallonin dhe oborrin i mbuloi errësira, ajo errësirë përshkuese, që ndehet kur sapo fillon të ndahet nata nga dita. Në prag të sallonit shkëlqyen dy sy të vegjël, si dy kokrra fosfori; macja, duke parë dy trupat e palëvizur, rrëshqiti matanë si hije e zezë. Pulat kakarisën të trembura. Një gjel i rïj pasi ia tha «ki-ki-ki-i!», u lëshua pas një pule, që i lubitej plot ojna.

Saibe hanëmi u ngrit më këmbë dhe duke shtrënguar Qazimin për dore, i tha me zë të ulët:

— Hajde në dhomën time...

— ...!

— Diavolo! — ia pat ajo duke e hequr pas vetes.

— Hanëm... Jam unë Qazimi, Qazim fshatari! — u hutua ai.

Por hanëmi e futi brenda dhe e përplasi në krevat:

— Nuk i duroj historitë e gjata!

Zhurma e çelësit të derës, pastaj...

— Qazim!

Heshtje.

— Diavolo!

— Lepe!

— Dëgjo q'të them unë...


— Fol, hanëm!

— Rrëfemë sekretin...

— Sekretin? Ta rrëfej unë ty sekretin, po se mos ia thuash tyt biri? Është punë kontrabandë. Meazallah, se e marrin vesh gjermanët.

Flokët e shpupurisur të hanëmit ishin shpërndarë nëpër jastëk. Kombinezoni me dantellë si dhe fustani, ishin hedhur te këmbët e krevatit, përmbi pushkën e gjatë të Qazimit.

Herë pas here Qazimit ia kishte qejfi të gërricte me thua lustrën e krevatit, pastaj t'i frynte e të shikonte kur ajo vishej si pasqyrë.



— Dëgjo, pra. Dje kapëm gocën e... mësuesit. E quajnë Lumto.

— Fol shpejt!

— E kapëm, po si e kapëm se... — Një copë herë ai i tregoi se me forcat e Ballit ata kishin rrrethuar lagjen buzë zallit të Zaranikës, prej nga pritej të largoheshin komunistët. Në këtë gardh kishte ngecur goca e mësuesit. — S'e bëmë të gjatë, e dënguam menjëherë në komandën tonë fshehurazi nga gjermanët... Pa po unë pastaj brodha pas të atit...

— Lëre plakun, po sa mirë që e paski zënë kuçkën! — ia preu fjalën hanëmi.

— Kuçkën? — foli Qazimi. — S'është gocë e tillë ajo. Me të ardhur në vete e me të parë beun e vogël, veç të ishe aty, i ktheu kurrizin e s'e ngriti më kokën. Ti lëmë të gjitha, po, me sa kuptoj unë, yt bër e ka me tërë mend. Digjet e vuan çuni... Epo, që ta pata fjalën, unë pastaj brodha pas të atit...

— Lëre, pra, plakun... Sa ta shtjerë një herë në dorë është puna. Pastaj le ta mbajë si mantenuatë.

— Ajo le e le që s'të bëhet mantenuatë, por as nuse, jo. Zor ta tradhtojë Partinë e vet.

— Qazim! — iu përmblodh hanëmi me të egër.

— Thuaj q'të duash, por nderi është nder. Atë e kemi të gjithë njësoj, si beu, si fukaraja.

— Me sa kuptoj unë, ti paske rënë në dashuri me vajzën!

— Unë?! — Qazimi tundi kokën në shenjë mohimi dhe pa folur gjë, uli fitilin e llambës. Muret e trëndafilita të dhomës, tavani e dyshemeja ranë në gjysmerrësirë dhe qdo gjë mori një pamje më të bukur, më të hijshme.

— Ah, moj hanëm, — foli duke mos qenë i zotit të përbante një pshërëtimë të thellë, — ku është përmua ajo! Bukuria e saj s'rrëfehet me gojë e nuk shkruhet me kalem. E ku ta vë unë atë? Një copë qehaja. Le që ajo s'do beun, pa le mua... Po ja, që ta pata fjalën, unë brodha pas të atit...

— Or Qazim, q'të ka zënë me plakun?

— Po atje, moj hanëm, dua të dal, te goca ime. E ndoqë mësuesin deri te hani i Murat Hanxhiut, që më ka një gocë të re të njomë me gërshetat në bel. Sa për atë, Qazimi jep kokën kur të duash. E kam dhe fshatare.

Një copë herë s'folën dhe sikur i mbajtën mëri një-ri-tjetrit. Një e dy hanëmi zgjaste dorën dhe merrte sa-hatin nga komodina.

— Ngrihu tashti. Mund të zgjohet Nazmiu.

— Edhe....

— Shpejt, nuk i duroj historitë e gjata!

## Kapitulli i tetë

### TAKIMI I PARE

Nazmi beu u zgjua vonë. Veshi kostumin e ri blu, eci para sallonit pa bërë zhurmë dhe trokiti në dhomë të Qazimit, por ai s'u bë i gjallë. «Fli, dreq!» murmuriti beu dhe doli në rrugë.

Qielli ishte veshur me re të bardha; rrezet e diellit mezi arritën në tokë me një shkëlqim të vrarë. Era e Krastës pështjellonte pluhurin e rrugëve, përkulte majat e pemëve, merrte me vete gjethet e thata dhe i grumbullonte në kapica të mëdha rrëzë mureve të shtëpisive.

Një plak çapitej kokulur me njérën dorë te hunda. Po ja, era i rrëmbeu kapelën dhe ia rrrokullisi gur më gur e gropë më gropë, drejt vijës që gurgullonte e turbulluar. Rosat gagarisën të trembara, por një vogëlush që vrapoi pas saj, e zuri para se ajo të notonte në ujë. I drojtur, duke marrë frymë me zor, iu afroa plakut që priste me shami te hunda. Plaku, pasi e falënderoi të voglin, u largua gjithmonë ngadalë, ndërsa vogëlushi mori vrap përpjetë rrugicës, ku dëgjohej një kor i përbashkët çekanësh, që binin mbi kudhra, bakra e llamarina.

Te sheshi i drithërave, një tufë harabelësh herë binte në tokë dhe çukiste në plasat e gurëve kokrrat e grurit, herë ngjitej në buzën e çative të ulëta. Dëgjo-

heshin zëra: «Simite të ngrohtal!», «Salep iëmbël!», «Qofte ke daja». Çak, çak, çak, masha e Refik kafexhiut tek ecte përpara dyqaneve me tabakanë të mbushur me filxhanë që nxirrnin avull. Dhe ja:

— Një kafe, Refik!

— Peqeji! — dhe u fut në dhomën e post-rojës, pranë kalasë, pas së cilës ngrihej komanda e rinisë së Ballit.

Kafexhiu buzëqeshi duke zbuluar dhëmbët e gjatë e të verdhë:

— Edhe beu i vogël e paska bërë zakon kafenë me mëngjes herët?! — pyeti, la filxhanin mbi tavolinë dhe doli jashtë duke thënë:

— Po fillon stuhia, bej!

Nazmi beu e rrufiti kafenë ngadalë e pa u ngutur. «Oj, qerrataj i vogël, e shpëtoi kapelen e plakut! Po si e shpëtoi se?!» — rikujtonte Nazmi beu skenat që pa rrugës. Pastaj, mbështeti mjekrën mbi grusht dhe hodhi vështrimin përtëj xhamave të dhomës.

Majë kullës së kalasë shekullore, një lejlek qëndronte me një këmbë në buzë të çerdhes, me tjetrën të hedhur jashtë, në gurët e zinj. Me qafën të mbështetur mbi krahun e vet, ai dukej sikur shikonte tufat e mëdha të zogjve shtegtarë, që fluturonin drejt jugut. «Kot mendohesh! — murmuriti Nazmiu. — Nisu sa më parë, se të zuri dimri. Koha e sotme mund të të gënjejë, por nesër do të gjëmojnë bubullimët, do të fillojnë rrebeshet dhe tufani ka pér ta shkultur pa mëshirë çerdhen tënde.»

Nazmi bej Topi hodhi sytë në quell. Vërtet, atë ditë koha nuk ishte as e mirë, as e keqe. Retë e bardha mund të nxiheshin papritur e të lëshonin rrebeshe vjeshte, ose mund të zhdukeshin pa u vënë ré. «Diell apo shi? — pyeti ai pa e hequr vështrimin nga retë. — Po Lumta ç'qëndrim do të mbajë? Do përulet para meje, apo... Oh, kjo era e Krastës vetëm shi sjell... Lejleku mendohet akoma! S'di ç'të bëjë: të rrijë apo të ikë! Ik, ore, ik, se të zuri dimri!...»

Kur u fut në zyrë, Nazmi bej Topi urdhëroi t'i përgatitnin një mëngjes të mirë pér dy veta. Kjo i çuditit të gjithë, pasi beu s'e pat bërë zakon të hante në zyrë.

Para se t'i sillnin bukën, Qazimi futi kokën te dera.

— Erdha unë, bej! — Ai ngriti fyttyrën drejt tavannit dhe mori frymë me hundë, si kalë i lidhur.

Sytë e Qazimit qenë skuqur dhe enjtur si të pijsnecit kur sa po është ngritur nga gjumi.

— Ti e di ku e kam hallin! — i thë Nazmiu. — Shko thirre, se do të hamë mëngjes!

— Bej!

— Ç'do?

— Jo, asgjë...

Qazimi zbriti shkallët e bodrumit dhe përgjoi pas derës së hekurt.

— Ç'të qarë ka bërë kur i treguan emrat e atyre që u kapën te shkolla! — foli roja.

Qazimi ktheu kokën:

— S'po të pyet njeri! — ia priti me inat.

Roja vërtiti nëpër gishta zinxhirin e biçakut, zgërdhiu fyttyrën, hodhi patickën në krah dhe u largua duke fishkëllyer një këngë të vjetër turqelie, nga ato që i pëlqenin shumë Qazimit.

Pas pak Qazimi dhe Lumta ngjitën shkallët e bodrumit:

— Zonjushe, majtas... Shoqja zonjushe! — i thirri ai më fort. — Ja, futu te kjo dhoma... A?! Ti sigurisht do që të pyesësh ç'do të bësh atje brenda. E ku ta di unë i shkreti! Unë s'jam veçse një copë ordinancë. Ja, këtu është vendi im, në korridor... — Qazimi vazhdoi të fliste akoma, megjithëse Lumta që futur me kohë në dhomën që i tregoi ai.

Një copë herë Nazmi bej Topi s'diti ç't'i thoshte Lumtës. Pasi kërciti gishtat e duarve, zuri të e cte mbi qilimin e zyrës, duke shkelur butë-butë, si për të mos prishur rrjedhën e mendimeve. Ai mundohej të kujtonte lumin e fjalëve që kishte përgatitur një natë më parë, por më kot. Zëri i Lumtës e solli në vete:

— Kjo që bën ti është e poshtër dhe çnjerëzore!

— Dashuria s'njeh ligje dhe zakone! — foli ai.  
Lumta bëri një rrrotullim mbi thembra. Nazmiu u ul  
në kolltuk dhe priti.

— Flet edhe për dashuri...

— Qazim! — thirri ai.

Qazimi hapi derën dhe futi kokën ngadalë, si të  
kishte frikë se mos ia pritnin.

— Afroi zonjushes kolltukun!

— S'është nevoja!

— Shoqja zonjushe, do s'do ti, kolltuku s'luan nga  
vendi, është i mbërthyer me gozhdë. Duhet ti të shkosh  
te kolltuku...

— Pusho!

Qazimi u zhduk prapa derës.

— Trimëri e tepruar! — iu kërcënuai me zë të  
përbajtur.

— Trimëri je duke shitur ti. Me sa më kujtohet,  
ti arrite të lexoje disa nga broshurat e Partisë sonë!

Sytë e mëdhenj të Nazmiut u mbërthyen në një pikë  
të dyshemesë. Rrallë e tek vështrimi i tij ndeshej me  
atë të Lumtës, por si të mos e duronte dot shikimin e  
saj, ngulej përsëri në dysheme.

— Fillove nga idetë?

— Po.

— Léri ato. Të kanë mbuluar kokën me përralla! —  
u nxeh Nazmiu. — Edhe të marrët mund të krijojnë ide.  
Puna është të kapesh pas ideve që, praktikisht, të lejojnë  
të jetosh. Në radhë të parë njeriu duhet të shikojë  
interesin personal... Në mos gaboj, ju këtë e quani in-  
dividualizëm borgjez... A, kështu? Mikroborgjez!

— Fol më thjesht.

— Idetë e juaja s'kanë fare jetë. Ato janë nxjerë  
nga librat aziatikë!

— Paske nisur të flasësh me një gjuhë të lartë!

— S'të pëlqen kjo gjuhë?

— Jo!

— Lumtë, t'i lëmë këto gjepura. Ti e di dëshirën dhe  
qëllimin tim. Unë jam po ai që kam qenë. Ne të dy...

Lumtës iu duk se për herë të parë gjatë bisedës Naz-

miu qe i sinqertë. E shikoi në sytë e bukur, por të pajetë, si prej kristali, dhe, pér një çast, zemrën e saj e fshiku simpatia e dikurshme pér të. Megjithëse kishin kaluar shumë vite, fytyra e tij, në të cilën s'kishin lënë asnje gjurmë gëzimet e hidhërimet, ishte po ajo, me të vetmin ndryshim se tani dukej si e një fëmije të rritur. «Mbase lufta jonë do ta kishte bërë njeri të vërtetë».

— Ti gjithmonë ke folur «unë» dhe «ne». Dihet që ne s'jemi veçse pjesë e pandarë e shoqërisë ku jetojmë.

Nazmiu zbërtheu e mbërtheu automatikisht sumbulat e jelekut, drejtoi nyjën e kravatës që i kishte shkuar shtrembër, dhe u fundos në kolktuk i mërzitur. Duke shkuar duart e veta të buta e të bardha si faqet e pashkruara të një libri, ai s'gjeti fjalë pér të kundërshtuar.

— T'i lëmë këto! — e ktheu bisedën. — Hape zemrën. Vetëm pér çlirim e vendit luftoni ju?

Lumta s'iu përgjigj.

— Në bankat e shkollës babai yt na ka mësuar të themi kurdoherë të vërteten.

— Dihet, ne jemi kundër padrejtësisë shoqërore.

— Atëherë, përsë flitni vetëm pér luftën kundër okupatorëve, vetëm pér çlirim? U keni marrë mendjen edhe disa njerëve, që nesër mund të jenë armiqtë tuaj.

— Ne nuk fshehim asgjë. Detyra më e afërt është çlirimi i vendit.

— Marksizëm?

— Kuptoje si të duash!

— S'ke tjetër? — pyeti ai me ton zyrtar.

— Kam. Dërgomë në burg, ku janë shokët e mi.

Nazmiu u ngrit dhe me duart të lidhura prapa, zuri t'i binte dhomës lart e poshtë. Mos vallë idealit, politikat, qëndronin me të vërtetë më lart se vetë dashuria që kishte ai pér Lumtën?

— Pse e kërkon këtë?

— Dua të jem me ta, ballë pér ballë me gjermanët.

— Sipas teje, gjermanët qenkan më të mirë se ne!

— Tradhtarët janë kurdoherë më të ndyrë se armiqtë e huaj.

Nazmiu e ndjeu sé ishte pikërisht politika ajo që mund ta ndante nga Lumta.

— Mos u rrëmbe, Lumtë. Pa mendo një herë, a s'do tē qe më mirë qoftë dhe një Shqipëri e robëruar, por e përjetshme, sesa të zhduket fare nën thonjtë e komunizmit?

— Komunizmi nuk zhduk Shqipérinë, por çifliqet.

Ndërkhohë, lart në qancell, retë e bardha të mëngjesit ishin bërë sterrë. Një gjëmim i fortë drodhi xhamat e dhomës. Vetëtima ndriti si tel i skuqur. Padashur, Nazmiu hodhi vështrimin në kullën e kalasë në fund të obo-rrit, Lejlekun s'e pa më në çerdhë. Ai ishte nisur përshtegtim.

Fantazma e komunizmit! — briti papritur e pakujtuar.

— Me sa duket, të ka hyrë frika në palcë!

— S'është e vërtete. Por unë s'e marr dot me mend si mund të përblyset organizimi i tanishëm i shoqërisë, si mund të hipë në fuqi populli, kurse pasuritë t'u merrin disave dhe t'u jepen të tjerevë.

— ... Unë jam futur në organizatën e Ballit Kombëtar me ndërgjegje të plotë, pasi kjo organizatë është armiku më i vendosur i komunizmit në Shqipëri.

— ... Njëqind herë më mirë t'ua dorëzojmë fatet e Atdheut të huajve, sa të lejojmë që Shqipëria të bjerë në lëkthetrat e një regjimi shoqëror fund e krye të padrejtë.

— ... Ja, ky është programi im! Siç e shikon, komunizmin unë e urrej me gjithë shpirt! — Kaq foli Nazmiu, ngrysi vetullat dhe heshti.

E ç't'i thoshte Lumta ish-shokut të saj të fëmijërisë? T'i thoshte se komunizmi dhe Shqipëria... Asgjë, s'do t'i thoshte. Ai s'do ta kuqtonte. Dhe ajo s'ishte aty për të bërë agitacion.

Por heshtja e gjatë nuk i pëlqeu Lumtës. Mos vallë kujtonte Nazmiu se ajo lëkundej, luftonte me veten? Asaj i dukej sikur Petriti përgjonte pas derës dhe sytë e tij e qortonin për sjelljen e butë ndaj armikut.

— Ti duhet të dish vetëm një gjë, — foli ajo me

vendosmëri, — për ty, unë s'kam asgjë në zemër, përvëç urrejtjes.

— Edhe unë i urrej armiqtë, por ata s'janë si ti. Mos harro, ti je femër. *Bel sesso*. Seksi i bukur. Seksi i dobët. Ti ke lindur për të krijuar familje, për të rritur fëmijë e jo të merresh me revolucion!

— Shko një herë maleve dhe lufto kundër partizaneve tona dhe do të bindesh se ç'do të thotë krijesë e dobët dhe *bel sesso*.

— S'është ashtu, jo! — briti Nazmiu dhe u fundos përsëri në kolltuk. Ai ishte i bindur se gruaja nuk mund të merrte pjesë në qështjet e politikës njësoj si burri. Vetë natyra e femrës, praktika e së kaluarës, e vërtetownin një gjë të tillë.

— Unë s'e marr kurrë me mend që duart e gruas të jenë krijuar për të mbajtur armët e vdekjes. A s'është luftë dhe përpjekje të rritësh një fëmijë? Një nënë e mirë mund t'i japë botës një gjeneral, një muzikant, një shkrimitar, një... një... — pasi nuk e gjeti dot fjalën që kërkonte, beu u nxeh pak dhe trokiti gishtat mbi tavolinë.

— Ne luftojmë që jo vetëm të lindim e të rritim fëmijë, por që këta fëmijë të bëhen njerëz me dinjitet dhe jo vegla qorre dhe xhelatë të popullit të tyre, siç je bërë ti. Nëna jote është për t'u mëshiruar që lindi dhe rriti një njeri si ti.

Lumta priti që pas këtyre fjalëve Nazmi bej Topi të nxehq përsëri, mirëpo, për çudi, kësaj radhe ai vuri buzën në gaz.

— Unë do të isha mbytur me kohë sikur të pranoja se armiqtë e mi janë femra dhe aq më tepër vajza të bukura.

Lumta heshti. Kafshoi buzët dhe mendoi me hidhërim: «Në ç'duar të ndyra kam rënë!»

— Po largohem, — ia preu shkurt. — Njerëz si ti janë aq të dobët, sa kanë paturpësinë që, për egoizëm e për të vënë në dorë një femër, janë gati të ngatërojnë tërë botën. Kur të më thërrresësh një herë tjetër, sillu ndryshe me mua. Dije, jemi armiq për vdekje. — Kaq i

tha dhe pa e bërë të gjatë, i ktheu kurrizin dhe eci drejt derës gjysmë të çelur, ku dukej hunda e Qazimit tek përgjonte.

— Kthemë në qeli! — e urdhëroi.

Qazimi shikoi nga Nazmi beu, por ai s'dukej fare, aq ishte fundosur në kolltukun e thellë. Ngriti supet dhe ia bëri me shenjë Lumtës të ecte përpara.

Te dera e qelisë Qazimi u përkul para saj duke i pëshpëritur me zë të butë:

— Shoqja zonjushe, ha bukë se do vdesësh! — Nga mënyra si ia tha këto fjalë nuk kuptohej në tallej apo ndiente me të vërtetë mëshirë.

Me të mbetur vetëm, Lumta është përplas në krevat dhe u shkreh në vaj. Ajo ishte gati të bënte çdo sakrificë, vetëm buzëqeshjen e Nazniut të mos e shikonte më. Oh, ç'i imbetej asaj të bënte që armiku ta urrente?

I fundosur në kolltukun e thellë, Nazmi bej Topi ndjeu trazirë në gjoks. Mbuloi fytyrën me pëllëmbë dhe murmuriti: «Ç'ëndrra thura tërë jetën time! Tani mjaf-ton vetëm një nxitje e vogël dhe e gjithë kjo dashuri të më kthehet në urrejtje». Në këto çaste ai e ndjeu veten të braktisur nga gjithë bota, nga gjithë të njojurit, nga vetëjeta. Me të dëgjuar çapet e Qazimit, ngriti kokën dhe urdhëroi me ton të prerë:

— Nxirre herë pas here në tarracë, siç e kërkon ligji për të burgosurit. Jepi të veshë kostumin që i gjetëm në shtëpi. Edhe sandalet e kuqe. Të lahet çdo mëngjes dhe çarçafët ndërroja shpesh.

Qazimi puliti sytë:

— Kostumin aty e kam. Po shkoj t'ia jap tani bashkë me sandalet. Edhe në banjë e çojmë përditë. Po, aman, bej, edhe në tarracë paska hipur ligji?! Ç'i ngjit tërë ato shkallë deri në majë, kur këmi oborrin për bukuri?!

— Në tarracë, që të shohë botë me sy. Ndoshta i kthehet përsëri shija e jetës. Zbutet.

Heshtje.

— Merr dhe gramafonin nga shtëpia.

— Demek, ta zbutim me myzikë! Mendje! — tundi kokën Qazimi, po, si gjithmonë, s'u kuptua nëse e talli beun apo e mburri!

— Bej, po mëngjesin që porosite zotrote për dy veta, a ta sjellim?

— Përjashta!

Në mbrëmje, Nazmi bei Topi u kthye në shtëpi me çehre të dërrmuar.

— Çun, ti s'je mirë. Je dobësuar. As bukë s'të hahet, as gjumë s'të flibet. Vetëm për kuçkën mos më fol.

Ndoshta për herë të parë Nazmiut nuk i bëri përshtypje fjala «kuçkë». Por, megjithëkëtë, gjeti aq fuqi sa t'i thoshte:

— Ajo më ka dëshpëruar.

— Mblidhe mendjen. Nuk është dashuri kjo! Punë fëmijësh. Ç'të lidh me të?

— C'më lidh me atë? — pyeti. — Nuk e di! — u përgjigj dhe nisi të hante me zor e pa shije pilafin me gjel të pjekur, që i kishte vënë e éma përpara.

— E mora vesh që e ke myllur, — i pëshpëriti ajo dhe priti që i biri të çuditej, por ai as e ngriti kokën. — Dëgjo, të kam të vetëm e s'dua të më vuash për shkakun e saj. Përdhunoje. Aq e ka femra, sa ta shtiesh një herë në dorë. Pastaj mbaje si mantenutë.

Nazmiu s'foli. U ngrit nga tavolina dhe shkoi lart, në dhomën e gjumit. Me të rënë në dyshek, zuri kokën me duar, pa qenë i zoti të përqëndrohej në mendimet e veta. Po sïkur të dilnin fjalët e Lumtës? Balli ta humbishtë luftën e çifliqeve t'u vinte fundi? Ku të shkonte ai, ku të futej, ku të përplaste kokën për shpëtim? Kujt t'i kërkonte mbështetje, Lumtës? A s'qe ajo që i tha se tradhtaret janë më të ndyrë se armiqtë e huaj?

«E s'tradhtar jam unë! Unë jam vetëm antikomunist!»

Koka iu rëndua dhe gjumi ia lëshoi kapakët e syve.

Mendimet iu tretën njëri pas tjetrit. Gjithkund qetësi, veç një zë i njojur i thirri në vesh:

«Përdhunoje!»

Hapi sytë. Në errësirën e dhomës, s'pa asgjë, por zëri i mëparshëm i pëshpëriti për herë të dytë:

«Përdhunoje!»

Një shkëndijë e vetme ndriçoi trurin e tij të përgjumur dhe, në shkrepëtitjen e zbehtë të ndërgjegjes, pa ditur si ta zgjidhte këtë enigmë, hëpërhcë, vendosi të ndiqte këshillén e s'ëmës.

«Përdhunoje!»

— Do ta përdhunoj! — briti.

\* \* \*

Pasi u bë çakërqejf në kafene të Refikut, Qazimi mori rrugën për te hani i Muratit. Si kohë lufte, njerëzia qenë mbyllur herët, kështu që ai e ndjeu veten fare të lirë. Bashkë me arapin, që po thërriste jacinë majë minaresë, edhe Qazimi ia mori një kënge të vjetër. Para se të trokiste te porta e hanit, nxori shishen e kolonjës dhe e derdhi në flokët e palarë dhe në setrën e re ushtarake, ku shkëlqenin sumbulla të shumta ngjyrë ari. Por era e fortë dhe e vrazhdë e kolonjës sikur e solli pak në vete. Nuk i pëlqeu Qazimit të shkonte te Murati për t'i kërkuar gocën duke qenë i pirë. Murati qe burrë zakoni, ose do t'ia merrte për shaka, ose, kushedi, mund t'i vinte dhe drunë. U ul në seqe të portës me shpresë se mos i dilte rakia. Por, duke pritur që të bëhej esëll, Qazimin e zuri mërzitja dhe padashur i shkuant duart te faqorja në xhepin e setrës. Zuri të pinte me gërqe të gjata dhe, sa herë që e hijte nga buzët grykën e saj, dëshironte t'i largohej ajo turbullirë e të bëhej esëll, se s'po i durohej më burrit larg gocës së hanxhiut, që i kishte ato gërshtëtë trashë deri në bel.

— Sanije! — mezi shqiptonte. — Ku je, moj Sanije! Hajde, moj, ke Qazimi yt. Se vdiqa. Mbarova. Sharrova.

Uf! — dhe i binte një herë kokës me grusht, një herë gjoksit, pastaj i kthehej dy herë kokës, dy herë gjoksit.

— Gërr-gërr-gërr, s'i hoqi buzët Qazimi, derisa e thau fare fagoren.

— Sa pér sonte, po iki, Sanije! U deha, s'kam guxim tē futem në han! Po hap sytë, po s'më deshe, Qazimi s'të lë pa tē rrëmbyer. E dëgjon? Të dua! Do tē tē rrëmbej!

Qazimi u langua duke u kolovitur. Padashur këmbët e quan atje ku ishin mësuar tē shkonin çdo mbrëmje. I ra përmes fushës së sportit, trokiti, por aty brenda s'u bë njeri i gjallë. Hapi derën me çelësin e vet, që hapte çdo bravë, dhe u zvarrit deri te krevati i Aishes. Pasi u sigurua se ajo po flinte, ndezi elektrikun. Po c'të shikonte! Edhe Aishja e re, edhe Deme kasapi, një alamet burri, që ia kalonte pér gjatësi dhe vetë Qazimit, ishin shtrirë mbi krevat e po bënин gjumë tē thellë. Kur pa ftyrën e njomë tē Aishes, tē lodhur e tē munduar, buzët e saj tē hapura e në mes tē tyre majén e kuqe tē gjuhës. Si e gjarprit kur e zë vapa, Qazimit iu veshën sytë. Aishja po e përqeshëte! Paf, uli siguresën e pushkës.

— Çohu, qerrata! — thirri ai.

Deme kasapi hapi sytë. Aishja u zgjua dhe, siç që gjysmë lakuriq, fësht u fut nën krevat. Sakaq, Demja brofi më këmbë me kokën në tra.

— Demo, mos e hidh gapin, se tē vrava. Vishu e qërohu një orë e më parë me faqe tē bardhë, — briti Qazimi me grykën e pushkës diku gjetkë, pasi sytë nuk i shikonin vetëm një Deme, por katër.

Deme kasapi ia zuri pushkën pér tyte si pa tē keq dhe ia hodhi matanë. Qazimi u ngjesh pas murit. Demja e përmblodhi midis kraheve dhe duke e mbajtur peshë, doli te dera. Atje u zhvillua ky dialog me zë tē ulët:

— O Deme, ku po më çon?

— Në përrua. Të paska zënë keq rakia.

— Lëshomë, se do iki.

— Të lëshoj, po mos i bjer më qafë Aishes. Mezi e kam pér vete. Unë e ushqej me bybyreke dashi, kurseti më vjen si kapadai. Po derën, hapur e gjete?

- Hapur e gjeta.
- Aishja m'i ka fajet. Ma ka me hile!
- Ta merr mendja, ajo lë kokën pér mua.
- Pusho, se të shqeva!
- Deme, si s'pate frikë kur ma zure me dorë pushkën?

— Horri i horrit, sikur s'e di unë që t'i s'e mbush kurrë patickën!

— C'ma hodhe, ore! Prit se do të vij një herë tjetër e do t'i fut një donomit të madh... Oh! Mos ma shtrëngó belin ashtu. A s'u lodhe që më mban në krah?... Me donomit do ta mbush. Ta mbash mend fjalën time.

— Eja, pa të çaj me kacaturre.

E vuri Qazimin mbi një trung arre të kalbur dhe u kthyesh shpejt, se mbrëmja qe e freskët. Pas pak dera u hap përsëri dhe te këmbët e Qazimit u përplas paticka e gjatë.

Qazimi ndenji mbi atë trung më se një orë kokë e buzë varur, derisa i doli rakia. Ai çuditej me vete. «Sa poshtë kam rënë!» Dhe kujtonte fshatin. Atje kishte qenë i pastër. «Bah, sa natë e prapë! Kështu si është bërë sot qyteti, nuk sheh hajër opinga... Sanijes s'kam guxim t'i dal përpara. Përse? Sepse e dua. E merr vesh, e dua! Aishen ma qaplosi Deme Myrryli. E, or Dem, po s'ta gjeta vaun. Mos rënç në hile të fshatarit!»

Ngriti kokën në quell dhe pa një yll tek ai bënte me sy midis reve. Ylli u mbulua. Qazimi u ngrit. Që në çapet e para harroi gjithçka: edhe Sanijen, edhe Aishen, edhe Deme Myrrylin. E, me të harruar ata, në mendje të Qazimit u ngjallën Nazmi beu me Saibe hanëmin.

Dhe kështu, atë natë ordinanca e komandantit të rinisë së Ballit mori rrugën e shtëpisë disa orë pas «coprifuoco-s». Atij s'po i pritej sa t'i rrëfente hanëmit ato që pa e dëgjoi në dhomën e beut të vogël.

«Oj, goca, meazzallah se i bie në dorë. Ama, edhe beu... Si i tha ai?... Saksi e bukur! Hej, o bei, shkollë ke, verdhushka ke, por vetëm mendje s'të ka dhënë perëndia! S'para di t'i vërtitësh punët. Ja, më merr mua, vërtet njeri pa shkollë jam, por di të qep me dyzet gjil-

përa. Sonte do shkojë vëllai yt... phu, — pështyu me neveri Qazimi, — çfarë vëllai të kam unë ty. E që thua ti, o bej, o vëlla, phu, do shkoj vëllait yt e do shkrijë kockat në karajollin me pupla të hanëmit të Elbasanit. E, kur ta shikoj se po më kärcënohet, do t'ia pres:

— Hesht! Saksi bukur. Saksi dobët! Ha-ha-ha-ha-hi-hi-ho-ho-ho.

Në gaz e sipër, nxori çelësin që ngjante si kobure e madhe, dhe hapi portën. Pasi përgjoi një hop në errësirën e sallonit, u fut si hije në dhomën e hanëmit... me buzët të shtrënguara fort nga frika se mos i shpëtonin para kohe fjalët:

— Hesht! Saksi bukur. Saksi dobët!

## *Kapitulli i nëntë*

### **P E R P E L I T J E**

**N**atën e dytë Qamil Tapinë e morën në pyetje. Përballë tij, në njérën anë të tavolinës, ishte ulur feldfebeli, në anën tjetër përkthyesi, një burrë i panjohur, i veshur pastër, pamja korrekte e të cilit e tregonte të edukuar e shpirtbutë. Meqë feldfebeli ishte në orë të mira, Qamili e pa të udhës t'ia niste menjëherë nga dredhitë. U tha se ai qëlloi rastësish afér shkollës dhe se doli me natë nga shtëpia e një kushëriri, pasi kishte dashur të udhëtonte për në Tiranë në mëngjes herët. Armë s'pat me vete dhe, kur plasi pushka, u tremb e deshi të kapercente murin e një kopshti, por aty e qëlloi në gju një plumb qorr.

Hetimet zgjatën gjysmë ore. Feldfebeli s'nguli këmbë dhe, për çudi, i besoi të gjitha sa i tha Qamili.

Kur feldfebeli kërkoi nga ai për të firmuar një si biçim deklarate (kështu ia shprehu përkthyesi), Qamili foli:

— Pse duhet kjo?

— S'ka rëndësi. Një formalitet i thjeshtë, që duhet ta lëshojë cilido që ndodhet në gestapo, qoftë dhe përkohësisht.

Në hetim e sipër, midis feldfebelit dhe Qamilit u

ndeh një gjendje paqeje dhe butësie, një mirësjellje e atillë, që e detyroi Qamilin të tundej mbi këmbën e shëndoshë dhe të heshtte një copë herë. Atij i vinte rëndë të përgjigjej: «Jo!» Aq më tepër, kur me një «jo» mund të ngjallte përsëri dyshime te gjermanët. Pérderisa punët muarën këtë rrugë dhe ai doli i paparti, apolitik, e mira e të mirave do të qe sikur ta jepte edhe atë copë deklaratë. Pasi e pa se e teproi me heshtjen e tij të gjatë, më së fundi, tha me gjysmë zëri:

— Mirë!

Hodhi firmën. Njëkohësisht vendosi që, sapo të dilte — po të dilte i gjallë nga thonjtë e tyre — do t'ia trengonte menjëherë Partisë rrethanat në të cilat e firmoi.

Me kaq nata e parë e hetimeve mori fund.

Çfarë priti, çfarë i doli! Ai qe përgatitur të përballonte torturat më të egra, kurse punët rrodhën krejt ndryshe. Por, duke e menduar e stërmenduar gjendjen e vet në errësirën e bodrumit të gestapos, zuri të dyshonte se e gjithë ajo që i ngjau me feldfebelin, s'qe vëçse një shaka, ose kushedi se çfarë... dhe se çasti i vërtetë s'kish te ardhur akoma. Sidoqoftë, ai ishte i përgatitur, veg të vinte pa vonesë ai çast, sepse pritja në ato kushte që më e tmerrshme se vëtë torturat. Qamili i trembej mjafth heshtjes dhe errësirës së bodrumit. Ai kishte frikë se mos kjo gjendje e nderë e thyente dalngadalë, ashtu si pikat e ujit hapin vrimë në shkëmbin e granitit.

\* \* \*

Të nesërmen, forcat e esesëve rrethuan shtypshkronjën dhe fabrikën e cigareve. Punëtorët u lajmëruan të grumbullohen në oborrin e përbashkët midis dy ndërtësave. Pasi u mblohdhën të gjithë, përkthyesi nxori nga xhepi një letër dhe lexoi nja njëzet emra me zërin e tij monoton, si të qe duke kënduar psallme.

— Ata që dëgjuan emrin, të dalin mënjanë!  
Por radhët e punëtorëve i mbuloi heshtja.

Siq u sqarua pak më vonë, doli se asnijéri prej tyre nuk e kishte dëgjuar emrin e vet. Pa humbur kohë, u mblohdhën të dyqind e ca leternjoftimet dhe u bë kontrolli i përpiktë me listën. Vërtet, asnijë emër i listës nuk figuronte në leternjoftimet e punëtorëve. Por, megjithëkëtë, major Franci, me sprovën e tij, nuk e mori punën me të ngutur: rrëthimin nuk e hoqi. La aty feldfebelin kuqualash dhe vetë i hipit veturës. Me të arritur në gestapo, dha urdhër për arrestimin e avokat Demir Tapisë.

— Në listën që na dhatë ju, nuk janë veçse pseudonimet, — foli me të egër majori. — Keni pesë minuta afat. Në qoftë se nuk gjeni rrugëdalje, do të pushkatoheni bashkë me djalin.

Demir Tapia ngriu në karrige.

... Këtu e tri ditë më parë, kur mori vesh arrestimin e të birit, ai mbylli avokatoren dhe e mbajti frymën drejt në shtëpi. «Mirë ka thënë ai i motit, kush i bën gropën tjetrit, bie vetë brenda!» — bërbëliste me vete. Por s'ishte koha që Demir Tapia të kryqëzonte duart. Çuni duhej shpëtuar me çdo kusht. Mori nga sirtari i tavolinës listën me emrat e të rinjve komunistë të fabrikës e të shtypshkronjës dhe në mesnatë u fut në gestapo. Ky qe kallëzimi i dytë i Demir Tapisë. Por, me sa duket, edhe ky kallëzim ra po mbi kokën e tij e të të birit.

Avokati e ndjeu se po përmbysej gjithçka. Në qoftë se herën e parë ai u bë shkaktari që e arrestuan, tani po e fuste në gropë po vetë.

«Ah... Ah!» — rënkoj me zë në sy të majorit, duke e mallkuar veten për rrugën që zgjodhi e për të gjitha ato që bëri.

Në fytyrë i ra çehreja e të vdekurit. Ai e dinte farë mirë sa lehtë ishte për major Francin të pushkatonte dy njerëz.

«Mbaruam! Mbaruam!» përsëriste pa ditur ç'të shpifte e ç'të gënjkente.

— Herr, — u përpoq të fliste, por zëri i mbeti në grykë, pasi te pragu i derës bëri ballë i biri.

Me të parë të atin, Qamili shtangu. Mos vallë kjo ishte arsyjeja e vërtetë që silleshin mirë me të në atë

bodrum vdekjeje? Po, kur vuri re gjendjen e ligshuar e tē rrëzuar tē tē atit, mendoi: «E paskan arrestuar! Tani fillon pér nejeta e vështirë nē gestapo!»

Demir Tapia deshi tē ngrihej pér tē përqafuar tē birin, por sytë e ftohtë tē majorit e mbërthyen nē vend.

— Herr, — u dëgjua zëri i tij i thellë, — lista është e djalit tim... — zëri iu shua, u drodh mbi karrige dhe u rrëzua pa ndjenja nē këmbët e majorit.

Qamili ra më gjunjë pranë trupit tē palëvizur tē tē atit, por nuk e ndihmoi dot, ngaqë duart i kishte tē lidhura nga prapa. Atij i erdhi plasja kur pa Kurtin që e goditi tē atin nē faqe.

Pas pak, avokati tundi kokën, shkrofëtiu dhe hapi sytë, por s'pati fuqi tē ngrihej.

— Jam nē shërbim tē zotërisë sate! — mezi foli.

— Puna do tē tregojë, — ia priti ftohtë majori.

— Ç'kérkon nga unë? A doni t'ju bie këtu tē gjithë qytetin? Veç djalin mos ma vritni. E kam tē vetëm!

— Hëpërhë ne duam vetëm pseudonimet e listës.

— Veç djalin mos ma vritni!

Qamili e dëgjonte dialogun e tyre duke shedhur sytë sa nga njëri te tjetri, sikur ta kuptione gjuhën tē cilën flitnin.

Pak nga pak Demir Tapia e mblodhi veten, u ngrit ngadalë, u ul nē karrige, i tmerruar përsëri pér premtimin e madh që u dha gjermanëve. T'u binte nē gestapo tē gjithë qytetin! Avokat Demiri tē luante rolin e një spiuni tē thjeshtë! Oh...

— Schnell!<sup>1)</sup> — thirri majori.

Avokat Demiri e mblodhi veten.

— Dëgjo, çun, këtë listë e gjetën gjermanët nē do llapin tënd. Tregoju emrat e vërtetë. Shpëto veten dhe mua.

Qamili shikoi listën ku ishin shkruar emrat e shokëve dhe u përgjigj vetëm me një tē tundur tē kokës: jo.

---

1) Gjerm. — Shpejt!

— Bir, Partia u shemb. Këto ditë është arrestuar gjysma e qytetit. Petriti po vdes në spital. Lumtës i humbi gjurma, duket se e turpëroi veten me çunat e bejlerëve. Ka ardhur kohë e keqe!

Koka e madhe e Demir Tapisë tundej ngadalë; sytë e vegjël gati i kishte mbyllur; veshët e mëdhenj e të kthyer përpara dukeshin sikur përgjonin dhe pritnin përgjigje. Ndoshta për herë të parë Qamili mendoi me keqardhje për sytë e vegjël të të atit në atë fytyrë të hijshme dhe njëkohësisht nuk i erdhi mirë që trashëgonte nga ai veshët e mëdhenj.

— Schnell! Schnell! — thirri major Franci.

— Bir!

Majorit iu sos durimi. Dha shenjë dhe në dhomë u tutën tre esesë me automatikë.

Demir Tapia e humbi toruan. U ngrit nga karriga dhe iu lut Qamilit:

— Trego, aman, me flori do të të peshoj!

«Edhe këtu të florinjtë i shkon mendja!» — u çudit Qamili.

Major Franci nxori revolen dhe ia vuri Demirit në ballë. Qamili u drodh nga frika se mos shikonte të atin të vrarë pranë vetes.

— Të pushkatohen! — tha majori duke e qëlluar avokatin në kokë me dorezën e revoles.

Kur po dilnin nga dhoma, atë e bir qenë bërë si të vdekur e mezi qëndronin më këmbë. Demiri, i mbështetur në krahun e të birit, pati një parandjenjë se Qamili s'kishte më guxim dhe fuqi për të kundërshtuar.

— Në makinë, — i pëshpëriti majori. — Çojeni para punëtorëve.

Kur e hipën në veturë, Qamili s'ishte në gjendje të thoshte as «po», as «jo».

— Shko në avokatore! — e urdhëroi majori Demir Tapinë. — Hap fjalë sikur të patën arrestuar gabimisht. Shkurt: ti na duhesh akoma.

— Herr, herr! Çunin mos ma vritni! Çunin!.. — por

tymi që doli nga skapamentoja e makinës, iu fut në grykë dhe kolla s'e la të fliste. — He... Herr, kum, kum, kum.

Vetura ushtarake u duk përsëri tek oborri i fabrikës, ku feldfebeli i kishte grumbulluar punëtorët rrëzë murit. Zbritën njëri pas tjetrit major Franci me një dosje nën sjetull, Qamil Tapia me duar të lidhura prapa, Kurti me rripin e kapeles nën mjekër.

Pa humbur kohë, feldfebeli urdhëroi punëtorët të rreshtoheshin. Përsëri u dëgjua si në kishë zëri monoton i përkthyesit:

— Luan Shpati!

Oborri i fabrikës heshtte. Të gjithë sa ishin aty, gjermanë e punëtorë, shikonin në drejtim të Qamil Tapise, që rrinte kokulur.

— I kujt është ky pseudonim? — Kësaj radhe zëri i përkthyesit qe i shqetësuar.

Qamili peshoi mbi këmbën e sëmurë dhe, për çudi të tij, s'ndjeu asnjë dhembje. Ngriti kokën ngadalë dhe hodhi vështrimin mbi punëtorët e heshtur. «Gënjeshtë! — mendoi. — Partia jeton!» Dhe padashur u shikua sy ndër sy me Bardhylin e vogël, që mbante pseudonimin «Luan Shpati».

Dukej sikur asnjë s'merrte frymë, përvèç major Francit, që thirri:

— Schnell! Schnell!

Aty, para shokëve, Qamil Tapia ra në dilemë. Aq sa u trembej britmave të majorit dhe grykës së automatikut të feldfebelit që e shponte pas kurrizit, aq i trembej edhe zërit të vet nga frika se mos e tradhtonte në këto çaste vendimtare. Mbushi gjoksin me frymë dhe u mat të fliste: zemra i rrahu fort, gjaku i ngriu, mendja i fluturoi diku larg, pastaj... trupi i tij u thye ngadalë dhe para se të humbiste çdo ndjenjë, ai gjeti fuqi sa të ngrinte sytë për të shikuar edhe një herë fytyrën e qetë të Bardhylit...

\* \* \*

Me të dalë nga gestapoja, Demir Tapia mori rrugën pér nё avokatore buzëvarur, duke u mbështetur nё bas-tunin e tij, pa çarë kokën pér përshëndetjet e të tjerëve. Nën degët e rrapit të madh, te sheshi i Bezistarit, u takua me usta Dine Çelikun. Burrat hapën krahët dhe shikuani njëri-tjetrin buzagaz. Nё fytyrat e të dyve dukej qartë vula e trishtimit, por nganjëherë burrat e thyer nё moshë ngjajnё me të vegjlit, të cilët janë gati të gëzohen nga një takim i rastit me shokun. I tillë, ndoshta, qe edhe gëzimi i tyre, kur u gjendën ballë pér ballë. Dinia mendoi se, pas gjithë kësaj fatkeqësie, avokati, si njeri i interesuar, do t'i thoshte ndonjë lajm pér çunat, kurse Demiri pati një gëzim të castit, jo se ashtu i diktonte zemra, por atë e bëri pér vete ciltësia fëmimore që ndriti nё sytë e thellë e të pastër të Dines.

— Po ku humbe, mor i uruar? — foli i pari Demiri duke shtrënguar dorën e ashpér e me kocka të Dines nё mes të duarve të veta të buta e plot tul.

— Atje, Demir efendi, — iu përgjigj me zë të ulët usta Dinia, — nё mal, me çunat.

Me të dëgjuar fjalën «mal», pa ditur sepse, Demir Tapia ndjeu njëfarë kureshtjeje.

— Hajde, pra, Dine, na thuaj ndonjë të re! — iu lut avokati pa ia lëshuar dorën.

Megjithëse moshatarë, ata s'kishin ndonjë miqësi të madhe. Ku një avokat, ku një armëndreqës i thjeshtë! U pat rënë rasti të takoheshin kur usta Dinia i ndreqi bravat e dyerive nё shtëpinë e re dhe tek-tuk, kur i thyhej ndonjë çelës ose i kalbej ndonjë civi. Që kur u «lidh» me çunat dhe nё mes tyre pa edhe Qamilin, pér usta Dinen, Demir Tapia u bë shembull i babait, i cili megjithëse i ka të gjitha të mirat, prapëseprapë është gati t'i dalë zot vendit sa herë që ta lypë nevoja.

— Pa hë, ç'flitet?

— Ç'të të them unë i shkreti! — ia ktheu Dine Çeliku. — Na gjet hata e madhe!

Pa i läshuar dorën njéri-tjetrit, dy burrat u futën në një rrugë me kaldrëm të prishur dhe u drejtuat për në kafenenë e vogël të Refikut. Kafexhiu i priti me buzën në gaz e me një të shkelur të lehtë të syrit. Kjo donte të thoshte se në kafene ndodhej një njeri i dyshimtë. Në njérën nga tavolinat ishte ulur një mesoburrë, çertexhi i Bezistanit, që numëronte tespitë. Pak më tej, Musa lëkuraxhiu fliste pa pushim me vete, herë duke qeshur, herë duke sharë me inat, dhe me të kthyer gërqen, përplaste grushtin mbi tavolinë. Refik Kafexhiu me një dorë i mbushte gotën, me tjetrën i merrte paratë:

— Pi, po mos thirr! — këshillonte me zë të ulët lëkuraxhiu.

Afër derës ishte ulur një fshatar i tħyer në mosħe: hante me oreks një copë bukë misri thatë, pa shikuar kush hynte e dilte në kafene. Pranë banakut po luanin bixhoz dy vetë, jo dhe aq tē rinvj, po jo dhe burra në mosħe; ata e hijnqin veten për sportistë, por, në tē vërtetë, s'dihej se me q'zanat merreshin kohët e fundit. Heré-heré ia nisnin shamatës, përplasnim letrat duke thirur e numëruar paratë e njéri-tjetrit. Tavolinat e tjera ishin bosh.

Sipas shenjës së Refik kafexhiut, Demir Tapia dhe usta Dine Čeliku u ulën në qoshen tjetër, përballë banakut.

— Dy me pak, o Refik! — porositi avokati, duke u hedhur një sy njerëzve që ishin në kafene.

Dyshemeja, e sħtruar më rrasa prej guri, sapo qe larë dhe pastruar. Por, megjithatë, Mizat ishin tē panumërta. Fluturonin duke zukatur e tē futeshin drejt në filxhan tē kafesë ose në bebe tē syrit.

— Prapesi, Demir efendi! — tha Refiku kur solli kafetë. — Thonë se kur qorrohet miza, ka qesatllék.

— Për kokë tē hasmit! — shtoi usta Dinia.

— Tē lumtë goja, — foli Refik kafexhiu dhe u largua duke trokitur nallanet mbi rrasat e gurit.

— Si the ti, vajte deri te çunat në mal! — foli Demiri për tē hapur bisedën.

— U ndreqa ca pushkë, Demir efendi.

Megjithëse ishte mesi i tectorit, në kafene bënte va-

pë. Pasi piu gërqen e fundit, Demiri zërtheu xhaketën, vuri kapelën e zezë në qoshe të tavolinës, nxori nga xhepi një shami të vogël dhe fshiu bulat e njersës, që i shkëlqenin në ballë. Edhe usta Dinia zërtheu sëmbullën e sipërme të jekut, të punuar me lesh çile, çiroi lidhëset e këpucëve, se i shtinin vapë, ngriti qeleshen e bardhë në majë të kokës dhe nga pala e brezit që i shtrenjonte pantallonat, nxori një peshqir të madh.

— Harrova të them pér çunin! — foli befas usta Dinia.

— Hë, çfarë? — pyeti me padurim avokat Demiri, që kujtoi se ishte fjala pér të birin, me të cilin sapo që ndarë.

— Shpëtoi!

— Cili, cili shpëtoi? Fol!

Usta Dinia u çudit pér këtë hutim të bashkëfolësit.

— Marku, Demir efendi, që u plagos dy javë më parë. S'të paska thënë çuni?

— Se mos rrinte në shtëpi im bir! Ditë e natë pér Partinë punonte! — e mblođhi veten Demir Tapia.

— Dy ditët e para thamë se aq e pat, por tani e kaloj të keqen. Të mos qe ndodhur doktor Besim Kodra, që zbriti kastile nga Malet e Shqipes, iku e shkoi çuni! E kanë shtruar në shtëpinë time. Operacion.

Ja dhe një sekret tjeter! i penduar pér ato që pat bërë Demir Tapia e mallkoi me vete usta Dinen pér pakujdesinë që tregoi: Mjaft! Sekrete s'donte të dinte më!

— Dine, dëgjo këtu! — foli ai me ton të rëndë. — Shyqyr që paska shpëtuar ai... Marku, por ti... — dhe i mbeti fjala përgjysmë.

— Fol, Demir efendi, — murmuriti usta Dinia duke shikuar me çudi fytyrën e zverdhur të avokatit.

— S'duhet të më tregoje pér të plagosurin që mban në shtëpi. Janë gjëra të fshehta këto!

Usta Dinia e ndjeu veten pak të fyjet:

— Demir efendi, po zotrote je baba komunisti! Me kokën në torbë pér Partinë!

— Por sekretet e Partisë s'duhet treguar.

Herë-herë Refik kafexhiu mbante vesh pér të pro-

vuar nëse dëgjohej pëshpëritja e tyre deri tek ata që loz-nin bixhos. Kur u sigurua se çdo gjë ishte në rregull, u qetësua dhë s'u duk pér një kohë të gjatë në banak.

— Hajt, ta lëmë këtë muhabet! — ia pat me gjallëri Demiri pas një heshtjeje të papëlqyer. — Po s'na the një fjalë pér çunat që i kemi në burg?

— Unë pres nga ti, Demir efendi. U copëtua Dana e shkretë, por nuk dëgjoi një fjalë të saktë!

Demir Tapia tundi kokën i dëshpëruar, aq sa usta Dinia e kuptoi para se ai të hapte gojën.

— As unë s'di ç'të them. Gjermanët ta humbin bo-jën, s'dinë llafe ata.

Afër banakut, bixhozçinjtë zunë të shanin njëri-tjetrin. Si pér inat të tyre, Musa lëkuraxhiu ia nisi një këngë të Isuf Myzyrit:

*Iku nata, agun malet,  
Ç'na u gëdhi, na ra sabah!  
Jani shokë e m'qani hallet  
përsëri kam vu sevda!*

Zëri i lëkuraxhiut vinte si në të qarë e në të qeshur. Në kafene s'dëgjohej më as zukatja monotone e Mizave, as cicërima e zogjve në degët e rrapit aty pranë.

*Sevdaja në pleqëni,  
S'asht memqym o me u durue!  
S'ma qajn hallin shokt e mi,  
Mjeri unë si kam mësue!*

— Demir efendi, unë i kam dëgjuar çunat kur mbaj-në konferenca në mal! — foli usta Dinia pér të ndërruar muhabetin.

— Ç'thonë — e pyeti me kureshtje Demiri, megji-thëse takimi me usta Dinën nuk e lehtësoi asnjë grimë.

— Ç'thonë? Ja si thonë: zanatçinjtë si unë na u quakan punëtorë e, si ta them unë i shkreti, bie fjala, punëtorët e fambrikës do ta marrin fuqinë në dorë...

— Ai u mendua pak pér të kthjelluar e mbledhur men-dimet. — Kur bisedovë para ca ditësh me komisarin,

me atë komisarin e kuq, Skënder Shpatën, e di vetë zotrote, që e shpëtoi doktor Besim Kodra dhe e shtroi në barrakën e Gjonajt, komisari më tha, se pasi të kemi çliruar Shqipërinë, do të ngremë fabrika të mëdha, si ta them, një fabrikë do të jetë njëzet herë më e madhe se hani i Muratit. Mua do më vënë që t'u mësoj çunave zanatin. He, vallahi, do t'i mësoj që... Po dale, jahu, e pyeta njëherë komisarin e kuq, kemi njerëz, të ditur, me shkolla të larta, të lidhur këmbë e kokë me Partinë, që i kanë edhe çunat komunistë të flaktë, po me ata ç'do të bëhet? Apo vetëm ne, punëtoria, do jemi në qeveri? Komisari i kuq, vuri buzën në gaz. Mos u bëj merak, usta Dine, ma priti, edhe ata i kemi tanët.

— Mor pusht! — u dëgjuar befas te dera e kafenesë zëri i një gruaje, mbuluar me napë e ferekhe. — Fëmijët po të vdesin për bukë, kurse t'i m'i bëre paratë rrush e kumbulla!

Lëkuraxhiu shikoi me bisht të syrit andej nga erdhë zëri dhe u ngrys.

— Më ler rehat, grua, në pyeç për para, as kam, as më mbarohen!

— T'u nxiftë faqja t'u nxiftë. Oj, burri me katër kalamaj, më vjen me sabahile në kafene.

Demir Tapia dhe usta Dinia u ngritën.

U dëgjuan nallanet e Refilkut, i cili përpigjet t'i mbushte mendjen lëkuraxhiut të mos thërriste. Por sytë e të dehurit u ndezën më keq.

— Kujt ia thua këto fjalë ti! — e brofi më këmbë, duke u tundur nga inati. — Ti do më mësosh mua! Demek, ti thua se unë s'ia ditkam kimetin punës!

Refik kafexhiu mundohej ta qetësonte, por lëkuraxhiu, duke nxjerrë kokën sa nga njëri sup i tij në supin tjetër, vazhdonte:

— Tërë jetën më këmbë, moj rrospi, i kam qëndruar punës. Po tani si t'ia bëj hallit kur s'ka? Apo ti thua të dal e të mbledh lëkura fshatrave. Kështu thua ti? Mirë! Ja ku dola! Apo s'kam dalë. Kam dalë! Po kush të lë rehat sot, moj tutkune! A s'më thanë gushikuqët se gjaja unë shkokam fshatrave, jo për të mbledhur lëkura, po

për t'u takuar me partizanët?! Sot, ose rri e ngcp trutë me raki, në i paç edhe ato në kokë, ose, në ta mbajtë dil partizan. Por unë s'ua kam ngenë atyre punëve...

Fjalët e fundit dy plegjtë i dëgjuan në sheshin e Bezistanit. Ata ecën një copë herë pa folur, duke shikuar secili para këmbëve të veta.

— Ashtu është, Partisë i duhen jo vetëm punëtorët, por edhe ata me shkollë e me kulturë, — foli Demir Tapisë me gjysmë zëri, por mendja zuri t'i rrishët përsëri tek i biri.

— Por, ama e di si tha komisari? Ata njerëz që kanë shkollë dhe e heqin veten për të ditur, nëse s'kuuptojnë edhe sot detyrën karshi atdheut, por shkojnë e lëpjinë sahanët e armikut, për ata drejtësia do të jetë e pamë-shirshme.

Demir Tapisë i therën këto fjalë. Armëndreqësi, me mendjen e tij të pastërvitur, i kishte vënë gishtin në plagë. Një si perde e hollë ia veshi sytë dhe në çast këmbët iu penguan nëpër gropat e kaldrëmit.

— Tyt, Demir efendi, mbahu, bre burrë! — e zuri për krahu usta Dinia. — Thuaj q'të duash, u plakëm!

— S'kam gjë, jo, — foli avokati nëpër dhëmbë. — Më pengoi ky dreq bastuni. S'janë rrugë për bastun këto.... Fol ti, fol, — iu drejtua Demiri, i shtyrë nga një instinkt i pakuptueshëm për të dëgjuar deri në fund fjalët që e tmerronin më tepër se çdo gjë tjetër. Ai për hir të atij tmerrri pat qëndruar larg politikës deri aty ca ditë më parë.

— E, që ta kam fjalën, — u gjallërua usta Dinia, — unë i thashë komisarit, ashtu de, si na e pret neve plegve, pa shkollë, se njerëzit që duan t'i bëjnë varrin vatanit, ka për t'i dënuar vetë perëndia. Do t'u lëshojë gurin e nxehëtë: «Na, qerrata, të dhashë mend e s'dite t'i përdorësh, hajt sikter e përvëlohu në xhehenem.»

Demir Tapisë i theri përsëri në zemër; perëndisë, që s'dihet se q'të punon «në botën tjetër», ai i trembej një-soj si komunizmit «në këtë botë». E shikoi me bisht të syrit bashkëfolësin, si për t'u bindur se romuzet nuk ia

hidhte atij. I kënaqur nga fytyra e butë e Dines, Demiri mori guxim:

— Po, ashtu éshtë, — belbëzoi.

— ... Mirëpo, do ti, njëri nga partizanët na dëgjoi e më t'ia pat, mashalla, i priste gjuha çunit si thikë: «Po të jetë për perëndinë, spiunët rrojnë njëqind vjet, se as që ka perëndi, po ne do t'i vrashim vetë, një plumb kokës dhë hajt në...» mender teje, Demir efendi, këputi një koqe të sharë partizani, që ç'ke me të.

Mjaft! Ç'qejf kishte avokati të bisedonte me një plak matuf?! Uli kokën për t'i dhënë të kuptonte se nuk pu e dëgjonte më. Në krye të rrugës Demir Tapia qëndroi dhe, pasi lëshoi një psherëtimë, ashtu siç bëjnë njërzit kur janë në hall të madh, tha:

— Eej, ç'të bësh! — Me këto fjalë, ai silkur i vuri kapak bisedës me usta Dinen. Jam bërë gjysmënjeri nga halli për çunin!... Epo, mirupafshim, usta!

Burrat u ndanë dhe secili hoqi çapin në drejtim të kundërt.

— Po të dëgjosh ndonjë të re, eja nga shtëpia! — i lëshoi zë avokat Demiri.

— Mos ki merak! — ia ktheu usta Dinia pa ndaluar.

Demir Tapinë se ç'e ngacmonte në gjoks. Mëgjithë neverinë që ndjeu gjatë bisedës, prapëseprapë s'e linte kureshtja për të dëgjuar një njeri që shkonte e takohet me partizanët e malit.

— Mos harro, Dine, eja! — i thirri përsëri nga larg.

S'ishte i qetë Demir Tapia, që kur mësoi se në shtëpi të Dine Çelikut ndodhej një komunist i plagosur. Dhe cili? Mark kokëmadhi!.. Po i biri, ç'qëndrim do të kishte mbajtur para punëtorëve të fabrikës dhe të shtypshkronjës?..

... Afër prefekturës usta Dine Çelikut i zunë sytë një tufë pëllumbë, që, pasi fluturoi ca kohë përmbi çatitë, mori përpjetë qellit.

— Pëllumbat e Muratit! — tha me vete dhe aty për aty ktheu rrugë pér t'i bërë një vizitë mikut të vjetër.

Në han, usta Dinia nuk gjeti vetëm një, por dy miq: Murat hanxhiun dhe Vasil Gjinarin.

\* \* \*

Major Franci nuk i humbi shpresat. Ai nguli këmbë në mendimin e vet se të birit të avokatit duhej t'ia hante zemrën me të mirë. Pasi dha urdhër pér arrestimin e punëtorëve të shtypshkronjës e të fabrikës tridhjetë vjet e poshtë, u nis pér në gestapo, duke marrë në makinë edhe Qamilin, që s'kishte ardhur akoma në vete.

Në mbrëmje majori e mori në pyetje personalisht, Qamil Tapia i përgjigjej me kujdes dhe më se një herë kafshoi gjuhën, kur i dukej se po e shkelte me ato që thoshte. Por, në të vërtetë, tregimet e tij s'para po e kënaqnin major Francin... Kur Qamili zuri të numëronte emrat e atyre që u jepnin ndihma partizanëve, lista u bë pa fund e gjatë. Sipas Qamilit, dilte se i gjithë qyteti, të mëdhenj e të vegjël, të varfér e të pasur, u jepnin ndihma dëhe ishin me partizanët. Major Francit iu duk se komunisti po përpinqej të shiste idetë e veta para syve të tij: i gjithë populli me partizanët. Kjo ishte demagogjji. Megjithatë, majori kërkoi nga Qamili të mendohej atë natë dhe nesër në mëngjes t'ia numëronte me gishta. cilët ishin të parët e Partisë dhe ku strehoheshin.

I pushtuar nga një ndjenjë e rëndë, afër mesit të natës, majori doli nga bodrumi dhe u ngjit në tarracë, që të prehej e të merrte pak ajër të pastër para gjumit.

Një qetësi mbytëse zotëronte anembanë: asnjë dritë, asnjë lëvizje. Veç andej larg, mbi shpatullat e maleve (ku do të ngjiteshin së shpejti forcat e gjeneral fon Gumanit)jeta jepte shenja gjallërie. Zjarre të shumta ndriçonin nëpër grykat e thella dëhe ndërsa majori shikonte ato xixëllime, mendonte se do të qe një mijë herë më mirë sikur të mos kishte pasur fare jetë në ato vende të egra. Por, mbi të gjitha, majorin e çudiste gjendja në qytet. Si ishte e mundur, që këtu, nën këmbët e tij, në një qytet të vogël sa grushti, ai s'po dinte t'i jepte fund organizatës së fshehtë? Nganjëherë i dukej vetja si minëzbërthyesi, i cili e zotëron mekanizmin e minës ashtu si major Franci qytetin; por ja që nuk e zbërthen pér një

mrekulli, a për një keqkuptim. Ku u shtypën komunikat që u shpërndanë përsëri dje në qytet? Cilët ishin ata që merreshin me këto punëra në një kohë kur, jo vetëm «kryetarët», por edhe qindra të tjerë të rinj ndodheshin në burg? Si e çanin rrëthimin e qytetit dhe ditaditës shkonin me dhjetëra të rinj te partizanët? I mbështetur mbi murin e tarracës, major Franci mundohej të zbulonte me hamendje bazat e kundërshtarëve. Mos vallë atje ku po dridhej një dritë e zbehtë, në mesin e atij kopshiti të mbuluar me pemë? Apo majë minareve, ose nën ato selvi, lartësia dhe bukuria e të cilave sepse i fuste trishtim në zemër! Majori bëri një prapakthim ushtarak. (Delli poetik kishte marrë fund). Tha:

— Avokati të mbahet në mbikëqyrje. Ai është gaçi të na shërbejë. Nesër të merret nga spitali komunisti tjetër dhe të fillohet menjëherë nga torturat! Punkt! — përfundoi, duke ndriçuar për një çast të vetëm me elektrikun e dorës fytyrën e Kurtit.

Në këndin e errët të tarracës u dëgjuan thembrat e disiplinuara të atij që kërkonte të merrte hak për dhëmbët e thyer...

## *Kapitulli i dhjetë*

**N E I N ! <sup>1-)</sup>**

Petrít Guraj dhe Qamil Tapia qëndronin në heshtje në mes të bodrumit që ndriçohej nga një llambë e fortë elektriku. Major Franci ecte lart e poshtë, duke hedhur shikimin sa nga njëri, te tjetri. Ai ngjante me ata skif-terët, që para se të ngrihen, shkojnë në një drejtim, por në të vërtetë fluturojnë në drejtimin tjetër. I ulur në karrige, në qoshe të bodrumit; Nazmi bej Topi dukej qartë se s'para ishte në qejf. Në rrudhat e syve i pas-qyrohej dinakëria dhe zemërimi i atyre njerëzve, që janë gati të bëjnë çdo gjë, veg tymi t'u shkojë drejt. Pas shpinës së Nazmiut qëndronte përkthyesi. Edhe atij s'para i pëlqente të afrohej atje ku ishin dy të burgosurit me major Francin. Si zakonisht, i thelluar në vetvete, kruante thonjtë e gjatë me një limë të vogël, që e mbante plot elegancë në majë të gishtave. Herë pas here kontrollonte shtegun e drejtë të flokëve, që i ndritnin nga brillantina e pastërtia, pastaj, me pëllëmbët e bardha e të buta fërkonte faqet e porsarruara, si për t'u thënë të tjerëve: «Ja, shikomëni, unë merrem vetëm me përkthim,

---

1) Gjerm. — Jo.

kruaj thonjtë e s'dua t'ia di pér politikë!». Kurti, me rripin e belit të shtrënguar fort, i kishte vënë shpatullat murit dhe ndiqte me vështrim të kujdeshëm lëvizjet e majorit të vet. Që nga pragu i derës shpërndahej në ajrin e palëvizshëm të bodrumit era e rëndë e parfumit të Qazimit, i cili rrinte me një këmbë brenda, me tjetrën në korridor, thua se ishte gati pér të vrapuar në çastin më të parë. Setri, i ulur në bisht mbi tavolinën e zhveshur pranë majorit, s'e hiqte vështrimin e syve të lagur nga dy të panjohurit.

Në mes të gjithë këtyre njerëzve të heshtur e përgjues, Petrit Guraj qëndronte i lodhur, i dërrmuar, sa të dukej sikur mezi mbahej më këmbë, por prapëseprapë, nën këmishën e grisur e të mbuluar me njolla gjaku, vizatoheshin qartë format e trupit të tij të lidhur. Nëpër të djegurat e pantallonave dukeshin plagët e kofshëve dhe pulpa e djathhtë, e enjtur dhe e nxirë, si e përcëlluar nëtym. Nga gishtat e këmbëve i rriddhnin vazhdimisht currila gjaku. Flokët e zinj e të butë i kishin zënë ballin dhe majat e tyre i vareshin deri në faqet e përcëlluara. Gjithçka kishte ndryshuar tek ai, përvëç syve, të cilët ruanin një shikim pak si tallës. Pranë tij qëndronte Qamil Tapia. Sytë e enjtur e të skuqur i mbante gjithmonë të mbyllur; buzët e mavjosura i shtrëngonte fort, si pér të mos lënë gjakun, që i rridhët nga goja.

Tërë atë ditë, nga mëngjesi në mbrëmje, Kurti i torturoi me të gjitha imenyrat e mjetet që dinte. U ndezi thumba pishe në thonjtë e këmbëve e të duarve, u vuri vezë të ziera nën sjetull, u hodhi ujë të valuar, i mundoi aty ku nuk shkruhet, i rrahu me kamxhik derisa u ratë fikët më se një herë. Pasi i lanë një tri orë të qetë, i nxorën nga qelia dhe në mesnatë major Franci zbriti vetë më bodrum...

...Petriti erdhi në vete më spital mëngjesin e ditës së dytë. Me të hapur sytë, zuri të shikonte me vëmendje sendet që e rrethonin, veglat e gjakosura të kirurgjisë, shishet me ilaqe, doktorin ushtarak dhe esesin që i rrinte mbi krye.

— Ujë! — qe fjala e tij e parë.

Pa si në ëndërr esesin që mori shishen e ujit mbi tavolinë, doktorin që i vuri dorën nën kokë dhe i afroi gotën te buzët. Pasi piu ca gërqe, bashkë me ftohtësirën që i shoi gjoksin, e ndjeu veten disi të lehtësuar dhe kur i hapi sytë sérish, shqoi ftyrën e doktorit gjerman, që diç donte t'i thoshte.

Që nga ajo minutë Petrit Guraj u kthyte përsëri në numrin e të gjallëve. Duke kujtar gjithçka deri në hollesitë më të vogla, i dëshpëruar për gjendjen në të cilën ndodhej, u ktheu kurrizin doktorit dhe esesit e me orë të tëra shikoi nga dritarja njerëzit poshtë në rrugë. Petriti duroi dhembjet që i shkaktuan lëkundjet e makinës, kur e nisën për në gestapo, duroi tërë ditën kamxhikun e Kurtit mbi kurrizin e gjakosur, por tortura më e madhe e ditës së parë qenë fjalët e Qazimit, i cili gjeti rast t'i pëshpëriste se edhe Lumta kishte rënë në duart e Nazmi bej Topit...

Ai ndodhej në këtë gjendje, kur në bodrum zbriti major Franci, i shoqëruar nga Nazmi beu, Kurti, Qazimi, përkthyesi dhe Setri veshllapush. Shokët e fëmijërisë u shikuani një herë sy për sy, pastaj Nazmiu u tërroq nga kjo betejë e heshtur, duke u ulur në një karrige në poshe të bodrumit.

Major Franci, pasi la kapelen mbi tavolinë, shtyu Qamilin mënjanë dhe zuri të vështronte me kureshtje trupin e Petritit. Pas pak, ia bëri me shenjë përkthyesit.

— S'ju vjen keq të vdisni kaq i ri? — pyeti.  
Petriti nuk iu përgjigj.

— Komunistët njohin vetëm jetën në këtë botë, në botën reale, prandaj dinë edhe ta çmojnë!

Meqë Petriti s'kishte ndër mend të fliste, përkthyesi ia tha dy herë me radhë fjalët e nazistit.

— Detyra që ka secili ndaj atdheut të vet, — vazhdoi majori, me një grimasë të zbutur të buzëve, ku çarku i dhëmbëve të florinjtë shkëlqeu si prushi në hi, — na detyron të gjejmë mënyrën për të jetuar me çdo kusht, se vetëm kështu mund të jemi akoma të vlefshëm për atdheun!

Petriti e shikoi me çudi ftyrën pak të tharë të ma-

jur Francit. Në spital, doktori ushtarak i buzëqeshje vazhdimisht me një dashamirësi të hapur. Edhe esesi i ri, që bënte roje te koka e krevatit, dukej sikur e shikonte me dhembshuri shokun e tij të moshës! Por ja, edhe komandanti i gestapos tek po i fliste me një butësi të jashtëzakonshme! Mos vallë vetëm Kurti, ai ushtar noprani e i prapë, që e torturoi tërë ditën, ishte i vetmi barbar në mes gjithë këtyre armiqve?.. Shikoi nga përkthyesi dhe tha:

— Për ç'jetë flet majori, kur mua më torturuan gjithë ditën?

Majori lëpiu buzët, si të kishte ngrënë diçka të thartë, pastaj mori nga tavolina një letër dhe ia zgjati përkthyesit:

— Lexoje, — u dëgjua zëri lutës i përkthyesit. — Lexoje dhe firmoje.

— S'dua as ta lexoj, as ta firmoj!

— Or ti! — ia priti me inat përkthyesi, por aty për aty e zbuti përsëri zërin. — Dëgjomë mua, djalë, mos e fillo kështu, se do të përfundosh keq.

Major Franci s'lejonte biseda në gjuhën shqipe:

— Uluni, — i tha Petritit.

Kurti i afroi karrigen dhe Petriti u ul pa e zgjatur, me bindje se s'do të kishte më fuqi për t'u ngritur më këmbë.

— Ja, pra, — filloi majori pas një heshtje të shkurtër, — rrata e historisë e solli që trupat tona të vijnë për herë të dytë në atdheun tuaj të vogël. Me sa di unë, në Luftën e Parë Botërore, populli shqiptar i priti me dashamirësi forcat tona. Kjo shpjegohet se në ato vite traditat e shqiptarizmit ishin më të gjalla. Kurse sot unë shikoj me keqardhje se komunizmi ka infektuar një numër të madh shqiptarësh, me gjithëse edhe ata e kuqojnë fare mirë se qëllimi i Gjermanisë së madhe nuk është robërimi i popujve, por vendosja e rendit të ri në Evropën plakë. Ne s'jemi kundër justi, ne e kemi me Moskën e kuqe. Mos harroni, Shqipëria është Evropë, kurse Moskë është një bisht që ndan kontinentin tonë me Azinë... — Këtu major Franci heshti një hop, nxori nga xhepi një

fotografi të mbajtur me kujdes dhe foli duke pshëretirë:

— Azia, Azia! Në kufijtë e saj, në tokën e mallkuar të Leningradit lufton im bir, Ferdinandi. Bënte vitin e fundit të fakultetit të mjeksisë. Sa keq më vjen! Jo që aq pér universitetin, sesa pér mjeshtërinë e tij të dytë. Ai ishte një ndër kitaristët e rrallë të Gjermanisë. Ju e dini qështë kitara? Ah... jo! Ah... po! Gut, gut! Ferdinandi e mori kitaren me vete, po se di si i ka hallet. U bënë gjashtë muaj që s'kam marrë letër nga ai. Ja shikoje. Ju ngjani me të. Në përgjithësi, shqiptarët janë të pa-shëm. Ezmerë. Hundëshqiponjë. A! A! Sa do t'ju dashuronin vajzat tonë! E kam fjalën pér ju personalisht, — përfundoi major Franci, duke afruar fotografinë e të birit pranë hundës së gjakosur të Petritit. — E shikon? Ju i keni sytë të zinj, kurse ai i ka të qartë, sy muzikanti. Ju i keni flokët të zinj, kurse ai është biond, por megjithë-këtë ngjan krejt me ju.

Sytë e majorit në fillim sikur u veshën me mjergull, pastaj sikur u lagën dhe u bënë ëndërrues. Majori e futi fotografinë me kujdes në xhepin e xhaketës, pshëretiu e tha:

— Ky do të jetë fati i mbarë rinisë së rruzullit tokësor, përderisa në botë ka pér të ekzistuar komunizmi i çifudit Karl Marks.

Gjatë gjithë kohës përkthyesi e merrte fjalën me vonesë. I çuditur nga ndjenjat e buta dhe nga zëri i ëmbël i major Francit, ai nuk e kishte aq lehtë të përkthente vërshimin melodioz të fjalëve të tij.

— Si mendoni ju, a s'do të qe më mirë sikur shumë djem të zgjedhur të rinisë shqiptare të shkonin në Berlin pér të studjuar? Ja, pér shëmbull, e kam fjalën pér ju personalisht, mund të mbaronit pér inxhinier, pér doktor, si Ferdinandi im. Jo, më mirë pér inxhinier. Vendi juaj është shumë, shumë i shkatërruar. Ai ka nevojë të ndërtohet. Duhen ngritur pallate. Duhen shtruar rrugë asfalti. Makina, Radio. Keni radio në shtëpi?... Selvitë që mbushin qytetin tuaj janë të bukura. Por duhen prerë. Duhen prerë. Të kujtojnë mesjetën. S'kanë asnjë lidhje me qytetërimin e sotëm. Prejini. Unë kështu-

ju këshilloj. Shkuleni që nga rrënjet mesjetën... O, po, mesjeta juaj është e lavdishme! Skënderbeu! Mbrojtësi i Evropës! Hitleri, mbrojtësi i Evropës! Por selvitë ju këshilloj t'i pritni. Këtë e kërkojnë rr Ethanat e reja. Kështu ndodh shpesh. Një vend i prapambetur, brenda një kohe fare të shkurtër, thyen zinxhirët dhe marshon krahas me të tjerët. Edhe ju duhet të përfitonin mjaft nga rasti i tanishëm. Lufta sjell me vete qytetërimin. Çdo luftë që zgjat një vit, e çon njerëzimin një shekull përpara. Sikur të mos kishin qenë luftërat, popujt do të kishin mbetur në errësirë. As elektrik s'do të kishte pasur sot, as tanke, as aeroplani, as topa. Çdo gjë që shpiket, shpiket për qëllime luftarake. Mjafton hija e saj që t'i nxitë njerëzit të bëjnë mrekullira. Ja, edhe ju tani mund të bëni mrekullira. E kam fjalën për Shqipërinë e vogël legjendare. Bile edhe ju mund të bëni mrekullira. E kam fjalën për ju, personalisht. Të vetmuar nga gjithë bota, në buzë të vdekjes, por, megjithatë, nuk i pranoni të mirat tona, pasi nuk na keni kuptuar. Ne duam që të jetoni, kurse ju, e kam fjalën për ju personalisht, kërkoni vdekjen. Nuk e firmoni deklaratën?... Mos e firmoni! Po pse luftoni kundër nesh? Ç'të keqe kemi ne? — Pas kësaj pyetjeje majori heshti. Vështrimi njerëzor i syve të tij dukej sikur priste përgjigje me domosdo.

Petriti deshi të ngrihej nga karrigia, por i ndjeu gjunjët të dobët.

Thuaji majorit të mos e shtrembërojë historinë, — iu drejtua përkthyesit. — Populli ynë s'i ka pritur kurre okupatorët me dashamirësi. Përsa u përket ushtarëve të huaj në Luftën e Parë Botërore, atëherë kur ata mbeten si qeni pa zot, pa armë e pa ushqime, kur ata s'ishin veçse fantazma të braktisura rrugëve, njerëzit tanë u zgjatën dorën, u dhanë kafshatën e gojës. Por, jo ushtarëve të perandorisë, por të mjeruarve të luftës. Edhe ushtarët e Vermahitit tuaj, po ta pësojnë si ata, ne s'do t'i lëmë të vdesin nga uria. Në këtë kuptim ne jemi popull mikpritës, sic e tha edhe vetë majori. — Kaq foli dhe priti derisa përkthyesi të mbaronte.

— Dhe përsa u përket të gjitha bisedave të tjera politike, — shtoi Petriti, — i thoni majorit se është duke folur me një kundërshtar, që mendon krejt ndryshe nga ai.

— Pa më thoni, ju lutem, që kur janë bërë agjent i Moskës? — pyeti majori duke u ngritur më këmbë, pa e humbur gjakftohtësinë e mëparshme.

— Çfarë agjenti, herr, tregtar apo politik?

Buzët e majorit u shtrëmbëruan nga një ngërdheshje.

— Ju e dini mirë për çfarë agjenti pyetet në gestapo.

Meqë s'mori përgjigje, majori bëri dy çape dhe qëndroi përpara Petritit?

— Përse nuk flitni?

Petriti dha të ngrihej, por majori i vuri dorën në sup me ndot.

— Rrini, ju lutëm, çlodhuni.

— Falënderojeni majorin për sjelljen e mirë. U bënë njëzet e katër orë që, sipas urdhrit të tij, s'na lënë të ulemi, bile Kurti, që të mos mërzitemi, na gudulis shpesh me kamxhik e me ca lodra të tjera. Falënderojeni... C'pritni... Shumë mirë.

Major Franci tundi kokën dhe vuri buzën në gaz për të treguar me këtë se i pëlqente humorin i njerëzve të zgjuar, pavarësisht cilët ishin ata.

— Po këtë e njihni? — ndërroi bisedë majori, duke treguar me dorë Nazmi bej Topin.

— Po. Kemi qenë shokë në fëmijëri.

— Shumë mirë...

— Pastaj ai u kthye në strofikën e vet të oxhakut. Ndodh shpesh që ujku kur është i vogël, shoqërohet me njerëzit, por kur rritet, prapë bëhet i rrezikshëm.

Majori dha të kuptohej përsëri se zgjuarsia e bashkëfolësit i pëlqeu.

Nazmi bej Topi, i ulur në karrige, as sytë nuk i ngriti nga dyshemeja. Petriti vuri re se ai mpleksi e shtrëngoi njërin me tjetrin gishtat e duarve, zakon i

vjetér i fëmijërisë, sa herë që e gllabëronte vala e zemërimit.

Majori u zmbraps te tavolina. Pasi fërkoi kurrizin, e Setrit, foli pa e ngritur kokén:

— Ç'kërkoni nga unë që të firmoni deklaratën e pendimit?

— Herr komandant, ç'ju duhet kaq shumë deklarata ime?

— Për t'ju shpëtuar juve dhe pas jush shumë të tjerë. Ju shqiptarët keni një proverb: «Shikon rrushi rrushin dhe piqet!»

Fjalë e këshilla të tilla Petriti i pat lexuar kaq herë nëpër thirrjet e kryeministrave, që mbinin njëri pas tjetrit si kërpudhat pas shiut. Por nuk deshi të bëhej nervoz, nuk deshi të tregohej i dobët para majorit. E shikoi drejt në sy.

— Pse kërkoni gjëra që s'varen nga unë?

— Deklarata varet nga ju!

— Por veprimi im mashton të tjerët!

— E tmerrshme. Ju sikur jeni makinë jo njeri!

Kësaj radhe major Franci e humbi durimin. Përplasi këmbën pas cimentos:

— Dije, pra, se shoku yt e firmosi. Ja! — tha duke i vërtitur deklaratën para syve.

Me të dëgjuar këto fjalë, Qamil Topi pat një dridhje të vogël. Petriti i hodhi një vështrim pyetës. Nën torturat e asaj dite, Qamili e kishte kaluar provën e parë. Kurti i kishte lidhur bashkë, në mënyrë që çdo goditje kamxhiku binte njëkohësisht mbi të dy trupat e zhveshur. «E lau gabimin!» — mendonte Petriti, duke mos e hequr vështrimin nga ajo fytyrë, me të cilën e lidhte gjaku i afërt.

— Unë jam penduar për deklaratën! — tha Qamili nëpër dhëmbë.

Por major Franci bëri sikur nuk u dha rëndësi fjalëve të Qamilit dhe mendoi që ta veçonte sa më shpejt në qelinë e tij. Qëndrimi i djalit të avokatit pranë përgjegjësit të tipografisë së fshehtë, nuk mund të sillte ndonjë dobi. Pasi urdhëroi që ta largonin, nxori nga

sirtari një kokërr sheqeri dhe ia futi Setrit në gojë.

— Hop, — i thirri majori duke e ndërsyer me krrën e dytë.

— Hum, hum, — gjëmoi në heshtjen e bodrumit.

— Hop, hop, hop, — dhe kokrrat e shequerit hynin njëra pas tjetërs në gojën e madhe të Setrit.

— Hum, hum, hum...

Kokrrën e pestë majori e futi në gojën e vet. Pasi kërciti ca herë gjuhën pas qiellzës, iu drejtua Petritit:

— S'ju dhemb mishi kur ju torturojnë?

— Më dhemb. Po në ato çaste unë përpinqem ta largoj mendjen gjetiu.

— Ku?

— Ta zëmë, te llojet e peshkaqenëve apo te shoqëria e ardhshme.

— Prapë... Në fund të fundit ka dicëka interesante në sinqeritetin tuaj naiv!

Heshtje.

— A mund të më thoni si e mendoni shoqërinë e ardhshme? — pyeti ai pas pak.

— Pa ju! Vetëkuptohet, pa peshkaqenë.

Major Franci u çap një herë në vend, si kali kur bëhet gati të lëshohet në vrap. Kurti, që e kuptoi se po afrohej çasti i tèrbimit, e pa të arsyeshme të shtrëngonte edhe një syth në rripin e belit. Me sprovën e tij, ai e dinte se, kur majori bëhej nervoz, fliste dhe bënte marrëzira. Nazmi Topi u tund në karrige. Qazimi, që po dremiste syhapur te pragu i derës, shikoi beun e vogël, si për t'i thënë: «S'është punë për ne kjo, ikim!»

— Shpresoni? — pyeti majori.

— Po!

— Si thua, a nuk e shkurtojmë pak bisedën tonë?! Nuk ka njeri pa dëshira dhe asnjë dëshirë nuk realizohet pa para! — përfundoi majori, duke nxjerrë nga sirtari një qese të madhe me florinj.

Kurti: «Ja marrëzia numër një e majorit tim!»

— Jua kam falur! — i tha, ndërsa po i derdhëte mbi tavolinë. — Na tregoni qoftë dhe një sekret të vetëm

të organizatës suaj ilegale. Siç e shikoni, me këto para mund të bëheni prefekt.

Kurti: «Marrëzia numër dy!»

Nën dritën e fortë të llambës elektrike që varej në tavan, florinjtë shkëlqemin me një ngjyrë të ëmbël. Petriti s'kishte parë kurrë aq shumë florinj. Buzëqeshi me vete. Buzëqeshi gjatë.

Kurti: «Mos po i ndez kësaj radhe majorit?»

Majorit i ndritën sytë. Nervat e kundërshtarit ishin ekzaltuar. Sprova i thoshte se kishte ardhur çasti kur njeriu, duke qenë tepërëndërrimtar, mund të flasë të vërteta të mëdha; duke qenë tepër i rezervuar, mund të zbulojë sekretet më të thella. Mbështeti dorën e thatë e plot damarë në kurrizin e butë të Setrit dhe, para se të fliste, pastroi gërmazin me një kollë të lehtë:

— Djalë i mirë, — filloi ai, — na tregoni kush ju udhëheq dhe pastaj do të jesh i lirë, krejt i lirë.

— Vërtet? — u çudit Petriti duke vërejtur shprehjen poetike në fytyrën e hijshme, por të thatë të major Francit.

Majori ngriti duart para fytyrës me lëvizje thjesht teatrale dhe foli me një zë përkëdhëlës, siç flasin shpeshherë gratë e bukura dhe nazelie kur ndiejnë se të tjerët po i shikojnë me kënaqësi:

— Ju betohem!

Kurti: «Marrëzia numër tre!»

Petriti vuri buzën në gaz:

— Herr major, a e keni parë filmin tuaj «Shando», që tregon për një magjistar të famshëm? Ju i ngjani shumë magjistarit, ju jeni një artist i vërtetë!

Majori shtangu. Ai e bëri me qëllim atë gjest teatral, por ja që, një humbalaq nga Shqipëria ia vuri menjëherë në dukje. U përtyp pa ditur c'përgjigje t'i jepte. T'i buzëqeshte? Ah, jo! Ai e bëri magjistar. T'i bërtiste? Gjithashtu jo. Ai e quajti artist, artist të vërtetë dhe major Franci kishte dobësi të veçantë për artistët, si Kurti i tij. Prandaj as i buzëqeshi, as i bërtiti, por vëtëm u ngërdhesh me vete.

— Hajt, pra pa na tregoni kush ju udhëheq? — e theu heshtjen zëri iëmbël, por pak i zemëruar i majorit.

Gjatë kësaj hetuesie të mërzitshme, Petrit Guraj u bind se ndoshta ishte hera e parë që major Franci sillej butë me viktimat e gestapos. I butë ai nuk durohej, dukej tepër artificial, i sheqerosur.

— Unë e kuptoj, — foli Petriti me pamje gjoja të pikëlluar. — tani ju doni nga unë gjënë më kryesore. Udhëheqësit. Mbani shënim, pasi do t'ju tregoj çdo gjë me hollësi. Apo nuk doni hollësira.

Majori që dyshonte në shakarat e tjetrit, foli në për dhëmbë:

— Po, po, të gjitha na hyjnë në punë.

— Ju e dini fort mirë, — filloi Petriti, — se në Shqipëri ka një Parti Komuniste, që udhëhiqet nga Komiteti Qendror, me në krye Sekretarin e Përgjithshëm.

— Ku e ka qendrën Sekretari i Përgjithshëm? — foli majori me zë të ciltër, si të qe duke biseduar me një njeri të besuar.

— Kudo.

— Si? Kudo? — pyeti shefi i gestapos dhe shtriu duart përpara. E gjithë pamja e tij, vështrimi i butë i syve të vegjël, përpëlitja e qepallave dhe dridhja e lehtë e buzëve, tregonin se ai ishte gati t'i lutej, t'i binte ndër këmbë Petritit, t'i falte një botë të tërë, veç t'i tregonte ku ishte Sekretari i Përgjithshëm. — Kudo? Mos ndodhet tani në qytetin tonë?

Kurti: «Marrëzia numër katër!»

— Jo në qytetin «tonë», herr major. Qyteti nuk është juaji, por yni.

Majori heshti një hop, pastaj foli:

Ah, po, keni të drejtë... Pra, këtu e ka qendrën.

— Po. Vendi i tij është gjithmonë në mes të popullit.

Shefi i gestapos u përcap i pakënaqur. Petriti e zbuti:

— Herr major. Do të jetë mirë të më pyetni përgjëra që mund t'ju përgjigjem. Ju, sigurisht, e merrni me mend se unë nuk e di ku ndodhet Sekretari i Partisë sonë. Ai është si shqiponjat. Sot gjendet në Tomor.

Nesër në majë të Çermenikës. Pastaj në zemër të Tirana. E lëmë këtë, nuk është punë për ne të dy. Jujeni në bodrum dhe vërtiteni rreth meje. Kurse ai majë malesh. Gjarpri që zvarritet, nuk mund të kafshojet shqiponjën që fluturon

Fraza e fundit e pickoi major Francin, por Petriti foli me aq butësi dhe bindje, sa ai, padashur, u detyrua të heshtte një copë herë.

Në bodrum gjithçka ishte si më parë. Nazmi bëj Topi rrinte buzëvarur. Setri nuk e hiqte vështrimin nga Petriti dhe nga florinjtë mbi tavolinë. Kundërmontë era e kolonjës së Qazimit, që ishte mbëthyer me shpatulla pas derës. Përkthyesi, si gjithmonë indiferent. Kurti shikonte majorin e vet, si për t'iu lutur t'u jepte fund marrëzive: kishte ardhur koha e kamxhikut. Majori trokiti thembrat pas çimentos dhe tha:

— Atëherë na tregoni, cili ju udhëheq në qytet? Me cilin mbante lidhje tipografia juaj?

— Po, për këtë mund t'ju përgjigjem.

Majori lëvizi vetëm këmbët, por fytyra e tij nuk shprehte asgjë. Ai dyshonte se kundërshtari mund ta kthente përsëri fjalën.

— Flitni, — i tha me gjysmë zëri.

— Ju, sigurisht, doni të dini anëtarët e Komitetit Qarkor të Partisë, që udhëheqin lëvizjen në qytet?

— Ku e kanë qendrën?

— Sikur të takoheshit me ta, do të kënaqeshit me të vërtetë.

— Doni të thoni se janë të arsyeshëm?

— Po.

— Shumë mirë.

— Nesër ata do të shpërdajnë një komunikatë të re.

— Nesër?

— Po nesër. Do të flasin edhe për zotërinë tuaj që më torturon mua.

Në të vërtetë komunikata kishte dalë një ditë më parë dhe major Franci e dinte fare mirë këtë gjë. Ajo kishte folur për të dy.

— Kjo s'duhet lejuar! — foli me rrëmbim e singitet major Franci.

— Do ta lejoni, s'keni q'bëni!

— Hesht! — Këtu majori deshi të përsëriste edhe një herë gjestin e mëparshëm teatral, por me të ngritur duart, u kujtua dhe e la përgjysmë. — Po sikur të mos kérkonim asgjë nga ju dhe t'ju lironim me tërë këta florinj, a do të bëheshit përsëri komunist?

— Unë edhe tani që po bisedoj me ju vazhdoj të jemë komunist.

— Hesht! — briti major Franci.

Në këtë valë histerie, Petriti ndjeu kënaqësi ta ngacmonte edhe pak.

— Unë çuditem si keni luftuar deri më sot me nerva kaq të dobëta, herr! Pa mendoni, a do t'ju vinte mirë sikur Ferdinandin tuaj ta zinin rob e ai të gjunjëzohet para rusëve?

Majori u zmbraps, u tulat në vetvete, shtrëngoi nofullat, ngriti mjekrën si çekan dhe rrudhi ballin e gjerë. Pastaj shikoi shtrembër, si skifteri kur përgatitet të lëshohet mbi gjahun e vet. Për herë të parë në fytyrën e tij të butë u dukën shenja të vemuara. Ferdinandi i tij! Po si mund të harronte ky shqiptar i lumbur se Ferdinandi i tij ishte gjerman me gjak ariani të kuilluar?! Pastaj, a mund të kapej rob Ferdinandi i tij? Befas përplasi grushtin mbi tavolinë, nxori revolen, u hodh përpëra dhe thirri:

— Sage Aus!<sup>1)</sup>

Kurti: «Oh, më në fund. Kulmi i zgjuarsisë së majorit!»

— Nein! Nein! — ia priti Petriti me qetësi, i përgatitur me kohë për këtë çast.

Majorit iu bë sikur komunisti vuri përsëri buzën në gaz.

— Sage Aus!

---

1) Gjerm. — Trego.

— Nein! Nein!

Major Francit iu sos durimi. Vendosi ta vriste. Le të shpëtonte një orë e më parë nga këto hetime, që po i shkatërronin nervat. Le të shërbente kjo vrasje për të frikësuar komunistin tjetër, në dobësinë e të cilit ai shpresonte akoma. Me qetësinë e gjakësorit të sprovuar, ngriti dorën dhe ia mbështeti grykën e revolos në ballë. Pasi shikoi trupin e lidhur të Petritit, vuri gishtin në këmbëz. Dhe kur vështrimet e tyre u kryqëzuan për herë të fundit, Petriti hapi pak këmbet anash, si të mos rrëzohej me plumbin e parë.

— Shtjer! — i thirri.

Major Francit iu drodh dora! Jo nga frika, por nga një turbullim i pakuptueshëm.

— Shtjer! — i përsëriti Petriti.

Një hop heshtje. Pastaj majori uli revolen. Atij iu duk sikur tjetri e priste me qejf vdekjen! A mos do të thoshte kjo se nervat e tij qenë dobësuar? Se tani ai i trembej më shumë jetës se vdekjes?! Ah, po të qe kështu, atëherë le të jetonte dhe ca e të gjykonte se cila ishte më e këndshme:jeta në bodrumin e gestapos apo vdekja e menjëhershme. Le të shikonte ai komunist, që guxoi t'i gjunjézonte Ferdinandin para rusëve, se ç'fund e priste!

U zmbraps, mori kamxhikun nga duart e Kurtit dhe u lëshua përsëri me një shpresë të turbullt:

— Sage Aus!

— Nein! Nein!

Kamxhiku fishkëllói disa herë në trup të Petritit. Nga dregëzat e gërvishura të fytyrës, të krahëve dhe të kërcinjve, i plasën curila të hollë gjaku.

— Kurt! — thirri major Franci.

Tre esesët që u futën në bodrum, me të parë gishtin tregues të majorit, e ngritën peshë Petritin dhe, pasi e shtrinë mbi çimenton e përgjakur, zunë ta zhvishnin duke ia shqitur këmishën bashkë me copat e lëkurës e të mishit të djegur. Petriti lëshoi një thirrje të mbytur, pastaj kafshoi buzet e mbylli sytë.

Major Franci u habit kur pa atë trup të sakatuar. A mundej vallë t'u qëndronte akoma torturave ky shqiptar i marrë?...

Ndaj të gdhirë, major Franci ngjiti shkallët, i shqëruar nga Nazmi bej Topi.

Poshtë, në bodrum, ushtarët sollën një mangall të ndezur më qymyr. Kurti hoqi xhaketën, përveshi mëngët dhe me gjësim të veçantë futi në mes të prushit një shufër hekuri. Në pritje e sipër, ndezi një cigare dhe ia mori nëpër dhëmbë këngës së tij të preferuar: «Wie einst Lili Marlen!»

Pasi e piu cigaren deri në fund, nxori shufrën e skuqur nga prushi dhe e mbërtheu Petritin për flokësh:

— Jo tregon? Kaput! — iu kërcënuar po me ato fjalë, që i kishte thënë tërë natën...

Në dhomën e heshtur të major Francit, Nazmi beun e kapiti gjumi. I futur thellië në kolltuk, kishte varur kokën dhe gërhiste. Por ja... i bëhej sikur po rrëzohej nga një shkëmb i lartë! Zgjohet duke u mbajtur pas anëve të kolltukut.

Me mjekrën të mbështetur mbi grusht, major Franci shikonte para vetes. Herë-herë trokiste me njërin gisht mbi tavolinë, si për t'i thënë «ndal» sahatit të murit, që thyente heshtjen me tiktakun e tij monoton. Por nga sahati u hapën ca dyer të vogla dhe që nga pragu i tyre kukumjaçka lajmëroi ditën e re me gjashtë të zgjatura të qafës:

— Ku-ku! Ku-ku! Ku-ku!

Kurti u fut pér të pestën herë në dhomën e majorit pa qenë në gjendje të thoshte asnje fjalë. E ç'të thoshte? Kurti e njihte mirë majorin e vet: ai i kuptonte të gjitha!

Sakaq, major Franci hodhi krahëve pelerinën e

hollë, fundi i së cilës u hap si çadër e zezë, dhe mori tatëpjetë shkallëve.

Drita e mëngjesit shpërndau ngadalë mjegullën e dendur që kishte mbuluar çati e kopshte. Këndesat ia morën këngës. U hapën dritare, kërkëllinë porta, lëvizje, zhurmë, makina, karroca.

Diku dëgjohej kënga e ushtarit të huaj, por njerëzit ecnin në punë të tyre, pa ia vënë veshin gramafonit. Ata ishin të heshtur, të mbyllur në vetvete. Dukej sikur diçka ruanin, diçka fshihnnin. As nuk e vështronin reklamistin e filmave — i vetmi zë — që bërtiste me një tabelë në dorë:

— Lufta e Verdunit!

## *Kapitulli i njëmbëdhjetë*

### **SEKRETET E NJË DITE**

Një javë të tërë qyteti u mbajt në gjendje rrithimi. Nëpër kalldrëmin e rrugëve s'dëgjohej tjetër përveç këpucëve të rënda të ushtarëve. Trokitnin dyer, bëheshin kontolle dhe njerëzit arrestoheshin pa lënë gjurmë. Për Petrit Gurajn, Qamil Tapinë dhe Lumta Gjinarin s'merrjej vesh gjë. Ca thoshin se ishin në burgun e madh, të tjerë thoshin se i kishin kyçur në bodrumin e gestapos dhe s'dihej në ishin gjallë apo jo. Nënë Dana mbeti vetëm me Markun të sëmurë, plaga e të cilit qe keqësuar, pasi edhe doktor Besim Kodra nuk kishte mundur të zbriste nga Malet e Shqipes që ditën e arrestimeve në masë.

Me t'u hequr shtetrrethimi, Dana, pasi i tha fqinjës të kujdesej për Markun, mori rrugët duke i rënë larg e larg, për t'i shpëtar syrit të ndonjë spiuni. Te porta e Kalasë mbeti një hop e menduar. Mirë që erди deri këtu, po tani ku të shkonte? Cilin të pyeste? Padashur eci përmes pazarit, doli në Rrugën e Drejtë dhe trokiti në shtëpinë e Demir Tapisë. Ata vërtet qenë ndarë keq para tri javësh, por avokati mund të dinte ndonjë gjë, në mos për Petritin, të paktën për të birin. Trokiti e trokiti në portë, por atje brenda s'u bë njeri i gjallë.

Mbrëmja e gjeti në shtëpi, pa ditur ç't'u përgjigjej vështrimeve pyetëse të Markut dhe të fqinjës.

Kaluan edhe dy ditë në heshtje. Ditën e tretë ajo u vesh dhe doli përsëri, kur Marku s'ishte zgjuar akoma. Fqinjën e la duke bërë një kafe sade për të qetësuar pak zemrën, pasi tërë natën i plagosuri kishte pasur zjarmi dhe të dyja gratë mezi kishin fjetur pak ndaj të gdhirë. Kur arriti në fund të kopshtit, Dana zuri të dredhonte me kujdes nëpër pupat e pashkelura të barit vjeshtak. Pikërisht në këtë vend, ajo kishte parë për herë të fundit të birin, i cili, pasi i ra rreth e rrotull për të mos shkelur barin, hodhi kapërcyllin dhe u zhduk... E ku ta dinte Dana se atë natë çunin e saj e priste ajo që ngjau te shkolla?

Pa e bërë të gjatë, e mbajti çapin para portës së hekurt të burgut.

— Ej, ti atje! Ç'kérkon?

— Si gjithë të tjerët, çunin kérkoj!

— Futu nga dera e vogël.

Korridori i ngushtë dhe gjysmë i errët ziente si koshere blete. Njerëzit ishin mbledhur nga ana e anës, kush kérkonte të birin, kush të shoqin; një djale donte t'i fuste një bohçe me rroba së motrës, që e kishin ngritur parmbërëmë nga shtëpia vetëm në këmishë; një nuse e re pyeste për burrin, që s'ishte dukur prej tri ditësh.

— Nuk dimë gjë, — i përgjigjeshin.

— Burrin...

— Këput qafën... Kérkoje andej... se mos është mbyllur me ndonjë...

Ca pleq e plaka ishin shtruar këmbëkryq mbi rrasat e ftohta dhe pinin duhan, duke shkëmbyer rrallë e tek ndonjë fjalë. Nga fytyrat e tyre të mërzitura dukej se ato pritnin aty me orë të tëra. Dana stepi një copë herë në prag të korridorit. Sapo u fut brenda, njerëzit i ranë njëri-tjetrit me bërryla, prenë muhabetet, duke hedhur vështrime pyetëse dhe mëshiruese në drejtim të së porsaardhurës. Nëna u tremb. Pse e shikonin në heshtje, pse nuk i flitnin? Mos kishin dëgjuar ndonjë lajm të keq për çunin e saj??

— Kjo éshtë nёna e Petritit! — i dёgjonin veshёt ndonjё fjalё.

— Korba unё! E atij ditёziut qё luftoi te shkolla?! Atё kohё, njё dorё e fuqishme e mbёrtheu pёr krahу:

— Erdhe ti? — e pyeti i panjohuri.

Pas njё minute Dana u gjend nё njё dhomё tё mадhe. Kёrrusur mbi tavolinё dukej tulla e njё burri tё thyer nё moshё, i cili, megjithё praninё e Danёs, vazhdoi tё shkruante, pa i ngritur sytё nga letra.

— Erdhe ti? — foli ai, duke lёshuar njё psherёti-mё, si tё چirohej nga njё barrё e rёndё.

— Erdha tё marr vesh pёr چunin.

— Prit pak! — i tha ai dhe nisi pёrsёri tё shkruante.

Danёn e veçuan nё njё dhomё tё vogёl, ku priti mё se njё gjysmё ore.

...Megjithёse Nazmi bej Topi dhe Qazim Dёshiranjaku ishin pajisur me kartabiankёn e gestapos, ata s'ki-shkuar asnёherё nё qelitё pёr tё parё tё burgosurit, pёrveç asaj nate kur shoqёronin major Francin nё bодrumin e torturave. Dy ditё mё parё, i shtyrё nga njё kureshtje e pakuptueshme, Nazmi beu urdhёroi Qazimin tё shkonte nё qeli tё Petritit pёr ti thёnё diçka tё rёndёsishme. Dhe Qazimi shkoi... Kurti i hapi deren e qelisё, por Qazimi ngurroi, aq e tmerrshme u duk biruca e errёt: po tё hynte aty, i dukej sikur s'do tё dilte mё i gjallё. Por Kurti e shtyu me forcё:

— Kaput, ballist! — qeshi ai.

Me tё mbetur vetem, Qazimi shkeli nё majё tё kёmbёve, si pёr tё mos i prishur qetёsinё Petritit, qё ishte shtrirё gjysmёlakuriq mbi dy fijet e dёrrasave rrёzё murit, spёrkatur me pika gjaku. Kur pa sё afёrmi trupin e sfilitur tё Petritit, pulpat e kёmbёve me mishin tё nxirё e tё چарё, tё prerёn nёn gushё, si tё kishin dashur ta thernin me thikё, Qazimin e kapen tё dridhura. «Jo more, ç'i paskan punuar faqezinjtё! — mendoi. — Por edhe ky, ama, s'e paska shokun pёr budalla!»

Petriti hapi sytë:

— Po ti, ç'kérkon këtu? — e pyeti. — Beu të nisi?  
«More, sa i zgjuar! I ra më të menjëherë!» Qazimi kishte marrë një porosi të çuditshme, që as vetë s'e kuptonte ku e kishte qëllimin Nazmi beu. Ai kishte ardhur këtu për t'i thënë se Lumta Gjinari i qe dorëzuar megjithësej beut të vogël!... Ja e gjithë porosia. Mirëpo i thuheshin këto fjalë kaq të rënda një njeriu që dergjej në qeli pa pikën e shpresës? E pa Qazimi se Petrit Guraj s'e kishte të gjatë, jeta e tij ishte punë ditësh e orësh. A s'do të qe më mirë për atë fatzi sikur të vdiste pa dëgjuar gjë?

— Erdhe t'u ndihmosh gjermanëve? — ia preu mendimet zëri i dobët i Petritit: — Ke të drejtë. Ata u lohdhën me mua!

Qazimit sa vinte po i shtoheshin të dridhurat. Mendoi se edhe i burgosuri duhej të kishte të ftohtë. Pa e kuptuar as vetë, ra më gjunjë dhe i hodhi përsipër batanien.

— Ftohtë, mor... zotni, pse s'mbulohesh? — foli Qazimi, duke ndier në të njëjtën kohë se s'do të gjente fuqi të plotësonte porosinë e beut. Iu bë sikur po i merrë fryma në atë birucë, u zmbraps në heshtje, doli në korridor, ku u ndesh ballë për ballë me Kurtin:

— Kaput komunisti!

«S'dinë fjalë tjetër këta dreqër, vetëm kaput!» — u çudit Qazimi.

— Lëre mos e pyet, kaput e përtej kaputit! — ia ktheu Qazimi, duke u larguar sikur gjoja e priste një punë e shpejtë.

Dhjetë minutat që ndanin gestapon nga komanda e rinisë së Ballit, Qazimi i bëri pothuaj me vrap. Kur u fut në zyrën e beut, fytyra i qe mbytur në djersë.

— Ia the?

Qazimi tundi kokën:

— Fol!

— Po, o bej!

— U pikëllua?...

— Lëre mos e pyet, kaput e përtej kaputit!

— Ç'të tha?

Qazimi kroi tepen e kokës dhe mbeti një copë herë më këmbë si hu gardhi. Mendja i punonte ngadalë, ngaqë s'para ishte i zoti për të kurdisur gënjeshtëra të shpejta.

— S'foli asgjë? — pyeti përsëri Nazmi beu.

— Foli, bej, si s'foli! — ia ktheu Qazimi, duke ngritur fytyrën drejt tavanit, si për të fshehur djallëzinë që i lëvrinte në sytë e vegjël. — Jo, mazallah se e hapi gojën, bej. E ç'të thoshte? Ç'i kanë punuar të ziut! A ke parë ndonjëherë zotrote mish pastërma? — Qazimi heshti dhe kroi përsëri tepen e kokës. — Kur dëgjoi emrin e zonjushes, i mbylli sytë e bukur e s'i hapi më çuni. Të të them të drejtën, ose vdiq, ose e zuri gjumi; sidoqoftë, ditët i ka të numëruara. Po, që ta kisha fjalën, për të folur s'foli çuni.

Pas një heshtjeje të shkurtër, Qazimin s'e la ku-reshtja:

— Bej, s'para ia pret radakes sime, ç'të duhet ty që t'ia thuash ato fjalë komunistit?

Nazmi beu nguli sytë në ballin e gjéré të Qazimit dhe, si gjithmonë, mendoi: «S'i gjendet shoku për budalla!»

— Ik e mos bëj llafe të tepërtë, — ia preu shkurt.

Për Nazmi beun kjo s'ishte një kureshtje e thjeshtë, as shaka e kotë, as dëshire e egër për të shuar urrejtjen karshi rivalit të vet. Që ditën kur major Franci i dha kartabiankën, ai zuri të përpunonte plane pas planesh për t'i ardhur sa më shumë në ndihmë gestapos. Me anën e lajmit për tradhtinë e dorëzimin e Lumtës, Nazmi beu mendonte se do ta ligshtonte sadopak zemrën e armikut. Por, duke quar edhe një herë në mendje skenën që i përshkroi Qazimi, duke kërkuar me këmbëngulje rrugët e suksesit, ai e ndjeu fare mirë se vetëm ky lajm ishte i pamjaftueshëm, prandaj dy ditë më parë mendja i polli diçka të re. Ai kishte shpikur ballafaqimin e nënës me të bërin, i bindur se njëri nga të dy do të ligshtohej. Dhe çuditëj me vete. Nazmi bej Topi çdo gjë e kryente me gjakftohtësi, megjithëse, thellë në ndërgjegje, sa herë

që komunikatat e Partisë shkruanin kundër tij ose partizanët bënин aksione të fuqishme, ai padashur përfytyronte disfatën, hakmarrjen, litarin ose vetëvrasjen... Të gjitha këto së bashku, të shoqëruara sidomos me idenë e vetëvrasjes, kishin sjellë ndryshime në karakterin e tij, e kishin tutur, po në të njëjtën kohë e kishin bërë më të paturpshëm e më të egër. Në çastet e qetësisë, ai merrte vendime të përmbahej, të tregohej më i matur, por vazhdimisht i ndodhë e kundërtë. Dhe duke u përpjekur për të gjetur rrugët e suksesit, po të mos dilte gjë edhe nga plani i ballafaqimit të Petritit me t'ëmën, atij i kishte lindur në kokë një plan i tretë...

Dolën nga godina e burgut, tullaci përpara, Dana në mes, Qazimi dhe një çunak ballist prapa. Në gestapo, Kurti i shoqëroi në bodrum.

— Të ka marrë malli për djalin? — e pyeti i panjohuri. Zëri i tij ishte i butë dhe orë e çast kapsalliste sytë, si të mbrohej nga një rrezik i papritur.

Nënë Danës i hynë të dridhurat. U bë e qartë: së shpejti ajo do të takohej me të birin.

— Dua të ma lironi, — i tha me gjysmë zëri.

— Për të liruar tët bir kam ardhur nga Tirana. A më njeh? Jo?... E shikon, pra... Në qoftë se ti je nënë e mirë, thuamë vetëm disa fjalë dhe djalin do ta lirojmë menjëherë. Bile, ta marrësh me vete, për dore.

— C'farë të them? — e pyeti Dana, që s'po e kuptonte të panjohurin.

— Emrat e shokëve, shtëpitë ku banojnë dhe... çikërrima të tjera, — tha ai, duke lëvizur me naze duart, në gishtat e të cilave shkëlqenin unaza të florinjta.

Danës iu drodhën leqet e këmbëve. Po sikur të çmendej përpara tullacit e t'i tregonte se ajo banonte te Dine Çeliku? Po atëherë, ç'do të bëhej me Markun? E kuptoi rrezikun, mblodhi veten dhe foli:

— C'pritni nga një grua e humbur si unë? Që kur

më kapët djalin, endem sa nga një fshat në tjetrin përtë mbajtur shpirtin me bukë.

Aq ishte e shushatur, sa as vuri re si u gjend në një korridor të errët, ku qëndroi një copë herë pa dëgjuar e pa shikuar njeri, përveç majave të cigareve që pinin ballistët. Pastaj u dëgjuan këmbët e një ushtari, u ndez një dritë e vogël në tavanin e ulët, tringëlluan disa çelësa, u hap një derë e hekurt dhe befas në prag bëri ballë Petriti.

— Nënë, moj, nënë! — i thirri ai. — Si je?

Dana shtangu, Deshi të fliste. Zëri i mbeti në grykë. Çapiti, por maja e mprehtë e një bajonete e gozhdoi në vend, e ndau nga i biri.

— S'ka gjë, Danë, mos u dëshpëro. Mbaje veten, ne do të takohemi përsëri! — i thirri për herë të dytë Petriti.

Tullacit nuk i pëlqeu takimi i tyre. Me të dëgjuar fjalët e fundit të Petritit, dha shenjë me kokë që t'i ndanin. Dera e hekurt u mbyll, drita e dobët u shua dhe pas pak Dana u gjend përsëri në dhomën e vogël. Aty sikur erdhi në vete:

— Ku e kam djalin? Nuk e preka as me dorë, nuk e pyeta, nuk i fola fare.

Në të vërtetë, ajo vetëm zerin i dëgjoi të birit. Ajo s'mundi të shikonte asgjë, përveç disa njollave të zeza e të kuqe, që feksnin e shuheshin para syve të saj.

— Më çoni te djali! — klithi.

— Dëgjo këtu! — e tundi për supi tullaci për ta sjellë në vete. — Djalin do ta lirojmë menjëherë po të tregosh ku janë shokët e tij dhe ku flenë...

Dana heshti me mendjen tek i biri. Gjunjët zunë t'i dridheshin.

— S'më beson mua? — pëshpëriti tullaci me zë të ëmbël. — Unë i kam në dorë të gjithë komandantët e Elbasanit. Hajt, nënë e mirë, fol. A nuk e pe si ta kishin bërë djalin?

— Cfarë m'i kishin bërë?

— Ta kishin rrahu! Ta kishin prerë, copëtuar e gjakosur dhe së shpejti do të ta varin! Fol!

— Do të ma varin?

— Po!

— Ti?

— Përkundrazi, unë dua ta liroj.

Dana ndjeu t'i ngjethej trupi. Koka iu trullos dhe veshët i gjëmuani. Zëri i burrit u bë i thellë, trupi i tij u zvogëlua sa një pikë. Pastaj iu bë sikur dy vetë e mbanin që të mos rrëzohej:

— Fol! Fol! Fol!

— E ç'të flas?

— Shpëto djalin! Trego!

— Ç'të tregoj?

— Fol!

— Ç'të flas?

— Trego! Do ta liroj!

— Do ta lirosh?

— Menjëherë! Trego! Trego! Trego!

— Të tregoj?

— Shokët! Bazat!

— Shokët? Ku janë shokët e çunit tim?

Nënë Dana tundi kokën dhe mori frymë thellë, si të zgjohej nga një ëndërr e keqe. Dalngadalë, pika që kishte para syve u zmadhua, dhe atëherë ajo shikoi para vetes tullacin tek i vërtiste grushtin para hundës:

— Fol, pra!

Dana fshiu sytë me dorë dhe e mblodhi veten:

— Ah, faqezni, m'i marrsh të keqen djalit! — briti, dhe e pështyu të panjohurin në fytyrë. — S'ke turp e tallesh me një grua!

Burri u zmbraps, u skërmít dhe u hodh me grushtet përpara, por nënë Dana s'ia bëri të gjatë:

— Phu! — e pështyu në surrat dhe në tullën e bardhë. — Phu, jazëk të qoftë!

Pas një ore u dha urdhri që Dana të mbytej në Shkumbin dhe kufoma e saj të hidhej në qeli para të birit. (Ai ishte shkaktari që ajo kishte mbytur veten). Ky përbënte planin e tretë të Nazmi bej Topit...

Qazimi, Dana dhe çunaku ballist hipën në karrocerinë e zbuluar të një kamioni dhe, sakaq, motori gjëmoi. Kaluan nëpër rrugët pa njerëz të qytetit, muarën tatë-pjetë kazermave, kapërcyen urën e Shkumbinit dhe në vend që të shkonin pas rrugës së automobilit, i ranë majtas gjatë buzës së lumit.

— Mor guna, ku po më çoni?

Dana pyeti dhe dy herë të tjera, por ata s'iu përgjigjën.

Makina u fut thellë, duke çarë përmes tufave të dheneve, që lëviznin si njolla të bardha mbi shtrojën e blertë të fushave. Kamioni la fushën dhe ra në një rrugë të ngushtë qerresh. Ferrat e larta që ngriheshin nga të dy anët, pickonin herë pas here me gjemba e vegjël fytyrat e tre pasagjerëve të heshtur. Nga frika se mos i ngekte gjëkundi napa, Dana u ul në mes të karrocerisë. Çunaku, ballist nga qyteti, kishte zënë vend në anën e prapme dhe s'e hiqte vështrimin nga ajo. Qazimi shikonte mendueshëm fushat që vinin e shkonin njëra pas tjetrës.

— Or çun, — e qortonte Dana qytetarin, — mos u ul aty se do të hapet kanata.

— S'më gjen gjë mua, jo! — përgjigjej tjetri.

Por Danën e kishte zënë edhe një hall tjetër: sa herë që kamioni merrte kthesat ose anohej mënjanë, paticka e gjatë, të cilën Qazimi e kishte lëshuar pranë këmbëve, rrökullisej pas dyshemësë së karrocerisë, duke e drejtuar grykën herë nga ai, herë nga çunaku, herë nga nënë Dana.

— Mor bir, merre këtë të shkretë, se mazallah e zbraz qoftëlargu!

— Mos u tremb, patickën nuk e mbaj kurrë të mbushur. Plakun e kam të gishtit pa mua më zuri berihaja. E pësova si ai që dha një grosh e hyri në valle, pagoi dhjetë e s'doli dot!

Tek e shikonte me vëmendje, Qazimit i bëhej sikur kishte pranë nënën e vet, aq ngjanin të dyja: të thinjura, syzeza e të bëshme nga trupi.

— Sa vjec je, moj nënë? — e pyeti pas pak!

## — Pesëdhjetë!

— Mos ki merak, do tē tē bëjmë përsëri nuse që tē na pjellësh një komunist tjetër, — ia pat qytetari.

Danës i therën fjalët e gunakut. Ah, pér cilin kujdesej ajo? Pér xhelatin e djalit tē yet? Le tē rrëzohej, le tē bëhej copë-copë. E mblodhi veten dhe u bë gati t'i thoshte: «Plaç», por tamam atë çast civitë kërkëllinë dhe ajo:

— Ruhu, mor bir, — i shpëtoi padashur nënë Damës dhe nga inati që s'e mbajti dot veten, kafshoi buzët dhe uli kokën.

— Nuse do tē tē bëjmë, nuse!

— Plaç! — briti nënë Dana.

— Si the? — iu mat ai me kondakun e pushkës.

— Na, — i afroi fytyrën Dana. — Bjerë, zabërhani qyteti, ballist i qelbur!

Çunaku ngriti kondakun. Qazimi e zuri pér krahu. Shoferi, që pandehu se ndodhi ndonjë aksident, frenoi.

— Mbaje dorën, çun! — i foli vrazhdë Qazimi.

— A s'e dëgjove zotrote si më shau?

— Nuk tē shau!

— Më shau!

— E shava! — foli Dana.

— Dale, mor jahu, dale tē merremi vesh, — foli Qazimi, duke i shikuar tē dy në sy. — Ballisti është ballist, komunisti është komunist. Çfarë doni më! A?

Heshtje. Çunaku u ul i pakënaqur në vendin e mëparshëm, nënë Dana kërrusi kokën e zemëruar, Qazimi briti:

— Hajde, lal! Nise makinën.

E kështu ecën një kohë tē gjatë pa thënë asnje fjalë.

Gjatë rrugës, me sa duket, Dana ndjeu njëfarë butësie dhe mëshire në fytyrën e Qazimit, prandaj mori guxim dhe e pyeti përsëri me gjysmë zëri:

— Mor bir, ku po më çoni?

Që kur e hipën në kamion, asaj i shkoi mendja pér keq. Po sikur tē nisnin pas saj edhe tē birin dhe t'ia vritnin para syve? Mirëpo fytyra e Qazimit e bëri pér

vete dhe Dana, pasi i ktheu kurrizin çunakut të qytetit, foli përsëri:

— S'më ka marrë malli të shëtis! Dua të di...

— Së shpejti do ta marrësh vesh, — i tha çunaku në vend të Qazimit.

Dana u mblodh. Ajo kishte dëgjuar se komunistët i pushkatonin jashtë qytetit.

Qazimi, i tretur në mendime, vështronte renë e pluhurit që ngrihej prapa kamionit.

Më në fund, qytetari i lëshoi zë shoferit të qëndronte, dhe dy ballistët, pasi futën në mes Danën, morën rrugën në heshtje drejt lumit. Ajo kyçi gojën, uli kokën dhe eci si të mos i kishte këmbët e veta.

Gjithnjë e më afër dëgjoheshin dallgët tek përplasheshin pas një shkëmbi të lëmuar e të bardhë, që dukej si top bore i ngjeshur. Kur iu afroan buzës së lumit, Dana mbajti çapin.

— Mirë e ke, ulu! — e urdhëroi Qazimi. — Ulu një herë të çlodhemi, pastaj shohim e bëjmë.

Çunaku i kërceu përpara:

— C'është kjo e çlodhur?

Qazimi ofshani:

— Ti rri e bëj sehir. Këtu jam unë i parë.

Çunaku bërbëliti diçka nëpër dhëmbë dhe u hoq mënjanë. Por, me gjithatë, nuk i rrihej në një vend; se ku gjeti një gur, e lidhi për mesi me një copë litar dhe pastaj e peshoi në duar. Duket se mbeti i kënaqur, hoqi pushkën e shkurtër nga krahu, u ul këmbëkryq, duke shikuar me sytë e tij të gjallë e të mëdhenj herë Qazimin, herë Danën, të ulur pranë njëri-tjetrit.

Qazimi vuri kutinë e duhanit mbi gju dhe mezi e drodhi një cigare me duar të ngathëta. Buzë lumi era frynte duke ngritur shtëllunga pluhuri në qiellin e kaltër. Me mendjen gjetiu, Qazimi dogji gjithë kutinë e shkrepëseve, por cigaren nuk e ndezi. Çunaku ia befi para syve të tij, nxori një qese të vogël dhe, pasi fërkoi pas gurit copën e eshkës, me goditjen e parë të masatit pirgu i hollë i tymit u gudulisi me lezet hundët.

— Allah, allah! — u çudit Qazimi. — Ne fshatarët

po mbajmë shkrepëse, kurse qytetarët u kthyen te masati! S'po merret vesh kjo botë!

— E-e, mirë e ke ti, — foli çunaku me seriozitet të tepruar për moshën e tij të re. — Mua s'para më pëlqen qytetërimi! Dua të jem primitiv. Bile edhe clinik. Kurse me femrat sadist.

— Ah?!

— Jo, hiç!

Qazimi nuk e piu deri në fund. Ndjeu t'i hidhëro-hej gjuha, pështyu, duke e hedhur cigaren tërë inat në valët e lumi.

— Sa t'i lidh duart e t'i var gurin në qafë, pastaj një sekondë punë, — i pëshpëriti ngadalë qytetari.

Qazimi, pasi shikoi edhe një herë nënë Danën, e cila s'i hiqte sytë nga rruga ku qëndroi kamioni, mezi shqiptoi:

— Lidhja... Ose....

— Na pret Nazmi beu!

\* \* \*

Nazmi bez Topi e priste me një ndjenjë të turbullt kthimin e Qazimit. Mbytja e një njeriu të pafajshëm, e aq më tepër e një gruaje, i rëndonte në zemër dhe, bashkë me hidhërimet që i shkaktonin disfatat e përditshme politike me rininë e qytetit, atij iu shtua dhe njëfarë zemërimi karshi vetes, që ra aq poshtë, duke kryer një vepër të tillë. Përveç kësaj, beun e shqetësonin gjithnjë e më tepër ndjenjat e fyera, epshi i ndezur dhe dëshira për fitore ndaj Lumtës. Dhe, megjithëse qe betuar ta përdhunonte, prapëserapë nuk i vinte mirë të njolloste pastërtinë e dashurisë së parë. Por, sidoqoftë, ai e kuptonte se të gjitha këto ishin ndjenja të përkohshme, përveç pikëllimit të përhershëm që i shkaktonin lufta partizane në Shqipëri si dhe tërheqja e trupave hitleriane në frontin e Lindjes.

Duke pritur me padurim kthimin e Qazimit, hëpër-

hë vendosi të merrej me ndonjë punë tjetër. Mori dosjen me emrat e të rinjve të arrestuar pesë ditë më parë dhe doli në rrugë për të shkuar në godinën fqinjë të burgut. Ndërsa ekte ngadalë, duke u kthyer ftyrrën rrezeve të këndshme të diellit të tetorit, bënte nga bënte dhe mendja i kthehej përsëri te Qazimi. Sepse kohët e fundit s'para i pëlqenin shakatë e tij, si dhe vështrimi kureshtar i atyre syve të drejtë e naivë, por njëkohësisht të rëndë. Prania e Qazimit sikur e pengonte të merrje lirisht me punët e veta, dhe kjo ndodhë pikërisht në një kohë kur ai mendonte se duhej vepruar me guxim kundër armiqve. Vërtet krerët e Ballit shpresat kryesore për të marrë pushtetin i kishin mbështetur në fuqitë e jashtme, por, sidoqoftë, derisa të vinin ata, duhej luftuar me të gjitha mënyrat e me ç't'u vinte për doresh. Me këto mendime, me dosjen të shtrënguar nën sphetull, Nazmi bej Topi shpejtoi hapat, por në një shtyllë elektriku afër godinës së burgut, pa diçka që e tmerroi. «Përsëri!» — murmuriti, duke i përpire me sy rreshtat e parë të komunikatës. Si gjithmonë, në fillim ai lexoi për luftën e partizanëve shqiptarë, për rrininë e fshatrave e të qyteteve që po mbushte radhët partizane e po krijonte brigada të reja; gjithashtu, komunikata bënte fjalë edhe për gjendjen në qytet, për qindra të arrestuarit, për Petritin, Qamilin, Lumtën, të cilët me qëndrimin e tyre po nderonin Partinë dhe shokët. Aty nga fundi i saj Nazmiu lexoi emrin e vet, si një nga armiqtë më të ndyrë, që e priste shpata e pamëshirshme e drejtësisë së popullit. «Ah, qenëri!» — bërtiti i zemëruar dhe u kthye prapë, megjithëse as vetë s'e dinte ç'të bënte e ku të shkonte...

Duke gjarpëruar nëpër rrugët e njoitura, padashur këmbët e çuan në godinën e komitetit të Ballit, ku ca kohë më parë patën qenë zyrat e fashios. Edhe atje njerëzit iu dukën të shqetësuar. Një frikë e heshtur kishte pllakosur ftyrat e menduara e të ngrysura të anëtarëve të komitetit. Kudo bisedohej për shtimin e forcave partizane në male, për aksionet nëpër qytete, pa marrë parasysh masat e rrëpta të ditëve të fundit. Dyert ha-

peshin e mbylleshin dhe komunikata sekrete e ushtrisë gjermane për zmbrapsjet «strategjike» në të gjithë frontin e Lindjes, shkonte nga njëra dhomë në tjetër. Nëpër korridore zotëronte një rrëmujë, ku s'e merrte vesh i pari të dytin. Ballistë të sfilitur, të porsakthyer nga fshatrat, hynin e dilnin të hutuar, ndërsa komandantët e Ballit, Karemanci, Cërla, Alush Leshi dhe Xhafer Pala, bënin përgatitjet e fundit për një operacion që do të ndërmerrnin së shpejti në afërsitë e qytetit kundër forcave partizane. Shkurt, në qytet punët shkonin keq, në fshatra edhe më keq. Nazmiut i dukej sikur komandantët e shikonin me qortim për pazotësinë e tij për të mbledhur qoftë një kompani të vetme nga rinia e qytetit, por edhe Nazmiu ndiente një zemërim të heshtur ndaj tyre dhe në të njëjtën kohë shfrynte kundër komunistëve, të cilët, meqë s'dinin ç'të bënin, dënonin me vdekje në komunikatën e fundit, bashkë me komandantët e Ballit, edhe atë, Nazmiun, sikur gjoja ai ishte subjekti kryesor në terrorizimin e rinisë së qytetit. Duke biseduar me ta për gjendjen e krijuar, në sytë, në fjalët dhe në shprehjet e tyre të përgjysmuara, Nazmiu e ndjeu se, po të shtrëngoheshin vidhat dhe ca më shumë nga ana e partizanëve dhe sikur gjermanët të mos ndërmerrnin së shpejti veprime në shkallë të gjerë (Fon Gutmani po hartonte planet e operacionit të madh), të gjithë ata që e mbanin veten si krerë e politikanxhinj të zotë, ishingati t'u mbathnin këmbëve dhe, po të vinte puna për të dhënë llogari, ata ishin gjithashtu të gatshëm për të tradhtuar njëqind herë në minutë, duke akuzuar të tjerët për krimet që kishin kryer vetë. Jo, Nazmiu s'kishte qenë i gabuar! Dita-ditës ai po bindej se e ardhmja po bëhej shumë e dyshimtë. Ajo nuk u besohej të tjerëve. Secili duhej të përpinqej për vete, secili duhej të fillonte punën nën rrogoz...

Ai u largua nga komiteti i Ballit me shpresa të dërrmuara, me lëkundje të mëdha, me frikë se komunistët kishin vënë gishtin edhe mbi kokën e tij dhe në mos sot, nesër, do t'ia gjenin rastin për t'u hakmarrë.

Po në qoftë se për të siguruar të ardhmen e dyshim-

të duheshin mposhtur komunistët kryesorë, atëherë, pse të mos e fillonte nga Lumta? Po, ajo duhej mposhtur edhe si femër, edhe si komuniste. Tym të bëhej. Të dilte ku të dilte. Kur do t'i vinte uji në dorë më tepër se sot?...

Lumta Gjinarin e ngritën nga bodrumi dhe e kyçën në një dhomë të katit të dytë. Nga kryqëzimi i hekurave të drifatës së vogël, hynte vjedhurazi ndonjë rreze drite dhe që nga muri i trashë i kalasë vinte zhurma e njojur e qytetit. Lumta mbështete faqet në hekurat e drifatës dhe me orë të tëra shikonte zogjtë tek i gjëzoheshin freskisë së mëngjesit me fluturimet e trillet e tyre. Në mbrëmje, bashkë me errësirën, Lumta ndiente një angushti të rëndë; shikonte yjtë e shumtë dhe çuditej me vete se si të gjitha mendimet e ditës i zëvendësohen me një dëshirë të vetme: të mbaronte sa më shpejt nata pér t'i hapur rrugë dritës së kaltër të mëngjesit dhe uturimës gjallëruese të qytetit.

Që nga dita kur e kapën, në dhomën e saj s'kishte hyrë njeri tjeter përvèç Qazimit. Vetëm para dy ditësh që dukur pér herë të parë Nazmi beu. Në bebëzat e zemëruara të syve të tij fshihej një vendim i prerë, diçka e prapë dhe e djallëzuar. Pasi qëndroi një minutë te pragu, kërrusi kokën dhe Lumtës iu duk sikur pamja e tij e egër, u zbut nga disa dyshime dhe tallaze të brendshme. Ashtu siç erdhi, edhe iku, pa hapur gojë fare. Po atë pasdite Qazimi i solli kostumin e ri, sandalet e kuqe dhe në dhomën ngjitur u kurdis një gramafon, që s'pushoi deri në mbrëmje. Këngët e ndryshme që kumbonin njëra pas tjetrës, e çonin Lumtën herë në viset e Italisë, herë në ullishtat e Spanjës. Por, në qoftë se këto melodi (me gjithë joshjen e tyre) e mbulonin shpirtin e saj me një mjegull, përtej së cilës zotëronte diçka e paparë me sy, këngët e vendit ishin më të afërta pér të. Kënga e vajtueshme e të riut që vuan nga tuberkulozi e që ka humbur çdo shpresë, por megjithatë kërkon ndihmë nga mjeku, padashur e detyronte Lumtën të ngjeshej pas

murit! Me ndërrimin e melodisë edhe ajo largohej nga muri, si të përgatitej për të marrë pjesë në vallen e gëzuar myzeqare. Për Lumtën e bungosur kjo muzikë merrte një fuqi dhe kuptim të veçantë, ajo i ngrinte peshë ndjenjën e ndërgjegjen dhe e çonte lart në hapësirën e pamatur, duke i dhruuar lirinë e humbur, qoftë dhe për një çast të vetëm.

Dje, Qazimi e ngjiti në tarracë. E mbështetur me bërryla në parmakët e hekurt, Lumta shikonte në oborin e burgut, nja dyqind metra larg, ku një grup esësësh po ngulnin një trikëmbësh.

— Me urdhër të major Francit! — dëgjoi nga pas zërin e butë të Qazimit.

— Cilin? — pyeti ajo.

— Jo, hiç... Si puna e atij Motit, kur po thyente drynin e një dyqani. Kur e pyetën udhëtarët se c'ishte duke bërë, ai u përgjigj se po i binte qemanes.

«— Po ku e ka avazin? — e tallën ata.

— Nesër i dëgjohet!» — ia pat, — dhe vërtet, me mëngjes herët dyqani u gdhi i vjedhur. Edhe trikëmbëshit së shpejti do t'i dalë avazi. Të shohim kujt do t'i bjerë llotaria. E shikon? Me dy laqe po e bëjnë. Ia ka qejfi fort majorit të varë dy desh menjëherë. Ej, moj shoqja zonjushe, kanë ardhur kohë të prapa. U bënë njerëzit si kasapë. Asgjë s'merr vesh Qazimi nga gjithë këto që po ndodhin. Ama, ky qenka qyteti! Phu! Lanet qoftët

Kur atje përtetj esesët lidhën nyjet dhe varën dy laqet e litarit, Lumta instinktivisht u largua në qoshen tjetër të tarracës, prej nga shikohej pjesa më e madhe e qytetit. Duke shëtitur sytë nëpër ato vende të njobura, ku jeta e saj ishte lidhur me kujtime të pashlyeshme, padashur ajo pyeti veten e trishtuar.

«Vallë, kaq shpejt duhet të vdes!»

Ja rruga nëpër të cilën ajo shkonte në shkollë çdo mëngjes. Në krye të saj, disa muaj më parë. Nazmi beu i kishte dalë përpara. Atje larg, brezi i dendur i gjelbërimit të ullinjve shtrihej sa të hante syri! Sa herë pat shkuar Lumta në ato brigje bashkë me shoqet e shkollës për të mbledhur vjollcat e para të pranverës! Më

afër, aty ku plepat rreshtoheshin si mur, ndodhej sheshi i vogël, ku ajo pat kaluar ditët më të bukura të fëmijërisë. Ja dhe selvitë e Namazgjasë, që ngriheshin si roje të heshtura në mes të qytetit! Lumtës iu kujtua dita kur Nazmiu, Petriti dhe Qamili hipën në majën e selvisë më të lartë. Sa vite kishin shkuar që atëherë! Sa ngjarje kishin rrjedhur! Sa qenë ndryshuar njerëzit... Disa ishin rritur e bërë burra!... Të tjerë s'jetonin më!... Po i ati, gjallë do të qe akoma? Petriti si i kishte punët!

«Ndoshta s'kam për t'i parë më kurrë!»

Kur qe e vogël, asaj i pat qëlluar të fluturonte shpesh përbimi çatitë e shtëpive të qytetit, të ngrihej deri në re... pastaj, atje lart trupi befas i lëshohej poshtë; mirëpo, para se të binte në tokë, për çudi, Lumta zgjohet në dyshekun e ngrohtë pranë të atit me lutjen në gojë: «Sa mirë që s'linda zog!» Por tashti, ndërsa vërtitej nëpër tarracë, e shoqëruar nga vështrimi i butë, por i pakuptueshëm i Qazimit, Lumta ëndërronte të kishte krahë si të zogut..

«Pa asnë shpresë!»

E topitur nga trishtimi, ajo mbërtheu shikimin në çerdhen e braktisur të lejlekut, majë kullës së kalasë. Çerdhja po prishej nga era e nga shirat, buzët e saj qenë shembur, kallamishtet e shkopinjtë ishin shpërndarë nëpër gurët e zinj e të lëmuar, gati për të rënë në tokë me tufanin e parë.

— Ah?! Shoqja zonjushe! Të pyeta, pse nuk e vesh kostumin e ri? — pyeti Qazimi. — Unë për të mirën tënde e kam, që të mos ftoshesh. Iku vera. U prish Ko-ha... Çerdhen shikon ashtu? U prish edhe ajo. S'ka gjë që s'prishet. Edhe kostumi yt do të vjetrohet, edhe në do plakemi. Ohu, është fare e kotë të kursesh sot! Ç'na i ke mbathur këto lëpitka? Hiqi, vish sandalet e kuqe!

Heshtje.

— Shoqja zonjushe!... A të them një fjalë?

Por, meqë Lumta heshtte, atëherë ai vendosi të fliste:

— Shoqja zonjushe! A më shikon mua burrin këtu? Kam rënë unë i gjori më një merak të madh, sa

gjumi i natës s'po më merr. Jo se goca është shumë e bukur, por ama, m'i ka ata gërshta si bishti i kalit cil. Mirë, moj zonjushe, pa më këshillo një herë si t'ia bëj hallit! Nga meraku, s'guxoj t'i dal gocës përpara. Po të qe femër tjetër, s'pyeste Qazimi. Të çaj unë. s'di llafe! Femrat prandaj i ka krijuar perëndia. Edhe meshkujt. Kam prova për këtë që flas. Në shtëpinë e beut çdo natë... A? Dëgjove gjë zotrote? Aishen, atë gocën e përdalme, që e ka shtëpi pas fushës së sportit, e kam si të dashur. — Me të thënë këto fjalë, fityra e Qazimit u ngrys. — Edhe me Aishen ma prenë riskun. Njëfarë Deme Myrryli, po ta kesh dëgjuar. Është një alamet burri ai, moj shoqja zonjushe... Po ajo goca me gërshtat si bishti i kalit ma dogji zemrën. Si më këshillon ti, shoqja zonjushe, si zonjushe me shkollë që je, a t'i shkoj në shtëpi e t'i bie gjunjas?

— Kot e ke!

— Oh, moj shoqja zonjushe, po unë i shkreti e dua, aq e dua, sa s'ta rrëfej me gojë! — tha Qazimi. — Unë do t'i shkoj.

— Do të të vënë drunë! Je ballist!

— Do të më vënë drunë? Kështu thua ti? Se jam ballist! Ani ç'ka, burrë jam unë, le të ma vënë. Unë do t'i shkoj! — murmuriti Qazimi dhe u hoq, mënjanë, i pikëlluar e buzëvarur. Por kjo gjendje nuk zgjati shumë. Nuk zgjati shumë, se ndërkohë dielli ishte ngritur mbi majat e selvive. Po afrohej koha që Qazimi do të njomte gërmazin me ujin e bekuar në pijetoren e Refikut, pastaj do të shkonte te Adebin akciu për të ngrënë pilafin me mëlcikca.

— Shoqja zonjushe!... — dhe i tregoi shkallët me drojtje, si ta ndiente veten fajtor për diçka.

Kështu, Lumtë Gjinari shtynte minutat dhe orët, derisa në mëngjesin e asaj dite dëgjoi zhurmën e çelësit dhe te pragu, në vend të Qazimit, pa Nazmiun.

— Po të lutem për herë të fundit, — foli ai me një zë të ndryshuar.

E trondituri nga pamja e tij e zverdhur, Lumta u

zmbraps në qoshe të dhomës. Nazmiu eci drejt saj i pavendosur.

— Lumtë, dëgjomë. Unë të dashuroj. S'ke tjetër rrugë, vëçse t'i nënshtrohesh fatit. Shkruaj një deklaratë, ku të vërtetosh se erdhe vullnetarisht në radhët e rinisë së Ballit... Ç'pret? Ç'mendon?

— E shoh se të ka hyrë frika për krimet që ke bërë.

— Unë merrem me luftë politike dhe jo me krimet.

— Mjafton që u fute në radhët e Ballit. Çdo hap i yti është krim e tradhti.

Me të dëgjuar këto fjalë, Nazmiu qëndroi në vend. Lumta vazhdoi:

— Ti do të japësh llogari për të gjithë ne që namban në burg.

— Si the? Edhe ti s'më kupton?! Edhe ti vetëm mbi mua e vë gishtin?! Në beson perëndi, lutju për herë të fundit!

— Nuk besoj perëndi, — foli ajo me tallje.

Nazmi beu nxori revolen nga këllëfi dhe ia vuri në ballë.

Tamam në çastin kur Lumta priste fundin, ai hodhi revolen dhe papritur e pakujtuar ra në gjunjë para saj, duke e puthur në kërcinj e në pulpa.

— Lumtë! Unë s'jam kriminel. Kot shkruajnë përmua. Mblidhe mendjen... Më duhet deklarata jote... Eja në shtëpinë time.

Lumta u përpoq të çliruhej, pos s'lëvizi dot, pasi krahët e Nazmiut ia kishin shtrënguar këmbët si hallka.

— Eja në shtëpinë time... Petriti s'jeton më!

— Gënjen!

— Ai tradhtoi!

— Gënjen!

Duke u dridhur i téri, Nazmiu u ngrit ngadalë dhe e pushtoi për beli. Lumta u përpoq përsëri të çliruhej, por më kot, ajo e njinte që në vogëli fuqinë e atyre krahëve!

— Ai është bërë kockë e lëkurë. Së shpejti do ta varin. Çdo shpresë është e kotë.

— Lëshomë!

— S'të lëshoj, jo! — i briti duke e shtrënguar më fort.

E dobësuar nga mundimet e ditëve të fundit, Lumta nuk i përballoi duart e Nazmiut.

Ndërkaq, ai e vuri poshtë, i këputi sumbullat e bluzës, i grisi kombinezonin dhe mbështeti fytyrën e djerisitur në supin e saj.

— Së paku ti të bëhesh me mua. Edhe në humbsha, atëherë ti duhet të më shpëtosh, siç po të shpëtoj unë ty sot!

Për një hop në dhomë zotëroi heshtja.

Duke ndier rreth belit krahët e fortë të Nazmiut, Lumta mbloodi forcat e fundit:

— Largoju! — i briti dhe u përpoq të ngrihej, por Nazmiu e vuri përsëri poshtë. Lumta e ndjeu se po e linte fuqia, po i priteshin krahët e s'po mbushej dot me frysë. Provoi të lëvizte, por pa dobi. Mezi shqiptoi:

— Sa i ndyrë!

— Të kam grua!

— Mos harro hakmarrjen!

Ashtu siç iu hodh papritur pak më parë, po ashtu e çlirroi. Lumta u ngrit, mbuloi me pëllëmbë gjoksin e zbuluar dhe u zmbraps drejt këndit të dhomës.

— Unë të dashuroj! Po s'më kuptove ti, kush tjetër do të më kuptojë? — foli ai me zë lutës.

Ajo heshtte.

— Unë mund të veproj edhe kundër gjermanëve. Po të dua edhe Petritin e çliroj nga burgu. Atë e pret vdekja e sigurt, por unë mund ta shpëtoj. Ndoshta edhe ai do të ma shpërblejë. Po kështu, a do të më kuptojnë?... Veç ti bëhu gruaja ime!...

Në fillim Lumta Gjinari s'para ua vuri veshin fjalëve të tij. Por kur Nazmi Topi ia përsëriti premtimin dhe kërkoi përgjigje, asaj i lindi një shpresë e vagëlluar se në gjendjen që ai ndodhej, mund ta bënte vërtet një gjë të tillë. Atëherë, pse të mos e nxiste për të vepruar? Lumtës iu këputën të gjitha fijet e mendimit, para saj u fshi qdo gjë, përvëç emrit të Petritit.

— Shpëtoje! — tha ajo.

— Atéherë?...

«Ç'bëj kështu?!» — u trondit Lumta.

Pastaj ajo nuk foli. Nuk iu përgjigj pyetjes së tij. Ajo vetëm e shikoi. E shikoi përsëri. E shikoi gjatë. E shikoi si t'i thoshte «jo». Një «jo» të vendosur. Një çast më vonë Nazmi beut iu bë sikur Lumta e shikoi ndryshe. Me sy të dyshimtë, me qepalla gjysmë të mbyllura. Dhe ky shikim atij iu duk sikur i thoshte «Po». Shpëtoje! Ai fshiu djersët e ballit me mëngën e xhaketës dhe nuk qëndroi më. Ai s'donte të qëndronte më gjatë aty. I ktheu kurrizin dhe iku. Po kur po ekte nëpër korridor, kur ngjiti shkallët e kur u fut në zyrë, qdo gjë, shikimin e Lumtës, qëndrimin e saj, që i thoshin një mijë «jo» e një mijë «po», i vuri në dyshim. Po tashmë kjo s'kishte rëndësi. Ai kishte vendosur. Ai do të vepronte. Ai do t'ia jepte celësin Petritit. Ai do ta shpëtonte. Dhe kur Petriti të kishte shpëtuar, dhe kur Lumta të bindej për këtë, kur të ndodhej para këtij fakti, atëherë ajo do të vendoste në favorin e tij... në favorin e të dyve.

— Bej, ku je zhgërryer zotrote kështu? — e pyeti Qazimi në zyrë.

Nazmiu kërrusi kokën dhe pa kostumin me një vështrim të fjetur, vështrim, i cili tregonte se mendja e tij ishte akoma gjetkë.

— Zotrote paske fshirë gëlqeren e mureve!

— ...?

— Në kohë luftë s'duhen veshur kostume blu.

— Fshije e mos bëj llafe.

Qazimi nxori peshqirin dhe e lidhi nyjë.

— Pse m'i zbardh dhëmbët, — e pyeti Nazmiu me dyshim, se për të përgjuar Qazimi ishte i vetmi:

— Jo, kot bej! Sot duhen veshur vetëm rrrobat e gjuetisë. Si gjuetarë rosash jemi bërë. Luftë i thonë! — përfundoi Qazimi, duke ia vërvitur peshqirin pas kurrizit me sa fuqi që pati.

Përtej resë së hollë të pluhurit të gëlqeres, Nazmi  
beu pa fytyrën serioze të Qazimit dhe u qetësua pak:  
«Me sa duket, kësaj radhe s'paska përgjuar!»

— Bej, ti s'më pyete...

— S'kam q'të të pyes. Fshimë kostumin.

Nazmiu do të dëshironte një mijë herë të mos e  
kishte dhënë atë urdhër. A mbahet gjë e fshehtë? Ku  
të futej ai kur të merrej vesh se Balli kishte mbytur  
një copë grua? E pse?

— Pastromë kostumin! — i tha duke i kthyer  
shpinën.

Qazimi mbylli sytë dhe hapi sa mundi flegrat e  
hundës. U lëkund një herë mbi këmbët e holla e të  
gjata, pastaj foli nëpër dhëmbë:

— A ta them çfarë ngjau?

— Jo!

Qazimi tundi kokën në mëdyshje, pastaj nxori  
nga xhepi një peshqir të dytë për t'i lidhur bashkë.

— Mos kërkon të më thyesh kockat? Mjafton ai që  
ke në dorë!

— Mirë, e zëmë se mjafton, po të kam rixha, përsë  
zotrote s'do të dëgjosh si e pësoi nëna e komunistit?

— S'kam kohë të merrem me të vdekurit!

— Me q'të vdekur? Me të mbyturit, thuaj!

Nazmiu e shikoi përsëri me dyshim përtej resë së  
pluhurit, që dukej si brez i ndritur nga refleksi i rre-  
zeve të diellit. Para se të fliste, Qazimi e goditi fort  
me nyjën e peshqirit, sa Nazmi beu kërceu matanë.

— Më vrave, dreq!

— Që ta kam fjalën, bej, Dana Guraj të çon të fala.  
I vumë gurin në qafë dhe e hodhëm, pëlltum! Kur pas  
një minute ia pat përmbi ujë dhe, pa e prishur tere-  
zinë, i ra më not. Në bregun tjetër thirri:

— Jepi të fala, beut!

— Ç'flet ashtu, budalla. Mos u tall me të vdekurit,

— i foli Nazmiu, duke kruar kurrizin aty ku i ra  
peshqiri.

— E lirova, bej, — ia ktheu me seriozitet Qazimi.

— E lirova. S'ishte punë që bëhej ajo. I thashë, ik në fshat, se të piu e zeza, e mos u duk më në pazar.

— Fol si burrat, e lirove?

— E lirova.

— Hé, ashtu, — llomotiti Nazmi bez Topi me theks tē pakuptueshëm, por, në të vërtetë, kjo e papritur ia freskoi kokën e mpirë si dush i ftohtë. «Në këtë kohë, vetëm budallenjtë mund tē bëjnë gjëra me mend. E mjera Shqipëri» — mendoi Nazmiu duke shikuar me bisht tē syrit fytyrën e lodhur tē Qazimit.

Megjithëse Lumta Gjinari i dha një fije shprese, me vështrimet e saj tē dyshimta, atë mbrëmje Nazmi bez Topi u kthye në shtëpi i dërrmuar. Koka zuri t'i dhembte si në mëngjes. Gojën e kishte tē hidhur. Sytë i digjinin. Mendtë i merreshin. Nuk hëngri asgjë. U ngjit në dhomën e vet, vuri revolen sipër komodinës dhe u shtri mbi dy-shek. U përpoq tē mendonte për ngjarjet e ditës, por s'qe i zoti tē rikujtonte asnjë. Nguli vështrimin në tavani dhe zuri tē numëronte. Një, dy, tri... katër... pesë... pesë... pesë...

— Re-e-v-o-le-en! — briti, hapi sytë dhe shikoi grykën e saj në mes tē ballit. Endërr: vetëvrasje!

Djersë tē ftohta. Hodhi revolen në dysheme. Largoj jorganin. U kthye përmbyss. U shkreh në vaj. Kurrizi i gufonte. Lotët i lagën jastëkun. Një peshë e rëndë e batësi përsipër.

Mesnata ishte e qetë. Rrallë e tek dëgjohej ndonjë zhurmë e mbytur. Diku aty poshtë pikasi zëri i s'ëmës: «diavolo.» Fëshférinin gjethet e portokalleve në obor. Një bisk përplasej pas xhamit dhe Nazmi beut i dukej sikur i thoshte:

— Ti-ti-ti!

— C'do? — e pyeste pa zë ai.

— Ti-ti-ti! — i trokiste bisku pas xhamit.

Një zhurmë e mbytur.

Fëshfërima e gjetheve në oborr.

— Diavolo!

— Ti-ti-ti!

— Ç'do?

Heshtje.

Dhe befas një krismë e fortë gjëmoi nëpër qiell.

— Ah, — klithi ai dhe zuri të qante me dënesë.

— Mos vallë duhet të vrás veten?!

Mesnatë.

— Diavolo!

Dhe zëri i Qazimit...

\* \* \*

Nënë Dana e kuptoi se me të birin e ndanin gjithë ato mure të trasha dhe gjithë ajo ushtri e panumërt. Priti derisa u errësua, pastaj mori rrugën ngadalë drejt shtëpisë.

«Si m'u veshën sytë e s'e pashë çumin dy hapa larg! Pse nuk e putha? Pse nuk i ktheva përgjigje, kur më foli: «Ne do të takohemi përsëri!» Ma nxorën te hunda dhe unë i dëgjova vetëm zérin! Përse më çuan jashtë qytetit, buzë lumi?!» — çuditej e fliste me vete Dana.

Rezet e dobëta të hënës para reve nuk binin deri në tokë. Dana mezi i gjeti shtigjet e gardhet, derisa më në fund iu afrua shtëpisë së usta Dines. Në oborrin e saj, në atë oborr ku ajo pat pritur e përcjellë kaq herë të birin bashkë me shokët e tij, Dana ndjeu diçka të paprovuar deri atëherë. Bota e vjetër, ku ajo pat jetuar pesëdhjetë vjet, i bëhej se kishte mbetur diku prapa krahëve të saj. Në mes të hajatit nxori duart nga xhepat e ferekhesë dhe pesë hapat e fundit ajo i hodhi lirisht.

— Danë! — i thirri fqinja që rrinte pranë Markut.

— More vesh gjë për çunin?

— Çunin e kam gjallë, motë! Dhe kjo qeveri s'e ka të gjatë!

## *Kapitulli i dymbëdhjetë*

### **NË MES TË PLEQVE**

Një ditë, ndërsa tre pleqtë, Murat hanxhiu, Dine Çeliku dhe Vasil Gjinari, po bisedonin për hallet e luftës, Samija u fut në dhomë. Atë e kishin dërguar një pesë shoqe të lagjes për t'iu lutur zotit mësues që të merrte mundimin e t'u mësonte shkrim e këndim, pa të cilin, siç i kishin thënë ato, njeriu ishte si qorri pa të dy sytë...

Me të dëgjuar këto fjalë, Vasil Gjinari i hyri punës, Brenda ditës, sipas porosisë së Vasilit, Murati prishi një dy arka të vjetra dhe i bëri një dërrasë si ato të shkollës. E lyen me bojë të zezë dhe e yunë pranë zjarrit për t'u tharë. Me mëngjes herët, në dhomën e veguar të hanit, që lidhej me magazanë e barit me një derë të vogël, filloi mësimi. Në minutat e para, shoqet e Sanijs u skuqën e u zverdhën ca herë, pastaj ato u mësuan me fytyrën e butë e me zërin e ëmbël të zotit mësues.

Sa herë që ndodheshin aty Murati dhe Dinia, uleshin në qoshe të dhomës dhe shikimin me gudi Vasilin, kur u fliste gocave, duke u shkruar në dërrasë të zezë shkronjat e shqipes.

— E shikon! — i binte me bërryl Murati shokut të vet.

Dinia buzëqeshte:

— Lëre mos e pyet! Qenka çudi e madhe punë e shkollës!

— Jo po, paska një gjuhë Vasili! Ta futka në kokë, fap, si me dorë, mor jahu!

— Ej, ke po mësojmë edhe ne në pleqëri! — pshterëtintë usta Dinia, duke hedhur në gjunjët e Muratit kutinë e duhanit.

— Dridhe, Murat, se e humbëm fare!

Murati, mbasë për të dhjetën herë, i pëshpëristë në vesh:

— Më ka thënë Sanija se mësuesve u vjen zët kur të tjerët pinë duhan në kohën e mësimit.

— Ashtu thua? Ah, po, harrovë! Hajt se po durojmë për hatër të Vasilit.

Meqë duhan s'mund të pinin, as tespitë s'mund t'i hiqnin, të dy pleqtë zhvisheshin nga çdo mendim dhë pardashur dëgjonin mësimin e Vasilit.

Pesë germat e para Dinia dhe Murati, duke ndihmuar njëri-tjetrin me goditje të lehta bërryli e me ndonjë pëshpëritje, bënë si bënë dhe më në fund i kuptuan, por te gërmë «DH» ata ngecën dhe shikuan njëri-tjetrin me dyshim.

— Demek, u bashkokan dy acoj dhe u formoka vëtëm një acoj.

— Tashti u prish puna!

— Me të ikur gocat, do pyesim Vasilin.

— Ej, ke na hyri miza!

Por dy pleqtë s'mund ta merrnin kurrë me mend se Vasili e kishte kuptuar gjendjen e tyre dhë se ai i pat regjistruar edhe ata në regjistrin e çuditshëm të atij viti shkollor, i cili s'ekzistonte veçse në kokë të mësuesit.

Ato ditë Murati s'ishte i zoti ta fshihte krenarinë, kur shikonte se hani i tij ishte kthyer në shkollë. Vasili, i dhënë me mish e me shpirt pas punës, shpërndau disi brengën e madhe për rrezikun që i kanosej se bijës në burg. Dhe, sa më shumë që mësonin gocat shkrim e këndim, aq më shumë lehtësohej edhe ndërgjegjja e tij, e fyter nga papunësia e atij viti. Kurse usta Dinia, po-thuaj çdo ditë, sa mbaronte punët e vëta në magaza,

ku kishte ingritur punishten, nisej për në han të Muratit dhe, në mes të haleve të tjera, ai gjente aq kohë, sa të mendonte edhe për çudirat e shkrimit. Gërmat, siç i quante Vasili, i jepnin dorën njëra-tjetrës dhe formonin fjalë... Dhe ç'fjalë se? Nga ato që Dinia kishte folur tërë jetën! Ama, me ca fjalë s'bëhej shaka, sa të gjata që ishin, pa, pa, pa.

...Por atë ditë usta Dinia s'e kishte mendjen te çudirat e shkrimit. Në mëngjes, ndërsa po punonte në magaza si zakonisht, dikush erdhi nga prapa dhe i mbylli sytë. Ai dha të çlirohej, por s'qe e mundur... E kuptoi usta Dinia se e kishin mberthyer një palë duar të forta.

— Cili je, mor bir?

— Gjeje!

— Mor çun, çliromë e fol kush je! S'është kohë për shakara.

— Një mikut yt!

— Pa dale?... Të njoha, se ma ke zërin si buri, mاشالا. Rifat muraxhiu?

— Tamam. I re në të. Tani hapi sytë! — gjëmoi basi i tjetrit.

— Si kështu në mes të ditës? S'ke frikë se të kapin?

Edhe pyet, usta? Ne ua kemi frikën atyre, ata neve. Kështu shkon kjo punë.

— Ule zërin!

— Ah po!

— Këta qafira po përblytin qytetin! E mblodhën rininë nëpër burgje! Më ka hyrë frika për Markun!

— Për atë erdha!

— Ule zërin!

— Ah, po!

— E pe?

Rifati tundi kokën.

— Është tretur!

Usta Dinia, dhe Rifati biseduan dhe vendosën: Marku duhej nisur sa më parë në spitalin partizan, pasi nuk dihej si do të shkonin punët përderisa qyteti po mbahej gjithnjë i rrëthuar. Gjithashtu, Rifati u conte të fala Vasil

Gjinarit dhe Murat hanxhiut dhe u lutej atyre që të ndihmonin usta Dinen pér tē mbartur Markun deri në kopshtet buzë ullishtës, ku do tē vinte një skuadër partizane pér ta hedhur matanë zallit. Me kaq, Rifati u largua parë mbaruar cigaren, kurse usta Dinia vuri qeleshen në kokë dhe erdhi në han.

Muratin e gjeti tē shqetësuar. Një orë më parë Bardhoshi qe shkëputur nga tufa e pëllumbave dhe qe ngriitur në qiell, pa lënë gjurmë. Por ja, kur burrat po bënin toka në mes tē oborrit, krahët e Bardhoshit fërfëllinë maje çatisë. Me tē zbritur në qymez, Murati e mori ndër duar pëllumbin e lodhur dhe tha:

— E kam trim.

— Bardhoshin e njeh i madh e i vogël.

— Pa hë, ç'të reja kemi?

— Plot, Murat. Kam ardhur pér një punë me rëndësi tē madhe!

Ecën në heshtje përmes oborrit, Murati duke përkëdhelur pëllumbin, që ishte tulatur pas gjoksit tē tij, Dinia duke rrotulluar nëpër duar qeleshen e bardhë.

— Si the ti? — e pyeti Murati, dhe nisi tē shuajë etjen e pëllumbit me pështymën e vet. — Ke ardhur pér një punë me rëndësi tē madhe?

Dinia përpéliti qepallat dhe vuri qeleshen në kokë.

— Oksion, Murat!

— Çfarë the?

— O-oksion! Na e ka ngarkuar Partia.

— Këtë fjalë s'e marr vesh ku rrëh.

— Luftë, Murat, luftë!

Murati qëndroi në prag tē derës:

— Ulu një çikë më poshtë, se ke hipur lart. Unë e ti, luftë!...

— Ani, ç'ka, unë e ti a s'jemi popull?

— Ore, më thuaj ç'është ky oksion që zure në gojë...

— Prandaj erdha, po hajt se ta them brenda.

Me tē hyrë në dhomën ku që vendosur Vasil Gjinali, Murati i lëshoi zë së bijës:

— Hajde, moj, tē marrësh Bardhoshin!

Pëllumbi shikonte rrrotull me sytë e vegjël si rruaza të kuqe.

— Pa na e thuaj një herë, ku e ke hallin? — s'lu durua Muratit.

— Ja si qëndrojnë punët, — s'e bëri të gjatë Dinia, por, meqë në prag të derës u duk Sanija, është duke shikuar nga Murati.

— Merre, moj, Bardhoshin! Jepi ca ujë, se iu tha gjuha.

Sanija e mori pëllumbin me kujdes dhe nisi ta puthte në sqepin e kuq.

— «Hej dreq, — mendoi Murati, — edhe kjo na u desh». —

— Hajt, pra, ikë, të thashë!

— Murat, mos i bërtit gocës! — i doli zot Vasili, që e dinte se ajo bënte pjesë në rininë antifashiste fshe-hurazi nga i ati. — Sa herë të kam thënë, mos e mbaj të myllur në katër muret e shtëpisë. Jeta në mes të njerëzve është shkollë më e madhe.

Usta Dinia përpëliti sytë duke shikuar herë njërin, herë tjetërin. Murati lëvizi nga vendi, u kollit në të thatë dhë, pa shikuar njeri në sy, foli:

— Mirë e ke ti... zoti Vasil. Po ky Dinia se ç'më ngatërroi me një fjalë. Kam frikë se kjo punë e oksionit s'është për gocën.

— Ja ku po jua them, — ia preu fjalën Dinia dhe u tregoi me hollësi gjendjen e Markut dhe vendimin që ishte marrë.

Pleqtë e ndien veten të nderuar për barrën që u kishte vënë Partia; dhe puna shkoi aq larg, sa Murati s'hapi gojë edhe kur qe dëshmitar i kësaj bisede:

— Do të vij edhe unë bashkë me një shoqen time! — foli Samija.

Dinës i qeshi ftyra. Murati lëvizi edhe një herë nga vendi, duke lëshuar një kollë të thatë.

— Mirë! — theu heshtjen i pari Vasili. — Gocat e hapin rrugën më lehtë se pleqtë. Ne do ta mbajmë, kurse ju do të përgjoni.

Pas këtyre fjalëve, padashur, sytë e të treve u drejtuan nga Murati, por ai tundi vetëm kokën, pa ditur si t'u përgjigjej vështrimeve të tyre.

Me kaq «mbledhja» e parë e pleqve mori fund. Sanija u largua me Bardhoshin. Dinia u ngrit e shkoi përtu' ndodhur pranë të plagosurit, Murati nxori nga magazaja e barit një dhjetëshe turku, dhe filloj ta pastronte, i rrethuar nga pëllumbat.

— Po goca, xhanëm! Edhe ajo të futet në luftë? — murmuriste dhe, megjithëqë s'ua kishte ngenë pëllumbave, prapëseprapë përpiquej të bënte sa më pak lëvizje përtë mos trembur ata që i çukitnin herë pas here fijet e xhokës në supe.

U dëgjua kërkëllima e portës. Në kanatin gjysmë të hapur u duk më parë tyta e një paticke, pastaj koka e Qazimit me flokë të gjatë e të lyer me brilantinë. Pasi buzëqeshi si me pahir, duke zbuluar dhëmbët e bardhë, Qazimi e përshëndeti që nga larg Muratin, që kishte ngrirë te buza e sofës me revole në prehër.

— Kabull mysafir! — thirri ai dhe buzëqeshi përsëri.

— Mirësevjen, or ti shoq! — e priti ftohtë Murati, duke fshetur revolen nën jastëk.

Qezimi kapërceu pragun dhe eci ngadalë përmes oborrit.

— Një pëllëmbë mbi tokë ke qenë. Thamë se s'do merrje përpjetë. Mirëpo, mashallah, pyll të është bërë shtati!

Qezimi qeshi nën hundë dhe shikoi me kureshtje rrretheqark.

— Edhe Sania jote, mashallah, gjithë ajo gocë ishte bërë!

— Kum, kum, kum, — u kollit Murati në të thatë.

— C'të solli era këtej? — e pyeti pas pak.

— Hi-hi-hi, — veç qeshte Qazimi me sy të picërruar, duke mos zënë vend në buzë të sofës.

— Jo, hiç, thashë t'i bëj një vizitë fshatarit tim!

— foli ai: — Ja kështu, nga mërzitja.

Pëllumbat u vërtiteshin mbi kokë, derisa më në fund njëri prej tyre zuri vend në tytën e patickës, të cilën Qazimi s'e kishte hequr akoma nga krahu.

— Shufër për qymez e paske pushkën. Edhe pëllumbave u pëlqeu.

— Hi-hi-hi. Po Sanija i do pëllumbat?

Murati u ngrys.

— Po. Shpezét e butë i pëlqeijnë fort.

— Samijes?

Murati e shikoi në sy:

— S'na the gjë fare! Ç'të reja kemi nga qyteti?

Unë vërtet banoj këtu, po rrallë dalë rrugëve.

— Ç'të të them unë i shkreti? Mérzitem. Nganjëherë them t'ia mbath në fshat.

— Po qe se mérzitesh, ik, ç'pret!

— Po... thashë të martoheshha një herë, pastaj të iki.

— Martohu. Merr ndonjë të serës.

Qazimi lëvizi përsëri nga vendi.

— Të martohem, a?

— Ç'të presësh?

— E po, dua të gjej ndonjë gocë... Po Sanija ku pas ka shkuar? — pyeti befas duke shkuar nga xhamat e pastër të shtëpisë.

Murati e shikoi nën vetullat e trasha e të thinjura:

— Samijen në shtëpi e kam... E kishim fjalën të martesa jote. Merr një grua të ve, se gocat e qytetit nuk i kanë me qejf beqarët e plakur. Ti vërtet po u afrohesh të tridhjetave, por me këto rroba ushtarake dukesh si burrë i thyer në moshë. S'të kanë hije hiç fare!

Qazimi u thartua në fytyrë. Shikoi setrën e re me kopsa bojë floriri, kilotat e ngushta, dollakët, këpucët e mëdha me gozhdë, pastaj tha:

— Do t'i heq, pra. Sikur po më térheq fshati.

— Hiqi, mos e bëj të gjatë. Dhe martohu.

Ndonjëri nga pëllumbat herë zinte vend në supin e Muratit, herë në tytën e patickës. Një glasë i ra Qazimit në majë të hundës.

— Ah, ç'më fëlliqi!

— Ani, ç'ka. Në pyeç hollë, kam dëgjuar se nga fundi i dynjasë glasat e dallëndyshes e të pëllumbit ka njerëz që edhe i hanë. Sa për erën, t'i s'para e ndien, se qenke lyer me livando.

Qazimi u fshi me peshqir. Pastaj hoqi patickën nga krahu dhe e lëshoi pranë këmbëve.

— Pajën qep Sanija, Murat?

— Po, edhe pajën qep... T'i them të na bëjë një kafe, se kështu s'ka lezet! — i tha Murati me djallëzinë e babait që ka rënë në erë për hallin e tjetrit.

— Jo, xhan, Murat, lëre gocën të qepë pajën. Vij një herë tjetër për kafe.

— Si të bësh emër zotrote. Po sikur ke një hall, Qazim. Ma thuaj. Në paç punën e martesës, unë kështu të këshilloj, merr një grua të ve.

Qazimi u ngrys.

— Ajo punë duhet menduar mirë, Murat, — tha ai duke u ngritur. — Ma ka qejfi të marr një gocë të re.

— Zoti ta pruftë mbarë!

— Rri me shëndet.

— More, atë mësuesin që kërkonit një natë tek unë, a e gjetët?

— E gjetëm, posi. Në burg e kemi.

— A!

— Puna e tij ka marrë fund. Po... nejse, Murat. Më është bërë dhallë kjo e shkretë mendje. Do vij një herë tjetër të bisedojmë shtruar.

Sakaq Qazimi e zuri mesin e oborrit me hapat e tij të gjatë.

— Oj, domethënë, e rrretheqarkuat mësuesin!

— Ou! Edhe pyet! Rri me shëndet! — tha prapë Qazimi, kur po shkelte te pragu.

Murati i thirri që nga buza e hajatit:

— Qazim, ta paskan dhjerë pushkën pëllumbat. Fshije, se ashtu siç je katandisur ti, s'gjen dot as grua të ve!

Qazimi shikoi me bisht tē syrit tytēn e lerosur tē patickës.

— Ah, po... — tha dhe u zhduk pas portës.

Pasi i vuri rezen kanatit, Murati mori përsëri revolen pér ta fshirë dhe i lëshoi zë Sanijes:

— Dëgjon, moj, shko e pastro dhomën e re tē zotit Vasil.

Atë mëngjes, nga frika se mos i diktonte njeri, Murati e nxori Vasil Gjinarin në një dhomë tjetër në shpinë tē hanit, tē cilën e mbanin tē mbyllur.

I térhequr nga sendet që ndodheshin aty, zoti Vasil qe tretur në mendime pér një kohë tē gjatë. Nga fundi i dhomës radhiteshin ca vegla pune: një kazmë, lopatë, sfurk dhe s'dihej përsë ruheshin akoma dy kularë qesh dhe një parmandë e vjetër, plugu i së cilës ndriste nga pastërtia. Mbase këto ishin tē vetmet vegla që Murati trashëgonte nga i ati dhe, me sa dukej, ai s'kishte pasur zemër t'i flakte këtu e dhjetë vjet më parë, kur zuri vend në qytet... Tani gjysmën e parmandës e mbulonte dërrasa e zezë, ku Vasili u mësonte shkrim e këndim pesë gocave e dy pleqve. Tundi kokën, shikoi orën e xhepit dhe, megjithëse nuk i hiqej nga mendja aksioni që do tē bënin pér mbartjen e Markut në mesnatë, zoti Vasil hapi dritaren që shikonte nga oborri i shtëpisë.

— Sanije! — thirri. — Lajmëro shoqet tē vijnë në mësim!

Pas pak te praku u duk Sanija me fshesë në dorë, me përparëse dhe me shami në kokë. Vasilit iu kujtua e bija: ashtu qe veshur Lumta natën e fundit, para se ta arrestonin.

— Sa t'i jap një fshesë!

— Po shoqet, a janë gati pér mësim?

— Gati janë! — tha Sanija. — Vetëm usta Dinen s'do ta kemi sot.

Po, sa pér usta Dinen që s'do tē merrte pjesë atë ditë në mësim, zotit Vasil Gjinari i vinte keq!

## *Kapitulli i t'rembëdhjetë*

### **GJËMIME VJESHTË**

Maj or Franci e humbi shpresën se mund të nxirri te ndonjë fjalë nga goja e Petrit Gurajt. Torturat u rra lluan dhe Petriti sikur e mori veten. Në qeli hynte vetëm Kurti, sa për t'i hedhur një copë bukë të zezë. Pasi e shikonte nën vetulla, me sy të ndritshëm prej të riu, largohej duke shuar elektrikun, çelësi i të cilit ndodhej në korridor. Qelinë e ftohtë e të zhveshur, ku s'kishte gjë tjetër përvèç një mangalli me hi të shuar, i lënë aty që nga ditët e torturave, e pllakoste një heshtje e thellë dhe një errësirë e plotë. Qëllonte shpesh që Petritit t'i sosej durimi, t'i acaroheshin nervat dhe atëherë i dukej sikur kishte humbur dritën e syve. S'ishin të rralla rastet kur ai vërtitej pas derës së hekurt derisa gjente një vrimë të vogël, ku shkëlqente një fije drite sa një majë gjilpëre. Kur lagështira ia mbështillte trupin si çarçaf i lagur, ai shtrihej mbi dërrasat e vetme, mbullohej me batamijen e grisur dhe dremiste. Nganjëherë zgjоhej duke thirrur «Dritë! Dritë!» Pastaj i binte derës me shkelma, derisa vinte Kurti me kamxhik në dorë.

— Dritë! — thërriste Petriti.

Kurti as qeshte, as ngrysej. Pasi e qëllonte me kamxhik, largohej duke e lënë përsëri në errësirë. Petritit i

thernin kockat e plagët, që sapo i kishin zënë kore, por megjithatë, kënaqësia kur shikonte dritë, qoftë dhe për një çast të vetëm, sikur e çlironte pak nga ajo gjendje nervore.

Një ditë në bodrumin e gestapos ndodhi një e pa-pritur: në qeli u fut Qazimi, i shoqëruar nga Kurti. Ky i fundit, me t'i hedhur bukën, doli në korridor, pasi s'mund ta duronte erën e rëndë që kutërbonte qelinë, kurse Qazimi mbeti i ngurosur te pragu. Petriti e kuptoi se ballisti kishte diçka pér t'i thënë.

— Përse erdhe?

— S'më njeh? — ia ktheu Qazimi me zë të ulët.

— Po. Është hera e dytë që më viziton.

— Tamam. As topi s'e luan.

Një copë herë heshtje.

— Sa është ora? — e pyeti Petriti.

— Rrafsh dympëdhjetë, — iu përgjigj Qazimi, duke shikuar me vëmendje derën e hekurt dhe mangallin me hi në qoshe të qelisë.

— Natë apo ditë?

— Ditë vëllaçko! S'e ditke ti kur është ditë e kur natë?

— A doli tetori?

— Ohu! Gati në të dalë.

Qazimi u mat t'i thoshte diçka, mirëpo në fund të korridorit u dëgjuan këmbët e Kurtit...

Por Qazimi erdhi përsëri mëngjesin tjetër dhe nuk dihet se pse Petriti ndiente një farë kënaqësie të pa-shpjegueshme kur shikonte fytyrën e dobët të ballistikës atë vështrim gjithmonë të trembur. Ndoshta kjo kënaqësi rriddhëtë, sepse sytë i shikonin një fytyrë tjetër përvëç asaj të Kurtit, ndoshta sepse në këto vizita të shkurtra qelia e errët ndriçohej nga elektriku.

Kësaj radhe vizita e Qazimit u shoqërua me disa klithma, që vinin nga fundi i korridorit.

— Vëllaçko, mos më shiko me butësi, se na dikton gjermani! — i tha befas Qazimi, që po rrinte në prag, duke hedhur vështrimin si zakonisht nëpër qeli. Herë-

— herë ai prekte bravën automatike më gishtat e hollë e të gjatë si shkopinj dhe diç murmuriste me vete.

— E dëgjon? Po rrahin çunin e avokatit. Taksirat!

— dhe, duke shkuar gjatë korridorit, shtoi:

— Oj, çudi, paska një derë atje në fund! --- bënte sikur s'dinte gjë Qazimi. — A të ka rënë në sy?

— Po.

— A? Domethënë të pëlqeka të ikësh prej këtej?

— ...

— Vëllaçko, të thashë, q'më shikon ashtu?!

Në heshtjen e bodrumit dëgjoheshin të qarta fishkëllimat e njohura të kamxhikut dhe thirrjet e pandërprera të Qamil Tapisë.

— Më mori malli, prandaj të shikoj! — ia ktheu Petriti me të butë e me të tallur. — Në të parë dukesh njeri i mirë, veç je tharë si kallam, sikur s'të ushqen fare beu. Po me gjermanët e me ballistët ç'pate që u bëre?

— Se mos po më hanë ndonjë copë mish ballistët e gjermanët! — i foli vrazhdë Qazimi, por Petriti e ndjeu se ai u nxeh sa për sy e faqe. — Jam tharë, vëllaçko, vërtet jam tharë. Beu i vogël eshtë dorëgjerë, me palë e me arra më ushqen, mirëpo hanëmi, që ta kam fjalën, eshtë e egër, sidomos natën, s'ka burri t'ia dalë asaj.. O-oh, sa po e rrahin të gjorin. Ia nisen përsëri torturave. Ç'kokë më vete paskeni ju komunistët! Thuajeni të shkretën një fjalë, se nuk u bë vrimë në qiel! Mirë ka thënë ai i dituri: «Kiameti do të bëhet kur të vdes unë!» Kurse ju... — Qazimi e preu fjalën dhe tundi kokën me keqardhje.

Atje tej klithmat e Qamil Tapisë u rralluan, u bënë të thella e të pafuqishme, derisa në bodrum ra heshtja e zakonshme.

— Bravën e derës sikur e ndërruan dje, apo jo? — pyeti befas Qazimi.

— Brava s'është ndërruar asnjëherë, — iu përgjigj me vonesë Petriti, duke e pasur mendjen te Qamili. — Ai s'po dëgjohet më, — shtoi si me vete.

— Cili?

— Qamili, çuni i avokatit.

— A... Demek ti. thua se brava është po ajo e para!

— Ec e shiko çunin e avokatit në ç'hall është.

— Çunin e avokatit? Unë?! Bah! — ia priti Qazimi duke e përshëndetur me dorë. — Ika, s'ia kam vaktin të përzihem andej!

Me kaq edhe kjo vizitë mori fund dhe Petriti bënte çudi me sjelljen e pakuptueshme të ballistik...

Një herë Petriti u zgjua nga një gudulisje e lehtë në faqe. Hapi sytë dhe mbi kokë pa trupin e gjatë të Qazimit.

— Dëgjo, vëllaçko, — i foli ai me të shpejtë. — Në hirin e tij, — dhe i tregoi me dorë mangallin. Në qoshe të qelisë, — sapo të futa dy çelësa. I vogli është i derës së këtushme, tjetri është i derës së korridorit që del prapa ndërtesës së gestapos. Andej s'ke asnë pëngesë. Vrapo në kopshtin fqinjë. Veç ruhu nga roja e tarracës.

— Kush t'i dha çelësat? — e pyeti Petriti.

— Çelësat u bënë kur qe vendosur përkohësisht në këtë ndërtesë komanda e rinisë së Ballit.

Petriti u hodh në këmbë.

— Nuk të pyes kur janë bërë, por kush t'i dha?

Duke parë afrimin e Petritit, Qazimi u zmbraps pashur:

— I ke nga Nazmi bej Topi dhe nga goca e mësuesit! — iu përgjigji shkurt.

Petriti shtangu nga kjo e papritur.

— Dëgjon? Nazmi beu me të shoqen të cojnë të fala. Mos ua harro këtë të mirë. Kushedi ç'ditë vijnë. Mali me mal s'piqet...

— Fol të drejtën!

— Të gjitha nuk t'i them dot. Për të mirën tënde e kam. S'dua të të hidhëroj, — foli nëpër dhëmbë Qazimi, duke u zmbrapsur. — Janë punë të thella këto, vëllacko. Merr çelësat dhe... — në vend të fjalës së fundit Qazimi lëshoi një fishkëllimë të hollë, por aty për aty u kujtua për gabimin që bëri, kafshoi buzët dhe shikoi anash, — Cuni i avokatit po vdes në spital. Dëgjove?... Ik shpejt, se po të vjen vdekja rrotull. Ik, mos e bëj të gjatë.

— Qenke bërë mashë e Nazmi beut edhe për kodoshllëqet e tij!

— Kush, unë?!

— Po.

— Prit, se do t'i them të gjitha. E shikon këtë? — dhe i nxori gjuhën. — Më ha kur s'them të drejtën. Kështu jam jaratisur. Ja si qëndron puna: goca e më-suesit, që ta kam fjalën, nuk deshi t'i dorëzohej beut të vogël. As paçaurën nuk e firmoi... Mirëpo njëditëzaj sikur ranë në ujdi me kusht që beu të të shpëtojë ty...

— Mjaft! — i thirri Petriti.

Qazimi i zmbraps te pragu dhe mbajti vesh çapet në korridor.

— Po vjen murtaja! — murmuriti dhe s'dihet se pse zuri të zgjidhte e të lidhët njërin nga dollakët. — E shikon? As tek unë s'kanë besim. Pushkën ma mbajnë te dera... — Me të parë Kurtin, Qazimi e preu fjalën e përvshëndeti me dorë në zemër dhe u zhduk si hije.

Kurti e përcoll me sy dhe, para se të mbyllte derën futi kokën në qeli. Petritit iu duk sikur ai shikoi me dyshim rretheqark, sidomos mangallin.

Me të mbetur vetëm, Petritin s'e la të qetë kureshtja. Eci me hamendje më qoshe të qelisë, ku ishte mangalli, dhe zhyti duart në hi.

— Këtu qenkan! — tha apo majat e gishtave takuan në hekurin e ftohtë të çelësave. — Këtu qenkan!

Aty për aty Petriti mendoi se çelësat nuk duheshin lënë në hirin e mangallit. Po ku t'i fshihte? Në qeli s'kishite asnjë vrimë. Në trup ai s'kishite veçse këmishën e pantallonat e grisura e gjysmë të djegura. Pra, hëpërhë, derisa të vinte nata, më mirë se kudo çelësat ishin në hirin e mangallit.

— I vogli është i derës së këtushme!.. — përsëriste fjalët e Qazimit dhe në të njëjtën kohë quditej me vete, që në gjithëkëtë të papritur, s'ndiente as gjëzim, as dëshpërim.

Por heshtja dhe errësira e qelisë e nxitnin të ikte sa më parë. Të dilte edhe një herë më ajër të pastër, të

shikonte qielin, xixëllimën e yjeve, tē ndiente filladin, shushuritjen e plepave që rreshtoheshin prapa godinës së gestapos. Edhe po tē qe provokim, tym tē bëhej, veç atje tē vdiste! Përgjoi me orë tē tëra pas derës pastaj, kur e mori me mend se ishte bërë natë, futi çelësin në bravë. Në qetësinë tingëlluese tē bodrumit, që ndriçohej paksa nga disa rreze tē zbehta tē hënës, veshët e Petritit këpën ca zhurma tē largëta. Duke u mbajtur pas murit, ai eci, pa qenë i zoti tē mposhtte atë dridhje shqetësuese që ndiejnë tē dënuarit me vdekje, kur fati i jetës së tyre varet vetëm nga një e rrrotulluar e çelësit. Por ja, sapo mbështeti faqet në hekurin e ftohtë tē portës së rendë tē korridorit, përtej së cilës e priste liria, befas e pushtoi një dobësi e madhe. Pa kuptuar se ç'bënte, pas një minute mezi u zembraps, u fut në qeli, mbylli derën dhe u përmbyss gati pa frymë mbi dërrasat e ftohta e tē lagështa.

Përse gjithë kjo dobësi? Mos vallë do tē qe më mirë sïkur t'ua kthente prapë çelësat ballistëve? Ç'bënte Lumta atje?

Kështu mendonte Petriti duke ndier njëkohësisht se, bashkë me lirinë që po linte prapa, ai po humbiste edhe fuqinë për tē jetuar. Pushtoi kokën me duar dhe para se tē binte në kllapi, një shkëndijë e vogël e ngacmoi për herë tē fundit trurin e mpirë:

— Dreqi ta marrë! Nuk është e mundur! Lumta nuk tradhton! Duhet ikur! Duhet ikur!... Po, a kam fuqi?!

U ngrit duke u mbajtur pas murit, por që në çapin e dytë këmbët iu prenë dhe ra përmbyss mbi çimento.

«Ngrihu! Ik!

U përpoq tē lëvizte këmbët, duart, tē paktën tē mendonte... Asgjë... Asgjë... Vetëm veshët i dëgjonin zërin e brendshëm:

«Ngrihu! Ik!

Ai donte t'i përgjigjej:

— S'iki dot, jo! S'kam fuqi! — por as buzët s'i hapeshin, as zëri s'i vinte.

«Ngrihu! Ik!

— Dua tē iki, por s'kam fuqi!

Mëngjesin tjetër Kurti, në vend që t'i hidhte bukën, si zakonisht, i tregoi derën me gisht:

— March!

Pasi ngjitën shkallët, Petritin e mbyllën në një dhomë të katit të parë. Meqë ndihej akoma i dobët, u shtri në parketin e pastër me duar nën kokë.

«Përse nuk ika mbrëmë? — pyeste ai herë pas here veten. — Përse më lanë të gjitha fuqitë, përse u mposhta dhe s'lëviza dot nga vendi?»

Në drekë i hodhën, si zakonisht, bukën bajate.

Pastaj copa e qiellit u zverdh.

Pastaj u bë ngjyrë vjollcë.

«Përse e pata mendjen aq të turbulluar?!»

Në hekurat e drithares u përplas një gjethje plepi akoma e njomë. Veriu që fryu nga jashtë e ngriti nga hekurat dhe e hodhi në dysheme. Petriti e zuri me duar plot drengëza dhe padashur e fërkoi pas faqeve me kujdes, si të mos i shkaktonte ndonjë dhembje mikeshës së paftuar.

«Kur jemi të lirë, — mendoi ai, — as që na shkon ndërmend një gjethë!» Por tani për Petrit Gurajn ajo gjethje plepi ishte bërë simbol i jetës që ziente jashtë në natyrë... Mars. Acari zbutet, era zëvendësohet me veriun e freskët, zbërthejnë sythët e parë në bisqet e zhveshura të pemëve. Prilli sjell me vete gjelbërimin, gjethin e ri. Maji, muaji i luleve, muaji i ngjyrave. Nga vezët e shpezëve dalin trashëgimtarët, në shpellat e ngrohta nënat u çojnë ushqim krijesave të tyre. Qielli mbushet me trillet e zogjve shtegtarë të sapokthyer. Natyra ringjallet anembanë dhe kjo bukuri do të vazhdojë gjatë gjithë muajve të verës. Atë s'e zhdukin as rrebeshet e çastit, s'e djegin as rrezet e diellit në korrik e në gusht. Nën shirat e buta e freskuese të shtatorit gjithçka përtorihet; çdo vjeshtë sjell me vete një pranverë të vogël. Po tetori e nëntori fillojnë ta zhveshin natyrën dhe ja... Petriti fërkon pas faqeve atë gjethë, të cilën era vjeshtake e kishte shkëputur nga maja e plepave dhe e kishte zvarritur deri në burgun e gestapos... Ai kishte rënë në ëndërrime. Ai binte rrallë në ëndërrime. Dhe kjo ndodhë pa dëshirën e tij. Pastaj mendja i fluturoi

tek eëma, te Lumta, te shokët, te... dhe èndërrimet u ndërprenë...

Vonë, kur errësira dhe heshtja ranë kudo, në korridor u dëgjuan çapet e njohura. U ndez llamba dhe Kurti bëri ballë te pragu i derës. Që nga koha e ndërpërjes së torturave, Petriti sikur qe mësuar me ftyrën pa rrudha të Kurtit, si dhe me të qeshurën e tij pa vend. Po atë mbrëmje Kurti kishte ndër mend t'i këpuste edhe këto fije të fundit. Pasi kaloi pragun, që ndroi para Petritit, duke e shikuar nën vetulla. Me këtë Kurti paralajmëronte viktimën se kishte ardhur çasti për t'u futur në veprim kamxhiku, të cilin sakaq fillojta vërtiste në erë. Për të mbrojtur ftyrën, Petriti i ktheu kurrizin, mirëpo kësaj radhe kamxhiku nuk e goditi mbi supe, por në krah e në grushtin që mbante të myllur. Dicka ra nga dora e Petritit në dysheme. Kurti e kapi gjethen në majën e gishtave dhe, pasi e ktheu më dyshim mbarë e prapë, ia krisi të qeshurit. Pastaj:

— March! — e urdhëroi të dilte nga dhoma e të zbriste shkallët.

Përsëri në bodrum! Po sikur ta futnin në qelinë e mëparshme dhe mangalli me çelësat të ishin të pacënuar?

Me t'i shkelur këmba në pragun e njohur, Petriti e përfshiu qelinë me një vështrim të shpejtë. Gjithçka ishte si më parë, dërrasat dhe batanija, me përjashtim të mangallit, që s'ia zunë sytë gjökundi.

— Los! Los!<sup>1)</sup> — e shtyu me forcë Kurti.

Petriti ra përbys mbi dërrasa, duke ndier erën e sapunit dhe të pastërtisë. Dera e hekurt krikëlli dhe drifta u shua. Po ajo errësirë, po ajo-heshtje. Përderisa qelia ishte pastruar, do të thoshte se major Franci do të dukëj vetë së shpejti për ta torturuar personalisht, si në ditët e para. Ai s'pati kohë të mendonte gjatë, as të dëshpërohej për mungesën e çelësave, se Kurti u kthyte përsëri me mangallin në dorë, e vendosi në qoshe të qelisë dhe

---

1) gjerm. — Ik!

para se të mbyllte derën, tha tri fjalët e vetme që kishte mësuar shqip:

— Gjumë! Nesër dru! Kaput!

Me t'u larguar Kurti, Petriti zuri të kërkonte nëpër hirin e mangallit. Pas pak kërceu më këmbë me çelësat në dorë. Çdo gjë iu fshi nga koka, e gjithë qenia e tij jetonte pér një qëllim të vetëm. Përgjoi pas derës një kohë të gjatë dhe kur u bind se gjithçka ishte në rregull, futi çelësin në bravë. As vetë s'e kuptoi si u gjend aq shpejt para dritës së zbehtë të korridorit, si arriti të porta nga ana e kopshtit, brava e së ciles u hap pa e munduar. Por ja që kanatet e saj, megjithëse ai zuri t'i tërhiqte me forcë, s'lëviznin nga vendi, Kur gëzimi i Petritit ishte në kulm, kur dukej se gjithçka kishte mbaruar, ai parandjeu se s'ishte aq lehtë të shpëtonte nga vdekja. Pa humbur kohë e zuri përsëri dorezën me të dyja duart, mbështeti njerën këmbë pas murit, mblodhi gjithë fuqinë e vet, por pa dobi. Në këtë gjendje të ethshme kaluan minuta, mbase dhe orë, derisa pëllimbët iu gjakosën dhe fuqia iu pre fare. I mbytur në djersë u ul në çimenton e ftohtë të korridorit, duke vrarë mendjen pér të gjetur medoemos një rrugëdalje. Pasi e mori pák veten, ungirit, grisi mëngët e këmishës, mbështolli me to dorezën e portës dhe e mbërti heu me të dyja duart. Kaq shumë ta kishte lënë fuqia, sa të mos hapse dot një portë të ndryshkur? E mbështeti njérën këmbë në dysheme, tjetren pas murit, dhe zuri ta tërhiqte prapë. I thernin kyçet dhe herë pas here ndiente se si i shkëputeshin mishtë në krahët e në kurriz. Befas diçka lëvizi. Me sytë të mbyllur, me djersën çurg, që i përcëllonte plagët e trupit, ai vazhdoi ta tërhiqte, derisa u dëgjua një zhurmë e mbytur...

Për një çast Petriti harroi ku ndodhej.

— Shpëtova, — tha duke shikuar qiellin që shpohet nga yje të panumërtë.

— Shpëtova, — përsëriti dhe vrapi pa shikuar prapa.

Kaloi kopshtin e parë, të dytin dhe vetëm kur që larg rrezikut, ngadalësoi çapet pér t'u mbushur më frysë. Nga gëzimi u rrotullua rrëth vetes me krahe të hapur, ashtu

siç lozta kur ishte fëmijë, derisa iu muarën mendtë dhe u rrëzua mbi barin me vesë. Aty u kthyte mbarë e prapë, i mori erë tokës, futi gishtat në ujin e freskët të vijës që gurgullonte pranë, dhe... papritur mendja e tij u shkëput nga gjithçka që e rrethonte. Si do t'u përgjigjej shkëve, me ç'sy e faqe do të dilte përpara tyre? Po Lumtën, Lumtën ku e kishte lënë?

Pa ditur q'rrugë t'u jepte këtyre mendimeve, vuri re se këmbët po e çonin drejt shtëpisë së usta Dine Çelikut. Në kopshtin e fundit, kur s'e ndanin nga shtëpia veçse njëqind metra, Petritin e pushtoi po ajo dobësi që iu shfaq dy net më parë. U lëkund dhe u këput në tokë. Ngriti kokën dhe përmes ndriçimit të parë të agimit shikoi pullazin e njohur të shtëpisë së vogël, nën të cilin ndodhej Dana dhë dergjej Marku i plagosur. Ai duhej të ecte edhe pak, qoftë dhe duke u zvarritur. Dhe ashtu bëri. Një metër, dy, dhjetë, pesëdhjetë... derisa arriti te muri ku usta Dine Çeliku fshihite armët që ndreqte. Hoxhi disa gurë nga muri dhe nxori prej andej një pushkë. Mbase do t'i duhej të luftonte. Ai e merrte me mend çfarë do të ndodhëtë në mesditë kur të futej Kurti në qelinë e tij për t'i hedhur bukën e zezë, racionin e vetëm të ditës... Petriti u përpoq të përfytyronte pamjen e habitur të Kurtit në qelinë e boshatisur. Alarm! Po, ndoshta do t'i duhej të luftonte. Tashmë ai ishte i armatosur, dhe për më tepër ndodhej pranë shtëpisë së Dine Çelikut. Por duhej të ecte dhe pak. U ngriti. Kokën e ndiente të trullo sur. Pushka i rëndonte, këmbët i dridheshin. Padashur u shtri dhe me duart nervoze u kap pas truallit, si të pushtonte diçka të gjallë e të dashur. Donte të zvarritej... Por, ah... Dhe humbi...

Po atë mëngjes, Demir Tapia mori rrugën ngadalë për në avokatore. Ai kishte vendosur të bënte ç'ishte e mundur për ta shkëputur të birin nga thonjtë e gestapos. Ç'kërkonte më tepër ai qerrata majori nga një avokat i

ndershëm, që kaq qe bërë e s'mbahej mend të kishte turballuar ujët?! Dy herë i pat shkelur në prag dhe që të dy herët me duart plot, aq sa u bë vetë shkaktar që i biri dergjej në burg e s'dihej në ç'gjendje ishte.

Duke ecur nëpër pazar, avokat Demiri u bë pishman që kishte veshur kostumin e zi të festave dhe që kishte marrë bastunin e të atit me kokë prej sërmi. S'dihet se pse atë mëngjes trokitja e tij ritmike nëpër gurët e kall-drëmit i vriste veshët dhe i zgjonte një ndjenjë të rëndë.

Afër hanit të Muratit ai qëndroi pak i veçuar nga turma që shikonte në qiell një krahathatë dhe katër pëllumba. Grabitësi, pasi veçonte njërin nga viktimat, i lëshohej prapa me tërë vrullin e krahëve të gjatë. Pas çdo çasti largësia shkurtohej dhe aty poshtë turma shqetësohej kur shikonte se kthethrat e krahathatës ishin gati të binin mbi kokën e pëllumbit të lodhur. Por tamam në kohën kur dukej se i erdhi fundi duelit, njëri nga pëllumbat e tjerë u priste rrugën dhe befas zinte vendin e të parit. Krahathata humbiste drejtimin dhe lëshohej pas të dyt fit, që hynte në këtë betejë të pabarabartë, me fuqi më të freskëta. Kështu, atje lart në qiell pëllumbat zëvendësonin njëri-tjetrin, ndërsa poshtë në tokë, turma aty gjëzohet, aty pikëllohet.

— U kam dalë hakut me të ushqyer, — tha Murati që ishte bashkuar me njerëzit, shumica e të cilëve qenë fëmijë e rini.

— Murat, shiko Bardhoshin, sa hercek që është! — fliste usta Dinia me dorën mbi ballë për t'u mbrojtur nga rrezet e diellit. — Partizanët i janë afruar qytetit, — ia ktheu muhabetin me një pëshpëritje në vesh.

— Jo, more! — u çudit Murati. — E, që thua ti, Bardhoshit ia kam frikën. Mu në kthethra i futet krahathatës.

Usta Dinia shikonte në qiell, duke tundur kokën me keqardhje.

— Edhe unë ia kam frikën... Kështu, pra, turbullirë e madhe në mes të ballistëve. Thonë se po mbledhin ushtri për t'u rënë... E kapi laneti!

Murati vuri pëllëmbët mbi ballë dhe u ngrit në majat e këmbëve:

— Ah, jo! — tha. — Kur është puna pér dredha, Bardhoshi ia hedh krahathatës, — foli me bindje dhë, pasi shiko i anash, i pëshpëriti:

— Domethënë, ballistëve po u shkojnë të shtatat!

— A të ka ngrënë ndonjë pëllumb këtë vit krahathata? — e ndërroi muhabetin usta Dini nga frika se mos i dëgjonte njeri.

Murati u ngrit sérish në majat e këmbëvë dhe përpjui qielin me sy:

— Vjet. I pata të rinj. Axhami. S'dinin ta lodhnin krahathatën. Ajo iu lëshua njërit dhe s'iu nda, derisa e përfshiu nën kthetra. Po këtyre s'para ua kam frikën. Po shiko si ulen pas çdo rrëthi drejt çatisë së hanit? Kur-se Bardhoshi jep jetën pér shokun...

— Çudi, Murat! — ia preu fjalën Dinia. — Edhe shpesët i japid dorën njëri-tjetrit. — Dëgjo, — e uli përséri zérin ai, — sonte do ngremë Markun. Te buza e ullishtës na pret një skuadër partizane.

— A, sonte? — ia pat Murati duke i shkelur njërin sy. — Bre-e, bre, Dine! — bërtiti Murati. — M'u lodh një pëllumb.

Turmën e mbuloi heshtja. Tani që pullumbat ishin ulur, beteja në quell shikohej më mirë. Krahathata, duke ndier, me sa duket, fundin e përleshjes, iu lëshua më të dobëtit dhe, megjithë përpjekjet e pëllumbave të tjerë, ajo s'e humbi drejtimin. Iu afrova viktimës një pash... një pëllëmbë... një bërxhik...

Poshtë fëmijët zunë të thërritnin sa u hante zëri:

— Krahathatë t'u thaffshin krahët! Hu-hu-hu-hu-uu-u!

— Sa keq më vjen pér pëllumbin! — u dëshpërua Dinia.

Murati ngriti krahët drejt qielit dhe thirri:

— Ho-hoo-ho-ho-o-o-o!

Turma është rindjeve dhe e fëmijëve zjeu e gjëmoi një copë herë.

— Hu-u-hu-u-hu-u — hoooo!

• Tamaam në kohën kur kthetrat e krahathatës prekën

bishtin e pëllumbit dhe atje poshtë dajë Murati kafshoi buzët, Bardhoshi u lëshua pingul, mblodhi krahët dhe sa hap e mbyll sytë, u përplas mbi kurrizin e krahathatës. Pastaj s'u muar vesh q'u bë në qiell, po kur tre pëllumbat e tjerë u zhytën drejt çatisë së hanit, krahathata hodhi kthetrat e saj në puplat e bardha të Bardhoshit.

Poshtë, me të mëdhenj e me të vegjël, zunë të thërritnin me sa kishin fuqi:

— Hu-hu-hu-hu-u-u-u! — Ushtima përhapej dhe njerëzve u dukej se ajo shkonte deri te krahathata, që bënte herë pas here lëvizje të panevojshme:

Në këto e sipër krahathata dhe Bardhoshi, lëmsh njëri me tjetrin, dolën kundrejt rrezeve të diellit dhe asnjeri nuk shqoi se q'po ndodhë lart. Pas pak, Bardhoshi u pa të lëshohej drejt tokës. Krahathata, e trembur nga thirrja e bashkuar e njerëzve, pasi bëri një rrötullim mbi çatinë e hanit, u ngrit përpjetë si njollë e zezë, pastaj u bë sa një pikë, derisa u tret fare në kaltërsinë e qiellit.

Kur fëmijët sollën nga bahçja Bardhoshin të gjakosur në krah, Murati e mori pëllumbin në dorë, e fërkoi dhe e puthi në sqepin e vogël, Bardhoshi, pasi shikoi turmën me sy përpëlitës, u tulat, duke fshehur kokën nën mustaqet e gjata e të dendura të Muratit.

— Shiko si i rreh zemra, — foli ai.

— Me shpir! — ia ktheu usta Dinia duke i vënë dorën nën gushën e bardhë, ku dukeshin ca cirka të kuqe gjaku.

— Dajë Murat, a do shërohet Bardhoshi? — pyeti njëri nga fëmijët.

— Mos kini merak për Bardhoshin. Hajde çuna, shpérndahuni, se na vijnë gjermanët.

Murati dhe Dinia u futën në han të shoqëruar nga vështrimi i patrullave gjermane në qoshe të rrugës.

Sheshi i vogël u zbrazi, njerëzit ikën secili në punë të vet, vetëm Demir Tapia, i mbështetur pas bastunit, mbeti edhe pak rrëzë murit.

— C'bëj këtu? — pyeti me zë, duke ardhur në vete.

Në rrugën e spitalit, avokat Demirit i zunë sytë një të

vdekur, tē hedhur mbi karrocën e plehrave tē bashkisë. Rrotat e palyera tē karrocës sē vjetër krikëllinin. Patkonjtë e liruar nxirrnin një tingull tē mbytur; kolla e karrocierit plak, tek hiqte kalin pér freri, ngjante sikur mallkonte tē vdekurin, që s'i kishte lénë vend ku tē ulej. Kufoma, e mbuluar me pëljurë tē zezë, dridhej sa herë që rrotat me qemer hekuri binin nëpér gropat e kall-drëmit. Kur i vdekuri i kaloi pranë, padashur sytë e Demirit u mbyllën pér tē mos parë këmbët e zbuluara, ku s'kishin mbetur veç kockat dhe lëkura. «Sa këmbë tē vogla, si tē Qamilit tim!» psherëtiu avokati dhe njëkohësishët pështyu në tokë, phu, pér krahasimin e padëshirueshëm. Shau veten dhe u mat t'i lëshonte zë karrocierit që t'iash trinte pëljurën kufomës, mirëpo vështrimi i qetë i syve tē përgjumur tē plakut i dha tē kuptonte se pér atë kjo ishte një gjë fare e rëndomitë, njësoj si tē hidhët një barrë pleh jashtë qytetit. Sa tē mjerë vdisnin në botë pa njeri tē afërt mbi kokë? Sa kufoma tē tilla kishte çuar në varreza ajo karrocë? Por atë ditë nuk dihej se pse Demir Tapisë iu duk se jo vetëm kufoma, por i gjithë ekuipazhi po bënte rrugën e tij tē fundit e po shkonte në varr me këmbët e veta. Edhe plaku me kurrizin tē dalë që i gufone nga kolla, edhe karroca me krikëllimën e shëmtuar, vetë kali, tē cilit i numëroheshin fijet e brinjëve, i merreshin këmbët, dhe tē dukej sikur ja, qafa e hollë do t'i këpütej e koka do t'i binte përtokë.

Me këto përshtypje, Demir Tapia ngriti kapelen me një respekt tē dyfishtë pér t'i bërë nderimet e fundit funeralit tē varfër. Pastaj, me ndishmëri e bastunit u capit ngadalë, si tē donte tē numëronte hapat e veta: tak-tak-tak.

Demiri po bënte çudi me vete; pas kufomës që pa në rrugë, as vetë nuk e kuptoi se si shkoi deri në avokatore dhe u ul përpara tavolinës. Po me atë pavetëdije hapi dosjet e gjyqeve më tē afërtë. Çështja e pyllit tē shushicarëve. Ai qe bindur me kohë se pylli u përkiste atyre, por në tē vërtetë gjyqin do ta fitonte Kareman bez Cërla. Avokatit i doli para syve një flori pesëbashkë.

Premtimi. Ja dhe një dosje e fryrë që kishte të bënte me një gjyq dhjetëvjeçar. Më në fund tregtari i madh Bim Hirra, që ngrihej kundër Dullë aga Festekut, e kishte ngritur ryshfetin në njëzet napolona flori. «E gëzofsh!» tha me zë avokat Tapia. Ishte dhe një dosje tjeter, që fliste për dy fukarenj që haheshin për një mur. Demir Tapia s'u kishte mësuar akoma emrat. Pa dale, si i quajnë? Kroj kokën dhe lexi. Njëfarë... Selmani... Selman... dreqi... dhe një Hamit... Hamit... shejtani... Të shkretën. E kush u futej atyre materialeve e vocërrimave për një mur?.. Të shkretët! Do t'ua ndante përgjysmë!.. Këto ishin tri proceset më të afërta. Dosjet e tjera ishin të panumërtë, por ai s'para kishte kohë të merrej atë ditë me to. Por, duke parë tërë ato dosje... pra... tërë ata florinj... gjithë ato mundësi të fitimeve pa mundim, Demir Tapinë e pushtoi prapë dëshpërimi për gjendjen në të cilën ndodhej ai dhe i biri. Pa e bërë të gjatë, i futi dosjet dhe aktet në vendin e tyre dhe zuri tëmthat me grushte. Cfarë avokati mbrojtës ishte ai, kur s'mbronte dot as të birin? Demir Tapisë s'i hiqeshin nga mendja beteja e pëllumbave dhe këmbët e vogla të kufomës, të thara, pa pikën e gjakut. Pëllumbat shpëtuan, sepse qenë katër kundër një krahathate, po i biri, që ishte një i vetëm në mes të krahathatave të panumërtë? C'i duhej jeta atij, kur të birit t'i thaheshin këmbët si të të vdekurit që pa sot? A s'kishte ardhur koha të harxhonte fishekun e fundit?.. Po, sot ai do të shkonte te major Franci e do t'ia priste shkurt: më jep çunin që e kam si pëllumb të butë, të të jap një komunist të vërtetë. «Fundit i fundit, jeta e Qamilit, si trashëgimtar i gjithë asaj pasurie, — mendonte ai, — do të gëzojë zemrën e një babai të zhuritur, kurse për Markun, që është i vetëm në botë, s'ka kush të gëzohet dhe të hidhërohet!» Avokatit i erdhi pak keq për Dinen që do ta pësonte në pleqëri, pa çka, për fukarenjtë, që përveç gjithë kusureve të tjera kanë mbetur edhe të pamartuar, s'para ka lezet jeta kur të rëndojnë mbi shpatulla gjashtëdhjetë vjet. Me kapelen në dorë e me bastunin të varur pas qafës,

Demir Tapia doli nga avokatorja, kur dielli qe ngritür dy pash mbi Krastën e vogël. Megjithëse përpinqej të mbahej gjakftohtë, hapat e tij herë shpejtoheshin, herë ngadalësoheshin. Mos vallë edhe kallëzimi i tretë, ashtu si dy të parët, do të binte po mbi kokën e të birit, e do ta fuste thellë e më thellë në atë bodrum vdekjeje?!

Me mendje të shqetësuar për të kërkuar rrugëdalje, Demir Tapisë i dha zemër një shprehje e Jul Qezarit, që kishte imbetur e paharruar në histori... Në kohën e triumviratit, senati, i nxitur nga Pompeu, urdhëroi Qezarin të shpërndante ushtrinë e të kthehej në Romë. Buzë lumi të vogël Rubikon, që ndante kufirin e Galisë me Italinë, komandanti ushtarëk ra në mendime për një kohë të gjatë. Më në fund ai vendosi të mos i bindej sennatit, por ta shpartallonte me luftë e të vendostë push-tetin e tij. Ngriti duart lart dhe urdhëroi kapërcimin e lumi kufitar, duke thënë:

— Alea jacta sunt!<sup>1)</sup>

— Kurse unë, — mendonte për vete Demir Tapia, — do të kisha bërë punë me nder sikur të mos isha përzier fare me gjermanët, por tanë që e nisa, duhet ta çoj deri në fund. Aty ku shkova dy herë, do shkoj edhe të tretën!»

— Alea jacta sunt! — tha me zë avokati, kur shkeli nië prag të gestapos.

Në qendër të qytetit usta Dine Çeliku i vuri krahët murit, si shumë të tjera, dhë shikoi në heshtje kolonë e gjatë gjermano-balliste, që marshonte në ritmin e trumbetave.

Në krye të kolonës ecnin komandantët e Ballit: Ka-

1) Lat. — u hoq shorti! (ad lit. zaret u hodhën!)

reman bei Cërla, major Alush Leshi dhe kapiten Xhafer Pala. Me kilota lëkure e torba të vogla elegante në kurriz, ata të linin përshtypjen sikur po niseshin për gjah e jo në luftë. Nga prapa u shkonin ordinancët, duke tërhequr për freri kuajt e harbuar. Aty ku mbaronte kolona e ballistëve, fillonte batalioni gjerman, armatosur i tëri me automatikë e mitralozë të lehtë. Në fund zgjatej vargu i mushkave, të ngarkuara me arka municipesh e mortaja. Kolonës i vinin kapak dy topa të vegjël, që tërhiqeshin nga mushka të mëdha e fort batalle përrugët e maleve tonë. Topat u bënë shkak të hapej biseda në mes të sehirxhinjve:

— E ku i çojnë ato rrotavile? — pyeti një burrë i thyer në moshë.

Një tjetër, pasi shikoi me bisht të syrit, foli me zë të ulët, por pa e fshehur tonin thumbues:

— Demek, muarën fund partizanët!

— Lëre mos e pyet!

— Si në kohën e italianëve!

— I re në pikë. Sa herë u shkatërruan atëherë partizanët? — pyeti zëri i parë.

— S'e mbaj mend! — u përgjigj një tjetër.

— E ç'të mbash mend. Shtatë herë në javë. A të kujtohet sulmi i madh i italianëve, kur partizanët u shfarsën të gjithë? Mirëpo, sapo italianët u kthyen me trumbeta, partizanët u ngjallën përsëri dhe çatisën tek ura «paf», «puf»...

— E keni parë fon Gutmanin si kapardiset në makinë?

— Atë gjatovinën?

— Po.

— Pse pyet?

— Ka shpallur se së shpejti do të fillojë një operacion të madh kundër partizanëve.

— Do të shkojë vetë në Malet e Shqipes.

— Gjynah. Do të marrë reumatizmën.

— Hi-hi-hi, — u dëgjua një e qeshur.

Edhe ato fjalë, edhe e qeshura e fundit, u dukën të tepruara aty në rrugë. Disa zunë të shpërndaheshin

(se edhe kolona qe larguar), të tjerë vazhduan të bisedonin me zë të ulët:

— Topat le t'ia futin Kareman bej Cërlës nga prapa, se nuk është dëgjuar të eci topi me rrota nëpër rrugët e dhive!

— Hajt se gjermanët nuk ua dinë maleve tonë, po ballistët?

— Ballistët? Se mos kanë luftuar maleve ata! Sapo kalojnë urën e Shkumbinit, ia futin kulturum pyjeve, bam, bum.

— Demek, hapni rrugën, se po vijnë trimat!

— Për të ngrënë pula!

— Cilët?

— Hajde, xhani i vëllait, të ikim.

— Pse, keq e ke. Me ujin, me qeverinë e me zjarrin s'bëhet shaka!

— Ha-ha-ha! — Me këtë të qeshur biseda mori fund dhe secili shkoi në punë të vet.

Edhe usta Dinia, me zemër të shtrënguar, e mbajti çapin drejt shtëpisë. «Po shkojnë të kafen me partizanët, — mendonte ai duke ndier një peshë të rëndë në gjoks. — Qafën thefshin! Mos harroni se atje ju presin Skënder Shpata, Spiro Shtegu, Fon Zabeli e qindra të tjerë. Këto duar u kanë ndrequr pushkë e automatikë. Apo s'i kanë mitralozat çunat, që hej!» Në një qoshe rruge, usta Dinia qëndroi dhe pyeti një çunak se çfarë shkruhej në shpalljet e porsangjitura në shtyllat e elektrikut. Kur i tha çunaku se gjermanët do të pushkatonin në vend të gjithë ata që do të strehonin partizanë, ustai as që u kujtua se edhe ai vetë ishte një nga ata që strehonin komunistë. Mendja e tij kishte fluturuar te çunat e malit. «Mos ndodhtë ndonjë hata, sidomos me komandantin e kuq, me atë Spiro Shtegun, që është fort i hedhur në luftë!» fliste me vete.

Kur kaloi pranë hekurpunuesve, usta Dinia e ngadalësoi çapin. Vëmendjen e tij e tërhoqi një farkëtore e vogël në krye të rrugës. Kovaçi, një burrë i madh e

leshator, e vërviste çekanin me teflik duke lëshuar një «eh» të fortë, kurse një çunak i zbatbur e thatim, me kokën që i dilte paksa mbi kudhër, shtrembëronte ftyrën nga frika se mos i shpëtonte nga duart dara që mbante një kazmë të skuqur. Por çunaku vuri re se dikush qëndroi në rrugë dhe po e shikonte, atëherë puthiti buzët dhe përbysi vetullat e zeza, duke i dhënë ftyrës së tij të njomë një pamje të rëndë. Megjithë përpjekjen që bënte pér të treguar se gjoja atë punë e kryente me lehtësi, prapëseprapë, kur çekani i kovaçit binte mbi kudhër, ftyra e çunakut shtrembërohej dhe padashur thembrat e këmbëve i ngriheshin nga toka.

Usta Dinia nuk deshi t'u ndërpriste punën, por, kur u ftoh kazma dhe kovaçi e futi në prushin e gjyrykut pér ta skuqur përsëri, atëherë i lëshoi zë që nga mesi i rrugës:

— Cen! O Cen!

Kovaçi ktheu kokën dhe me të parë Dinen, vuri buzën në gaz:

— Bujrëm, usta, bujrëm!

— Ejvalla, Cen, s'kam kohë. Do iki, se edhe mua më pret puna. Por shiko, hap sytë... e ke të vogël çunin pér kudhër.

Kovaçi buzëqeshi përsëri, duke zbuluar dhëmbët e bardhë në lëkurën e zezë, që shkëlgente nga djersa.

— Në zemër më pikon, usta, po q'të bëj, kam nevojë pér krah pune. Ka ardëhur kohë e keqe fort, ta vrasësh lekun e s'e gjen dot.

— Jo, mirë, si ta dish, po veç sytë, se mazallah... fëmijë i thonë!

Mbi kudhër ra përsëri çekiçi dhe usta Dinia, pasi shikoi pér herë të fundit çunakun, që shtrembëroi trupin dhe ngriti thembrat nga toka, u largua duke murmurit me vete:

— I paska hyrë në qejf puna. Do bëhet punëtor i mirë!

Vëtëm kur s'u dëgjua më zhurma e çekanëve të kovaçëve, atëherë usta Dinia e shpejtoi çapin drejt shtëpisë, me mendjen te Marku. Në mbrëmje, sa të errësohej, do t'ua dorëzonin partizanëve që pritnin te ullishta.

Për herë të parë prej kaq ditësh, Demir Tapia u gëzua nga fjalët e mira e premtuese të major Francit. Ai e priti me buzën në gaz, si të donte t'i kërkonte ndjesë për sjelljen e tij të egër në takimin e fundit. Pyetjes së Demirit: «Wie geht es mein Sohne?»<sup>1)</sup> ai iu përgjigj: «Ihr Sohn ist wie eins Taibel!»<sup>2)</sup> Kjo përgjigje vërtet i kujtoi krahatatën, që sapo plagosë pëllumbin e Murat hanxhiut, por kësaj radhe, s'dinte se pse avokati ndjeu nevojë të domosdoshme t'i besonte sinqeritetit të majorit, i cili i premtoi se me të kapur komunistin e plagosur në shtëpinë e armëtarit të kuq, do t'ia lironë çunin menjëherë. Bile ai do t'ia conte vetë në shtëpi me makinë dhe zotit avokat s'i mbetej gjë tjetër veçse të qetësohej, pasi shumë-shumë në mbrëmje çunin do ta kishte në gjirin e familjes....

Duke shkuar në shtëpi për pushimin e drekës, Demir Tapia mendoi edhe një herë se kishte bërë mirë që kishte shkëmbyer Markun jetim, me të birin trashëgimtar. Me të dalë prej gestapos, turbullira që i kishte pushuar kokën, sikur iu shpërndi.

Me shpirt të lehtësuar kapërceu pragun e portës, i ra përqark oborrit dhe Demirit iu plagos zemra, kur pa trëndafilat që po veniteshin para kohe. Me sa i kujtohej, vitët e kaluara ata patën kundërmuar deri në mes të nëntorit! Apo s'kanë një bukuri trëndafilat në vjeshtë!

---

1) Gjerm. — Si e kam djalin?

2) — Djali juaj është si pëllumb.

Vetëm erë s'para mbajnë dhe, sadopak t'i prekësh me gisht, u bien menjëherë petalet. Vjeshtë! Sidoqoftë! Pa e bërë të gjatë, Demiri vari kapelen dhe bastunin në sallon dhe, siç qe në kostumin e zi, mori teneqenë për t'i ujitur. Asgjë tjetër s'i duhej më, veç t'i kthehej në shtëpi djali trashëgimtar, pastaj e dinte vetë ai q'do të punonte me lulet vitin e ardhshëm: s'do, linte pëllëmbë pa mbjellë. Kurse në pyeçi për politikën, ai qe betuar të mos merrij kurrë: më, kurrë më!...

Tak-tak-tak, trokiti lehitë portax s'i t'i binte një dorë fëmije.

Demir Tapisë iu drodh zemra.

— Çuni! — foli me zë. — Ma kthyen çunin!

Përplasi teneqenë me ujë në mes të oborrit dhe gjithë ai trup i ngjallur u hodh matanë si top llastiku. Po me atë vrull hapi derën, mirépo në vend të të birit, pa varrmihësin e varrezave.

— Q'do? — e pyeti me padurim.

Varrmihësi, i ngrysur dhe i pikëlluar si zanati i vet, pasi shikoi rretheqark, i pëshpëriti në vesh:

— Shëndoshë vetë, efendi! Kështu e kanë këto punë. Kur të erret, eja, se ta tregoj unë gropën e çunit...

Demir Tapia pushtoi kokën me duar dhe para syve iu shfaqën këmbët e vogla e të thara të të ydekurit që pa në mëngjes. Vallë të kishte qenë i biri në karrocën e plehrave?

— Kush e vrau çunin tim?

Varrmihësi ngriti sytë dhe i hodhi avokatit një vështrim të ftohtë e të qëtë:

— Mblidh mendtë, efendi!

Avokati, pasi murmuriti diçka me vete, befas ra më gjunjë para këmbëve të varrmihësit. Koka i gjëmonte dhe një zë i brendshëm e akuzonte vazhdimisht:

«Ti vetë je vrasësi i birit tënd!»

— Unë vraya tim bir? — pyeti ai.

— Ta vranë gjermanët. Sot në mëngjes ma sollën me karrocën e plehrave!

Avokat Demiri u hodh mëkëmbë, largoi varrmihësin dhe ia pat në rrugë me një britmë të fortë:

— Unë e vrava tim bir?

Një laraskë që po çukiste në mes të rrugës, u ngrit nën këmbët e tij dhe, pasi i fluturoi mbi kokë, zuri vend në majën e shtyllës aty pranë. Nën rrezet e diellit të mesditës rruga ishte fare e shkretë dhe veç atje te kthesa u dukën helmetat e dy patrullave. Demir Tapia zbërtelu sumbullat e xhaketës, la këpuçët në mes të kall-drëmit dhe mori vrap duke thirrur:

— Unë e vrava tim bir?

Laraska, që bënte sehir nga maja e shtyllës, tundi bishtin:

— Kra-kra-a.

Varrmihësi rrëmbeu një gur:

— M'u shporr prej aty! — i briti duke ia vërvitur gurin me tërë fuqinë.

Nga larg dëgjohej klithma e Demir Tapisë:

— Unë e vrava tim bir?

Laraska mori përpjetë qiellit:

— Kra-kra-a.

Dielli shkëlgente mbi rrugën e shkretë. Qyteti heshtte. Varrmihësi, duke tundur krahët e gjatë si lopatat që kishte mbajtur tërë jetën, hoqi këmbët zvarrë për të qenë në krye të detyrës...

\* \* \*

Pa hedhur hapin e dytë në oborrin e shtëpisë, Dana i doli përpara:

— Dine! Marku!

Dine Çeliku u fut në dhomën e zjarrit dhe u ul në qoshe të minderit. Marku hapi sytë; shikimi i tij donte të thoshte: «Gjallë, jam!» Usta Dinia kryqëzoi duart dhe tundi kokën, pa qenë i zoti ta ndihmonte në këto çaste të vështira.

Fqinja zuri t'i zgjidhje lidhëset e plagës. Marku u përpëlit nën dhembjet e forta; për të tretën herë gjatë ditës nuk u përmend një kohë të gjatë. Fqinja i hodhi të sëmurit ca pika uthull në hundë, i njomi ballin e buzët, derisa ai erdhi në vete.

— Duro, bir, — i murmuriti ajo. — Duro! — I zgjidi fashat që i pat vënë doktor Besim Kodra pesë ditë më parë. Gjoksi i Markut qe nxirë, kurse vendi përreth plagës së plumbit qe enjtur.

— S'ka rrezik! — murmuriti fqinja. — Si plaga e partizanit vitin e kaluar. Por i duhet shtrydhur.

Me të dëgjuar këto fjalë, Marku hapi sytë.

— Kushedi kur kthehet doktori nga Malet e Shqipes. Marku u mendua, pastaj tundi kokën:

— Jepi, nënë!

Pasi lau duart me sapun, fqinja ra më gjunjë.

— Mos ki frikë, — murmuriti. — Kur e pa doktori partizanin që shpëtova vjet, më tha: «Të lumtë, se ia paske bërë hyzmetin!»

Fqinja nisi t'i shtrydhte plagën ngadalë, pastaj i mëshoi papritur. Marku s'u bë i gjallë. Dana doli përashta e ligshtuar.

Fqinja e shtrydhi plagën si mundi, pastaj ia lidhi me fashat e një çarçafi të pastër. Me të ardhur në vete, Marku ndjeu lehtësi. Usta Dinia rrrotullonte qeleshen e bardhë nëpër duar, pa e hequr vështrimin nga fytyra e tretur e Markut. Befas u ngrit.

— Do shkoj të shoh se mos është kthyer doktori! Pa të s'mund ta çojmë as në ullishtë, të partizanët.

— Mos u vono! — i lëshoi zë Dana.

Një copë herë në dhomën e vogël s'pipëtiu gjë. Të dyja gratë dukej sikur i kishin vënë veshin heshtjes së mesditës, që pllakoste qytetin.

Pas një ore, në afersitë e shtëpisë u dëgjuan krisma dhe britma. Në oborr Dana u ndesh ballë për ballë me usta Dinen.

— Ç'të ngjau?

— S'eci dot, Danë. Më plagosën. Po na rrrethojnë.

— Marku! — klithi ajo.

Fqinja doli si hije te dera dhe mbeti me një këmbë në prag, me një këmbë në dhomë. Përtej, në rrugë britmat sa vinin afroheshin.

Duke u mbajtur pas murit edhe Marku doli në hajat me revolen në dorë.

— Mos u tronditni! — foli ai me zë të dobët. Po me të hequr duart nga muri, që në çapin e dytë u pengua dhe ra pa ndjenja.

Dana i futi duart nën kurriz. Kur e ngriti peshë, trupi i dobësuar i Markut nuk i u duk i rëndë.

— Dine! Nga të shkojmë? — pyeti ajo.

Një shkëndijë shprese ndriçoi trurin e shushatur të usta Dines.

— Nga kopshti, Danë!

— Dine, po ti? — pyeti fqinja kur po kaptonte derikën për t'i ardhur në ndihmë Danës.

— Markun shikoni. Humbitni gjurmat nëpër kopshte. Kur të erret lajmëroni Vasil Gjinarin dhe Murat hanxhiun me të bijën. Në ullishtë ju pret një skuadër partizane.

Usta Dinia doli nga magazaja me pushkën e Maleve të Shqipes. Porta e rrugës u tund nga shkelmat e nga goditjet e kondakëve. Usta Dinia as që e ktheu kokën prapa. Duke ecur anës së kopshtit, më në fund u shtri pas një soipi me dhë, përballë murit të rrugës.

Dana me Markun në duar, po vërtitej e hutuar për të hedhur kapërcyellin e kopshtit, mirëpo të dy herët që u përpooq të, njitej, u kthyje prapë në vend e pafuqishme.

Dinia donte t'i thërriste që ta merrte më shtruar e të mos ngutej aq, bile të pushonte diku për t'u çlodhur, mirëpo zëri i tij nuk shkonte deri në fund të kopshtit. Nga çasti në çast ai ndiente t'i shterrej gjaku, t'i shtohej e ftohta e t'i rëndohej koka si nga një pagjumësi e thellë. Herë pas here, ai hapte e mbyllte sytë vetëm e

vetém pér tē provuar nëse shikonte akoma. S'kaloi një minutë, kur shtëpinë, kopshtin dhe lagjen i mbuloi një heshtje e rëndë. Mbi kokën e Dines dëgjohej fëshfëritja e gjetheve të mushmullës që kishte lidhur pér herë tē parë atë vit. «S'i zura dot fill!» murmuriti i bindur pér fundin që e priste. U ngrit më gjunjë dhe ia bëri Danës me shenjë tē hidhte kapërcyellin, pasi gjermanët kishin thyer portën dhe qenë futur në oborrin e shtëpisë. Dana u ngrit me Markun. Ndërkokë, në tjetgullat e murit pérballë u duk një helmetë. Gjermani u hodh në kopsht dhe u çap duke shikuar rretheqark me sy tē trembur. Dinia u platis pas sopit me dhe, i hoqi sigurecën pushkës dhe priti se mos gjermani ikte vetë. Më se dyzet vjet që ndreqte pushkë e vinte nishane, por s'mbante mend tē kishte vrarë tē paktën një zog. Ndërkokë gjermani, me tē diktuar Danën majë kapërcyellit, ngriti automatikun:

— Alt! — thirri.

Dine Çeliku mbeti me gisht në këmbëz. Në rrëmbim e sipër Dana ngeci te maja e kapërcyellit e Marku po i rrëshqiste nga duart. Gjermani thirri përsëri:

— Kom! — dhe kësaj radhe i ra sigurecës gati pér tē shtënë.

Atëherë usta Dinia mbështeti faqen në kondakun e lëmuar tē pushkës, ashtu siç bënte çdo ditë në armëtore, mblodhi në një pikë tē vetme ballin e gjermanit, thepin dhe shënjestrën, mbajti frymën dhe, para se tē tërhiqtë gishtin pér tē dërguar plumbin në nishanin e pagabue-shëm, murmuriti:

— Mbeç me shëndet!

Gjermani s'bëri as gëk. Veç zuri ballin me dorë dhe u shemb përmbyss mbi automatikun e vet.

Usta Dinia mbështeti përsëri faqen mbi kondak dhe mbylli sytë e vegjël, që s'e humbitnin kurrë butësinë dhe getësinë e tyre. Megjithëse trupi i qe bërë si copë akulli, befas veshët e tij dëgjuan përsëri zhurmë në kopsht. Fshiu sytë e veshur si me perde dhe mu aty afër kapërcyellit pa tē rendte një eses tjetër.

Dana, që ishte gati për t'u hedhur matanë, u mbër-thye në majë të kapërcyellit, duke mbuluar Markun me trupin e saj të madh.

— Alt! — thirri gjermani dhe iu kërcënuar me gry-kën e automatikut që të zbriste poshtë.

Dana qëndroi një hop në dilemë, por kur pa se gjermani mori shenjë, u mblodh gërmuq mbi trupin pa ndjenja të Markut.

— Mbeç me shëndet! — murmuriti përsëri usta Dine Çeliku dhe plumbi i pagabueshëm sharroi ajrin me fish-këllimë.

Kaq, pastaj Dana kapërceu matanë; kopshti gjëmoi. Kokrrat jeshile të mushmullës zunë të binin mbi kurrit të ustait. Dy plumba e fshikën në qafë e në faqe. Por ai i tretur në shenjë, tërhoqi përsëri këmbëzën...

...Në mes të kopshtit tjetër, Danës iu pre fare fuqia. E vuri Markun në tokë dhe u ul pranë tij duke dëgjuar si në kllapi zërin e fqinjës, tek i thërriste shoqes.

— Shpejt, moj, dërgo çunin të thashë, se po na katin Markun!

Kur hapi sytë, Dana pa shijen e një trupi të gjatë.

Djaloshi, nga ata që s'i kanë rënë akoma faqes me brisk, pasi largoi balluket nga balli, e ngriti peshë Markun me aq lehtësi, sa Dana e pa të nevojshme ta porosiste:

— Kujdes, se e kemi të dobët Markun.

— Nënë, pas meje! — tha djaloshi.

— Të paça bir! Të paça bir!

Krismat që u dëgjuan aty pranë, e zgjuan Petrit Gurajn nga gjendja e rëndë që e pat pllakosur. Para së gjithash ai u zvarrit drejt vijës së ujit. Piu derisa shoi etjen, pastaj shikoi i çuditur në pasqyrimin e tij një ftyrë të huaj e të panjohur plot plagë. Vetëm flokët ishin po ata të parët: të gjatë, të zinj e dallgë-dallgë, por edhe ata i qenë ngatërruar. Padashur, Petritin e rrëmbeu dëshira e dikurshme për t'i krehur. Ngriti dorën të merrte

krehërin në xhepin e vogël të xhaketës, por... vuri bu-zën në gaz i hidhëruar dhe menjëherë në trurin e tij të turbulluar lindi pyetja: «C'janë këto krisma pérreth shtëpisë së usta Dines?!» Pa e bërë të gjatë u ngrit dhe eci pérpara me pushkën në krah.

Ndërsa po përgjonte pas një gardhi, Petritit i zuri syri një grup esesësh, të cilët kapërcyen murin e rrugës dhe, me breshëri automatikësh, ranë në kopsht. S'kaloi një minutë dhe ja, njëri nga esesët ra përmbytës... pas pak edhe një i dytë. Nga ana tjetër e kopshtit, përballë Petritit, dëgjohej krisma e një pushke. «Usta Dinia!» mur-muriti duke mbajtur vesh gjëmimet e pushkës. Pikkërisht në këtë çast ai shqoi nënë Danën tek vravonte pas një çunaku, që mbante në krah Markun. Thirri:

— Danë! Danë!

Por breshëritë e pandërprera të automatikëve, ia mbytën zërin.

— Danë! Danë! — thirri më fort.

Atje përtetje Dana qëndroi një hop dhe mbajti vesh, por në vend të fjalës «Danë», kësaj radhe ajo dëgjoi thirrjen e feldfebelit, që pasi kishte kapërcyer gardhin i pari, po i ndiqte me revole në dorë.

— Alt! Alt!

Dana vrapi përkrah çunakut që mbante Markun, por feldfebeli shpejtoi çapet duke shtënë nga larg:

— Alt! Alt!

U bë e qartë se e ëma bashkë me Markun e çunakun nuk do t'i shpëtonin dot feldfebelit. Koha s'prioste. Hoql pushkën nga supi dhe shënoi. Pas krismës feldfebeli ra në tokë.

— Largohu! — i thirri Petriti çunakut që mbante Markun në krah.

Dana klithi:

— Petrit!

Ai u zvarrit drejt feldfebelit që përpëlitez akoma, i shkuli nga duart automatikun dhe iu kthyse s'ëmës:

— Danë! shko pas Markut!

Por ajo instiktivisht i erdhë pranë. Të dy, nënë e

bir, hodhën shtegun kur e lehura e një qeni, ca britma e të shtëna po dëgjoheshin gjithnjë më afër. Ndërkaq, çunaku me Markun e me fqinjën qenë zhdukur. S'kishte rrugë më të shkurtër për ta, sesa të kapërcenin dy kopshtet që i ndanin nga Žaranika e të hidheshin në ullishtë. Po, a mund të ishte e hapur rruga nga ajo anë? A s'e kishin rrethuar lagjen gjermanët? C'ishin gjithë ato krisma, gjëmimë motorësh e tankesh që kishin pushtuar qytetin?.. Kështu, me vetëdije të plotë për këtë rrethim, ata u nisën ngadalë në drejtim të ullishtës.

— Të paskan copëtuar! — u çudit Dana.

Petriti mundohej t'i mbulonte plagët e gjoksit me cepat e këmishës. Nga pas ai linte një vragë gjaku sa herë shkelte mbi bar.

— Qafirët! — shau ajo.

Dhe, për ta ndihmuar të birin, i mori pushkën dhe e hodhi në krahun e vet.

— C'do të bëjmë?

Petriti nuk i përgjigjej. Ai u pendua që e thirri. A s'do të qe më mirë sikur ajo të mos e kishte parë fare e të kishte shkuar pas Markut? Në qoftë se ishte fjala për të vdekur, le të vdiste vetëm e jo në sytë e saj! Ah!.. Ai s'kishte më fuqi të ecte! Dhe e lehura e qenit sa vinte afrohej.

— Danë! Ti fshihu gjékundi. Unë do ta çaj vetëm rrethimin.

— C'flet kështu, Petrit!

Të zënë për dore, duke mbajtur njëri-tjetrin, çanë ngadalë përmes kopshtit të fundit, po kur dolën te gardhi, panë se atje dikush bënte roje.

— Danë, ktheu prapa. Lermë vetëm. Pa ty e çaj më lehtë rrethimin.

Aty nënë Dana e mori me mend ç'e priste të birin. Ajo s'gjeti asnijë fjalë për t'i thënë; tmerri ia kyçi gojën.

Të lehurat e qenit dhe britmat e një gjermani u dëgjuan pranë. Në këto e sipër qeni kapërceu gardhëin dhe iu hodh Petritit në gjoks, por ai i shkruhu një plumb

automatiku në kokë, kapi t'ëmën pér dore dhe bashkë me të u struk pas trungut të një arre.

Diku, aty përpara, dëgjoheshin britma dhe fjalë në gjuhë të huaj. Ata po vinin. Dhe ata ishin shumë. Ja helmetat e tyre. Petriti shënoi. Po para se të tërhiqte këmbëzën, aty pranë tij u dëgjua një krismë. Ai ktheu kokën. Po ç'të shikonte. E ëma me pushkën të mbështetur pas trungut, po i rrotullonte llozin pér t'i futur pushkës plumbin e dytë.

— Kështu, Danë! — u çudit Petriti.

Po Dana ishte platur e tëra me fytyrën të shtrem-bëruar nga që me zor mbyllte syrin e majtë pér të vënë nishan.

— Hajde, pra, Danë, bëjmë luftë! Të mbrojmë edhe çunakun me Markun, — tha ai i mallëngjyer dhe shkrehu automatikun.

Pushka e Dine Çelikut u dëgjua edhe pér ca kohë. Pastaj heshti. Dinia i ndjeu një pér një plumbat. Ata e shpuan në supe, në krahë, në shpatulla, në gjoks. Ai mbështeti faqen mbi kondakun e lëmuar të pushkës dhe..

Kur pushka e Dine Çelikut kishte heshtur, të dy, ëmë e bir, të zënë pér dore, kapërcenin gardhin e kopshtit të fundit...

## *Kapitulli i katërmëbëdhjetë*

### **MAJA E SELVISE**

Pas arratisjes së Petrit Gurajt nga burgu, komunitat vazhduan të shkruanin, si gjithmonë, për Nazmi bej Topin, duke e damkosur me vulën e tradhtisë. Por, ai jetoi akoma për disa kohë me një farë shprese të vagëlluar, se Lumta Gjinari do të bëhej me të. Po të mos u vinin në ndihmë miqtë e jashtëm, po të humbitnin të gjitha shpresat për të marrë pushtetin në duar, atëherë ai, duke pasur edhe ndihmën e Lumtës, do të merrej seriozisht për të gjetur rrugët e shpëtimit, duke krijuar situata të tjera kompromisi me komunistët.

Një ditë vendosi të bisedonte përfundimisht me Lumtën. E thirri në zyrë dhe bëri të gjitha përpjekjet për t'u treguar i qetë, si njeri që e ka gjendjen në dorë. Qazimit i tha t'i hiqte prangat nga duart dhe e urdhëroi të largohej.

Me të mbetur vetëm me Lumtën, Nazmiut, si zakonisht, iu ngaterruan mendimet dhe një copë herë në dhomë u dëgjua vetëm tiktaku i sahatit të murit. Ai ishte dobësuar mjaft që nga takimi i fundit. Sytë e kaltër e të mëdhenj i qenë skuqur e thelluar, faket i qenë mpirë dhe gjithçka tjetër tek ai dëshmonte për një jetë të shqetësuar e të pasigurt. Që përtej lëkurës së hollë e

pak tē zverdhur tē ballit lävronte një trishtim i pashë-rueshëm.

Lumta u bind se ai e kishte humbur toruan. Një-farë dëshire e nxiste pér ta ngacmuar e pér ta vënë në lojë. Por mendimet iu ndërprenë nga zëri i tij i rëndë.

— Deri kur do tē vazhdosh tē ecësh në këtë rrugë?

— S'të pëlqen rruga ime?

— Jo!

— Të duket e shtrembër?

— Pak më intereson në është e shtrembër apo e drejtë.

— Ty tē duhet rruga e shpëtimit!

Nazmi bej Topi heshti një hop. Lumta ia kishte kapur në fluturim mendimet.

— Besomë, tē dua shumë.

Lumta heshti.

— Ti do tē jesh gruaja ime. Të tjerët do t'i vras tē gjithë, — tha ai.

— Çfarë poshtërsi!

— Pse poshtërsi?... Ky është singeritet. Mos pandeh se do t'ua lë kokën mbi supe gjithë atyre rrëngallave që ti i quan shokët e tu!...

Nazmiu heshti. Padashur ai kishte folur ato që ndiente, gjëra që s'duhej t'i fliste.

Erdhi fundi, duhet tē zgjedhësh! — nguli këmbë ai.

— Çfarë tē zgjedh?

Vështrimi i syve tē zinj tē Lumtës dukej i patundur. Këtë e kuptoi Nazmi bej Topi, prandaj dalngadalë ai e humbi qetësinë falso tē minutave tē para dhe sytë e kaltër filluan t'i kapsalliteshin nga nervozizmi.

— Po sikur çështja tē shtrohet... — Heshti një çast, si pér tē përmbledhur fjalët e nevojshme. — Midis vdekjes dhe meje, cilin do tē zgjidhje?

— Vdekjen!

— Me litar! Mos harro, me litar!

— Po, me litar! — tha Lumta.

Nazmi bej Topi i ra tavolinës me grusht.

— Qazim! — klithi ai. — Vëri prangat dhe mbylle në bodrum!

Tek e përcillte për në bodrum, Qazimi, që i kishte përgjuar pas derës, jepte e merrte me vete i habitur: «Jo, xhanëm! Se mos u bë aq budallaçkë kjo sa të japë edhe jetën! Ç'ka rënë keq e shkreta. E paska të madh merakun me atë tjetrin, por s'ka ç'bën, beun do të zgjedhë!»

Kaluan ditë dhe Qazimi e kupto se goca e mësuesit s'kishte ndër mend të tallej me fjalët që tha. Dhe që kur u bind se çdo përpjekje nga ana e tij për t'i pajtuar ishte e kotë, dalngadalë Qazimit i kaloi shqetësimi i ditëve të para. Në shpirtin e tij tekanjoz u end përsëri qetësia e mëparshme, kuptimi i së cilës kufizohej vetëm në planet e ditës. Mëngjesi afronte çastin kur nga feneri i vogël do të gurgullonte lehtë-lehtë në grykën e fa-qores uji i bekuar, kur flegrat e hundës do t'i hapeshin nga avujt e pilafit me mëlçiçka dhe, çka ishte më e rëndësishme, në mbrëmje, kockat e tij do të preheshin në dyshekun e butë të Saibe hanëmit. Por, megjithatë, duke parë zemërimin e Nazmi beut, ai vazhdonte t'i lutej:

— Prit, bej. Tashti do t'i kthehet mendja gocës, veç prit. Durim. Mos u bëj si gjermani.

Por Nazmi beu ia kthente me të egër:

— Mos kërkon që Petrit Guraj të sulmojë kalanë e ta çlirojë fare?

«E humbi toruan beu. I ka hyrë frika!» — mendonte Qazimi.

Që nga minuta kur Nazmi beu i hoqi të gjitha shpresat për ta bërë Lumtën për vete, ai zuri të jetonte nën shtypjen e dy ndjenjave të kundërtë: dashuri dhe urrejtje. Ai ishte rob dhe njëkohësisht xhelat i saj. Nazmi beu e kupto se vetëm tani po linte mënjanë ndjenjat intime dhe po zinte vendin që i kishte caktuar oxhaku. Ai e pérçmoi dhe e mallkoi veten për ato çaste kur humbi arsyen dhe u lëshua në thonjtë e epshit. Por ja, më në fund, erdhi koha për të flakur çdo pengesë. Së shpejti do të fillonin përleshje të mëdha, ku do të vendo-

sej fati i tij, fati i Ballit, fati i Shqipërisë. Me këto mendime mori vendim të prerë të çlrohej një orë e më parë nga Lumtë Gjinari.

Në ballafaqimin e fundit, Lumta, si të kishte hyrë në mendimet e tij, ia preu shkurt:

— Mjaft më! Erdhi koha të marrë fund kjo lojë.

— Në ç'mënyrë?

— Duke u çliruar nga njëri-tjetri.

— Nganjëherë më bëhet sikur kam rënë në pëlhu-rën e merimangës. Megjithëse dua, nuk çlirohem dot, — tha Nazmiu dhe kafshoi gjuhën nga inati për këto fjalë. Në të vërtetë, sa herë ndodhej para saj, vendimet që kishte marrë i dukeshin të padrejta, dhe padashur zbutej e tërhiqeji.

— Nuk është pëlhura e merimangës ajo që të bën të lëkundesh.

— Po ç'është atëherë?

— Frika. Të ka hyrë frika.

— Nga cili?

— Nga unë!

Nazmi bez Topin nuk e turbulloi aq vendosmëria e atyre fjalëve, sesa gjakftohtësia e shpotia me të cilën ajo fliste.

Doli nga komanda e rinisë balliste dhe mori rrugën e gestapos me bindjen se në burg, pranë zyrës së vet, ai kishte mbajtur një nga armiqjtë më të tërbuar të asaj shoqërie, pa të cilën jeta dhe dashuria e tij s'kishin asnje kuptim.

— Po ti, ç'do që më vjen prapa? — iu kthye Qazimit, që e ndiqte si hije.

— Bej, vetëm me gjermanët mos e përziej punën!

Nazmiu do t'ia kishte prishur keq, po të mos notonte vetë në mes lëkundjeve e dyshimeve.

— Mos i fut hundët në punët zyrtare!

— Ç'është kjo pikë e zezë që më gjeti mua? Erdha nga fshati sagllam' e i pastër e më të rashë, o bej, bulldum në punët zyrtare!

Kështu, një ditë, mbi emrin e Lumtë Gjinarit u vendos kryqi i major Francit.

\* \* \*

— Shoqja zonjushe, ngrihu! — i përsëriti Qazimi me të butë.

— Tani ngrihem! — tha Lumtë Gjinari e përgjumur. Ngadalë e pa u ngutur, hodhi prapa kurrizit gërsheetat, mblodhi para gjoksit çipat e bluzës dhe, si e lutuar, diç kërkoi me sy në gjysmerrësirën e dhomës. Ah, po! Sot ajo do të vishej me kostumin e ri e do të mbathte sandalet e kuqe. Po përse e kishin zgjuar kaq vonë? Lumta pat lexuar nëpër libra dhe pat dëgjuar nga i ati, se të dënuarit me vdekje i zgjonin me natë dhe i ekzekutonin pa aguar. U kreh, lidhi gërsheetat, mbathi sandalet, veshi kostumin e ri dhe doli pas Qazimit.

— Shoqja zonjushe! — Ai deshi ta këshillonte që të vishej me të vjetra, se vetëm ashtu «mund ta mëllengjente e ta zbuste zemrën e egërsuar, por gjithmonë të mirë të Nazmi beut.» Por nuk i tha dot asnje fjalë. E përse të fliste? Fundi i fundit kujt t'ia thoshte? A s'ishte i huaj ai, qoftë për komunistët, qoftë për ballistët? Punët e tyre le t'i zgjidhnin vetë ata, shoqja zonjushe dhe beu i Elbasanit.

Lumtën e nisën për në oborrin e burgut të madh në të zbardhur. Freskia e ditëve të para të nëntorit, retë e ulëta dhe mjegulla e hirtë përbëti çatitë të futnin në zemër atë ndjenjë kur e shikon veten të nënshtruar e të pafuqishëm para fenomeneve të natyrës, që paralajmërojnë stuhi të pashmangshme. Diku, andej poshtë, Shkumbini uturinte.

Vështrimi i butë i Qazimit dukej sikur donte ta paralajmëronte Lumtën për rrezikun e vërtetë që e priste këtë mëngjes. Kurse Nazmi beun ai e shikonte me një përulje të zemëruar, si për ta porositur: «Bej, ç'bëre, bej! Matu mirë!» Por qëndrimi i heshtur i Nazmi beut s'jepte asnje shpresë. Asgjë s'do të ndryshohej nga vendimi që ishte marrë. Megjithatë, Qazimi më sé një herë mbylli sytë dhe mendoi se mos ndoshta të gjitha ato që

po ndodhnin rrreth tij s'ishin tjetër veçse një ëndërr, ëndërr e kotë. Por trokitjet e çapeve të rënda mbi kall-drem të skuadrës esese i kujtuan përfundimisht se ishte afuar minuta, kur për herë të parë në jetë ai po sho-qéronte një vajzë drejt vdekjes... Ajo që do të ndodhët më vonë ishte e tmerrshme dhe e panjohur për Qazimin.

Dalngadalë, drita e mëngjesit shpërndau mjegullën dhe në qiel mabetën vetëm retë e trazuara e të ulëta plot me vetëtima. Diku larg, si nga Malet e Shqipes, ushtonin batare topash.

Kur u futën në rrugën ku ajo pat shkuar çdo ditë në shkollë, Lumtën e pushtoi një dëshirë e thjeshtë: të ulej pak mbi gurin e njobur të portës së shkollës sa përt'u çlodhur e për të mbledhur në qetësi mendimet. Në rrugicën e fundit të burgut, para syve të Lumtës zuri të vërtitej fantazma e vdekjes. Me bindjen e njeriut që ka humbur të gjitha shpresat përt'ia nisur edhe një herë nga fillimi, e shtyrë nga ajo fuqi që arrin në zemër vetëm pasi të jenë imposhtur të gjitha tmerret, Lumta ngriti kokën dhe shpejtoi hapat për të shkuar drejt fundit të pashmangshëm.

... Duke menduar kështu, me shpirt disi të lehtësuar, padashur ajo kërkoi çlodhje në përfytyrimet e së ardhmes... Dhe ja, befas, u gjend në shtëpinë e vogël, e rrrethuar nga shoqet e saj.

Dita e fundit e vashërisë! Ditë e paharruar! Vello, këpucë me takë të larta, të kuq 'buzësh etj.

Vasil Gjinari e ngriti i pari gotën. Por Petriti, në vend që të pinte në heshtje, si gjithë dhëndurët, buzëqeshi dhe, si pa të keq, i shkeli syrin nuses. Lumta ngriti kokën dhe... ai dhe ajo u përqafuan dhe u puthën.

Krushqit u ngriten. Vasili e përçolli deri te porta. Në çastin e ndarjes, Lumta vuri re se sytë e të atit u lagën nga lotët. Ajo u mat t'i thoshte se s'do ta harrontë kurrë, se do të vinte shpesh tek ai, bile po të qe e mundur, edhe atë ditë. Po a mund t'i thoshte këto fjalë të atit në mes të krushqve? E puthi në heshtje dhe kaptoi pragun e portës.

Nä shtepinë e re të Petritit, nusen e priten shumë njerëz. Nënë Dana e mori për dore.

— Kaloje pragun! — i tha. — Futu brenda.  
— Kaloje!

— Kaloje pragun e burgut! — dëgjoi ajo për herë të tretë zérin e ashpër të një ballisti.

Vetëm pas kësaj britme, Lumta erdhi në vete dhe në vend të krushqve, sytë e saj panë përreth fytyrat e ushtareve, të vrenjtura e të heshtura nën helmetat e hekurta. Ajo pa Nazmi bej Topin dhe major Francin që rrinin përballë saj. Dhe pas tyre njozu fytyrat e shokëve që ishin reshtuar prapa hekurave të burgut. Lumta qëndroi një hop, pastaj eci përmes radhëve të esesëve dhe ballistëve, drejt trekëmbëshit. Aty ajo dëgjoi shokët që misën të këndonin «Internacionalen».

Nazmi bej Topi u hodh përparrë. Qazimi, në vend që t'i shkonte prapa, u zmbraps ngadalë, por me vendosmëri drejt portës së burgut, si i shtyrë nga ushtima e këngës:

*Ngrihuni ju, o të munduar,  
ju t'urët, skllevër anembanë.  
Na buçet gjaku i turbulluar,  
s'duam padronë, as tiranë!*

Rreshtat e esesëve lëvizën, por kësaj radhe major Franci nuk shpejtoi të jepte urdhrit. Kur u dëgjua në mes të korit zëri i lartë dhe i kulluar i Bardhylit, ai ngriti kokën dhe shikoi me butësinë e tij të djallëzuar, ashtu siç pat shikuar edhe qytetin nga maja e Kërrabës këtu e shtatë javë më parë. Atë ditë ai pat bindje se ky qytet i vogël dhe shtrembaluq do të gjunjëzohej menjëherë para tij, por sot, duke shikuar jo me dylbi, por së afërmi, ai ndoshta u bind... dhe bindjet, cilatdo që të ishin, gjithmonë e qetësonin major Francin... Atij i kujtohej mirë cili ishte ai djalosh që po ia hidhte këngës përmbi gjithë të tjerët.

... Dy javë më parë, të nesërmën e arrestimit, më rastin e ardhjes së major Francit, të burgosurit i rrë-

shtuan në oborr. Majori e kishte zakon t'i shikonte të burgosurit nga poshtë-lart, domethënë nga këmbët deri te flokët. Por, kur qe përballë Bardhylit, dhe pikërisht në kohën kur vështrimi i tij u ngul në flokët e verdhë e të butë si mëndafshi, Bardhylit iu krojt koka. Megjithëse në ballin e gjerë të majorit rrudhat u bënë të thella, megjithëse shoku që kishte pranë i ra me bërryl, prapëserapë Bardhyli vazhdoi ta kruante kokën, bile nga kënaqësia mbylli edhe sytë... Kur i hapi, majori e kishte zënë bishtin e rreshtit. Atë ditë, me t'i futur brenda të burgosurit, Bardhylin e thirrën në drejtori. Pas pak, ai qe kthyer shëndoshë e mirë te shokët, por me kokë të qethur toç. Me këtë dénim major Franci deshi ta tregonte veten si pedagog të hollë e të kulturuar, si përfaqësues të denjë të asaj fuqie, që luftonte për vendosjen e «Rendit të Ri» në Evropë. Flokët e Eardhylit qenë viktima e parë, që në vend të keqardhjes, shkaktuan të qeshura... Po kur e njëjta skenë u përsërit edhe ditën e dytë, atëherë major Franci urdhëroi që guximtari të vihej çdo mëngjes në korentin e elektrikut. Më se dhjetë ditë ai tundej nga korenti, rrëzohej pa frysë dhe jo vetëm që s'e kishte lënë fuqia, por as zëri...

Ndërsa aty pranë jehonte kënga e «Internacionales», major Franci dha shenjën që të merrete fund sa më shpejt kjo shfaqje e padëshiruar. Ai u largua nga burgu me çap të ngadalshëm dhe, ndoshta, në ballin e tij të vrenjtur po endeshin plane të reja për këtë vend. Nëse s'bëhej çiflig, atëherë le të bëhej kasaphanë...

I gozhduar nga fjalët e këngës, Nazmi bij Topi e zbrazi revolen disa herë. Ai kërceu përpara, por befas qëndroi dhe u step: vendin e Bardhylit e kishte zënë Refik kafexhiu.

— Edhe ti?!

— Po, o bij, edhe unë!

U shikuani sy ndër sy dhe si njeriu që heq dorë para kohe nga beteja, Nazmi beu u zmbraps, uli dorën dhe i ktheu shpinën, duke hequr këmbët zvarrë.

Sakaq, njëri nga esesët e shtyu arkën ku qëndronte Lumta. Në fillim trupi i saj u drodh, pastaj sikur u që-tësua, u shtriq dhe qepallat e zverdhura iu mbyllën. Nga këmbët që i përpëliteshin për të çikur tokën, i ranë sandalet e kuqe, të cilat pas një kolovitjeje të vogël mbi takat e larta, u përmbyssën mbi njëra-tjetrën.

Në oborr vërshuan forca të reja, por që nga prapa hekurave, të burgosurit nuk e ndërprenë këngën:

*Eshtë lufta finale,  
Vendimtare mbi dhe.  
Internationale  
Do jetë bot' e re!*

\* \* \*

I ndjekur nga ushtima e këngës, Nazmi bez Topi doli nga burgu me çehre të vdekuri. Qielli sterrë, vetëtimat që shtriheshin deri në tokë, shtëllungat e pluhurit dhe të gjetheve të thata paralajmëronin rrebesha, nga ato rrebeshe që ndodhin vetëm në muajt e vjeshtës. Njerëzit shpejtonin për të mbaruar punët. Vetëm Nazmi bez Topi ecet ngadalë e kokulur, si të qe duke numëruar ushtimat e topave në Malet e Shqipes.

Në mes të qytetit, nën rrapin e Bezistanit, një njeri i shkalafitur, këmbëzbathur dhe i parruar, i zuri rrugën duke i vërtitur gishtin tregues para syve:

— Unë e vrava tim bir?!

Nazmi beu u zmbraps me dorën në këllëfin e revolles. Por këtu, Qazimi, që s'dihet nga doli, i erdhi në ndihmë:

— Bej, vazhdo rrugën. S'e ditke zotrote? Ai është çmendur!

I shushatur nga kjo e papritur, i mpirë nga toni i Qazimit që i tingëlloi si urdhër, Nazmi beu eci, duke dëgjuar nga larg thirrjen e Demir Tapisë:

— Unë e vrava tim bir?

— Bej, — i foli Qazimi prapa shpinës, — s'para më pëlqejnë sot punët. Shkojmë në shtëpi. Ja dhe flamuri! Nazmi beu qëndroi në vend. Në majën e selvisë së njohur, nën qielin e errët, skuqte një flamur i madh me yll.

— Bej! U pa kjo punë. S'i dilet me plumb e më litar. Merre me mend që edhe Refik kafexhiu u bë me Partinë!

— Fukarenjtë si ai me Partinë janë. Po ti, ku ishe? — e pyeti me inat Nazmi beu, si për të mposhtur frikën që i shkaktonte flamuri atje lart.

— Shkojmë në shtëpi! — i tha për herë të dytë Qazimi.

— Ku ishe? — i briti më fort.

— Atje, bej... Karemanc bej Cërla dhe Alush Leshi sapo u kthyen nga fshatrat. Kapidan Xhafer Palën e sollën copa-copa brenda në thes. E kishin qëlluar në kokë me sharapnel. Ja, kështu më tha një shoq; partizanët i kishin vënë përpëra si dhentë. Disa ballistë qenë hëdhur matanë me dashje.

Nazmi beu e dëgjoi pa e bërë veten. Me vështrim të ngulur te flamuri, mori rrugën drejt Namazgjasë me çap të shpejtuar.

Në fillim ia nisën vetëm disa pikë të rralla e të më-dha, pastaj rrodhën qiejt, duke lëshuar shi e breshër bashkë.

— Bej, unë s'të hipni në selvi. Kam frikë ta prek me dorë flamurin e komunistëve. Po të ijetë kështu, më mirë më thuaj të kthehem në fshat me këmbët e mia, sesa të më shpijen kufomë pa shpirt. — Zërin e dridhur, por të vendosur të Qazimit e mbyti gjëmimi i fortë i një bu-bullime dhe që nga ajo kohë, ai s'foli më.

Te porta e Namazgjasë Qazimi qëndroi i tmerruar. Uji i rridhëte çurg nga flokët, nga hunda, nga mjekra. Hoqi pushkën nga supi, e mbështeti pas murit dhe tha:

— Bej, deri këtu më pate!

— Futu, qen i pabesë!

— S'jam i pabesë, po s'e marr vesh ç'na duhen gjithë këto që po bëjmë!

— **Futu!**

— Unë, o bej, s'të futem në Namazgja. Në shtëpi s'të shkel më. Pushkën s'ta hedh më në krah. S'jam as me ty, as me partizanët.

Nazmiu e mbërtheu dhe e përplasi përtokë. Qazimi u rrrokullis në vijën e ujit që gurgullonte turbulluar aty pranë dhe duke u mbajtur me zor nëpër shtratin e saj, mezi nxori kokën jashtë për t'u mbushur me frysë.

— Aman, bej! — klithi, kur pa Nazmiun t'i afrohej me revole në dorë.

— **Qen!**

Gryka e revoles iu mbështet në ballë.

— Aman, bej, në paç të drejtë. u bëfsh mbret. Kur se unë s'dua më asgjë, do kthehem përsëri në fshat e të mbledh mendjen pas bishtit të parmandës.

Qazimi u zvarrit nëpër baltë, pushtoi këmbët e Nazmi beut dhe zuri t'ia puthte:

— Mos më vra, sejeta qenka e dhembshur!

Beu shtiu. Shtiu një herë, dy, tri. Krismat dëgjoeshin të mbytura, stuhia i rrëmbente, i shpërndante dhe i shuanë menjëherë. Ai shtiu përsëri, por sa herë që e zbraste, instiktivisht e drejtonte grykën e revoles drejtreve të zeza, si të shfrynte inatin kundër tyre. Kështu, në këtë valë egërsimi dhe dëshpërimi, Nazmi Topi e mbajti veten dhe e mëshiroi atë që vazhdonte t'i puthte këmbët. Më në fund, e zuri Qazimin për gjoksi dhe gjysmë të alivanosur e hodhi në mes të rrymës së shkumëzuar.

— **Ik! Ik! Ik!** Qen i pabesë! **Ik!** — i thirri sa mundi.

Ndërsa po qëndronte i gozhduar në vend, Nazmi Topi ndjeu një turbullirë të madhe, atë turbullirë të njojur që ia vagëllonte mendimet. Shikoi një copë herë Qazimin që vravonte atje përtej. Veshët i bucitën nga fjalët e «Internacionales». Pastaj iu kujtuan Kareman bej Cërla me Alush Leshin, që ishin kthyer të mundur, me Xhafer Palën në thes. Kapsalliti sytë, gishti i Demir Tapisë: «Unë e vrava tim bir?» Gjëmimet e topave në Malet e Shqipes. Dhe ja: Lumta. Sandalet e kuqe, që ranë në tokë. Përpëlitjet e fundit të trupit të saj. Dhe përsëri

**Qazimi tek vràponte. «Internacionalja»... Vështrimi iu e-rrësua dhe Nazmi beu pati përshtypjen se trupi i tij u tret bashkë me stuhinë, me qiellin sterrë, me breshrin kokërrmadh që binte pa pushim...**

Zgjati duart në drejtim të flamurit që skuqte majë selvisë. Nuk e arriti dot. U ngrit edhe pak, por përsëri nuk e arriti. «Ah, ah!» — rënko nga inati. E ç'të shikonte? Ai ndodhej aty poshtë në tokë, i vogël, i lagur, i dërrmuar nga breshri, kurse para tij ngrihej tërë ajo selvi me majën në re. Dhe ai kishte zgjatur duart për të kapur flamurin që valavitej në qiell!

Ngadalë e me vendosmëri nxori revolen nga këllëfi, ngriti dorën dhe shënoi drejt flamurit. Por nuk shtiù. E uli revolen dhe pa e kuptuar as vetë, e mbështeti grykën e saj në mes të ballit. Shikoi rrtheqark, por gjëkundi nuk i zuri syri njeri. Hodhi vështrimin lart. Në qiell ulërinte stuhia. Retë trazoheshin. Majat e selvive përkuleshin. Një vetëtimë. Një bubullimë. Topat gjëmonin larg. Edhe një bubullimë. Prapë topat. Flamuri.

— Ah, ah! — rënko përsëri Nazmi Topi dhe, pasi mbështeti gishtin në këmbëzën e revoles, shikoi me zemërim flamurin që skuqte e valavitej atje lart.

Jo, më parë duhej mposhtur flamuri. E futi revolen në këllëf dhe vrapi. Me të kapërcyer murin e Namazgjasë, ndjeu një si farë qetësie. Në mes të selvive të larta e aq të njobura të atij sheshi, sikur iu kthye për një çast lumturia e dikurshme, lumturia e ditëve të fëmijërisë, lumturia e kujtimeve që i kishin lënë mbresa të thella. Dhjetë vjet më parë, mu këtu mbì këtë gur të bardhë qe ulur Lumta dhe e mbante për krahu:

«Mos, Nazmi, mos të thonë, — i lutej ajo. — Ç'të duhet që t'i ngjitesh selvisë?»

Tani atij i dukej sikur s'po ngjitej vetëm për të ulur flamurin, por për të shprehur edhe një herë dashurinë ndaj asaj që s'jetonte më...

Megjithëse duart i dridheshin, këmbët i rrëshqitnin pas degëve të lagura. Nazmi bej Topi u ngjit pa u çlodhur derisa i doli në majë. Dhe në atë majë të pabesë, ku

stuhia mund ta rrokulliste nga casti në çast, sytë e tij panë turmën e fëmijëve atje poshtë, Lumtën e trishtuar, degën e thyer të selvisë, ndërsa pranë vetes ndjeu Petritin dhe Qamilin tek valavitnin bashkarisht këmishët e tyre. Por jo, sot, duke u lëkundur në majën e hollë të selvisë, ai u bind përsëri se ishte armik i betuar për jetë i atij flamuri, që i rrëmbet vajzën e që do t'i rrëmbente tokën, pasurinë, të ardhmen dhe lumturinë. I rraskapitur, i rënduar nga rrobat e lagura, me sytë që i nxirrin xixa nga rrahhja e pandërprerë e breshrit, Nazmi Topi hyri në betejë me flamurin valavitës. Mbase stuhia do ta kishte fshirë me kohë, po të mos e mbante të lidhur në atë majë që jepej si hark, dëshira për ta fituar me çdo kusht betejën e fundit. Edhe pak... Edhe pak... Në këtë gjendje të pashpresë Nazmi Topi mendoi se qielli mund të ishte aq i paanshëm, sa të merrete me vete edhe trupin e tij për ta ngjitur atje, dhe, në rast se do ta lëshonte poshtë, s'ka gjë, ai do të kthehej përsëri mbi tokë, por do të kthehej po kaq i fortë dhe i bindur dhe armiqtë, cilëtdo që të ishin, do të dridheshin përpara idealit të tij... Me sytë e veshur mblodhi fuqitë e fundit dhe, pa e bërë të gjatë, u hodh drejt flamurit... Një freski therëse i mbësh-tolli trupin, një e ngjethur e fortë e dehu qenien e tij që po fluturonte diku në një drejtim të panjohur. Kur veshtët i fishkellyen dhe trupi zuri t'i binte poshtë, ai zgur-dulloi sytë, duke u qepur pas bisqeve të holla të selvisë. Por më kot. Ishte vonë. Me vetëdijë të plotë, Nazmi bij Topi ndjeu t'i thyhej trupi më dysh, t'i çahet gjoksi e t'i thërrmoheshin kockat...

Poshtë në tokë, pranë gurit të bardhë, hapi sytë që të shikonte për të fundit herë flamurin e mposhtur, por duart e tij shtrëngonin vetëm një bisk të thatë selvie, ndërsa atje lart, qielli skuqte si më parë. Mbylli qepallat, shtrëngoi nofullat dëhe nxori frymën e fundit, duke shkuar buzëplasur për betejën që humbi.

## NJË THIRRJE NËPER NATË

Grupi i vogël doli nga rrugicat e errëta dhe u fut përmes arave. Printe nënë Dana me Petritin, pas saj ecnin Vasil Gjinari, Rifat muraxhiu dhe çunaku që nxori Markun nga rrëthimi ca ditë më parë.

Nata ishte e errët, me yje të pakta. Disa topa gjëmonin në malet e largëta. Ushtimat përplaseshin faqeve dhe përsëri gjëmimë të tjera.

Bari qe freskuar nga shirat dhe aroma e tij, e përzier me erën e tokës së zbrujtur, në netët me lagështirë vjen e bëhet e rëndë, por gjithmonë e këndshme. Të pesë udhëtarët ecnin në heshtje, duke shkelur në gjurmët e njëri-tjetrit, si t'u vinte keq për gjelbërimin e fundit vjeshtak.

Nga kodra e vogël u dukën për herë të fundit çatitë e ulëta të qytetit me rrugët e ngushta e të shtrembra, me kopshtet, me minaretë e selvitë e gjata. Lumi uturinte. Dhe ja, nën këmbët e kodrës doli një botë tjetër, një botë e veçantë: varrezat. Por ata nuk qëndruan. As Vasil Gjinari, as të tjerët nuk e dinin varrin e Lumtës e të Dine Çelikut.

Nën dritën e zbehtë të një qiriu, mbi pllakën e mermertë të një varri, zoti Vasil shikoi fotografinë e një vajze të re. Mbishkrimi:

«Homines sunt viagiatores in terra!»<sup>1)</sup>  
Pleq e tē rinq i kthyen shpinën qytetit dhe iu ngji-  
tēn tē përpjetave tē para. Diku larg u dëgjua një thirrje:  
— E-he-he-e-e!  
— Tanët!

Pasi bënë ca rrugë thirrja u përsërit. Atëherë Petriti,  
Rifati dhe çunaku iu përgjigjën tē tre së bashku. Ushtima  
e zërit tē tyre mbuloi gjëmimin e topave, uturimën  
e lumit:

— E-he-e-e-e!

## — FUND —

Viti 1954-1958.

---

1) Lat. — Njerëzit janë udhëtarë mbi tokë,

